



Shkodër / 2021

**TITULLI ORIGINAL**  
**ÖYLE BIR RAHMET KI**

**PËRKTHEU**  
I lir Hoxha

**REDAKTOI**  
Alban Kali

**FAQSJA**  
Bledar Xama

**BOTIMI I**  
Prill 2021, Shkodër

**PROGRESI BOTIME**  
Sheshi "2 Prilli", Rr: Studenti  
Shkodër, Shqipëri  
Mob: +355 67 340 6182

# *Lulishtja e Zemrave*

Osman Nuri Topbash



# PARATHËNIE

*Falënderimet e panumërta i takojnë Zotit tonë, Atij që na trajton miqësisht, mirësisht dhe plot mëshirë, që na fal gjynahet dhe gabimet dhe që është me i Mëshirshmi i të mëshirshmëve.*

*Salavate dhe selame i dërgojmë profetit Muhamed ﷺ, mëshirës së të gjitha botërave që nga ezeli<sup>1</sup> e deri në pafundësi, shpëtuesit, shëruesit, sihariqdhënësit dhe ndërmjetësuesit të njerëzimit.*

Çdo gjë që ndodhet në univers fiton qenie, bukuri dhe vlerë nga dashuria dhe mëshira e Tij. Allahu ﷻ vazhdimisht i trajton njerëzit me mëshirë. Në sajë të kësaj mëshire jobesimtarët marrin frymë dhe begati. Me githë këto padrejtësi, trazira dhe kryengritje (rebelizma), kjo botë qëndron në këmbë falë mëshirës së pafundme të Tij. Sepse mëshira e Zotit është më e madhe se dënimi i Tij, sepse Allahu ﷻ e do mëshirën dhe rahmetin. Aq, sa edhe më të nderuarin, profetin e fundit Muhamed ﷺ, e cilësoi si **rahmet**<sup>2</sup>.

Allahu ﷻ në Kuran thotë:

1. Koha e krijimit të shpirttrave.
2. Mëshirë



**“Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed), veçse si mëshirë për botët.”** (Enbija, 107)

Ajo është **“Një mëshirë e tillë”**, sa që njerëzimi mund ta arrijë shpëtimin dhe lumturinë vetëm në sajë të **“Kritereve të moralit të lartë të personalitetit të tij shembullor të pashoq”**...

Nisur nga kjo, të gjitha krijesat janë vazhdimisht në borxh falënderimi ndaj tij. Prandaj edhe detyra jonë ndaj këtij borxhi është t'i dërgojmë salavate dhe të kultivojmë një dashuri të thellë ndaj tij dhe atyre që ai ka dashur. **“Dashuria ndaj Ehli Bejtit”** duhet të na e mbushë zemrën. Ne duhet ta konsiderojmë mirësi dashurinë si dhe përjetimin shpirtëror të atyre principeve jetësore që përcjellin tek ne Hulefai Rashidinët, si, kulmi i besnikërisë **“Ebu Bekri”**, simboli i drejtësisë **“Omeri”**, shembulli i devotshmërisë **“Osmani”** dhe dera e diturisë **“Aliu”** radijall-lahu anhum.

Sepse ato parime jete, e kanë shpëtuar njerëzimin nga barbarizmi, padrejtësia, si dhe nga shkatërrimi i pasosur, dhe kanë sjellë në jetë shekuj plot lumturi. Për **“Shoqërinë dhe Drejtuesit”**, të jetuarit larg këtyre parimeve do të thotë verbërim i moralit, drejtësisë, vërtetësisë si dhe diturisë. Sepse ne dimë që shoqëritë dhe drejtuesit mund t'i rezistojnë kohës vetëm duke u mbështetur në të vërtetën, dijen, moralin dhe **“Drejtësinë”**.

Rëndesa e kësaj **“Përgjegjësie”** me të cilën na ngarkon kjo e vërtetë, mund të bartet vetëm me **“Vetëdijen ndaj Amanetit”**. Për ta fituar (ose përftuar) një vetëdije të tillë duhet që të meditojmë pa ndërprerje. Por, këtë meditim nuk duhet ta realizojmë në vorbullën e nefsit/egos, por në një kontekst (mëshire) shpirtëror.

Në këtë pikë është e domosdoshme që mendja dhe zemra të mbruhen me edukimin shpirtëror të rrezatimeve Kuranore dhe gjithashtu që me një edukim shpirtëror të arrihet në nivelin e zemrës së pastër (kalb-i selim). Përkrah qëndrimit afër vepërmirë-



ve, për të arritur në këto grada të larta, një rëndësi të veçantë ka udhëzimi i mjeshtrove shpirtëror, të cilët përmbliohen në mënyrë të përsosur tek **“Rrezatime urtësie nga atmosfera shpirtërore e Mevlanës”**.

Ta jetosh jetën me një qetësi dhe lumturi të tillë shpirtërore, do të thotë ta jetosh atë në mesin e mëshirës dhe mirësisë... Në mesin e asaj mëshire, që është mëshirë për të gjitha botët ﷺ. Ai Profet mëshire na ka dhuruar parime që ta jetojmë jetën në çdo moment të saj, deri në frymën e fundit, me mirësinë: **“Edukimi i një jete shpirtërore: Muaji i Madhërueshëm i Ramazanit”**.

Në lëminë e këtyre parimeve ia vlen të ndalemi kryesisht në kujdesin që duhet shfaqur ndaj temës së **“Shpërdorimit”**, sepse në ditët tona, **“Shpërdorimi në Besim dhe Adhurime”**, **“Shpërdorimi në Kohë”**, **“Shpërdorimi në Dituri”**, **“Shpërdorimi në Vlerat e Moralit”**, **“Shpërdorimi në Meditim”**, **“Shpërdorimi në sigurimin e Jetesës”**, **“Shpërdorimi në Shëndet dhe në ngrënje-pirje”**, janë në kulmin e tyre. Në krye të këtyre shpërdorimeve, vjen padyshim **“Shpërdorimi i Njeriut”**, që përbën edhe vuajtjen dhe shqetësimin më të madh të kohës sonë.

Për këtë arsye besimtarët duhet ta ndjejnë (përjetojnë) këtë vuajtje dhe shqetësim thellë në shpirtin e tyre, dhe duhet të përpiqen që të edukojnë në atmosferën shpirtërore të Kuranit dhe Sunetit fëmijët e tyre të cilët u janë lënë amanet nga Krijuesi i gjithësisë, pra të ndikojnë në besimin e brezave të rinj. Kurrë nuk duhet të ndodhë që **“Për arsye boshe të shkelet kufiri ndërmjet Hallallit dhe Haramit”**.

Si përfundim, krahas parimeve që do të na sigurojnë Xhenetin si dhe një jetë të bereqetshme si ajo e Profetit ﷺ, nevojitet edhe një (vet)ndërgjegjësim shumë i fortë... Një shkundje e fuqishme që do të na sjellë në vete...! Kjo, sepse sot, kapitali po përdor individin, ndërkohë që individi duhet ta përdorë kapitalin. Dhurimi,

mëshira, dhembshuria dhe altruizmi duhet të jenë shenjat tona dalluese. Çdo frymë, gjendje dhe fjalë e jonë duhet të jetë mëshirë, siç ishte ajo e Profetit Muhamed ﷺ.

Kjo vepër modeste u shkrua për të udhëzuar të jetuarit me përpjekjen e realizimit të këtij qëllimi dhe gjithashtu me përpjekjen për t'u bërë sadopak shkak për hyrjen e të tjerëve në këtë rrugë. Temat që cekëm më sipër, jemi përpjekur t'i trajtojmë secilën në vete në formë artikulli. Këto artikuj janë botuar në revistën tonë Altinoluk dhe, gjatë procesit të përpilimit të një libri me to, u rimorën në dorë për të qenë sa më të kuptueshme e të dobishme për ju, të nderuar lexues.

**O Zoti im! Pranoji dhe bëji shkak mëshire qëllimet dhe përpjekjet tona të bukura në rrugën tënde, veprat tona të mira si dhe adhurimet që bëjmë për Ty!**

**O Zot! Na dhuro edhe ne një pjesë nga cilësitë e Profetit tonë Muhamed ﷺ që “është i butë e i mëshirshëm me besimtarët.”** (Tevbe, 128) **Na mundëso që të jetojmë në mëshirë dhe na përfshij në mëshirën Tënde!**

**Osman Nuri Topbash**





## NJË MËSHIRË E TILLË...



*Ruajtja e besimit, duke u pajisur me moralin profetik,  
është detyra jonë e falënderimit ndaj tij. Pas shprehjes  
së mirënjohjes ndaj Allahut, menjëherë ujen mirënjohja  
ndaj krenarisë së njerëzimit ﷻ.*





# NJË MËSHIRË E TILLË...

Allahu ﷻ e dërgoi Profetin ﷺ mëshirë për të gjithë botët.

Një mëshirë e tillë që, në raport me dashurinë ndaj tij, njeriu fiton vlerë tek Zoti.

Një mëshirë e tillë që, dhembshuria dhe zemërgjerësia e së cilës përfshin të gjithë njerëzimin, madje të gjitha krijesat.

Një mëshirë e tillë që, i sherben të gjitha mendjeve dhe zemrave, si eliksir përjetësie, si burim diturie, si perceptimi intuitiv... si një burim dashurie, urtësie, e diturie... dhe, një mëshirë e tillë që, u dhurua nga ana e Allahut ﷻ, si një burim i pashtershëm lumturie dhe begatie, me cilësitë më të veçanta.

Një mëshirë e tillë që, nëpërmjet tij u dhurua udhërrëfyesi i përjetshëm, Kurani Fisnik.

Një mëshirë e tillë që, e bëri atë të dashurin i Allahut ﷻ, Rrahman dhe Rrahim dhe iu fal mirësia e Miraxhit.

Një mëshirë e tillë që, pa të, botët do të shndërroheshin në shkretëtira të vdekura.

Një mëshirë e tillë që, vlerën dhe forcën e së cilës vetë Allahu ﷻ e shpjegon, duke i dërguar salat (përsëndetje, dua)...

Allahu ﷻ, duke i dërguar selame rezultatit të tij, na informon



për vlerat e pakrahasueshme të tij, vlerësim ky, që është mbi çdo lavdërim tjetër. Allahu ﷻ Vet bëhet shembull duke dërguar salate dhe selame drejt të dashurit të tij dhe na bën të ditur se, edhe melekët i dërgojnë salavate të dashurit të Tij. Prandaj, Ai urdhëron që edhe besimtarët t'i dërgojnë salavate Profetit ﷺ në të njëjtën mënyrë, sepse Allahu ﷻ na nderoi duke na bërë umetin e një profeti të tillë, në mesin e 124 mijë e më tepër profetëve të tjerë.

Kjo mirësi ndaj nesh, shpreh jo vetëm një privilegj për ne, por edhe një detyrim falënderimi dhe mirënjohjeje. Pra, grada e të qenit umeti i sulltanit të profetëve, është grada më e lartë ndër gradat e tjera por dhe përgjegjësia më e madhe ndër përgjegjësitë e tjera. Aq, sa Allahu ﷻ shprehet se, bindja ndaj Profetit ﷺ është bindje ndaj Tij, ndërsa rebelimi ndaj Profetit ﷺ është rebelim ndaj Tij.

Tek një besimtar, falënderimi dhe mirënjohja fillon duke e dashur Allahun ﷻ dhe Profetin ﷺ më shumë se çdo gjë tjetër, madje edhe më shumë se vetveten. Në këtë kontekst, dërgimi i salateve dhe selameve me gjithë shpirt saherë që përmendet emri i tij, të jetuarit me dashuri të zjarrtë ndaj Profetit Muhamed ﷺ duke u frymëzuar nga personaliteti i tij shembullor, duhet të jenë pjesë e karakterit dhe personalitetit tonë si besimtarë dhe, gjithashtu duhet të jenë formula të jetës dhe burime shpirtërore. Kjo, sepse në këtë botë ne kemi nevojë për udhëzimin e tij, që është bërë mëshirë për botët, ndërsa në botën tjetër, kemi nevojë për ndërmjetësimin e tij, që do të jetë mëshirë për të gjithë besimtarët.

Ajo me të cilën ne obligohemi, është të jetuarit së bashku me të në çdo gjëndje, çdo fjalë dhe çdo veprim, sepse **njeriu është së bashku me atë që do** dhe merr për model atë që do. E, në fakt,



njeriu është i prirë t'i ngajë atij që dashuron dhe respekton. Aq sa ne jemi të lidhur me dashuri e ashk, me sunetin e nderuar të Profetit ﷺ, aq e dashurojmë dhe e ndjejmë atë thellë në shpirtin tonë. Aq sa e njohim dhe e përmendim atë, aq i jemi afruar atij në shumë drejtime. Të njohim cilësitë e personalitetit të tij shembullor plot madhështi dhe virtyte, të shprehim bindje ndaj tij, të pajisemi me moralin e tij të lartë dhe ta njohim me zemër më shumë sesa me lexime, duhet të jetë ideali ynë më i madh.

I Dërguari i Allahut ﷺ, nuk mori mësim nga njerëzit, por u edukua aq mirë nga vetë Zoti i tij, sa që tek ai u shfaq morali më i lartë njerëzor. Ai u dërgua për të gjithë njerëzimin si përkthyes i botës së fshehtësisë dhe si mësues i shkollës së Zotit. Bukuritë e tij të brendshme janë aq të shumta, sa që nuk do t'i zinin dot as vëllime të tëra librash. Disa nga virtytet e personalitetit të tij shembullor e të pashoq janë:

### Dashuria e zjarrtë e Profetit për umetin e Tij

Mëshira dhe dhembshuria e Tij ndaj ummetit ishte më e madhe se ajo e nënës për fëmijën e saj. Në Kuran urdhërohet: **“Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët.”** (Teube, 128)

Njëra nga duatë plot mëshirë dhe dhembshuri që ai ka bërë për umetin e tij, na bëhet e ditur në këtë hadith:

Një ditë i Dërguari i Allahut ﷺ po përgjërohej duke qarë:

*“O Allah! Populli im, populli im!” dhe qau.*

*Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar urdhëroi:*



“O Xhebrail! Shko tek Muhamedi dhe pyete përse qan -Allahu e dinte-!”

Xhebraili erdhi tek Profeti ﷺ, i cili i tregoi për atë që kishite thënë. Në fakt, Allahu di më së miri gjithçka. (Pasi Xhebraili u kthye dhe e informoi) Allahu i Madhëruar urdhëroi:

“O Xhebrail! Shko tek Muhamedi dhe thuaji:

«Ne do të të kënaqim në lidhje me popullin tënd dhe kurrë nuk do të të hidhërojmë!» (Muslim, Iman, 346)



Një tjetër tablo që shpalos mëshirën e zotërisë sonë ndaj umetit të tij, transmetohet nga Abdullah ibn-i Mes'ud:

“I Dërguari i Allahut ﷺ, më tha:

«Lexomë Kuran!» Unë i thashë:

«A të të lexoj Kuran ndërkohë që ai të ka zbritur ty!?» Profeti ﷺ, tha:

«Mua më pëlqen ta dëgjoj Kuranin nga të tjerët.»

Unë i lexova atij suren Nisa derisa erdha tek ajeti: **«Si do të bëhet kur prej çdo populli të sjellin dëshmitarë dhe të të sjellin ty (o Muhamed!) për dëshmitar mbi të gjithë ata?!»**

[Nisa, 41.]

Profeti ﷺ, tha:

«Mjaft për tani!»

Kur u ktheva nga ai, i pashë sytë që po i rridhnin lot.” (Buhari, Tefsir, 4/9; Muslim, Musafirin, 247)

Kjo ndodhi përforcon faktin se Profeti ﷺ ishte i mëshirshëm dhe i dhembshur ndaj umetit të vet. Ditën e gjyqit të madh do të urdhërohet: **“Lexoje librin tënd! Ti mjafton sot si llogari-**



**tar kundër vetvetes!"** (Isra, 14), me ç' rast do të shfaqen të gjitha gjynahet e umetit. Në hadithin e mësipërm, Profetit tonë të dhembshur dhe zemërbutë iu kujtua pikërisht kjo pamje e ahiretit, e cila e përloti.



I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë:

*“(me këto ajete) Allahu ﷻ më shpalli dy sihariqe për umetin tim:*

**(1.) Por Allahu nuk do t'i ndëshkonte ata, përderisa ti ishe në mesin e tyre;**

**(2.) Allahu nuk do t'i ndëshkojë ata, përderisa ata i kërkojnë falje Atij.** (Enfal 33)

*Kur unë të ndahem prej tyre, do t'i lë ummetit tim istigfarin (kërkimin e faljes që është përgëzimi i dytë, i cili e ndalon ndëshkimin e Allahut) deri në Kiamet.”* (Tirmidhi, Tefsir, 8/3082)

Nuk duhet harruar se, nëse një besimtar arrin ta mbajë të ndezur në zemrën e tij dashurinë për Profetin Muhamed ﷺ, atëherë Allahu e ruan atë nga Xhehenemi, Ai nuk e hedh në zjarr një shpirt të mbushur me dashuri ndaj Profetit ﷺ.

Këto transmetime që përcollëm tek ju, janë vetëm disa nga shembujt e pafund që pasqyrojnë dashurinë, mëshirën dhe dhembshurinë e thellë që Profeti ﷺ kishte për umetin e vet. Detyra jonë ndaj dhembshurisë së thellë që zotëria ynë ka për umetin, pra për të gjithë ne, është kujdesi dhe kontrolli i vazhdueshëm ndaj të brendshmes sonë, për të matur nivelin e dashurisë që kulivojmë për të dashurin e Zotit, si dhe të nivelit të emocionit e dashurisë që ndiejmë për sunetin e tij, duke ecur në gjurmët e tij.



## Modestia e të Dërguarit të Allahut

Profecia e tij nuk mbartte dëshirën për të mbretëruar. Ai zgjodhi të ishte “Profet rob” dhe jo “Profet sundues”<sup>3</sup>. Interesohej për të dobëtit dhe të varfërit e umetit, përpiquej t’ia plotësonte nevojat atyre me mundësitë e veta, u bënte vend në mesxhid sahabëve të varfër dhe personalisht përpiquej t’i siguronte nevojat e tyre bazike.

Ai ishte shembull i pashoq në modesti. Shqetësimi i tij nuk ishte kurrë vetjak. Shqetësimi i tij, që shkonte deri në vetkonsu-  
mim, lidhej me udhëzimin e njerëzve në rrugën e drejtë, pra me lumturinë e tyre në këtë botë dhe në tjetrën.

Aisha رضي الله عنها, e shpjegon kështu mënyrën sesi Profeti صلى الله عليه وسلم e ndih-  
monte atë me një modesti të madhe:

“Babai im, pra familja e Ebu Bekrit, na dërgoi një natë këmbë deleje. i Dërguari i Allahut صلى الله عليه وسلم e mbajti mishin, e unë e preva -ose unë e mbajta e ai e preu-.”

Njëri nga dëgjuesit e pyeti:

“Këtë e bënit pa mjet ndriçues, në errësirë?”

Aishja رضي الله عنها iu përgjigj:



“Sikur të kishim aq vaj, do ta lyenim bukën e do ta hanim. Kalonte një muaj dhe familja e Muhamedit nuk gjente bukë të hante dhe nuk vihej tenxhere në oxhak.” (Ahmed, VI, 217)


## Bujaria e të Dërguarit të Allahut صلى الله عليه وسلم


Një ditë, një njeri erdhi tek Profeti صلى الله عليه وسلم dhe kërkoi prej tij diçka. I Dërguari i Allahut صلى الله عليه وسلم i tha:






“Nuk kam asgjë që mund të të jap, shko blej diçka në emrin tim (pra merri borxh), pasi të vijë malli, do ti paguaj”. Omeri , i cili nuk dëshironte që Profeti  të hynte në këtë siklet borxhi, i tha:

“O Resulullah! Nëse ke ia jep, e nëse jo, Allahu  nuk të ngarkon me përgjegjësi që s’mund ti bartësh.”


Nga fytyra e Profetit  kuptohej se fjalët e Omerit nuk i kishin pëlqyer. Njëri nga ensarët tha:

“Tu bëfshin kurban nëna dhe babai im o Resulullah! Jep! Mos ki frikë se ta pakëson Pronari i Arshit!”

Këto fjalë të këtij sahabi, që përforcuan dhe mbështeten dëshirën e Profetit , i pëlqyen shumë atij, prandaj buzëqeshi dhe tha:


“Edhe unë për këtë jam urdhëruar!” (Hejthemi, X, 242)




Kur vinte ndonjë nevojtar, Resulullahu , kërkonte diçka nga familjarët e tij. Por, kur informohej se nuk kishte asgjë tjetër përveç ujit, kthehej nga sahabët dhe kërkonte nga ata që t’ia plotësonin nevojat personit. Ai nuk gjente qetësi deri sa plotësoheshin nevojat e nevojtarit.

Një tjetër shembull shpjegohet nga Enesi :

“Profetit i erdhi mall nga Bahrejni. Ai urdhëroi:

«Hidheni në mesxhid!» Kjo ishte sasia më e madhe e mallit që i është prurë ndonjëherë Profetit , i cili pa e parë fare, shkoi të falte namazin. Pasi u fal, erdhi dhe qëndroi pranë mallit, duke i dhënë çdokujt që shihte pjesë prej tij... Ai nuk u largua prej aty pa e shpërndarë atë deri në dirhemin e fundit.” (Buhari, Salat, 42)

Gëzimi i besimtarëve, duke i ndihmuar për të përballuar nevojat, e mbushte me kënaqësi e qetësi të Dërguarin e Allahut .



Profeti ﷺ, ka thënë:

“Xhebraili më tha se Allahu ﷻ thotë:

«Kjo fe (pra Islami) është ajo të cilën e kam zgjedhur dhe prej së cilës jam i kënaqur. Asaj i ka hije **bujaria** dhe **morali i lartë**. Aq sa të jetoni si mysliman, lartësojeni atë me këto dy virtyte!» (Hejthemi, VIII, 20; Ali el-Muttaki, Kenz, VI, 392)

Parë nga ky aspekt, lartësimi i fesë dhe mbrojtja e besimit, duke u pajisur me moralin profetik, është detyra jonë e falënderimit ndaj tij. Pas shprehjes së mirënjohjes ndaj Allahut, menjëherë vjen mirënjohja ndaj Profetit ﷺ. Kjo mirënjohje është shprehja më e bukur e ndjesisë së falënderimit që i detyrohem atij Profeti besnik, i cili në duatë e tij na përfshinte të gjithë duke thënë “*umeti im, umeti im*”. Po ashtu ai priste kurban<sup>4</sup> edhe për ata pjesëtar të umetit të tij që se kishin këtë mundësi.

Kjo mirënjohje fillon me thellimin e dashurisë ndaj Profetit tonë dhe arrin përsosmërinë me shndërrimin e sunetit në një burim frymëzimi shpirtëror në jetën tonë.

Profeti Muhamed ﷺ, duke shprehur dashurinë e thellë ndaj vepërmirëve të umetit që do të mbruhen me këto ndjenja duke u bërë dashurues të flaktë të Profetit, ka thënë:

“Një pjesë e atyre që më duan mua, do të dalin më së shumti nga brezat që do të vijnë pas meje. Ata, do të dëshirojnë të sakrifikojnë pasuritë dhe familjet e tyre për të më parë mua.” (Muslim, Xhennet, 12)



Çuarja dëm të jetës për shkak të privimit nga këto të vërteta, buron nga kundërshtitë e egra që njeriu përjeton në botën e tij të



brendshme dhe të jashtme. Këto kundërshti, lindin prej faktit se tek njeriu ndodhet njeherësh edhe virtyti më i lartë që mund ta afrojë atë tek Krijuesi, pra takva-ja (frikë-respekti ndaj Allahut), por edhe e kundërta e kësaj, që e ul atë në një nivel edhe më poshtë se kafshët, pra fuxhur (gjynahu). Në Kuran urdhërohet:

**“(Betohem në Atë që) ia ka bërë të njohur atij të keqen e të mirën! Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë.”** (Shems 8-9)

Bota e brendshme e njerëzve, të cilët nuk janë edukuar me dritën e Kuranit dhe Sunetit, i përngjan një pylli që në brendësinë e tij strehon shumë lloje kafshësh, nga më e buta deri tek më e egra. Në secilin prej tyre fshihen cilësi kafshërore, sipas natyrës. Dikush ngjan si dhëlpër, dinak dhe hileqar; dikush tjetër si hienë, grabitqar; dikush si milingonë, është grumbullues lakmitar, e një tjetër si gjarpër helmues. Dikush të kafshon duke të përkëdhelur, dikush si ushunjëz të thith gjak, e dikush të buzëqesh ndër sy e pas krahëve ta bën të keqen. Këto që renditëm, janë të gjitha karakteristika kafshësh.

Një njeri i tillë, i cili nuk ka arritur ta shpëtojë veten nga robëria e egos (nepsit) nëpërmjet një edukimi shpirtëror, e për rrjedhojë nuk ia ka dalë të ndërtojë një karakter të shëndoshë, qëndron i zhytur në vorbullën e këtyre veseve të ulta. Ka njerëz tek të cilët dominon një karakteristikë e vetme e një kafshe, e ka të tjerë tek të cilët dominojnë disa karakteristika të tilla. Mbi të gjitha, për shkak se bota e tyre e brendshme reflektohet edhe në fizionominë dhe veprimet e tyre, në përgjithësi, njerëzit e kanë shumë të lehtë ta kuptojnë karakterin e tyre.

Sistemi i cili u ndërtua mbi gjakun e njëzet milion njerëzve, pra komunizmi, a nuk është reflektimi i një zemre gjakatare dhe grabitqare? Piramidat që ndërtoheshin për të fshehur trupin e



një Faraoni, që u bënë varret e sa sa njerëzve të gjallë, a nuk janë monumente të dhunës së egër?

Për shumë njerëz indiferentë, në një farë logjike, këto janë vepra madhështore që ngjallin mahnitje dhe admirim. Por, nëse do të vlerësoheshin objektivisht me syrin e së vërtetës, a nuk do të shpalosej para syve tanë një tablo që do të çudiste edhe kafshët më grabitqare?

Të gjitha këto tregojnë se, nëse në një shoqëri do të dominonin njerëzit me karakter bretkose, atëherë bota do të shndërrohej në një kënetë. Nëse njerëzit dominues të një shoqërie do të ishin shpirtgjarpër, do të helmohej i gjithë populli dhe do të shfaqej një gjendje terrori dhe anarshie. E nëse dominuesit apo sunduesit e shoqërisë do të ishin njerëz me natyrë trëndafil, të pajisur me mëshirë dhe dhembshuri, pra njerëzit me vlera shpirtërore, i gjithë vendi do të bëhej një trëndafilishte dhe shoqëria do të arrinte qetësinë dhe lumturinë e shumëkërkuar.

Të gjitha këto gjendje mund t'i pasqyrojmë me shumbuj të shumtë nga historia. Shembulli më i rëndësishëm dhe i pashoq në historinë e njerëzimit, që e ka shndërruar në një trëndafilishte kohën dhe vendin ku jetoi, është sultani i të gjithë Profetëve, Muhamedi ﷺ. Ai, i cili e kreu detyrën e tij të shpalljes gjatë njëzet e tre viteve, pra në një hark kohor kaq të shkurtër, me natyrën e tij më të trëndafilte se vetë trëndafil, e transformoi periudhën kohore dhe njerëzore në të cilën jetoi, në një trëndafilishte lumturie që nuk vyshket kurrë. Madje, ai edhe në vendet më të humbura që sot ndriçohen nga dielli i udhëzimit, bëri të qartë të vërtetën dhe mirësinë me të gjithë bukurinë e tyre, dhe gjithashtu nxorri në pah të keqen dhe të pavërtetën me të gjithë shëmtinë e tyre. U formësua vizioni më i bukur dhe më i saktë rreth Zotit, universit dhe nefsit. Njerëzit u vetëdijësuan për faktin se kjo botë është



një shkollë provimi. Ajo shoqëri analfabete dhe e paditur, u bë një shoqëri me **“dije të vërteta”**<sup>5</sup>. U zhvillua meditimimi. Njerëzit filluan të mendonin thellë mbi trupin e njeriut dhe prejardhjen e tij nga një pikë uji, mbi zogjtë që zhvillohen nga një vezë shumë e vogël, mbi pemët që marrin hov nga një bërthamë pothuajse e padukshme, e deri edhe mbi krijimin e qiejve e të tokës. Ky thellim u çeli njerëzve shumë dritare urtësie.

Si rezultat i edukimit profetik, mëshira, dhembshuria, sakrificë, ndjeshmëria dhe korrektësia e shpërndarjes së të vërtetës, arritën kulmin. Në qendër të miqësisë, u vendos Allahu ﷻ dhe i dashuri Tij, profeti Muhamed ﷺ. Jeta filloi të lëvizte në shinat e pëlqimit të Allahut ﷻ. Zemrat e të gjithëve u mbushën me emocionet e mendimit: **“Çfarë kërkon Allahu nga ne dhe si dëshiron të na shohë i Dërguari i Tij?”**. Netët u shndërruan në ditë e dimërat në pranverë. Ajo periudhë e historisë së njerëzimit u bë e njohur si **“Epoka e Lumturisë”**. Me të vërtetë, Profeti Muhamed ﷺ u bë një burim i tillë mëshire nga i cili edhe vendet më të humbura e të errëta u mbushen me nur e dritë. Në themel të fushatave që organizohen për të errësuar figurën madhështore të Profetit Muhamed ﷺ në aspektin intelektual, krahas injorancës së organizatorëve të tyre, qëndron edhe dashakeqësia dhe këndvështrimi negativ i perceptimit të profetit të njerëzimit.

Çdo qenie e jeton jetën e saj në habitatin e përshtatshëm me natyrën e vet. Njeriu nuk bën përjashtim nga ky rregull. Nuk është e mundur që ta zhvendosim jetën e bletës nga bota e brendshme e lules prej së cilës ushqehet dhe mbi të cilën ajo pushon, nuk mund t’ia imponojmë një miu qëndrimin në një trëndafilishte ndërkohë që natyra e tij është e lidhur me papastërtitë. Shpirtrat e lartë ushqehen me kënaqësitë e të vërtetave muhamedane,

5. Shih. Zumer, 9.



kurse shpirtrat rebelë e të prapë, e gjejnë kënaqësinë tek e keqja dhe e pista.

Ebu Bekri رضي الله عنه, kur shihte fytyrën e të Dërguarit të Allahut ﷺ mahnitej dhe thoshte: “Oh sa e bukur që është!”. Kjo, në fakt ishte edhe dëshmi e shikimit të botës së tij të brendshme në atë pasqyrë të përsosur. Kur Profeti i thoshte:

*“Sa kam pasur dobi nga pasuria e Ebu Bekrit, nuk kam pasur nga asnjë pasuri tjetër.”*

Ebu Bekri i përlotur i thoshte:

“A nuk jam unë dhe pasuria ime vetëm për ty, o i Dërguar i Allahut?!.” (Ibn Maxhe, Mukaddime, 11) . Kështu ai tregonte se çdo gjë të tijën, madje edhe vetveten, e kishte vënë në shërbim të Profetit të njerëzimit, me të cilin ishte shkrirë tërësisht.

Kurse armiku i përбетuar i Allahut dhe i të Dërguarit të Tij, Ebu Xhehli, ndikohej në mënyrë krejt të kundërt nga ajo bukuri profetike. Ai ishte plotësisht i huaj dhe i privuar nga bukuria dhe madhështia e Profetit Muhamed ﷺ. Ai zhytej nga dita në ditë në vorbullën e kufrit dhe të rebelizmit. Shkaku i kësaj diference perceptive ishte diferenca në aftësinë për të parë të vërtetat në pasqyrën muhamedane. Profetët janë si pasqyra të shndritshme ku çdokush sheh vetveten. Asnjë pasqyrë nuk mund të gënjejë me qëllim që të miklojë dikë, ta paraqesë të shëmtuarën të bukur apo anasjelltas.

Çdokush që do të tentojë t’u bëjë keq muslimanëve, Kuranit dhe Profetit, do të përballet me fuqinë dhe Madhështinë e Allahut ﷻ i Cili e ka marrë në mbrojtje fenë e Tij, dhe do të pësojë hakmarrjen e Tij. Herë herë, ata, të cilëve u ka rrëshqitur errësira në zemër si një gjarpër dhe intrigat e gjuhëve të liga dhe pendave të paditura, i kanë mërzitur shumë besimtarët të cilët në gjoksin e tyre kanë dashurinë për Profetin ﷺ.



Duhet të dihet mirë se është e pamundur të zhduket prirja e natyrshme e njeriut për të besuar në të Vërtetin. Sado të tentohet që ateizmi të përhapet nëpërmjet dhunës, asnjëherë nuk do të mund të pengohet gjelbërimi i filizave të së shenjtës që ka mbjellë feja në thellësi të shpirtit dhe ndërgjegjes njerëzore. Nuk mund të ndalet nevoja që ndjen njeriu për t'iu afruar Zotit. Këto ndjenja të larta shpirtërore që ekzistojnë thellë në qënien njerëzore, nuk mund të pengohen, sepse Fuqia Hyjnore, nevojën e fesë dhe të përafritimit me Krijuesin, e ka bërë ligj të natyrës që s'mund të ndryshohet nga askush përveç Tij!

**Allahu i Lartëmadhëruar na ndriçoftë sytë dhe shpirt-rat! Na dhëntë mirësinë që të mund ta shprehim gjatë jetës sonë, qoftë edhe për një moment të vetëm, falënderimin për mundësimin e të qenit pjesë e umetit të sulltanit të profetëve, Muhamedit ﷺ! I dhuroftë këtij shekulli dhe këtij brezi aromë nga ajo gonxhe e pashoqe e kopshtit të profetëve dhe jetë nga vesa e saj plot shpirt! Allahu me bujarinë e Tij, na dhuroftë lumturi shpirtërore nga atmosfera e brezit të lumtur! Na bëftë robër të mirë ndaj Krijuesit dhe na bëftë të meritueshëm për të qenë umeti i të dashurit të Tij!**

**Amin...**







# PARIMET E MORALIT TË LARTË

- 1 -



*Personalitetin shembullor të Profetit duhet ta kemi udhërrëfyes të vazhdueshëm në çdo etapë të jetës sonë. Selamet që vërshojnë nga shpirtrat tanë dhe salavatet e vazhdueshme, duhet të na përçojnë reflektimet e çdo "indi" të tij shpirtëror. Ai që zotëron nga morali i lartë i profetit Muhamed ﷺ, maturinë, dorëzimin tek Allahu, si dhe cilësi të tjera të ngjashme me këto, ka arritur lumturinë e vërtetë.*



# PARIMET E MORALIT TË LARTË - 1

Për t'u zhvilluar shpirtërisht në rrugën e përsosmërisë, një besimtar duhet të përvetësojë jetën shpirtërore dhe morale të profetit Muhamed ﷺ. Kjo gjendje arrihet në varësi të masës në të cilën shkrihet besimtari në dashurinë për Profetin dhe botën e tij shpirtërore.

Njerëzimi ka dëgjuar nga gjuha e mrekullueshme e të Dërguarit të Allahut ﷺ, pëshpëritjet hyjnore që përçojnë shërim dhe qetësi shpirtërore. Përballë gjithë kësaj mirësie, bujarie dhe përkujdesjeje, neve, si umet i Muhamedit ﷺ, na bie për detyrë ta kalojmë jetën brenda atmosferës shpirtërore të sunetit të tij, duke iu bindur tërësisht urdhëresave, ndalesave dhe këshillave të Tij.

Zoti ynë i ka dhuruar Profetit tonë gradën më të lartë shpirtërore “Makam-i Mahmud” dhe e ka këshilluar në bazë të këtij makami. Ndërsa ai, duke qenë **“shumë dashamirës dhe i mëshirshëm”** ndaj umetit të tij, ka dëshiruar që edhe umeti i tij t'i dëgjonte dhe t'i zbatonte këshillat që i jepeshin nga Allahu. Një pjesë e këtyre këshillave janë:

Profeti ﷺ, urdhëron:

***“Allahu ﷻ më urdhëroi t'i frikësohem Atij për çdo veprim të hapur apo të fshehur, (të njëjtën gjë jua këshilloj edhe juve).”***



Profeti ﷺ, ashtu si ndaj çdo urdhëri tjetër, ishte i përpiktë edhe në frikë-respektin ndaj Allahut. Ai thotë:

*“Betohem në Allahun ﷻ se ndër të gjithë ju, unë jam ai që i frikësohet më shumë Allahut, që i përulet Atij, që e nderon dhe e madhëron më shumë Atë.”* (Buhari, Nikah, 1.)

Kur dëshironte të ngrihej nga ndonjë kuvend miqsh, lutej duke thënë:

*“O Zoti im! Na dhuro frikë, që të bëhet perde ndërmjet nesh dhe gjynaheve tona!* (Tirmidhi, Deavat, 79), sepse Profeti ﷺ ka përjetuar majat e manifestimeve të njohjes më nga afër të të Madhërishtmit. Një ditë, ai u tha shokëve të Tij:

*“Sikur të dinit ato që di unë, do të qeshnit më pak e do të qanit më shumë!”* Në atë çast sahabet filluan të qanin me dënësë.

Allahu i Lartëmadhëruar i ka premtuar Xhenetin të gjithë atyre që i frikësohen Atij haptas, fshehtas dhe në çdo gjendje. Në Kuran urdhërohet:

**“E ai që i është frikësuar madhërisë së Zotit të tij dhe e ka frenuar veten nga dëshirat, padyshim që do të ketë për strehë Xhenetin.”** (Naziat, 40-41.)

*“(që do t’u thuhet) Kjo është premtuar për ju, për këdo që është penduar dhe ruajtur (nga gjynahet), që e ka pasur frikë të Gjithëmëshirshmin, edhe atëherë kur nuk e shihte kush, e që ka ardhur me zemër të kthyer (tek Allahu). ”* (Kaf, 32-33.)

**“Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që u kemi dhënë Ne.”** (Sexhde, 16.)

Për këtë arsye, profetët dhe miqtë e Allahut i gjallëronin netët e tyre duke iu frikësuar Allahut dhe duke shpresuar në



rahmetin e Tij. Netët e tyre ishin më të ndriçuara se ditët, sepse ishin të mbushura me qetësi dhe përshpirtshmëri sexhdesh të bëra në përlojtje.



Profeti i njerëzimit thotë:

***“Zoti im më urdhëroi të gjykoj me drejtësi edhe kur jam i zemëruar, edhe kur jam i kënaqur (të njëjtën gjë jua këshilloj edhe juve.).”***

Çastet e zemërimit janë çaste në të cilat njeriu has vështirësi në ruajtjen e ekuilibrit dhe aftësisë për të nxjerrë në pah të vërtetën. Ato janë momente kur njeriu mund ta humbë drejtpeshimin e gjërave duke u shmangur nga drejtësia. Në situata të tilla, duhet bërë durim i madh, duke kujtuar vazhdimisht Allahun dhe botën tjetër dhe të ruhet qetësia që të mos anojmë nga padrejtësia.

Allahu ﷻ urdhëron:

***“...Dhe mos shkoni pas epsheve tuaja e të shtrembëroni drejtësinë!..”*** (Nisa, 135.)

***“...me drejtësi dhe paanësi, sepse Allahu i do ata që veprojnë me drejtësi.”*** (Huxhurat, 9)

Resulullahu ﷺ në një hadith që cek tema të ndryshme, thotë:

*“Ekzistojnë tre vepra që sigurojnë shpëtimin:*

1. *Të jesh i drejtë edhe kur je i zemëruar, edhe kur je i kënaqur.*

2. *Të jesh kursimtar edhe në pasuri, edhe në varfëri.*

3. *Të kultivosh frikën ndaj Allahut edhe haptazi, edhe fshehurazi....”* (Hejthemi, I, 90.)



Një herë, kur dikush po dënohej për një vjedhje, një person erdhi për të kërkuar favorizim, në mënyrë që të pengojë zbatimin e ligjit. Mirëpo, Profeti ﷺ, duke sjellë shembull më të dashurën, vajzën e tij, i tha:

*“Betohem në Zotin tim se, sikur edhe vajza ime, Fatimja, ta kishte bërë këtë vjedhje, do t’ia prisja dorën.”* (Buhari, Enbija, 54; Muslim, Hudud, 8, 9)

Lumturia personale dhe shoqërore bazohet në drejtësi. Këtë të vërtetë, Omeri ؓ e shpreh në këtë formë:

*“Drejtësia është themeli i sundimit (shtetit, lirisë dhe ekonomisë së një vendi).”*

Në periudhën Emevite, në një hark kohor prej dy vite e gjysmë të kalifatit të Omer ibn Abdulazizit, i cili sipas historisë Islame konsiderohet kalifi i pestë i drejtë, në një kohë kur kufijtë e shtetit Islam ishin zgjeruar aq shumë, sa në to qe përfshirë edhe Spanja, populli jetonte në siguri dhe qetësi si rezultat i shpërndarjes së drejtësisë në mënyrë korrekte në tërë shtetin e tij. Zhvillimi dhe mirëqenia nuk mund të arrihen nëpërmjet dhunës dhe shtetet nuk mund të qëndrojnë në këmbë pa drejtësinë.

Në historinë Islame, kemi edhe shembullin e Sulltan Mehmet Fatihut, i cili për një çështje konflikti me një arkitekt të krishterë, cakton mikun e tij Hëzër Beun si gjykatës mes tyre. Pasi shqyrton çështjen nga afër, Hëzër Beu gjykon juridikisht jo në favor të sulltanit por në favor të palës tjetër. Ky rast është vetëm një shembull i drejtësisë që sundonte kudo në Shtetin Osman, gjë e cila siguroi vazhdimësinë shekullore të këtij shteti.



I Dërguari i Allahut ﷺ, thotë:

***“Allahu më urdhëroi të tregohem kursimtar edhe në***



***pasuri, edhe në varfëri (të njëjtën gjë jua këshilloj edhe juve.)”***

Njeriu duhet të jetë i matur në jetën e tij, qoftë kur është i pasur, e qoftë kur është i varfër. Ai nuk duhet ta kalojë masën në asnjë çështje. Profeti Muhamed ﷺ na këshillon vazhdimisht që t’ia dimë vlerën pasurisë, pa na ardhur varfëria.

Në lidhje me kujdesin dhe maturinë në shpenzime, Allahu ﷻ thotë:

**“Jepuni të afërmve, të varfrit dhe udhëtarit të drejtën e tyre, por mos bëni shpenzim të tepruar.”** (Isra, 26.)

**“Dorëshpuarit me të vërtetë janë vëllezërit e shejtanit dhe shejtani është mosmirënjohës ndaj Zotit të tij.”** (Isra, 27.)

**“Mos e shtrëngo dorën, as mos u bëj dorëshpuar e të mbetesh i qortuar dhe i mjerë.”** (Isra, 29)

I Dërguari i Allahut ﷺ thotë sërish:

*“Ata që janë të matur dhe nuk shpenzojnë pa kriter, nuk bëhen kurrë nevojtarë të të tjerëve”* (Ibn-i Hanbel)

*“Kush bën istihare nuk do ta provojë kurrë idhtësinë e humbjes, kush konsultohet nuk do të pendohet dhe kush shpenzon me kriter nuk do të varfërohet kurrë.”* (Hejthemi, Mexhmau’z-Zevaid, II, 280)

Prandaj, besimtari duhet të jetë i vetëdijshëm se Allahu ﷻ është pronari i çdo pasurie. Ai duhet ta shohë veten si rojtar të pasurisë që i është dhuruar, ta përdorë atë me kriter për nevojat e veta dhe, pjesën tjetër ta harxhojë në rrugë të Allahut. Allahu i Lartëmadhëruar urdhëron:

**“...Të pyesin se çfarë duhet të japin si lëmoshë, thuaju: ‘Tepricën!’ Ja, kështu jua shpjegon Allahu shpalljet e Tij, që të mund të mendoni.”** (Bekare, 219.)



Duke këshilluar kujdesin ndaj pasurisë shpirtërore në raste vështirësish ekonomike, Profeti Muhamed ﷺ thotë:

*“Ruajuni zjarrit qoftë edhe me një gjysëm hurme. Ai që s’mund ta sigurojë as këtë, të ruhet me fjalën e mirë e të bukur.”* (Buhari, Edeb, 34.)

Lumturia e zotërimit të diçkaje fitohet me dhurimin e saj në rrugë të Allahut. Për të pasur mundësi dhurimi dhe shërbimi në rrugën e Allahut, duhet që pasuria të fitohet në rrugë të pastër hallalli dhe të harxhohet pa lejuar hyrjen në zemër të lakmive materiale.

Profeti ﷺ thotë:

*“Sa bukur është kur malli i dobishëm dhe hallall ndodhet në duart e vepërmirit”* (Ibn-i Hanbel, IV, 202.), sepse një mirëbërës është i mëshirshëm dhe i dhembshur. Mëshirë do të thotë që, atë të cilën e ke në zotërim t’ia dhurosh atij që nuk ka. Me fjalë të tjera, mëshira është nxitimi në ndihmë të të tjerëve në përbalimin e skamjes. Në këtë botë, mëshira dhe bujaria janë qetësim i ndërgjegjes, ndërsa në botën tjetër janë sihariq i një lumturie të pafundme.

Të pasurit falënderues e dhurues dhe të varfërit durimtarë, janë shumë të rrallë në këtë botë. Prandaj, të dy këto grupe besimtarësh janë të pranuar nga Allahu. Të pasurit bujarë dhe falënderues dhe të varfrit durimtarë e të ndershëm, fitojnë pëlqimin e njerëzve dhe të Allahut. Po ashtu, Islami i përçmon të pasurit mendjemëdhenj e dorështrënguar dhe të varfrit që nuk kënaqen me caktimin hyjnor ndaj tyre, duke mosduruar dhe duke u rebeluar. Prandaj, Profeti ﷺ ka bërë vazhdimisht këtë dua:


*“Zoti im! Të mbështetem vetëm Ty nga sprovat e varfërisë dhe pasurisë.”* (Muslim, Dhikr, 49.)





Nisur nga këto, mund të themi se, vetëm ai i cili zotëron cilësitë e maturisë, dorëzimit dhe cilësi të tjera të larta shpirtërore, është vërtet i pasur. Mbretëria e vërtetë e pasurisë qëndron në këmbë vetëm në sajë të lumturisë së dhurimit.

Kur filluan përgatitjet për luftën e Tebukut, edhe sahabet që nuk kishin mundësi të mjaftueshme financiare u mbushën me ndjesinë e mundësisë së sakrifikimit të pasurisë dhe jetëve të tyre në rrugë të Allahut.

Një nga këta ishte edhe Ebu Akili , i cili punoi gjithë natën për të fituar dy masë hurma. Njërën masë ia dha familjes, ndër-  
sa tjetrën ia dhuroi ushtarëve që do të merrnin pjesë në luftën e Tebukut.

Në lidhje me të, i Dërguari i Allahut,  tha:

*“Allahu e begatoftë atë që solle këtu dhe atë që e mbaj-  
te!”*, dhe i hodhi ato hurma mes ndihmave të grumbulluara për  
luftën në fjalë. (Taberi, Tefsir, X, 251.)

Një ditë, profeti Muhamed  tha:

*“Një derhem është më i madh sesa njëqind mijë der-  
hem.”*

Shokët e Profetit e pyetën:

*“Si ka mundësi kjo, o Resulullah?”* Përgjigja që dha Profeti  
ishte shumë kuptimplote:

*“Një burrë kishte dy derhem. Më të mirin e tyre e dhuroi  
për hir të Zotit. (Pra dhuroi gjysmën e pasurisë së tij.) Kurse  
një tjetër (që ishte shumë i pasur) dhuroi nga pasuria e tij  
njëqind mijë derhem.”* (Nesai, Zekat, 49.)

Pra i pari, megjithëse ishte nevojtar dhuroi gjysmën e asaj  
pasurie që zotëronte; kurse i dyti, edhe pse kishte më shumë pasu-  
ri sesa i pari, dhuroi vetëm një pjesë të vogël të asaj pasurie.



Nga kjo kuptojmë se shpërblimi i dhurimit të ڇڪaje për hir të Allahut, nuk është i lidhur me sasinë, por me nivelin e sakrificës shpirtërore që përjetohet gjatë dhurimit të saj.

Po japim sërish një shembull që përforcon këtë të vërtetë:

Një herë, një person erdhi tek Osmani ﷺ dhe filloi të fliste:

“-O ju të pasur! I morët të gjitha veprat e mira; nga pasuria juaj jepni vazhdimisht lëmoshë, lironi shumë skllevër, shkoni në haxh dhe dhuroni nga pasuria juaj në rrugë të Allahut...”

Osmani ﷺ e pyeti:

“A na keni zili për këtë?”

“Po, ju kemi zili!”

Atëherë Osmani ﷺ i tha:

“Betohem në të Madhin Zot, se dhurimi edhe i një derhemi nga një besimtar në kushte të vështira ekonomike, është më i pranuar tek Allahu sesa dhurimi i një sasive të konsiderueshme nga një besimtar i pasur.” (Ali el-Muttaki, VI, 612/17098.)

Në lidhje me këtë të vërtetë, Sheh Sadi ka thënë:

“Allahu nuk ia ka mbyllur askujt derën e mirësisë. Dije mirë se mirësia e ڇdokujt është në varësi të fuqisë së tij. Një peshë me ar që jep një i pasur nuk është e njëjtë me një karat të fituar me mundin e krahëve që jep një i varfër. Këmba e karkalecit është peshë e rëndë për milingonën.”

Një vepër e mirë ka vlerë aq sa mbart sakrificë shpirtërore. Për shembull, në luftën e Jermukut, tre shehidë, edhe pse të tharë deri në vdekje për një pikë ujë, nuk pranuan ta pinin gotën e ujit, ngaqë donin t’ia dhuronin njëri-tjetrit. Kjo tregon ndjenjën e fortë të altruizmit që ata kishin kultivuar thellë në zemrat e në shpirtrat e tyre. Ky shembull përbën modelin e një niveli të lartë shpirtëror.



Ja pra, ky është ideali i brezit së sahabeve, i atyre që ishin ushqyer me moralin e Profetit Muhamed ﷺ. Brezi i sahabëve nuk e njihje aspak filozofinë e konsumit, harxhimin pa kriter, babëzinë, luksin, shpenzimet e tepërta për dukje si stil jetese. Të pasurit e tyre ishin **“falënderues”**, ndërsa të varfërit e tyre ishin **“durimtarë”**. Profeti ﷺ ishte shembulli më i mirë i të **“pasurve falënderues”**, kur i vinte plaçka e luftës dhe shembull më i mirë i të **“varfërve durimtarë”**, kur në shtëpinë e tij nuk gatuhej gjë për ditë të tëra dhe kur detyrohej të lidhte gurë në bark për të përballuar urinë.



I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë:

***“Zoti im më urdhëroi të ruaj lidhjet farefisnore, me ata që i shkëpusin ato (madje edhe atëherë kur ata kërkojnë t’i këpusin medoemos), (të njëjtën gjë jua këshilloj edhe juve).”***

Allahu i Lartëmadhëruar i ka urdhëruar me ngulm besimtarët të ruajnë lidhjet farefisnore dhe të jenë mirëbërës e bujarë me të afëmit e tyre. Ndërsa Profeti ﷺ ka thënë:

***“Unë jam dërguar nga Allahu ﷻ me detyrën për të shpjeguar domosdoshmërinë e ruajtjes dhe të përkujdesjes ndaj të afërmeve, për të thyer idhujt dhe për t’ju mësuar njësinë e Zotit të pashoq.”*** (Muslim, Musafirin, 294.) Me këtë hadith, Profeti ynë thekson në mënyrë thelbësore rëndësinë e ndërtimit të marrëdhënieve sa më të rregullta me të afërmit, duke u bërë vizita, duke u kujdesur për ta dhe duke i ndihmuar në çdo situatë.

Edhe sikur të afërmit të mos na shprehin të njëjtin interesim dhe mirënjohje, e madje edhe sikur t’i këpusin fare lidhjet me ne, është detyrë që rrjedh nga imani të përpiqemi përsëri t’i ruajmë



lidhjet, t'i këshillojmë për të mirë me një gjuhë të ëmbël dhe t'i ndalojmë nga e keqja.

Në një hadith tjetër thuhet:

*“Ai që ia kthen mirësinë të afërmve me të njëjtën mone-dhë mirësie, nuk konsiderohet si përkujdesës dhe ruajtës i lidhjeve farefisnore. (Me të vërtetë) Njeri që përkujdeset për lidhjet farefisnore konsiderohet ai i cili edhe kur të afërmit e tij i këpusin lidhjet me të, vazhdon t’u bëjë mirë atyre.”* (Buhari, Edeb, 15; Ebu Davud, Zekat, 45.)

Në lidhje me këtë temë, shembullin kulmor e përbën pro-feti Muhamed ﷺ, kur ai priste kurban dhe një pjesë të mishit ia dërgonte edhe të afërmve të bashkëshortes së tij, Hadixhes ؓ. Ai ka thënë:

*“Mësoni prejardhjen tuaj farefisnore, që të keni mundësi t’i vizitoni, të përkujdeseni dhe t’i ndihmoni ata...”* (Ali el-Muttaki, Kenz, X, 220, nr: 29162)

Në ajetet e mëposhtme Allahu i Lartëmadhëruar flet për shkatërrimin e atyre që anashkalojnë detyrën e përkujdesjes, ndihmës dhe vizitës tek të afërmit:

**“...(ata) të cilët shkelin besën e Allahut, pasi e patën dhënë, ndërpresin atë që e ka urdhëruar Allahu për ta mbajtur lidhur dhe bëjnë ngatërresa në Tokë; Ata janë njëmend të shkatërruar.”** (Bekare, 27.)

**“Nëse ju (o hipokritë) i ktheni shpinën besimit, atëherë do të bënit ngatërresa në Tokë dhe do t’i shkatërronit lidhjet farefisnore.”** (Muhamed,22.)

**“Këta janë ata, të cilët Allahu i ka mallkuar, i ka bërë të shurdhër dhe ua ka verbuar shikimin.”** (Muhamed, 23.)

Profeti Muhamed ﷺ e shpreh në këtë mënyrë humbjen



e madhe në të cilën kanë rënë personat që lënë mbas dore të afërmit e tyre:

*“Ai që shkëput lidhjet me të afërmit, nuk mund të hyjë në Xhenet.”* (Buhari, Edeb, 11.)

*“Përveç dënimit në botën tjetër, i cili do të jepet pavarësisht dënimeve që jepen në dynja, gjynahet që përshpejtojnë dënimin hyjnor në këtë botë, janë padrejtësia dhe braktisja e të afërmve.”* (Ebu Davud, Edeb, 43; Tirmidhiu, Kijame, 57.)



I Dërguari i Allahut ﷺ thotë:

***“Zoti im më urdhëroi t’i jap edhe atij që nuk më jep, (të njëjtën gjë jua këshilloj edhe juve.)”***

Në një ajet kuranor thuhet:

***“Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë, e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë.”*** (Fussilet, 34.)

Ndërsa në një hadith profetik thuhet:

*“Ti mos i shkëput lidhjet me atë që i ndërpret ato! Jepi atij që nuk të jep gjë! Fale atë që të bën keq!”* (Ibn-i Hanbel, IV, 148, 158.)

Në vitin e shtatë hixhri, në Meke pllakosi një thatësirë dhe varfëri e madhe. I Dërguari Allahut i ndihmoi mekasit, ata që për njëzet vjet e kishin luftuar kafshërisht, duke u dërguar atyre ar, elb dhe hurma. Pasi i mori në dorëzim këto ndihma, Ebu Sufjani ua shpërndau të varfërve të Kurejshëve.

Mirësia e mposht njeriun. Madje, bujaria dhe mirësia zbut edhe urrjtjen e armikut. Nga dhurimi që Profeti ﷺ u bëri të varfërve të Mekës, edhe në zemrën e Ebu Sufjanit u zbut urrjtja



dhe armiqësia që ushqente. Prandaj, ai e shprehu me këto fjalë kënaqësinë që ndjeu:

“Allahu e shpërbleftë me të mira djalin e vëllait tim, sepse ai u kujdes për të drejtën e të afërmeve!” (Ja’kubi, Tarih, II, 56.)

Prej këtyre mirësive dhe virtyteve të larta njerëzore që Profeti Muhamed ﷺ gëzonte në qenien e tij, shumë njerëz u nderuan me Islam.

Edhe Jusufi ﷺ është një shembull shumë i mirë në lidhje me këtë temë. Edhe pse vëllezërit e tij e hodhën në pus, ai u tregua bujar ndaj tyre, nuk ua përplasi në fytyrë gabimin, por i fali. Duke u prekur nga ky qëndrim, ata thanë:

**“...Betohemi për Allahun, vërtet që Allahu të ka ngritur ty mbi ne dhe ne paskemi qenë vërtetë të gabuar.”** (Jusuf, 91.)

Për t’i orientuar njerëzit drejt Zotit dhe drejt mirësisë, duhet gjetur damari që kalon nga zemra. Dhe rruga më e shkurtër është bujaria, dhembshuria dhe falja. Pra, të mund t’i dhurohen këto virtyte krijesave të Allahut.

Për t’u ngritur në nivelin e një besimtari të arrirë dhe për të merituar dashurinë e Allahut, duhet të bartim vazhdimisht në zemër **“frikën ndaj Tij”**, nuk duhet ta braktisim asnjëherë **drejtësinë**, edhe kur jemi të zemëruar, edhe kur jemi të kënaqur, duke qenë **të kujdesshëm dhe të matur** si në gjendje varfërie ashtu edhe në gjendje pasurie, duhet të dimë të dhurojmë në rrugë të Allahut brenda mundësive tona ekonomike; **nuk duhet t’i ndërpresim marrëdhëniet farefisnore me të afërmit**, por duhet të tregohemi **bujarë** qoftë edhe ndaj atyre që s’janë treguar të tillë ndaj nesh, si dhe **të mund ta falim** me zemërgjerësi edhe **atë që na bën padretjësi**.

**Allahu ﷻ na bëftë nga robërit që kanë fituar pëlqimin**



**e Tij dhe që i binden pa bërë asnjë lëshim, ashtu sikundër ndjek hija të zotin e saj, duke zbatuar urdhrat dhe këshillat e të dashurit të Tij më të moralshëm! Na dhëntë moralin e të Dërguarit të Tij, të cilin vetë e pajisi me moral të lartë e të shëndoshë, duke e bërë Personalitetin Shembullor për tërë njerëzimin, dhe na përfshiftë në bashkësinë e robërve mirëbërës që dëshmojnë Atë!**

**Amin!**







# PARIMET E MORALIT TË LARTË

- 2 -



*Nuk duhet harruar se Allahu i Lartëmadhëruar i ka krijuar njerëzit nevojtarë ndaj njeri-tjetrit. Shoqëria, ashtu siç ka klasën e pasur dhe të fortë, ka e do të ketë gjithmonë edhe klasën e të dobtëve, të njerëzve me probleme shëndetësore dhe të nevojtarëve. Ne duhet të pyesim veten: "Pse i krijoi Allahu i Lartëmadhëruar nevojtarët?" Përgjigjja dihet: "Nevojtarët janë amanet që Allahut ﷻ ua ka lënë jonevojtarëve"*



## PARIMET E MORALIT TË LARTË - 2

Ndjesia e dashurisë ndaj një qenieje, përhapet në çdo gjë që e bën të lindë atë dashuri ose që lidhet me atë dashuri. Për shembull, mes mijëra malesh që ekzistojnë, Mali i Uhudit është më i veçanti për besimtarët, sepse atë e ka dashur në mënyrë të veçantë i Dërguari i Allahut ﷺ. Qyteti “**Jethrib**”, para hixhretit ishte një qytet si të gjithë të tjerët, por më vonë, për faktin se atë qytet e lau me dashurinë dhe mirësinë e tij, ﷺ, ai u bë “**Medine-i Munevvere**”. Me të vërtetë, ajo dashuri aq e zjarrtë që gjallon në zemrat e besimtarëve për “Medine-i Munevvere”, nuk ka të krahasuar me dashurinë ndaj asnjë qyteti tjetër, sepse sa herë që përmendet ky qytet, besimtarëve u vjen ndërmend Profeti ﷺ.

Prandaj, siç del në pah edhe nga shembujt e mësipërm, dashuria ndaj Allahut të Lartëmadhëruar shpie në dashurinë dhe në bindjen absolute ndaj profetit Muhamed ﷺ.

Allahu ﷻ thotë në Kuran:

**“Thuaju (o Muhamed): ‘Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë dhe t’jua falë gjynahet! Allahu është falës i Madh dhe Mëshirëplotë.’”** (Al-i Imran, 31)

Rruga e bindjes ndaj të Dërguarit të Allahut, e bën njeriun të meritueshëm për të qenë pjesë e robërve që pëlqen Allahu i



Lartëmadhëruar. Rezultati i dashurisë dhe i bindjes ndaj Allahut ﷻ dhe ndaj Resultit të Tij ﷺ, është kënaqësia që besimtari ndjen nga prirjet e natyrshme të dashurisë dhe dhembshurisë kundrejt krijesave për hatër të Krijuesit, kënaqësia e të ndarit me vëllezërit myslimanë të çdo gjëje brenda mundësive, kënaqësia e të falurit, kënaqësia e të parit të krijimit nëpërmjet syrit të Krijuesit, si dhe plot gjendje të tjera.

Për t'iu afruar të vërtetës së Resulullahut ﷺ, sahabët e nderuar kanë qëndruar gjithnjë përreth Profetit ﷺ dhe, shkruarjen me të, e kanë konsideruar si mirësinë më të madhe në botë. Në këtë mënyrë, ata kanë arritur mirësi të mëdha hyjnore. Po ashtu, gjatë gjithë historisë, edhe besimtarët e mirë që kanë përfituar siç duhet prej personalitetit të tij shembullor, duke i përsosur më shumë bukuritë hyjnore të natyrës së tyre, arritën majat më të larta në aspektin e besimit dhe moralit, duke u bërë kështu pishtarë orientues për njerëzimin.

Ilaci më i efektshëm i zemrave të sëmura dhe indiferente është dashuria ndaj Profetit ﷺ dhe **“zbatimi i sunetit të tij”** që vjen rrjedhojë e admirimit të personaliteti të tij.

Profeti ﷺ dëshiron të jetë së bashku me umetin e tij në Xhenet. Për këtë arsye, ai ka kërkuar që umeti i tij të jetë i vëmendshëm ndaj çdo çështjeje të urdhëruar nga Allahu ﷻ. Lidhur me dashurinë që Profeti ﷺ ushqen për umetin e tij, në Kuran urdhërohet:

**“Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë dhe i mëshirshëm me besimtarët.”** (Teube,128)

Që të mund të bashkohemi në krye të burimit të Keutherit me Profeti ﷺ, i cili ishte aq i dhënë pas umetit të vet, duhet t'ia



vëmë veshin me gjithë shpirt këshillave të tij. Disa nga këshillat e rëndësishme që Profeti ﷺ ka kërkuar që t'i zbatojmë me përpikmëri, janë këto:

I Dërguari i Allahut, ﷺ, ka thënë:

***“Zoti më urdhëroi që heshtja ime të jetë meditim, (të njëjtën gjë jua këshilloj edhe juve).”***

Allahu i Lartëmadhëruar u ka dhuruar të gjitha krijesave aftësi “meditimi” sipas natyrës së tyre të krijimit. Meditimi i krijesave të tjera, përveç njerëzve dhe xhindeve, quhet “instinkt”. Ky lloj menditimi shërben për vazhdimësinë e jetës. Ai i ndihmon kafshët për ushqim, vetëmbrojtje, vazhdimësinë e llojit, etj. Ndërsa njeriut i është dhuruar meditimi si aftësi mendore, për të forcuar përbërjen e shpirtit dhe për të mundësuar të qenit rob i afërt me Allahun dhe mik i Tij. Sa humbje tragjike do të ishte përdorimi i kësaj aftësie vetëm për interesat e kësaj bote dhe kënaqësitë e nefsit!

Sa më shumë të lartësohet dhe të përsoset njeriu gjatë jetës së tij në meditim dhe thellësi ndjenjash, aq më shumë do të përfitojë prej dashurisë hyjnore dhe aq më shumë do t'i shtohet mundësia për të arritur lumturinë në botën tjetër.

Meditimi është një nga mjetet më të rëndësishme që e ngre njeriun në majat më larta të përsosmërisë njerëzore. Udhërrëfyesi ynë, Kurani, që nga ajeti i parë e deri tek i fundit, e thërret njeriun të mendojë thellë rreth mrekullive në krijimin e tij, rreth harmonisë së përsosur të universit, si dhe rreth Kuranit si një mrekulli e pashoqe. Ai i tërheq vëmendjen njeriut me shprehje të tilla si: **“A nuk zini mend?”**, **“A nuk po mendoni?”**, **“A nuk po merrni mësim?”** Kështu, cilido që dëshiron të jetojë në përputhje me vlerat njerëzore, është i detyruar të hyjë në atmosferën e të menduarit nën udhëzimin e Kuranit të Madhërueshëm.



Allahu ﷻ urdhëron:

**“Vallë, a nuk mendojnë ata në vetvete? Allahu ka krijuar qiejt dhe Tokën dhe ato që gjenden në mes tyre - vetëm me qëllim dhe afat të caktuar. E, me të vërtetë, shumica e njerëzve nuk besojnë në takimin me Zotin e tyre.”** (Rum, 8)

**“Vallë, a mos u lodhëm Ne gjatë krijimit të parë? Jo, por ata dyshojnë në krijimin e sërishëm. Ne e kemi krijuar njeriun, Ne e dimë ç’i pëshpërit atij vetja e tij. Ne jemi më pranë tij se damari i qafës së vet.”** (Kaf, 15-16)

I dërguar nga Allahu ﷻ si personalitet shembullor për umetin e tij, Profeti Muhamed ﷺ mendonte thellë për botën e krijesave dhe Krijuesin saj e saj të urtë. Ai nuk fliste pa qenë e nevojshme. Gjendja e tij e heshtur zgjaste shumë. Por, në çdo rast, e ftonte umetin e tij të meditonte rreth krijesave të Allahut ﷻ dhe shprehej se meditimi është një lloji i veçantë adhurimi.



Në vazhdim të këshillave profetike, Profeti ﷺ ka thënë:

**“Zoti im më urdhëroi që e folura ime të jetë dhikër, (të njëjtën gjë jua këshilloj edhe juve).”**

Të dashuruarit kanë nevojë ta kujtojnë atë që dashurojnë aq sa ndjejnë dashuri për të. Po ashtu, ky përkujtimi e rrit edhe dashurinë ndaj të dashurit. Ata që kanë shijuar kënaqësinë e besimit, sa më shumë të përparojnë në këtë drejtim, aq më shumë u shtohet dashuria dhe përkujtimi i Allahut.

Padyshim, se të përkujtosh Allahun, nuk do të thotë të përsërisësh vetëm disa herë shqiptimin e emrit të Tij, por do të thotë që, më vetëdije dhe perceptim të thellë t’i bësh vend Atij në qendrën e ndjesive, pra në zemër. Në Kuran urdhërohet:



**“...ata që besojnë dhe zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, qetësohen. Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!”** (Ra'd, 28)

Nga Aisha رضي الله عنها mësojmë se Resulullahu, صلى الله عليه وسلم, ishte vazhdimisht në përkujtim të Allahut të Lartëmadhëruar. Në Kuran, nëpërmjet një ajeti që kërkon prej nesh të njëjtën gjë, Allahu i Lartëmadhëruar urdhëron:

**“...Por, Zotin tënd përmende shumë dhe adhuroje Atë në mbrëmje dhe në mëngjes!”** (Al-i Imran, 41)

**“Pasi të kryeni namazin, përmendeni Allahun duke qëndruar në këmbë, ulur dhe shtrirë!.. ”** (Nisa, 103)

Në këtë ajet, Allahu i Lartëmadhëruar urdhëron që edhe në caste të vështira rreziku, lufte dhe fatkeqësie, nuk duhet harruar apo neglizhuar dhikri, pra, në çdo çast dhe situatë zemrat duhet të jenë të lidhura me Të.

Dhikri është kusht që njeriu të mos bjerë në indiferencë dhe në harresë. Allahu صلى الله عليه وسلم urdhëron:

**“Mos u bëni si ata që e harruan Allahun, kështu që Ai i bëri të harronin vetveten! Pikërisht ata janë të pabindurit (ndaj Allahut).”** (Hashr, 19)

Kur Allahu صلى الله عليه وسلم, dërgoi Musain dhe Harunin عليهما السلام tek Faraoni, i porositi:

**“Shkoni ti dhe vëllai yt me mrekullitë e Mia dhe mos reshtni së më përmenduri Mua!”** (TaHa, 42)

Ai që thotë me gjithë zemër “O Zoti im”, nuk mund të nxjerrë nga goja fjalë të gabuara, nuk mund të bëjë padrejtësi, nuk mund të sillet ndaj krijesave pa dhembshuri, sepse tek ai që bën dhikër manifestohen cilësitë e emrave të Allahut, **Rrahman dhe Rrahim.**



Ai që angazhohet vazhdimisht me dhikr dhe e ka zemrën të lidhur me Zotin, përsoset edhe në jetën e adhurimit. Profeti ﷺ ka thënë:

*“Ndryshimi ndërmjet atij që bën dhikër (përkujton Allahun) dhe atij që nuk bën dhikër, është si ndryshimi i të gjallit me të vdekurin. (Buhari, Deavat, 66)*



Si këshillë të tretë, Profeti ﷺ ka thënë:

***“Zoti im më urdhëroi që shikimi im të jetë për të marrë mësim, (të njëjtën gjë jua këshilloj edhe juve).”***

Allahu ﷻ shpreh lëvdata për robërit e Tij, të cilët i shohin gjërat e ngjarjet me kujdes dhe nxjerrin mësimin e duhur prej tyre. Ai na informon se ajetet i ka shpallur dhe i ka sqaruar pikërisht për këtë kategori njerëzish. Në disa ajete, të cilat e orientojnë njeriun drejt marrjes së mësimin nga qeniet dhe nga situatat që zhvillohen rreth tij, urdhërohet:

***“Vallë, a nuk i shohin devetë, se si janë krijuar?! Po qiellin, se si është ngritur?! Po malet, se si janë vënë të patundur?! Po tokën se si është shtrirë?!”*** (Gashije, 17-20)

***“Vallë, a nuk kanë udhëtuar ata nëpër Tokë, për të parë përfundimin e atyre që qenë përpara tyre!?... ”*** (Muhamed, 10)

Më e rëndësishmja e dijes dhe njohjes, është familjarizimi me gjuhën e posaçme të krijesave. Këtë fazë, Mevlana e shpreh me fjalët, **“u poqa”** dhe **“u dogja”**. Në veprën e tij madhështore **“Mesnevi”**, ai flet me të gjitha krijesat, duke u bërë përkthyesi i gjuhës së tyre të posaçme. Një nga këto është edhe biseda që zhvillohet me trëndafilin, ku Mevlana thotë:

*“Aromën e këndshme, trëndafili e fitoi sepse shkonte*





*në harmoni me gjëmbin. Këtë të vërtetë dëgjoje nga vetë trëndafili. Dëgjo çfarë thotë:*

*Pse të hidhërohem nga bashkëjetesa me gjëmbin, pse të pikëllohem? Unë, që të qeshurën e fitova duke duruar qëndrimin bashkë me të. Nëpërmjet tij, gjeta mundësinë për t'i dhuruar gjithë botës aroma të këndshme.”*

Ndërsa Junus Emre bisedon me lulen e verdhë, duke mësuar nga ajo, e duke i mësuar asaj urtësinë dhe të fshehtat e universit.

Sad-i Shirazi thotë:

*“Në sytë e të urtëve, çdo gjethë peme është një libër që e shpie njeriun drejt njohjes së Allahut. Ndërsa për indiferentët, të gjitha pemët nuk vlejné as as një gjethë!”*



Si përfundim, mund të themi se cilësitë e larta, **si meditim**, **dhikri** dhe **shikimi me syrin e urtësisë për të marrë mësim**, janë të domosdoshme për pastrimin dhe rafinimin e botës së brendëshme të njeriut, me qëllim që të arrijë pjekurinë e duhur shpirtërore. Resulullahu, ﷺ, na bën të ditur se Vetë Allahu e ka urdhëruar të jetë i kujdesshëm në këto pika, prandaj të njëjtën gjë kërkon edhe prej nesh.

Sa bukur shprehet Imam Rabbani kur thotë:

*“Sa fatlum është ai që ka arritur mirësinë e pasimit të sunetit të Profetit Muhamed ﷺ. Sot, edhe një punë e vogël që bëhet duke besuar në vërtetësinë e fesë së tij, do të shpërblehet njësoj si punët e mëdha...”* (Mektubat Rabbani, 44. Mektub)

Allahu na bëftë ne robërit e Tij prej atyre fatlumëve që zbatojnë me përpikmëri sunetin e të Dërguarit të Allahut, ﷺ!

Të bësh një jetë në rrugën e drejtë të moralit dhe këshillave



të Profetit tonë ﷺ, i kthen të dyja botët në gëzim e festë. Receta e vetme e lumturisë, që i kthen vuajtjet e përkohshme të kësaj bote në paqe të përjetshme, lotët e hidhur në buzëqeshje të pafundme dhe vajtimet e dala prej shpirtit në thirrje Xheneti, gjendet në parimet e larta të Resulullahut ﷺ; në dhembshurinë, në mëshirën dhe në ndërmjetësimin e tij.

Bajramet që përjetojmë në këtë botë, para së gjithash duhet të jetojen përreth këtyre të vërtetave, në mënyrë që të arrijmë të përjetojmë bajramet e jetës së pafundme. Mes këtyre të vërtetave është meditimi, dhikri dhe shikimi i botës me syrin e urtësisë për të marrë mësim... Me pak fjalë, është pajisja me moralin e lartë të Profetit ﷺ, altruizmi dhe solidariteti...

Nuk duhet harruar se Allahu i Lartëmadhëruar i ka krijuar njerëzit nevojtarë ndaj njeri-tjetrit. Shoqëria, ashtu si ka klasën e pasur dhe të fortë, ka e do të ketë gjithmonë edhe klasën e të dobëtëve, të njerëzve me probleme shëndetësore dhe të nevojtarëve. Ne duhet të pyesim veten: “Pse i krijoi Allahu i Lartëmadhëruar nevojtarët?” Përgjigjja dihet: “Nevojtarët janë amanet i Allahut ﷻ, që ua ka lënë jonevojtarëve.” Këtë përgjegjësi e ka dhënë Vetë Allahu.

Duhet menduar, se të pasurit mund të ishin në vend të të varfërve, e anasjelltas. Ata që gëzojnë një gjendje të mirë ekonomike duhet ta kuptojnë mirë përgjegjësinë që kanë në lidhje me plotësimin e nevojave të të varfërve, sepse përballë jetës së pafundme, jeta e kësaj bote është veçse një segment shumë i shkurtër dhe i papërfillshëm. Ndofta në sajë të durimit dhe të falënderimit të atyre nevojtarëve, të pasurit do të shpërblehen me mirësi të pamatë në botën e pafundme, në Ahiret.

Një ditë, Profeti Muhamed ﷺ tha:

*“Betohem në Atë që ka në dorë shpirtin tim se, përderi-*



sa nuk e mëshironi njëri-tjetrin, nuk do të mund të hyni në Xhenet.”

Sahabet thanë:

“O i Dërguari i Allahut! Ne jemi të gjithë të mëshirshëm.”

Profeti ﷺ tha:

“Mëshira për të cilën po flisja unë, nuk është ajo që kuptuat ju, pra nuk është vetëm mëshira që ju shprehni ndaj njëri-tjetrit. Unë po flisja për mëshirën e cila rrok të gjitha krijesat, një mëshirë e cila përfshin çdo krijesë!..” (Hakim, IV, 185/7310)

Prandaj, vajtimet e heshtura që ngrihen prej një shoqërie, duhet t'i ndejmë më thellë. Sigurisht, në krye të tyre vijnë të sëmurët dhe pleqtë e vetmuar, fëmijët e braktisur në rrugë në mëshirë të fatit, ata që kanë humbur rrugën duke u ndikuar nga helmi i mediave të papërgjegjshme, të rinjtë të cilët duke qenë në stinën më të bukur të jetës janë zhytur në batakun e alkoolit dhe të lëndëve narkotike, si dhe mendjet e njoma të të rinjve që kanë humbur ndjeshmërinë fetare e kombëtare.

Kur zemra dhe dora jonë zgjatet nga njerëzit që janë me të vërtetë të shkretë e nevojtarë, atëherë do të arrijmë të kuptojmë edhe bajramin e vërtetë, sepse myslimanët janë si organet e të njëjtit trup. Nëse humbim qoftë edhe një njeri, është njësoj si të kemi humbur një pjesë të trupit tonë. Duke dëshiruar që besimtarët të jenë pikërisht të tillë, Profeti ﷺ thotë:

“Besimtarët i ngjajnë një trupi në dashurinë, në dhembshurinë dhe në mbrojtjen ndaj njëri-tjetrit. Kur sëmurët një organ i trupit, edhe pjesët e tjera të trupit mbeten pa gjumë dhe i kap temperatura.” (Buhari, Edeb, 27; Muslim, Birr 66)

Duhet të mendojmë mirë se cila është ajo lëvizje shpirtërore



e cila do t'i zgjonte me të vërtetë nga gjumi indiferentët, që do t'i gjallëronte me gëzim e lumturi të varfërit e të vuajturit, që do ta bënte njerëzimin të buzëqeshte me fytyrën e ngrohtë e të qeshur të Islamit, duke sjellë festën e vërtetë mes tyre.

Sa mund të shkrihen zemrat dhe duatë tona me njerëzit në nevojë?

A do të mund të bëhemi sadopak shkak që në fytyrat e tyre të duket buzëqeshja, ajo buzëqeshje që do të na dhuronte kënaqësinë e vërtetë të festës, si dhe do t'i falte shpirttrave tanë pranvera të këndshme lumturie?

**Allahu i Lartëmadhëruar na e bëftë të mundur t'i ndjejmë thellë dhimbjet dhe vuajtjet e vëllezërve tanë myslimanë që po dhunohen, që zemrat e shpirttrat tanë të bëhen prehje për ta dhe t'ua mbështjellim plagët me ndihmën tonë materiale dhe shpirtërore! Allahu e bëftë derën tonë drejt ahiretit një bajram të përjetëshëm që vjen plot me manifestime lumturie!**

**Amin...**





## PARIMET E MORALIT TË LARTË

- 3 -



*Për të pasur sukses në thirrjen Islame, nevojitet një zemër e ndjeshme e brumosur me urtësitë kuranore, si dhe një fytyrë e ngrohtë dhe e buzëqeshur e cila reflekton bukuritë e Islamit. Ne duhet të flasim me një gjuhë zemre, e cila përhap mëshirë, duke u bërë shembuj të gjallë të së vërtetës, mirësisë, virtytit dhe drejtësisë.*





## PARIMET E MORALIT TË LARTË - 3

Allahu i Lartëmadhëruar e ka pajisur çdo krijesë, e kryesisht njeriun, me prirjen e natyrshme për të dashur. Në këtë botë e cila është një shkollë provimi hyjnor, njeriu rritet dhe fiton grada të larta kuptimore e shpirtërore në sajë të prirjes për t'u orientuar nga e Vërteta dhe mirësia. Qendra themelore dhe përfundimtare e dashurisë, ku shpirti do të gjejë qetësinë dhe prehjen e tij, është Allahu ﷻ, Ai që i fali njeriut prej shpirtit të Tij. Prandaj, të gjitha dashuritë që nuk përfundojnë tek dashuria ndaj Zotit, që nuk të shpien tek Ai dhe që konsumohen në rrugë të gabuara, janë lodhje dhe stërmundim i kotë për shpirtin.

Mevlana e shpreh indifferencën e njeriut me këtë shembull kuptimplotë:

*“Largimi me vrap i qengjit nga ujku, nuk shkakton habi, sepse ujku është armiku dhe gjuetari i qengjit. Ajo që shkakton habi është rënia në dashuri e një qengji me ujkun!..”*

Duke mos harruar qendrën e dashurisë, që është Allahu ﷻ, ne duhet të përpiqemi të arrijmë një nivel të atillë shpirtëror, që çdo dashuri ta shfrytëzojmë si një shkallë për t'u ngjitur në dashurinë sublime ndaj Allahut ﷻ. Ky është edhe qëllimi i krijimit të njeriut.



Rruga më e shkurtër dhe më e saktë që të shpie tek dashuria ndaj Allahut, është dashuria ndaj të dashurit të Allahut, pra dashuria ndaj të Dërguarit të Tij ﷺ. Një shfaqje e kësaj dashurie, është edhe bindja ndaj tij. Me formulën: **“Kush dashuron, dashuron çdo gjë që dashuron edhe i dashuri i tij”**, lidhja dhe bindja ndaj Profetit ﷺ duhet të jetë shumëplanëshe. Kjo lidhje dhe kjo bindje përbëjnë edhe shtyllën kurrizore të dashurisë ndaj Allahut ﷻ. Dashuria ndaj Profetit ﷺ reflektohet me qetësinë në namaz, me delikatesën në sjellje, me etikën tonë, me ndjeshmërinë shpirtërore, me dritën e fytyrës, me përshtypshmëri në gjuhë si dhe me thellësi në shikim. Burimi më i bollshëm prej ku mund të merren dhe mësohen të gjitha këto cilësi të mira, është Profeti ﷺ.

Në të vërtetë, vetëm atëherë kur zemrat të bëhen si flutura nate që digjen nga zjarri i dashurisë përreth shpirtit të atij Nuri të ekzistencës, ato do të mësojnë dashurinë hyjnore prej atmosferës së tij shpirtërore në kuptimin e vërtetë të saj. Për të matur nivelin e dashurisë ndaj Profetit ﷺ, Mevlana na jep disa shembuj të manifestimit të kësaj dashurie në univers:

*“Shumë flutura nate u hodhën drejt zjarrit për hir të dashurisë. Ato rrihnin flatrat brenda zjarrit, u dogjën e u përcëlluan dhe në gjuhën e tyre thoshin: «Bëhu edhe ti si ne!»”*

*“Qiri digjej dhe qante. Ia kishte lënë veten zjarrit dhe vuajtjes. Mirëpo, kur sytë i derdhnin lot, përreth përhapte dritë. E prap qiri thoshte: «E çfarë dobie do të kesh nëse shpërndan ar e argjend për të fituar në këtë botë? Nëse dëshiron përfitime shpirtërore, atëherë digju e shkrihu si unë!»”*

Ja pra, me një dashuri kaq të thellë duhet ta duam edhe Profetin Muhamed ﷺ, i cili gjatë gjithë jetës së tij jetoi duke thënë: “umeti im, umeti im”.





Dashuria dhe dhembshuria e tij ndaj umetit ishte aq e madhe saqë nuk mund të krahasohet as me dashurinë e një nëne që dridhet mbas fëmijës së vet. Aq shumë e shqetësonte fundi i umetit të vet, saqë në lidhje me këtë është shprehur: “...Në rrugë të Allahut ﷺ kam përjetuar vuajtje që askush si ka përjetuar...” (Tirmidhi, Kijamet, 34/2472)

Sahabeve gjithashtu u ka thanë:

“Bëni kujdes! Për sa kohë jam gjallë, jam shkak i sigurisë suaj. Por kur të ndërroj jetë, do t’i përgjerohem Zotit “O Zot, ummeti, ummeti!”, derisa t’i fryhet surit për herë të parë...” (Ali el-Muttaki, Kenzu-l Ummal, V.14, fq. 414)

Çdo besimtar duhet ta ndjejë si borxh moral shprehjen e mirënjohjes ndaj Profetit ﷺ, i cili e do kaq shumë umetin e tij. Duke u bazuar edhe në obligimin që na ngarkon hadithi profetik, sipas të cilit: “Njeriu është bashkë me atë që do.” (Buhari, Edeb, 96), ne duhet ta duam Profetin ﷺ më shumë se vetveten, t’i bindemi duke e aplikuar sunetin e tij dhe të vishemi me moralin e tij. Kjo është edhe peshorja që tregon masën tonë të dashurisë ndaj tij.

Dy këshillat e tjera të Profetit, të cilat përbëjnë pasurinë e shpëtimit dhe të lumturisë së pafundme për ne, janë:

**1. “Zoti im më urdhëroi të fal atë që më bën padrejtësi, (të njëjtën gjë jua këshilloj edhe juve).”**

Të falësh, do të thotë të mos e dënosh fajtorin duke u hakmarrë kur ke mundësi ta bësh një gjë të tillë. Ky është manifestimi më i bukur i shfaqjes së dashurisë ndaj krijesave për hir të Krijuesit. Pra, falje do të thotë, që në vend të kërkosh që fajtorit ti jepet dënimi i merituar, të shprehësh pjekurinë e duhur që ta përballësh fajtorin me faljen dhe mëshirën hyjnore, duke u larguar nga çdo tendencë dhe pretendim egoist i unit. Sigurisht,






pkjekuria që shfaqet në të tilla raste është në dobi të besimtarëve që kanë arritur gradën e përsosmërisë duke e përvetësuar moralin hyjnor, si dhe duke arritur vetëdijen e **“hiçit”** përballë Vullnetit Hyjnor. Ky është rezultati i përpjekjeve për të merituar falje, duke falur të tjerët.

Omeri  ka thënë:

*“Ai që nuk mëshiron, nuk do të mëshirohet. Atij që nuk fal gabimet e të tjerëve, nuk do t’i falen as gabimet e tij. Ai që nuk fal, nuk do të falet...”* (Buhari, el-e-debu’l-Mufred, s. 415, nr: 371)

Të mposhtësh zemërimin dhe të falësh, është diçka shumë e rëndë për nefs (egon). Mirëpo pesha e shpërblimit që fitohet në përfundimin e një vepre, ponderohet me koeficientin e vësh-tirësisë që hasen për ta arritur atë, pra të mund ta shfaqësh këtë aftësi për hir të Allahut, është një virtyt shumë i veçantë.

Kur një person i zemëruar dhe i nevrikosur kërkoi këshillë nga Profeti , ai Zotëri i tha: *“Mos u zemëro!”*. Edhe pse ai ia përsëriti disa herë pyetjen e tij Resulullahut , mori të njëjtën përgjigje prej tij. (shih Buhari, Edeb 76)

Profeti  i ka ftuar shokët e tij që të mposhtin zemërimin e të fitojnë virtytin e të falurit, duke u thënë:

*“Mos u bëni si njerëzit e rëndomtë që imitojnë të tjerët në çdo gjë dhe thonë; nëse njerëzit na bëjnë mirë, edhe ne u bëjmë mirë, e nëse ata na bëjnë padrejtësi, edhe ne u bëjmë atyre! Por, mësojeni veten t’u bëni mirë atyre që ju bëjnë mirë, dhe **të mos u bëni padrejtësi** (pra t’i falni) **atyre që ju bëjnë padrejtësi!**”* (Tirmidhi, Birr, 63/2007)

Nën dritën e këtyre të vërtetave, të parët tanë kanë thënë:

**“T’i bësh mirë atij që të bën mirë, është e thjeshtë për këdo. Por, t’i bësh mirë atij që të bën keq, është diçka që mund ta bëjnë vetëm të virtytshmit.”**





Në fakt, ky rregull moral është një metodë e rëndësishme e edukimit shpirtëror. Në qoftë se ai të cilit i bëhet mirësi është armik, kjo mirësi e zhbën armiqësinë dhe urrejtjen që ai ka në zemrën e tij dhe ngjall filizat e miqësisë. Nëse ai person nuk është një armik, por njeri që qëndron në një farë distance ndaj nesh, atëherë tek ai shfaqet dëshira e miqësisë dhe e afrimit. Nëse ai është një mik dhe një i afërmi i ynë, atëherë atij i shtohet dashuria ndaj nesh.

Në një ajet të Kuranit Famëlartë urdhërohet:

**“Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë.”** (Fussilet, 34)

Ibni Abbasi  e komenton këtë ajet në këtë mënyrë:

*“Ajo që nënkupton shprehja «me të mirë» është rruga e faljes në çastin e zemërimit dhe në momentin kur pëson një të keqe. Allahu  i mbron ata që mund ta bëjnë këtë, si dhe bën që keqbërësit të thyhen para tyre duke nxitur miqësinë e sinqertë.”* (Buhari, Tefsir, 41/1)

Gjatë historisë, “**falja**” ka dhënë shumë rezultate të mira dhe të pëlqyeshme në drejtim të orientimit të njerëzve nga e mira dhe e vërteta, si dhe në drejtim të heqjes dorë nga keqbërja, padrejtësia dhe dhuna e shumë njerëzve të pandërgjegjshëm. Ky virtyt është bërë shkak që të zgjohen nga gjumi i indiferencës sa e sa njerëz. Në ditën e çlirimit të Mekes, i Dërguari i Allahut, , shpalli faljen dhe sigurinë për të gjithë. Ndërsa popullit të mbledhur në Qabe u drejtoi këtë pyetje:

“Çfarë mendoni se do t’ju bëj juve tani?”

Kurejshët thanë:

“Duke shpresuar në mirësinë tënde, ne themi se do të na



bësh vetëm mirë. Ti je djali i vëllait tonë plot mirësi dhe fisnikëri, i vëllait tonë fisnik dhe të mirë”

Më pas, Profeti ﷺ u tha:

“- *Edhe unë, ashtu si Jusufi, po ju them: **Ai u tha: «Sot s’ka qortim për ju; Allahu do t’ju falë. Ai është më i mëshirshmi i mëshiruesve!»*** (Jusuf, 92). *Hajde ikni, jeni të lirë!*”

Edhe pse Allahu ﷻ bëri që idhujtarët Kurejsh, të cilët për vite kishin dhunuar myslimanët, të binin në dorën e tij dhe t’i nënshtroheshin, Profeti ynë i dashur ﷺ, i fali dhe i la të lirë ata.<sup>6</sup> Në sajë të këtij veprimi madhështor, shumë shpirtra të humbur në errësirë gjetën dritën e udhëzimit.



Zejnebja ؓ, vajza e dashur e Profetit ﷺ, tek po bënte hixhret drejt të atit, vrapoi pas një armiku të Islamit që quhej Hebar ibn Esved. Ai e goditi Zejneben me njërën nga heshtat e tij duke e hedhur në një shkëmb dhe duke e plagosur. Zejnebja, e cila ishte edhe shtatzënë, u gjakos dhe humbi fëmijën e saj. Përveç kësaj, plagët që mori në këtë ndodhi i shkaktuan vdekjen më vonë. Përveç këtij krimi, Hebari kishte kryer edhe plot gjynahe të tjera. Kur u çlirua Meka, ai u arratis dhe nuk u kap dot.

Një ditë, kur Resulullahu ﷺ, po rrinte me shokët e tij në Medinë, Hebari erdhi para tij, deklaroi se kishte pranuar Islamin dhe kërkoi falje për çdo gjë që kishte bërë. Profeti ynë ﷺ e fali edhe atë. Madje, ai ndaloi që Hebari të ofendohej apo të shahej për gjërat që kishte bërë para se të hynte në Islam<sup>7</sup>, sepse Allahu i Lartëmadhëruar urdhëron:

6. Shih. Ibn-i Hisham, IV, 32; Vakidi, II, 835; Ibn-i Sa’d, II, 142-143.

7. Shih. Vakidi, Megazi, II, 857-858.



**“Trego mëshirë, urdhëro vepra të mira dhe shmangu nga të paditurit!”** (A'raf, 199.)

Fajet apo gjynahet që i bëheshin kundrejt personit të tij, Profeti ﷺ i falte menjëherë pa treguar as më të voglën mëdyshje. Ndërsa në lidhje me fajet dhe gjynahet kundrejt shoqërisë, nuk gjente kurrë qetësi pa vendosur drejtësinë. Falja është një e drejtë dhe çështje e falësit në rastin kur ajo prek vetëm një person, por në qoftë se dëmi prek shoqërinë, atëherë duhet të mbrohet medoemos e drejta e asaj shoqërie, sepse të falësh një fajtor të tillë do të thotë t'i hapësh rrugë shumë padrejtësive të tjera, gjë që do ta shtonte edhe më tepër dhunën në shoqëri.

Virtyti i të falurit për hir të Allahut ishte tipari dallues i Profetit Muhamed ﷺ. Ky virtyt ishte kaq i pranishëm tek Resuli ﷺ sa që ai fali sa e sa njerëz të cilët i kishin bërë padrejtësi dhe e kishin ofenduar në kohën kur ai i ftonte në fenë e Allahut; ai bënte vazhdimisht dua për udhëzimin dhe hyrjen e tyre në Islam. Në një rast, kur ai kishte shkuar në Taif për të përhapur dhe shpjeguar fenë, banorët e paditur dhe zjarrputist të asaj zone, e gjuajtën me gurë duke e përgjakur të Dërguarin e Allahut ﷺ. Në atë çast, para atij Zotërie u shfaq Xhebraili ﷺ, i cili i tha se priste urdhrin e tij për t'i shkatërruar banorët e kësaj zone.

Mirëpo, Profeti i mëshirës ﷺ ia ktheu:

*“Jo, unë kërktoj nga Zoti i Lartëmadhëruar që të nxjerrë nga soji i tyre pasardhës që do të adhurojnë vetëm Allahun dhe që nuk do t'i shoqërojnë Atij asnjë shok.”* (Shihni Buhari, Bed' u'l-Halk, 7; Muslim, Xhihad, 111)

Në sajë të kësaj mëshire, pas pak vitesh populli i Taifit hyri i tëri në Islam.



Në mesin e atyre që shpifën duke përgojuar në lidhje me simbolin e nderit, nënën e besimtarëve, Aishen ة، duke kryer ndoshta edhe padrejtësinë më të rëndë në botë, ishte edhe një i varfër me emrin **Mistah**, të cilin Ebu Bekri ة e ndihmonte në mënyrë të vazhdueshme në aspektin ekonomik. Ky fakt e lëndoi shumë Ebu Bekrin ة, sepse ajo që po përgojohej ishte nëna e besimtarëve, bashkëshortja e Profetit të Allahut ﷺ dhe drita e syve të tij, pra, vajza e tij. Përballë kësaj mosmirënjohjeje të Mistahit, të cilin e kishte ndihmuar prej aq kohësh, ai merr vendimin për të mos e ndihmuar më, duke u betuar në lidhje me këtë. Me ndërprerjen e ndihmës që kishte marrë deri atëherë nga Ebu Bekri, gjendja ekonomike e familjes së Mistahit përjetoi një vështirësi shumë të madhe.

Më pas, kur Allahu i Lartëmadhëruar shpalli ajetin:

**“Vallë, a nuk doni ju që t’ju falë Allahu?”** (Nur, 22), nëpërmjet të cilit besimtarët e virtytshëm urdhërohen t’i falin dhe t’i dhurojnë edhe atyre që u bëjnë padrejtësi dhe dhunë, Ebu Bekri tha:

“Po, vallahi, unë kërkoj që Allahu të më falë mua!”. Ai pagoi shpagimin e betimit dhe filloi t’i jepte sërish Mistahit një shumë të hollash si ndihmë, ashtu që ai dhe familja e tij të mund të siguronin jetesën. (Buhari, Megazi, 34; Muslim, Tevbe, 56)

Pronari i vërtetë i faljes është Allahu i Lartëmadhëruar. Besimtarët ndjejnë kënaqësi nga falja, aq sa ndjejnë dashuri për Allahun e Lartëmadhëruar. Ata që dëshirojnë të shijojnë kënaqësinë takimit me Allahun e Lartëmadhëruar, janë ata që shpërndajnë aromën e faljes nga trëndafilat e bukur të trëndafilishtes shpirtërore. Shpirti i atij personi që për hir të Allahut arrin të falë atë që e ka dhunuar, ka fituar luftën e të vërtetën.

Në vazhdim të këshillave të të Dërguarit të Allahut, ﷺ, thuhet:



**“Zoti im më urdhëroi të këshilloj për mirë e të ndaloj nga e keqja (të njëjtën gjë jua këshilloj edhe juve).”**

Një nga shërbimet më të mëdha që mund t’i bëhet njerëzimit, është urdhërimi (këshillimi) për mirë dhe ndalimi (pengimi) nga e keqja, e cila tregon mëshirën dhe dhembshurinë ndaj krijesave për hir të Krijuesit. Nevoja më e madhe e njerëzve është **“shpëtimi me anë të besimit”**. T’i thërrasësh njerëzit drejt shpëtimit është një detyrë e shenjtë. Madje, mund të themi se është **“profesioni i profetëve”**. Allahu i Lartëmadhëruar urdhëron:

**“Pa dyshim, Ne do të kërkojmë llogari prej popujve që u kemi çuar të dërguar, e patjetër që do t’i pyesim edhe të dërguarit.”** (A`raf, 6.)

I Dërguari i Allahut ia kushtoi jetën kësaj detyre dhe në Hutben e Lamtumirës pyeti tre herë popullin duke thënë: *“A jua shpalla mesazhin?, që të merrte aprovimin e tyre në lidhje me çuarjen në vend të kësaj detyre kaq të rëndësishme dhe parësore. Kjo detyrë e shenjtë profetike është një përgjegjësi edhe për ne, si umeti i tij.*

Në Kuran urdhërohet:

**“E kush flet më bukur se ai që i fton njerëzit drejt Allahut, bën vepra të mira dhe thotë: ‘Unë, me të vërtetë jam mysliman’.”** (Fussilet, 33)

**“Le të dalë prej jush një grup që të thërrasë për në mirësi, të urdhërojë për vepra të mira e të ndalojë prej veprave të shëmtuara! Këta njerëz do të jenë të shpëtuarit.”** (Al-i Imran, 104.)

Ndërsa në një hadith profetik thuhet:

*“Betohem në Allahun e Lartëmadhëruar se, nëse Ai e nderon dikë me Islam nëpërmjet teje, kjo është më e mirë për*



*ty se sa zotërimi i një deveje të kuqe (kjo në atë kohë konsiderohej si gjëja më e shtrenjtë e botës).” (Buhari, As-habun-Nebi, 9.)*

Sa lumturi e madhe për shpirtrat e besimtarëve është përfitimi i kësaj mirësie dhe i këtij sihariqi. Në një tjetër hadith profetik thuhet:

*“Nëse dikush fton në rrugë të drejtë, shpërblehet si ata që e pasojnë atë. Dhe kjo nuk i pakëson asgjë prej shpërblimit atyre që e pasojnë atë.” ...” (Muslim, IIm, 16.)*

Ja pra, shpërblimi i përpjekjeve për të udhëzuar njerëzit në rrugën e drejtë e të hajrit, i ngjan një topi bore që duke rënë nga një pikë e lartë rritet duke vënë shtresë mbas shtrese deri sa shndërrohet në një ortek të madh. Prandaj, përpjekjet për t’i udhëzuar ata që janë të privuar nga besimi dhe tërheqja e vëmendjes ndaj besimtarëve, që për shkak të paditurisë dhe indiferencës nuk e jetojnë Islamin ashtu siç duhet, është mirësia më e madhe që mund t’i bëjmë atyre. Gjithashtu, është edhe një mundësi shumë e mirë për të fituar më tepër sevape dhe për të shlyer një pjesë të borxhit që kemi ndaj mirësisë së imanit.

Nga ana tjetër, niveli i përpjekjeve tona në çështjen e davetit është një kriter që tregon nivelin e besimit tonë.

Në një hadith thuhet:

*“Kush nga ju sheh një të keqe, le ta korrigjojë atë me dorën e tij. Nëse nuk ka mundësi për këtë, atëherë le ta bëjë me fjalën e tij. E, nëse nuk ka mundësi as për këtë, atëherë le ta urrejë me zemrën e tij. Mirëpo, kjo është gjendja më e dobët e besimit.” (Muslim, Iman, 78)*

Për ata që sillen me neglizhencë në lidhje me temën e thirrjes në rrugën e drejtë, janë bërë paralajmërime të shumta. i Dërguari i Allahut, ﷺ, ka thënë:

*“Betohem në Allahun që më dhuron jetë se, ju ose do të*





*urdhëroni të mirën dhe të ndaloni të keqen, ose Allahu do t'ju dërgojë ndonjë dënim, me ç'rast do të luteni, e lutja nuk do t'ju pranohet!"* (Tirmidhi, Fiten, 9)

Po ashtu, duhet të respektohen edhe rregullat dhe metodat e thirrjes në Islam. Përndryshe, në vend që të bëhemi të dobishëm, mund të bëhemi të dëmshëm. Për t'i ftuar njerëzit në rrugën e vërtetë dhe për t'i nxitur ata në mirësi, fillimisht duhet që e vërteta dhe mirësia të njihen në mënyrë të detajuar e me themel. Thirrja apo ftesa që bën një njeri i pakualifikuar në këtë çështje, nuk mund t'i shmanget gabimeve. Prandaj, kushti i parë i kësaj rruge është formimi intelektual dhe shpirtëror. Ashtu si nuk mund të qerasim dikë me një gotë ujë bosh, ashtu nuk mund të korrim sukses as nga një thirrje ose ftesë në Islam, pa pasur njohuritë dhe formimin e duhur shpirtëror.

Një njeri i mbushur me egoizëm dhe sëmundje të ngjashme shpirtërore, nuk mund të ngarkohet me misionin e rëndësishëm të thirrjes së të tjerëve në Islam. Kjo është zgjedhje shumë e gabuar. Kështu, duke pasur qëllimin e mirë të ftesës së njerëzve në Islam, ata bëjnë më shumë dëm sesa dobi. Për një thirrje Islame sa më të pranueshme, duhet të zotërohet një zemër e mbrujtur me urtësitë kuranore dhe një fytyrë e buzëqeshur që reflekton dashurinë dhe ëmbëlsinë e Islamit. Gjithashtu, duhet të flitet me një gjuhë shpirtërore të mbushur me mëshirë e dashuri, ndërkohë që jemi duke bërë një jetë shembullore dhe duke u bërë simboli i gjallë i ndershmerisë, virtutit, mirësisë dhe së vërtetës.

Ftesa Islame duhet bërë me një përfaqësim dinjitoz të bujarisë, mirësisë, mirësjelljes dhe delikatesës së një karakteri të fortë Islam. Njeriu ndikohet tej mase nga mirësia dhe i admiron njerëzit me karakter dhe me personalitet të fortë.

Ai që është i ngarkuar me përgjegjësinë e thirrjes Islame,



nuk duhet të privojë askënd nga ky shërbim kaq i rëndësishëm, pavarësisht nga gjynahu që ai mund të ketë bërë më parë. Duke pasur parasysh se ka edhe lule e bimë që çelin mbi gurë, madje edhe nga brendësitë e mureve, nuk duhet përjashtuar askush dhe nuk duhet harruar për asnjë çast pafundësia e mëshirës hyjnore.

Profeti Muhamed ﷺ nuk ia ka mbyllur derën e Islamit as Hebar ibn Esvedit, i cili shkaktoi vdekjen e vajzës së tij, Zejnebes, duke e rrëzuar atë nga deveja, as Ikrimë ibn Ebu Xhehilit, që deri në çlirimin e Mekes nuk la të keqe pa bërë duke u sjellë krejt armiqësisht ndaj përhapjes së kësaj feje të ndritur, as Vahshiut që martirizoi xhaxhain e tij, Hamzanë, e as bashkëshortes së Ebu Sufjanit, Hindit, e cila i nguli dhëmbët egërsisht mëlçisë së dëshmorit të Islamit, Hamzait.

Parë nga ky këndvështrim, edhe nëse bashkëbiseduesi ynë është mohues i nivelit më të ashpër, madje edhe në nivelin mohues të Faraonit, atij nuk duhet t'i mbyllet dera e ftesës në Islam. Allahu i Lartëmadhëruar e urdhëroi Musain عليه السلام të shkonte tek Faraoni dhe ta ftonte atë në rrugën e drejtë me një gjuhë të ëmbël e të butë.

Madhështia e mëshirës hyjnore duhet të shkojë edhe tek ata njerëz që janë të ngarkuar me një barrë të rëndë gjynahesh, e të cilët mendojnë se për ta nuk ka asnjë shpresë për shpëtim. Allahu i Lartëmadhëruar urdhëron:

**“Thuaj: O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti. Kthehuni tek Zoti juaj dhe nënshtroni Atij, para se t’ju vijë dënimi, sepse atëherë nuk do të mund t’ju ndihmojë kush.”** (Zumer, 53-54)



Kështu, gjynahqarët që po mbyten në batakun e gjynaheve, duhet të ftohen me metodën e mëshirës dhe fjalëve plot kuptim në rrugën plot shpresë e mëshirë të Islamit.

Ajo për të cilën duhet të tregojnë kujdes thirrësit Islam, është të mos bien në pesimizëm dhe plogështi, të mos shprehin lodhje dhe mërzë, por të jenë të vazhdueshëm e të qëndrueshëm në këtë thirrje, duke lënë rezultatin e përpjekjeve të tyre në dorë të Allahut dhe duke u mbështetur krejtësisht tek Ai. Gjithashtu, ata duhet t'i mbështeten Allahut për t'u çliruar nga egoizmi i të mjaftuarit vetëm me shpëtimin e vetes, pa u përfshirë në një sërë vështirësish që paraqet kryerja e kësaj detyre.

Allahu i Lartëmadhëruar, nëpërmjet një pafundësie krijesash që ka krijuar, na shpjegon shumë të vërteta dhe urtësi. Të mund ta lexosh siç duhet këtë botë fshehtësish dhe urtësish, është një art shpirtëror. Për ata që kanë një zemër të aftë për të marrë mësimë shpirtërore, universi është një shkollë mundësish. Duke i zbërthyer dhe grumbulluar fshehtësitë dhe urtësitë e kësaj bote, robërit e devotshëm të Allahut përhapën aroma shpirtërore për shpirtrat e etur për dije.

Ja pra, për ata që kanë shpirt të ndjeshëm dhe sy që shohin, Allahu i Lartëmadhëruar shpalos urtësi dhe mësimë në çdo krijesë të Tij. Nëpërmjet tyre, Ai na tërheq vëmendjen, sidomos në urtësinë e "**altruizmit**":

Për shembull, bleta që jeton vetëm dyzetepesë ditë, bën mjalte për vete. Mirëpo, ajo prodhon mjalte ndoshta njëqind fish shumë se sa ka nevojë. Kështu që, në një farë mënyre, ajo shpreh se qëllimin e saj të jetës, është t'u shërbejë sa më shumë të tjerëve.

Po ashtu, një kokërr kumbull, që është edhe fruti, edhe fara e pemës së saj, shërben dhe është i mjaftueshëm për vazhdimësinë



e llojit të saj. Por, edhe pse një frut i vetëm është i mjaftueshëm për vazhdimësinë e llojit të kumbullës, ajo prodhon shumë prej këtyre frutave në mënyrë që edhe të tjerët të përfitojnë prej saj. Sa të bukur janë këta shembuj altruizmi që shpalos Allahu i Lartëmadhëruar në natyrë!

Me anë të një peme rrap, Zoti ynë na tregon shembullin e jetës së kësaj bote. Kur vjen dimri, një pemë madhështore si rrap, zhvishet nga gjethet dhe me gjuhën e tij të veçantë na flet në heshtje për vërtetësinë e vdekjes. Ndërsa në pranverë, me blerimin e tij bëhet simboli i ringjalljes pasvdekjes. Por edhe me gjithë atë madhështi që zotëron, rrap është një pemë pa fruta. Ai nuk mund të përdoret as si lëndë druri për ndërtim, por vetëm për zjarr. Dobia që përftohet prej tij është pakët. Madhështor në dukje, rrap me gjuhën e tij na jep vazhdimisht mesazhin: “Kuptojeni përkohshmërinë tuaj dhe mos u bëni si unë, pemë pa fruta!”.

Cilësitë që zotërojmë duhet të jenë si ato të pemës së ullirit, me dobi të shumta. Ulliri, edhe pse me trung të vogël, fillon të japë prodhim një vit pas mbjelljes së tij dhe e vazhdon pareshtur këtë shërbim për aq kohë sa jeton. Një trëndafil, me gjuhën e gjendjes së tij na thotë: “Për shkak të durimit që kam treguar ndaj gjembit, unë buzëqesh gjithmonë me aromën time të këndshme. Bëhuni edhe ju si unë!”

Pasuria larg bujarisë dhe altruizmit, shëndeti për të cilin nuk shprehet asnjë mirënjohje e as falënderim, pozita, dituria, si dhe gjëra të tjera që arrihen për ego, janë si “madhështia e një rrap të tharë”. Për besimtarët është e rëndësishme të mund të jenë si një pemë me fruta dhe të përpiqen ta rrisin sa më shumë frytshmërinë e tyre.

Njeriu duhet t'i kërkojë llogari vazhdimisht vetes duke u matur me këto mendime dhe ndjenja:



“Sa përkujdesem unë për vete dhe për nevojtarët që më rrethojnë? Sa sakrifikoj nga vetja për ta? Çfarë më flet mua një bletë, një trëndafil, një pemë kumbulle, një pemë ulliri?”

Duke qenë një krijesë me më shumë vlera, njeriu duhet të jetë shumë herë më i dobishëm se sa blea dhe krijesat e tjera. Pra, ajo çka i ka hije njeriut që ka statusin më të lartë në mesin e krijesave, është **“t’i shërbejë vetes një e të tjerëve njëmijë”**. Allahu i Lartëmadhëruar urdhëron:

**“...Të pyesin se çfarë duhet të japin si lëmoshë. Thuaju: ‘Tepricën!’...”** (Bekare, 219)

**Allahu na bëftë nga njerëzit e vetëdijshtëm në lidhje me begatitë që Ai na dhuron dhe ta çojmë jetën me vepra sa më të frytshme, në mënyrë që të përshtaten me pëlqimin e Tij! Allahu na përfshiftë në bashkësinë e atyre besimtarëve vepërmirë, prej dorës, gjuhës, gjendjes dhe moralit të të cilëve njerëzit kanë vetëm dobi! Allahu i pajtoftë qëllimet, mendimet, ndjenjat dhe veprat tona me pëlqimin e Tij!**

**Amin!..**





# DASHURIA NDAJ EHLI BEJTIT



*Ehli Bejt janë përsonalitete të zgjedhura që kanë dëshmuar nga afër bukuritë profetike, pra, bukurinë e fytyrës së Pejgamberit, përsosmërinë e gjuhës së tij, delikatesën (elegancën, hijeshinë, bukuritë) e veprimeve të tij dhe elokuencën e kumtesave të tij.*

*Ata ishin më të dashurit e të Dërguarit të Allahut sepse ishin mpleksur me gjëndjet e tij, ishin pajisur me moralin e tij dhe edukuar nën kujdesin e tij.*





# DASHURIA NDAJ EHLI BEJTIT

*“Duajeni Allahun e Lartëmadhëruar sepse Ai ju ka trajtuar me mirësitë e Tij. Më doni mua për hir të dashurisë ndaj Allahut. Dhe duajeni Ehli Bejtin tim për hir të dashurisë ndaj meje!”* (Tirmidhi, Menâkib, 31/3789)

## Dashuria dhe Miqësia

Dashuria dhe miqësia burojnë nga emocionet dhe gjëndjet e përbashkëta. Sa më të shumta të jenë të përbashkëtat, aq më e madhe është edhe dashuria.

Allahu i Lartëmadhëruar i do më shumë ata robër tek të cilët vëren cilësi të bukura dhe i nderon ata me një afërsi dhe miqësi të veçantë.

Jakubi عليه السلام donte më shumë Jusufin ndër dymbëdhjetë fëmijët e tij, sepse tek ai kishte parë më shumë se tek tjerët ndjesitë, mendimet, aftësitë dhe cilësitë e veta. **Pra, miqësia buron nga cilësitë e njëjta që kanë dy personave që duhen.**

Pikërisht për këtë arsye më të afërmit e të Dërguari i Allahut ishin pjesëtarët e familjes së tij, pra **Ehli Bejti**, sepse tek ata dëshmoheshin më qartë gjëndjet dhe cilësitë e tij të larta.



Ehli Bejt janë personalitete të zgjedhura që kanë dëshmuar nga afër bukuritë profetike, pra, bukurinë e fytyrës së Profetit, përsosmërinë e gjuhës së tij, delikatesën (elegancën, hijeshinë, bukuritë) e veprimeve të Tij dhe elokuencën e kumtesave të tij.

Ata ishin më të dashurit e të Dërguarit të Allahut sepse ishin mpleksur me gjendjet e tij, ishin pajisur me moralin e tij dhe edukuar nën kujdesin e tij.

Për këtë arsye, për të qenë të meritueshëm ndaj dashurisë së Profetit Muhamed ﷺ dhe për të mos u privuar për asnjë çast nga dashuria e tij, ato personalitete të nderuara bënë shumë sakrifica gjatë gjithë jetës së tyre, vuajtur shumë vështirësi të ngjashme me ato të Profetit ﷺ.

Njeriu, koston më të lartë e paguan në rrugën e arritjes së gjërave që dashuron. **Kostoja më e lartë që paguhet në këtë botë të përkohshme, është kostoja e dashurisë hyjnore.**

Ehli Bejti përbën një kulminacion të pagimit të kësaj kostoje, pra koston më të lartë të dashurisë ndaj Zotit, me iman të lartë dhe kënaqësi.

## Ehli Bejti

Familjarët e dashur të asaj qenieje të nurtë, Profetit ﷺ...

Soj i nderuar që ka ndërtuar karakterin e vet duke u mburrur me virtytet, botën shpirtërore, diturinë dhe moralin profetik.

Këto personaletete të larta, që janë monumente devotshmërie dhe sinqeriteti në lidhjen dashurore me Profetin, janë **“Al-i Muhamed”**<sup>8</sup> ﷺ ...



Ehli Bejti përfshin fillimisht anëtarët e familjes së Profetit. Ehli Bejti përfshin Resulin dhe familjen e tij, Aliun, Xhaferin, Akilin, Abasin dhe familjet e tyre.

Ashtu siç është detyrë për çdo besimtar të dërgojë salavat për Resulullahun ﷺ, ashtu është detyrë për çdo besimtar të shpreh mirënjohje, respekt dhe dashuri ndaj Ehli Bejtit, sepse rezultati më i natyrshëm i dashurisë që ndiejmë ndaj dikujt, është përfshirja në këtë dashuri e çdo gjëje dhe çdokujt që lidhet me të. Këta mund të jenë njerëz, mund të jenë jofrymorë, mund të jenë veprime, mund të jenë edhe zona gjeografike.

Për shembull, nëse dashuroni dikë me gjithë shpirt, kur shihni ndonjë njeri tjetër që ka cilësitë e personit që dashuroni, menjëherë kujtoni atë që dashuroni dhe ndoshta për hir të kësaj, ai person fillon të jetë më i dashur për ju se të tjerët. Sigurisht kjo merr përmasa në varësi të dashurisë që ndjeni ndaj personit që dashuroni. Çdo gjë e personave që dashurojmë ndikon thellë në zemër, madje edhe mënyra e të ulurit, ngritja në këmbë, stili i të veshurit, e plot e plot të tjera. Po ashtu, edhe dashuria dhe respekti ndaj sendeve personale të Profetit ﷺ, vijnë si rezultat i këtij ndikimi.

Dashuria ndaj Allahut është maja e ndjesisë në konceptin e dashurisë. Një gradë më poshtë gjendet dashuria ndaj Profetit Muhamed ﷺ, si i Dërguari dhe i dashuri i Allahut. Personat që mbruhën me dashurinë ndaj Resulit, për arsyet që cituam më lart, mbushen me dashurinë ndaj Ehli Bejtit dhe admirojnë cilësitë e tyre të bukura.

Zejd ibn Erkam  shpjegon:

Një ditë, kur Resulullahu ﷺ, ishte në krye të burimit Hum ndërmjet Mekës dhe Medinës, u ngrit në këmbë dhe na mbajti një fjalim. Pasi falënderoi Allahun, na këshilloi:



“O njerëz! Edhe unë jam njeri. Së afërmi do të vij edhe për mua i dërguari i Zotit (për vdekjen) dhe unë do ti përgjigjem ftesës së tij. Do t’ju lë pas dy gjëra të rëndësishme. Njëri është Kurani, libri i Allahut, udhërrëfyesi i njeriut drejt të vërtetës dhe burimi i dritës. Kapuni pas saj dhe mos u ndani nga mësimet e tij!”

Pasi na këshilloi se si të kapemi pas mësimëve të Kuranit dhe ta respektojmë atë, Profeti ﷺ, vazhdoi duke thënë:

“Po ju lë pas edhe Ehl-i Bejtin. Kijeni frikë Allahun dhe respektojeni familjen time! Kijeni frikë Allahun dhe respektojeni familjen time!”

Husajn ibn Sebre e pyeti Zejdin:

-O Zejd! Kush është Ehl-i Bejti i Profetit? A nuk janë vetëm gratë e tij familja e Profetit?

Zejdi u përgjigj:

-Gratë e tij janë familja e Profetit, por, edhe të gjithë ata që e kanë të ndaluar të marrin sadaka nga myslimanët pas vdekjes së tij, janë familja e Profetit.

Husajni e pyeti:

-Kush janë ata persona që e kanë të ndaluar që të marrin sadaka?

-Familja e Aliut, e Akilit, e Xhaferit dhe e Abasit” (Muslim, Fedailus-Sahabe, 36)



## Selmani është prej nesh

Tani do të trajtojmë temën e të qenurit pjesë e Ehli Bejtiti në planin shpirtëror. Selman Farisiu ﴿﴾ kishte një karakter spi-




katës në Islam, të cilin e rrezantonte me të gjitha gjëndjet e tij, saqë edhe Ensarët, edhe Muhaxhirët donin ta kishin të tyrin dhe thoshin:




“Selmani është prej nesh.”

Pas kësaj përpjekje për ta bërë Selmanin , pjesë të tyren, Profeti Muhamed  ia fitoi zemrën duke e përgëzuar:

*“Selmani është prej nesh, është pjesë e Ehli Bejtit.”* (Ibni Hisham, III, 241; Vakidi, II, 446-447; Ibni Sad, IV, 83; Ahmed, II, 446-447; Hejthemi, VI, 130)



Kjo do të thotë se kushti kryesor për të qenë pjesëtar i Ehli Bejtit, është **“takva-ja”**. Pra, krahas të qenurit pjesëtar i Ehli Bejtit si pjesë e trungut familjar të Profetit, ekziston edhe mundësia e të qenurit pjesëtar i Ehli Bejtit në planin shpirtëror. Dhe kjo, është grada më e lartë për zemrat besimtare.

Sa i bukur është shembulli i Muadh ibn Xhebelit , që në mesin e sahabëve spikaste me virtytet dhe takvanë e tij:

Kur Profeti Muhamed  po e përcillte Muadh ibn Xhebelin  me detyrën e valiut në Jemen, e shoqëroi atë deri jashtë Medinës. Muadhi ishte hipur mbi kafshë, kurse Profeti Muhamed  po ecte në këmbë. Pasi e këshilloi atë për disa çështje, i tha:

*“O Muadh! Ndoshta mbas këtij viti nuk do të mund të më shohësh më! Njëra prej mundësive është që kur të vish, do të vizitosh varrin tim në mesxhidin tim!”*

Me ti dëgjuar këto fjalë, Muadhi  filloi të përlotej. Pastaj i Dërguari i Allahut  i tha:

9. Të qëndruarit larg gjynaheve duke iu frikësuarit Allahut , të qenurit i përpiktë (skrupuloz) ndaj urdhëresave dhe ndalesave të Allahut .



“Mos qaj o Muadh!” Ktheu kokën nga Medina dhe vazhdoi:

“Nga njerëzit më të afërt për mua, kushdo dhe kudo që ata të jenë, janë njerëzit që i frikësohen Allahut.”<sup>10</sup>

Një shembull tjetër i bukur në lidhje me këtë temë, është edhe ai i Usame ibn Zejd رضي الله عنه:

Një ditë, Aliu dhe Abasi رضي الله عنه shkuan tek Profeti dhe e pyetën se kë donte ai më shumë nga umeti i tij. Resulullahu صلى الله عليه وسلم i përgjigj:

“Vajzën time Fatimen.”

Ne nuk e kemi fjalën për atë që do prej gjinisë femërore o i Dërguari i Allahut! Atëherë Profeti صلى الله عليه وسلم iu përgjigj:

“Më i dashuri tek unë nga njerëzit e mi, është Usame ibn Zejd, i cili gëzon favoret e Allahut dhe të miat...” (Tirmidhi, Menakib, 40/3819)

Në këtë mënyrë, me shprehjen: “Miqtë e mi të vërtetë janë ata që i frikësohen Allahut صلى الله عليه وسلم, pra ata që kanë takva”, i dërguari i Allahut صلى الله عليه وسلم na zbulon se “**takva**”- ja është kushti më i rëndësishëm për t’iu afruar atij, si dhe shkaku i vetëm nëpërmjet të cilit njeriu rritet shpirtërisht drejt Krijuesit të vet.

Muhadithi i madh, Hakim et-Tirmidhiu, thotë se, për shkak se miqtë e Allahut janë vazhdimisht në kontakt me përmendjen e Zotit, ata konsiderohen si pjesëtar të Ehli Bejtit, jo nga aspekti i prejardhjes (pra jo nga gjaku) por për shkak të afinitetit shpirtëror. Në fund të fundit Resulullahu صلى الله عليه وسلم është dërguar për të gjallëruar përmendjen e Allahut dhe për ta rrënjosur atë thellë në zemrat e njerëzve. (shih. Hakim et-Tirmidhi, Kitabu Hatmil-Evljia, s. 345-346)

Nisur nga hadithi profetik: “Njeriu është me atë që do!” (Buhari, Edeb, 96), mund të thuhet se, për të qenë afër Profetit tonë

ﷺ, për t'u përfshirë në hallkën e miqve dhe të Ehli Bejtit të tij, duhet që, fillimisht zemra të mbushet me frikë dhe dashuri ndaj Allahut të Lartëmadhëruar, pra duhet ta kemi vazhdimisht zemrën të mbushur me Allahun e Lartëmadhëruar dhe me të Dërguarin e Tij të dashur. Treguesi më i qartë i kësaj gjendjeje shoqërimi vërehet në adhurimet dhe në veprat tona.

### Edukimi i Ehli Bejtit

I Dërguari i Allahut ﷺ, për pjesëtarët e familjes së tij të nderuar, ndaj të cilëve ishte shumë i dhembshur, dëshironte një jetë të mbushur me takva deri në atë nivel sa të bëheshin modele për njerëzimin.

Ehli Bejtin e tij, që ai e vlerësonte dhe çmonte aq shumë, e orientonte drejt sinqeritetit, takvasë, urtësisë, thjeshtësisë dhe hijeshisë, në mënyrë që pjesëtarët e tij të jetonin në përputhje të plotë me kriteret që mundësojnë lartësimin në këtë botë dhe në Ahiret.

Profeti kishte një dashuri të veçantë ndaj vajzës së tij dhe nënës sonë Fatimes. Asnjë vajzë nuk mund ta dojë babanë e saj sa e deshi nëna jonë Fatimja të atin dhe, asnjë baba nuk mund ta dojë vajzën e vet sa e donte Profeti vajzën e tij, Fatimen. Ne mendojmë dhe besojmë se në çdo familje duhet të ketë një emër Fatime, që mund të bëhet shkak për t'u afruar me Profetin Muhamed ﷺ dhe për të gëzuar mëshirë e begati.

I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë:

*“Fatimja është një pjesë nga unë. Ai që e ka mërzitur atë, më ka mërzitur edhe mua, ai që e ka lumturuar atë, më ka lumturuar edhe mua.”<sup>11</sup>*

11. . Muslim, Fedailus-Sahabe, 93-96.



Profeti ﷺ e ka përgëzuar vajzën e tij Fatimen, duke e lajmëruar se do të ishte një nga zonjat më të virtytshme të Xhenetit<sup>12</sup>. Por, në të njëjtën kohë, ai edhe e paralajmëronte shpesh herë atë që të mos binte në indiferencë ndaj përgjegjësiave që i ka obliguar Allahu duke menduar se është e bija e Resulullahut:

*“O Fatime! Ruaje veten nga zjarri i xhehenemit! Unë nuk kam fuqi t’ju shpëtoj nga dënimi i Allahut, por, për shkak të lidhjes farefisnore që kemi, as nuk do ti pres marrëdhëniet që kam me ju!”* (Muslim, Iman, 348, 351)<sup>13</sup>

Edhe pse ndër të gjithë pjesëtarët e Ehli Bejtit, Profeti ﷺ donte më shumë Fatimen, ai vazhdimisht kërkonte prej saj që mirësitë e kësaj dynjaje t’i shfrytëzonte në një minimum të mundshëm, duke bërë një jetë pothuajse askete dhe, tepricat e këtyre mirësive t’i dhuronte në rrugë të Allahut. Ai nuk toleronte që në zemrën e saj të lindte sadopak lakmi ndaj kësaj bote. Kështu, ai e udhëhiqte vazhdimisht vajzën e tij të dashur drejt Ahiretit.

Një ditë, Profeti ﷺ vërejti një gjerdan në qafën e së bijës. Ajo zonjë e zgjuar dhe e sjellshme, nuk vonoi të kuptonte shqetësimin e të atit. Menjëherë e shiti gjerdanin e saj dhe, edhe pse ishte vetë në gjendje vështirësie, me atë shumë parash i dhuroi një skllavi lirinë aq shumë të ëndërruar. Dhembshuria, mëshira dhe bujaria e vajzës së tij, e lumturoi pamasë Profetin ﷺ. (Nesai, Zijnet, 39)

Fatimja ﷺ ishte një zonjë e imët dhe e dobët në askpektin fizik. Punët e shtëpisë ishin mjaftueshmërisht të lodhshme. Fatimja ndizte oxhakun dhe mundohej kur gatuante ushqimin. Ndonjëherë, tek i fryente zjarrit për ta ndezur, ndodhte që i digjej

12. . Ahmed, I, 293.

13. . Gjithashtu shihni Buhari, Tefsir, 26/2; Tirmidhi, Tefsir, 27/2.





edhe rroba që kishte veshur. Ajo ndotej me pluhur e dhé tek pastronte shtëpinë. Hera-herës i bëheshin duart me plagë duke rrotulluar gurin e mullirit për të bluar misrin dhe kurrizi i bëhej gjak duke bartur ujë.

Njëherë, Profeti ﷺ i sollën disa robër lufte. Me këtë rast, Fatimja kërkoi nga babai i saj njërën nga ato si ndihmëse. Sërish Profeti ﷺ duke e orientuar qenien më të dashur të tij drejt lumturisë së përjetshme, i tha:

*“O Fatime! Ki frikë Allahun! Kryeji (me përkushtim e devocion) obligimet farz ndaj Allahut! Bëj punët e shtëpisë! Kur të hysh në shtrat thuaj tridhjetetë herë subhanallah, tridhjetetë herë elhamdulillah, tridhjetekatër herë Allahu ekber! Këto janë për ty më të dobishme se një hyzmeqar.*

Fatimja ﷺ, duke shprehur dorëzimin dhe pëlqimin e vet, tha:

“Jam i kënaqur prej Allahut dhe Resultit të Tij!”

Kështu, Profeti ﷺ nuk ia plotësoi vajzës së Tij të dashur nevojën për të marrë një hyzmeqare. (Ebu Davud, Haraxh, 19-20/2988)

Sipas një tjetër transmetimi, Profeti ka thënë:

*“Vallahi, për sa kohë që banorët e Suffes lidhin gurë në bark nga uria dhe unë nuk mundem t’i ndihmoj ekonomikisht, as juve nuk mund t’ju siguroj hyzmeqar. Fidjet<sup>14</sup> që do të marrë në këmbim të robërve të luftës, do t’i shpenzoj për sahabët e Suffes.”* (Ahmed, I, 106)

Kështu e ka edukuar i Dërguari i Allahut ﷺ vajzën e tij, duke i këshilluar thjeshtësinë dhe një stil modest jetese. Tekefundit, nëna jonë Fatimja do të bëhej “nëna” e Ehli Bejtit. Një tjetër

14. . Shpërblim lirim, shpërblim i dhënë në këmbim të lirimit.



shembull që tregon përkujdesjen e Profetit ﷺ për edukimin shpirtëror dhe për përgatitjen ndaj jetës së pasosur të pjesëtarëve të familjes së tij, është ky:

Në disa ajete të sures Ahzab thuhet:

**“O gratë e të Dërguarit! Ju nuk jeni si gratë e tjera. Nëse i frikësoheni Allahut, mos flisni me përkëdheli, që të mos ju dëshirojë ai që ka zemër eposhore, por flisni drejt dhe në mënyrë të ndershme! Qëndroni në shtëpitë tuaja e mos i zbuloni stolitë tuaja, ashtu siç zbuloheshin në kohën e padijes! Falni namazin, jepni zeqatin dhe bindjuni Allahut e të Dërguarit të Tij! O Familje e Profetit! Në të vërtetë, Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë (gjynahet) dhe t’ju pastrojë plotësisht.”** (Ahzab, 32-33)

Pasi u shpallën këto ajete, i Dërguari i Allahut ﷺ, për gjashtë muaj rresht nuk doli asnjëherë për të falë namazin e sabahut pa u ndalur më parë tek dera e Fatimes për ta paralajmëruar duke i thënë:

**“Zgjuhuni për të falur namazin o Ehli Bejt! «Në të vërtetë, Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë (gjynahet) dhe t’ju pastrojë plotësisht.»**” (Tirmidhi, Tefsir, 33/3206)

Në rastet kur për arsye lodhjeje ata mund të mos zgjoheshin në namazin e natës, i cili është edhe një ndër kapitalet kryesore të lumturisë shpirtërore, Profeti i trokiste në derë Aliut dhe Fatimes, për t’iu kujtuar atyre kohën e namazit të natës.

Enes ibn Malik ؓ ka thënë:

**“Nuk kam njohur askënd më të dhemshur ndaj pjesëtarëve të familjes, sesa Resulullahun ﷺ.”**

Kjo shprehje, do të thotë se asnjë njeri nuk mund t’i edukojë më mirë pjesëtarët e familjes së vet sesa Muhamedi ﷺ. Profeti



ﷺ ka jetuar në përputhje të plotë me parimet e përsosura të Islamit, me disiplinë të hekurt dhe takva, në mënyrë që pjesëtarët e familjes së tij, duke qenë se ishin familja e Profetit dhe duke marrë shembull prej tij, të bëheshin edhe vetë shembull për të tjerët.

Ashtu siç Profeti Muhamed ﷺ në sajë të edukimit hyjnor u bë zotëria i të gjithë profetërve, ashtu edhe pjesëtarët e familjes së tij të nderuar, nën edukimin cilësor të Resulullahut ﷺ, u bënë modele për njerëzit e tjerë.

Dhe, me të vërtetë që Familja e Profetit ishin njerëz të zemrës, në harmoni me jetën e Profetit dhe të mbërthyer me dashuri përreth të Dërguarit të Allahut ﷻ, i cili u dërgua si mëshirë për botët. Ashtu si një fllad që fryn në një kopsht të zbukuruar me trëndafila, karajfila dhe plot lule të rralla dhe çon kudo ku vete aromat e këndshme dhe qetësuese të këtij kopshti, ashtu edhe pjesëtarët e Ehli Bejtit, të cilët arritën gradat e përsosmërisë nën edukimin e të Dërguarit të Allahut ﷻ e shpërndanë me sinqeritet dhe përkushtim shembullor në gjeneratat e mëvonshme përmasën shpirtërore të atij Profeti madhështor.







## EBU BEKRI رضي الله عنه





*Ai kapërceu vetveten duke jetuar një jetë plot me zjarr dashurie hyjnore. Vetëm tek i Dërguari i Allahut gjeti jetë. Ai përjetonte emocione të forta shpirtërore sa herë që takohej me të ose bisedonin së bashku. Kur ishte në praninë e Profetit, në vend që dashuria ndaj tij t'i qetësohej, ndodhte krejt e kundërta: zjarri i dashurisë për Profetin i shtohej edhe më shumë.*



## EBU BEKRI

Periudha më e veçantë në historinë e njerëzimit, përse i takon virtytit, drejtësisë, altruizmit dhe moralit të lartë, është në mënyrë të padiskutueshme Epoka e Lumturisë, sepse në atë periudhë jetoi Profeti i dashur i Allahut, Muhamedi . Ajo periudhë mori formë me frymëzimin e tij shpirtëror. Po ashtu, ajo ishte koha kur Allahu i Lartëmadhëruar dhe Profeti i Tij, Muhamedi , u njohën më nga afër brenda një atmosfere meditim të thellë.

Gjatë asaj periudhe të ndritur, shoqërisë iu bë e mundur që, nga një injorancë e thellë, të lartësohej aq shumë sa të ngrihej në majat e qytetërimit të virtyteve, duke arritur deri në marifetullah, pra deri në njohjen e Zotit me zemër. Individët e kësaj shoqërie janë emërtuar **“sahabe-i kiram”**, pra, njerëzit me shumë vlera, miqtë e nderuar dhe ndjekësit shpirtërorë të Profetit  në çdo çështje.

Prej këtu mund të themi se brezi i vetëm që perceptoi në formën më të plotë fjalët, veprimet dhe gjendjet e të Dërguarit të Allahut  dhe që na përcolli çdo shenjë të nurtë të rrugës së tij, është brezi i artë i sahabëve.



## Hulefa-i Rashidin

Në krye të sahabëve që ndërtuan personalitetin e tyre duke u mbajtur me mëshirën shpirtërore, ndjeshmërinë dhe parimet e të Dërguarit të Allahut, janë padyshim **Hulefai Rashidinët**, pra, katër kalifët e mëdhenj. Kjo, sepse ata u lidhën tërësisht me një dashuri të pashembullt me të Dërguarin e Allahut ﷺ. Ashtu si një pikë uji që shkrihet në tërësinë e oqeanit, edhe ata u shkrinë në gjendjet dhe në moralin e të Dërguarit të Allahut ﷺ. Nëpërmjet dashurisë ndaj të Dërguarit të Allahut ﷺ, bota e tyre shpirtërore u bë caku ku manifestohej dashuria hyjnore dhe saraji i mrekullueshëm i thesareve të njohjes së Zotit. Fjalët dhe gjendjet e tyre plot kuptim, u shndërruan në një korpus urtësie dhe sekretit, duke u bërë për të gjithë njerëzimin burimi më i mirë i këshillës dhe modelit që duhet ndjekur.

Duke na lajmëruar për rëndësinë që do të kishte periudha e Hulefai Rashidinëve, Profeti ﷺ ka thënë:

*“(Pas meje) Kalifati i nubuvvetit do të zgjasë tridhjetë vjet...”<sup>15</sup>*




Kështu, ai la të kuptohej se për një kohë të caktuar, sistemi administrativ do të funksiononte në mënyrë të rregullt, e më pas, ky sistem do të dobësohej dhe nuk do të funksiononte si duhet.

Gjatë viteve të para të kësaj periudhe, harmonia dhe qetësia e kohëve të arta nuk u ndërprejnë por vazhduan lulëzimin e tyre. Faktori kryesor që ndikoi pozitivisht në lidhje me këtë qendrueshmëri, ishte largpamësia dhe aftësia e Ebu Bekrit ؓ .





## Ebu Bekri

I zgjedhuri i parë si kalife, **Ebu Bekri** , në Epokën e Lumturisë ishte shkrirë i tëri në besnikëri, në dorëzim të plotë dhe në dashuri ndaj të Dërguarit të Allahut . Ai e ka përjetuar lidhjen shpirtërore me Resulin e Zotit në nivelin më të lartë. Në lidhje me Ebu Bekrin, Profeti Muhamed  ka thënë:

*“Çdo gjë që kam në zemrën time, ia kam dhënë Ebu Bekrit.”*<sup>16</sup> Duhet thënë se kjo gjendje nuk ka qenë pa kosto, por është arritur në sajë të shumë sakrificave dhe vuajtjeve. Tekembramja, për hir të dashurisë njeriu është gati të paguajë koston më të lartë. Kostoja më e lartë që duhet paguar në këtë botë të përkohshme, është kostoja e dashurisë ndaj Allahut të Lartëmadhëruar.

Ebu Bekri jetoi me dëshirën dhe përpjekjen titanike për të qenë i gatshëm për flijimin e çdo gjëje me qëllimin e vetëm që të plotësohej me kënaqësinë e miqësisë me të Dërguarin e Allahut. Gjatë hixhretit/emigrimit, ai pati nderin të ishte bashkudhëtar i të Dërguarit të Allahut . Në këtë udhëtim të rëndësishëm ku u përjetuan shumë manifestime të mistershme hyjnore, në shpellën Sevr, gjatë një intervali kohe prej tre ditësh, nga gjoksi i Profetit  rrezatuan shumë urtësi dhe mistere. Ebu Bekri u bë meritues i nderit dhe virtytit të të qenit bashkë me Profetin. Në atë vend, që u bë shkollë e kredhjes në misteret hyjnore dhe në ngritjen shpirtërore, ai u nderua me titullin **“i dyti i të dyve”**, ku i treti i tyre ishte vetë Allahu i Lartëmadhëruar. Ajo qenie e përndritur i tha shokut të tij: **“Mos u mërzit, Allahu është me ne!..”** (Teube, 40), duke instaluar tek ai **“të fshehtën e maijjetit”**, pra të vërtetën e të qenit vazhdimisht me Allahun e Lartëmadhëruar.

16. Shih. Axhluni, *Keshfu’l Hafa*, v. 2, s. 419.



Këto gjendje, mjeshtërit shpirtërorë i kanë vlerësuar si fillesat e dhikrit të fshehtë dhe si shfaqjet e para të arritjes së qetësisë shpirtërore nëpërmjet përmendjes së Allahut të Lartëmadhëruar. Vendi i parë ku në skenën e historisë Islame u shfaq rruga e transmetimit të të vërtetave nga zemra në zemër, është shpella Sevr. Ndërsa fatlumi i parë që u prezantua me të, është Ebu Bekri رضي الله عنه. Prandaj, pas të Dërguarit të Allahut, ai është pranuar si hallka e parë e **Vargut të Artë** që do të vazhdojë deri në kiamet.

Kjo do të thotë se qëllimi i të gjitha rrugëtimitëve të shenjta arrihet në raport me dashurinë ndaj Allahut dhe Resultit të Tij. Tekefundit, kushti i dashurisë dhe treguesi i ashkut është të duash ato gjëra që do personi që ti dashuron.

Pra, njësimi me objektin tënd të dashurisë dhe shkrirja e gjendjeve të dy të dashuruarve është një hap shumë i rëndësishëm i rrugëtimit në fjalë. Jeta e Ebu Bekrit është e mbushur me manifestime të tilla.

### **Ebu Bekri është prej meje dhe unë jam prej tij.**

Ai kapërceu vetveten duke jetuar një jetë plot me zjarr dashurie hyjnore. Vetëm tek i Dërguari i Allahut gjeti jetë. Ai përjetonte emocione të forta shpirtërore sa herë që takohej me të ose bisedonin së bashku. Kur ishte në praninë e Profetit, në vend që dashuria ndaj tij t'i qetësohej, ndodhte krejt e kundërta: zjarri i dashurisë për Profetin i shtohej edhe më shumë.

Një ditë Muhamedi صلى الله عليه وسلم tha:

*“Sa kam pasur dobi nga pasuria e Ebu Bekrit, nuk kam pasur dobi nga pasuria e askujt tjetër...”*

Pasi dëgjoji këto fjalë komplimentuese, Ebu Bekri u përplot dhe tha:



“A nuk jemi unë dhe pasuria ime vetëm për Ty o Resulullah?!”  
(Ibni Maxhe, Fedailu As’ habin-Nebi, 11). Me këto fjalë, ai donte të thoshte se vetveten dhe çdo gjë të tijën, ia kishte kushtuar Profetit, tek i cili ishte shkrirë krejtësisht.

Gjithashtu, Profeti ﷺ është shprehur:

“*Ebu Bekri është prej meje dhe unë jam prej tij. Ebu Bekri është vëllai im në dynja dhe në ahiret.*” (Tirmidhi, Menakib, 20.)

Nga ky hadith, kuptohet qartë uniteti i të Dërguarit të Allahut me Ebu Bekrin në planin shpirtëror dhe marrëdhënia e tyre në planin emocional e ndjesor.

### Miku më i ngushtë i fshehtësive profetike

Zemra e Ebu Bekrit ﷺ ishte pasqyra më e kristaltë që reflektonte botën shpirtërore të Resulullahut, ﷺ. Kështu, ai ishte modeli shembullor që personifikonte shkrirjen shpirtërore tek Profeti. Në sajë të kësaj lidhjeje të fortë, çdo gjë që lidhej me Muhamedin ﷺ, fitonte kuptim shumë të thellë në zemrën e tij. Ebu Bekri ﷺ arriti të bëhej njëri nga sahabët më të aftë në kuptimin e duhur të ajeteve të Allahut, fjalëve të Resulullahut dhe rrjedhës së ngjarjeve. Shumë urtësi profetike, që të tjerët nuk arrinin t’i kuptonin, ai i kapte në mënyrë intuitive, falë largpamësisë dhe dhuntive të tij perceptuese. Kur në haxhin e lamtumirës u shpall ajeti: “**...Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj...**” (Maide, 3), të gjithë u gëzuan për plotësimin e fesë, por Ebu Bekri arriti të kuptojë në mënyrë të natyrshme se tani që feja ishte kompletuar në aspektin e shpalljes, Allahu i Lartëmadhëruar do ta ftonte së shpejti të Dashurin e Tij, Resulullahun ﷺ, në botën e përtejme. Në atë çast, ndërkohë që të tjerët lumturoheshin, atij iu mbush gjoksi me hidhërimin që shkaktohet nga ndarja e dy të dashuarve.



Një tjetër shembull që dëshmon mendjemprehtësinë e Ebu Bekrit, është edhe ky:

Në ditët e fundit të jetës së tij, për arsye të përkeqësimit të sëmundjes, Profeti ﷺ nuk arriti të dilte në mesxhid për t'iu falur njerëzve namazet. Prandaj, ai e caktoi Ebu Bekrin ؓ si imam të të gjitha namazeve që do të faleshin me xhemat. Një ditë, ai u ndie më mirë dhe doli në mesxhid. Pasi u dha disa këshilla sahabëve, u tha:

*“Allahu i Lartëmadhëruar, e la robin e tij të lirë në zgjedhjen e kësaj bote ose të mirësive qiellore që gjenden pranë Tij. Ky rob zgjodhi mirësitë qiellore pranë të Lartëmadhërueshmit...”*

Pasi dëgjoi këto fjalë, Ebu Bekri ndjeu hidhërim në zemrën e tij të butë, teksa në sy iu vërejtën disa pika të ngrohta lotësh. Ai e ndjeu se në një farë mënyre Profeti ﷺ po thoshte fjalët e lamtumirës, sepse ai ishte miku më i ngushtë i fshehtësive profetike. Prandaj, ai filloi të rënkonte si neji (fyelli) që rënkon nga ndarja. Ndërsa qante me dënesë, ai tha:

*“Nëna dhe babai im të qofshin falë o Resulullah! Ne jemi gati të flijojmë baballarët, nënat, jetën, pasurinë dhe fëmijët tanë vetëm për ty, o i Dashuri i Allahut!..”* (Ahmed, III, 91)

Kur Profeti ﷺ foli, asnjë prej personave që ishin të pranishëm, nuk e kuptoi thellësinë emocionale dhe faktin që Profeti po bëhej gati të ndahej nga kjo botë. Madje shumë nga sahabët nuk arritën t'i jepnin ndonjë kuptim përlotjes së Ebu Bekrit. Të çuditur, ata i thoshin njëri-tjetrit:

*“Me të vërtetë është e habitshme se pse qan ky njeri në moshë të thyer, ndërkohë që Resulullahu ﷺ po flet në lidhje me një vepërmirë që kërkon të bashkohet me Zotin e tij!..”* (Buhari, Salat, 80)



Përveç Ebu Bekrit, i cili e kishte kuptuar mesazhin e thënies së Profetit në mënyrë intuitive, askush nga të pranishmit nuk kishte arritur ta kuptonte se në këtë rast vepërmiri ishte vetë i Dashuri i Allahut, ﷺ. Ndërkohë, për të qetësuar zemrën e mër-zitur të Ebu Bekrit dhe për të shpalosur vlerat e tij të larta para sahabëve, Resulullahu, ﷺ, u shpreh:

*“Çdonjërit që na ka bërë mirësi, ia kemi shlyer në atë masë ose më shumë. Këtu bën përjashtim vetëm Ebu Bekri!.. Ai na ka bërë aq shumë mirësi, sa që vetëm Allahu mund t’ia shpërblejë në Ahiret.*

*Ebu Bekri është treguar më bujari ndaj meje, qoftë me bisedat e qoftë me pasurinë e tij. Nëqoftëse do të mund të kisha edhe ndonjë mik tjetër përveç Allahut, me siguri do të zgjidhja Ebu Bekrin, por vëllazëria Islame është më e lartë se çdo lloj miqësie.”*

Pastaj, Profeti ﷺ, të cilit tashmë po i afrohej vdekja nga çasti në çast, tha:

*“Të gjitha dyert që komunikojnë me mesxhidin të mbyl-len, vetëm ajo e Ebu Bekrit të qëndrojë e hapur! Unë jam duke parë një nur në derën e Ebu Bekrit...”<sup>17</sup>*

Kështu, në atë çast të vështirë lamtumire, u mbyllën të gjitha dyert, përveç derës së Ebu Bekrit ﷺ, që ishte e vetmja që qëndroi hapur.

Në një kuptim simbolik ky urdhër mund të kuptohet kështu: e vetmja rrugë që arrin të hapë derën e afrisë me Resulullahun, ﷺ, është ajo e bindjes, e dorëzimit, e besnikërisë, e sakrificës, e miqësisë dhe e dashurisë së Ebu Bekrit.

17. Shih. Buhari, As’habun-Nebi 3, Menakibu’l-Ensar 45, Salat 80; Muslim, Fedailu’s Sahabe; Tirmidhi, Menakib 15; Ibni Sa’d, II, 227.



## Një kala e palëkundshme besimi

Një nga sahabet më të pasur, Ebu Bekri رضي الله عنه, pasi u shkri në qenien e të Dërguarit të Allahut, flijoj pasurinë dhe jetën në rrugën e tij. Madje, disa herë, ai ia ka dhuruar të gjithë pasurinë të Dërguarit të Allahut, pa u frikësuar aspak nga varfëria. Një herë, Profeti صلى الله عليه وسلم e pyeti:

*“Çfarë i le familjes tënde, o Ebu Bekër?”*

Ai u përgjigj me një qetësi të madhe shpirtërore:

*“Atyre u lashë Allahun dhe të Dërguarin e Tij!..”<sup>18</sup>*


I Dërguari i Allahut nuk e lejonte asnjë sahab që të dhuronte krejt pasurinë e tij, por këtu bënte përjashtim vetëm Ebu Bekri. Ekziston mundësia, që njeriu i cili dhuron të gjithë pasurinë e tij, kur të gjendet i zhytur në varfëri dhe skamje, mund të ndikohet nga manovrat e shejtanit e të bëhet pishman për këtë akt sublim. Një pishmanllëk i tillë e shkatërron dhe e djeg sevapin e kësaj vepre të mirë. Por bota shpirtërore e Ebu Bekrit ishte pjekur me dashurinë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Bota e tij shpirtërore ishte një kala imani që nuk lëkundet.

Pranimi i menjëhershëm e pa asnjë lëkundje që ai shfaqti ndaj ngjarjes së Miraxhit, dhe miratimi i plotë e pa as më të voglin dyshim që ai i bëri fjalës së të Dërguarit të Allahut në lidhje me këtë çështje, tregon qartë forcën e besimit të tij. Në lidhje me qëndresën shpirtërore të Ebu Bekrit, Aliu رضي الله عنه ka thënë:

*“Ebu Bekri është si një mal që nuk lëkundet aspak nga asnjë lloj ere.”*



Me të vërtetë, ngaqë e flijonte të gjithë pasurinë e tij në rrugë të Allahut, Ebu Bekri binte herë pas here në gjendje varfërie dhe




skamjeje. Mirëpo dëshira që ai kishte që të kënaqte Allahun dhe Resulin e Tij, ia lehtësonte të gjitha vështirësitë tokësore dhe bënte që Ebu Bekri të jetonte i qetë dhe i kënaqur me çdo gjë. Përballë lartësisë së virtytit dhe besnikërisë së Ebu Bekrit, Profeti  ka thënë:

*“Ai që do të shohë dikë që është i shpëtuar nga Xhehenemi, le të shohë Ebu Bekrin!”* (Ali el-Muttaki, no: 32617)

## Modestia

Duke shpëtuar nga pasuria dhe egoja e tij, pra duke fituar jetë dhe qenie tek i Dërguari i Allahut, Ebu Bekri  u bë një shembull i gjallë i moralit të Profetit Muhamed .

Ashtu si i Dërguari i Allahut, , edhe ai i kishte harruar hallet e veta. Ishte ngjitur në kulmet e dhembshurisë, duke pasur si hall dhe problem të vetëm, hallet dhe problemet e umetit. Ai e kishte kaluar fazën e egoizmit të tij dhe nuk thoshte kurrë **“Vetja ime, vetja ime”**, por kishte arritur shkallën e njësimit me të tjerët, duke thënë **“Umeti im, umeti im”**.

Kur ai u zgjodh kalif për myslimanët, hipi në minber dhe tha me modesti:

*“O njerëz! Edhe pse nuk jam më i miri ndër ju, u zgjodha kalifi juaj. Në qoftë se e kryej detyrën time siç duhet, më ndihmoni. Nëse veproj gabim, më tregoni rrugën e drejtë...”*

(Ibni Sa'd, III, 182-183; Sujuti, Tarihul-Hulefa, s. 69, 71-72; Hamidullah, Profeti i Islamit, II, 1181)

Pra, ky sahab i madh e jetoi me një modesti dhe pjekuri të rrallë virtytin **“e pranimit të kritikës”**. Kur populli po i jepte atij besimin për këtë detyrë, ai u shpreh:



*“Unë nuk kam kërkuar asnjëherë pushtet, madje as nuk e kam vlerësuar ndonjëherë atë. Nuk ia kam kërkuar Allahut as fshehtazi e as haptazi, sepse tashmë (nga frika e përgjegjësisë që të ngarkon kjo detyrë) **nuk do të mund të kem asnjë çast qetësie.**”*

Kur Ebu Bekri ﷺ u zgjodh kalif, u bë edhe më modest e i devotshëm. Para se të bëhej kalif, milte delet e vajzave jetime dhe kujdesej për nevojat e tyre. Pasi u bë kalif, fqinjët e tij filluan të mendonin se për shkak të shtimit të punëve dhe të ndryshimit të kushteve të jetesës, ai nuk do milte më delet e vajzave jetime. Por asgjë nuk ndryshoi. Me të njëjtën modesti, ai vazhdoi të milte delet e vajzave jetime dhe të kujdesej personalisht për nevojat e tyre. (Sujuti, Tarihu 'Hulefa, faq. 80; Sariçam, Ebu Bekir, faq. 82)

Ai nuk anoi nga kjo botë as para se të bëhej kalif, e as më pas. Njësoj si vetë Resulullahu, ﷺ, dëshira e tij më e madhe ishte plotësimi i udhëtimit për në ahiret, bashkimi hyjnor dhe një qetësi shpirtërore të çliruar nga sikletet e kësaj bote. Për këtë arsye, pak kohë para se të ndërronte jetë, ai la si amanet shitjen e një toke që i përkiste atij, duke porositur që me të ardhurat e saj të shpaguante rrogat që kishte marrë në mënyrë të detyrueshme nga thesari i shtetit gjatë gjithë kohës që kishte qenë kalif. (Ibn-i Esir, el Kamil, II, 428-429)

### Model në maturi dhe pjekuri

Në jetën e tij kishte një ekuilibër të fuqishëm hyjnor. Ai, gjithmonë shfaqti modesti të pamatë, por asnjëherë nuk u tregua i shtypur dhe i dobët. Gjithmonë ishte serioz, por kurrë nuk e kaploi krenaria dhe mendjemadhësia. Ai ishte shumë falës, tolerant, i urtë dhe i matur, por ishte edhe i ashpër e i guximshëm aty ku duhej. Sidoqoftë, në çdo rast ishte model në maturi dhe pjekuri.





Me gjithë këto virtyte, ai asnjëherë nuk tregoi tolerancë ndaj kundërshtimit të urdhrave të Profetit. Ai qe mbrojtës i vendosur i Islamit dhe nuk lëshoi pe në asnjë çështje të fesë. Irtidatin (lënien e fesë) dhe refuzimin e obligimit të zekatit, që nisën të shfaqeshin pasi ndërroi jetë Resuli i Allahut, ﷺ, i luftoi me forcë dhe vendosmëri të madhe, duke thënë: “Do t’u shpall luftë atyre, edhe sikur të fshehin e të mos japin prej mallit të zekatit qoftë edhe një copë të vogël litari!...”

Kështu, ai u bë pengesë në shumëfishimin e mëtejshëm të ngatërresave dhe i mbylli të gjitha dyert që mund të bëheshin shkak për prishjen e fesë. Ky veprim i tij i vendosur dhe i guximshëm, mahniiti edhe vetë simbolin e drejtësisë e të trimërisë, Omerin.<sup>19</sup>

Ky sahab fisnik dhe madhështor jetoi gjithmonë në piedestalin e drejtësisë dhe miqësisë. Prandaj, në lidhje me këtë çështje, qortimet dhe këshillat e tij kanë një vlerë aq të madhe për ne, sa mund të hapin dyert e këtij piedestali të lartë. Me jetën e tij të karakterizuar nga një besnikëri shembullore, ai u bë një model i pashoq. Në të njëjtën kohë, me fjalët e tij plot margaritarë urtësie, fjalë të cilat shprehin fshehtësitë e kësaj jete, u bë model jetësor i zemrave të besimtarëve. Ja disa prej fjalëve të tij, të cilat përbëjnë një thesar urtësie dhe fisnikërie.

### Fjalë të urta nga Ebu Bekri

*“Midis Allahut dhe krijesave të Tij nuk ka asnjë lidhje familjare. Afërsia me Allahun është e mundur vetëm me bindjen ndaj urdhrave të Tij.”*

*“Allahu nuk kënaqet nga fjalët e pashoqëruara me vepra.”*

19. Ali el-Qari, *Mirkat*, X, 381-383/6034.



*“Fjalët e tepërta e bëjnë njeriun harraq.”*

*“Mendoje mirë fjalën që thua, kur e thua dhe kujt ia thua!”*

*“Bëhu skllav i të diturve që e njohin Hakun (Allahun)!”*

*“Mos ia fshih gjendjen tënde atij që dëshiron të të ndihmojë! Përndryshe mashtron vetveten.”*

*“Përmirësoje veten, në mënyrë që edhe njerëzit të sillen mirë me ty.”*

*“Katër lloj njerëzish janë prej robërve të mirë të Allahut:*

- 1. Ai që gëzohet kur sheh dikë që bën teube (pendohet).*
- 2. Ai që i përgjërohet Allahut për faljen e gjynaheve.*
- 3. Njeriu që bën dua për vëllanë e tij të fesë kur ai nuk ndodhet i pranishëm.*
- 4. Ai që ndihmon dhe i shërben dikujt që është nevojtar më shumë se ai vetë.”*

*“Pranë meje, më i forti prej jush është i dobëti, deri sa të marrë të drejtën e tij, ndërsa më i dobëti prej jush është i forti, derisa t’i merret e drejta që i ka borxh dikujt.”*

*“Kur imami është i vetëm në xhami, kur pasuria është tek koprracët, armët tek frikacakët dhe përgjegjësia tek të paaftët, atëherë çdo punë shkon ters.”*

*“Njeri me mend është njeriu i devotshëm, ndërsa njeri pa mend është keqpërësi.”*

*“Në Kuranin Kerim, Allahu Teala e ka përmendur shpërblimin e premtuar së bashku me dënimin, me qëllim që robi të dëshirojë adhurimin dhe të frikësohet prej dënimit.”*



“Nëse të shpëton një mirësi, mundohu ta kapësh; kur ta arrish, mundohu ta kalosh që të arrish një më të mirë!”

“Mirësia ndaj njerëzve e mbron robin prej belave dhe fatkeqësive.”

“Largohu prej famës, që të të ndjekë nderi. Përgatitu për udekjen, që të të jepet jetë.”

“Nuk ka asnjë fatkeqësi për të cilën mund të mendosh se nuk ka më të keqe se ajo.”

“Durimi nuk sjell dëm dhe hidhërimi nuk sjell dobi.”

“Durimi është gjysma e besimit, ndërsa dituria (absolute) i gjithë besimi.”

“Prej Allahut kërkoni shëndet, sepse pas diturisë (absolute) askujt nuk i është dhënë ndonjë gjë më e mirë se shëndeti.”

“Për mua është më e pranueshme të jem me shëndet dhe të falënderoj, se sa të jem në sprovë dhe të duroj.”

“Dynjaja është pazari i besimtarëve; nata dhe dita janë kapitali i tyre; punët e mira, mallrat e tregtisë, Xheneti janë fitimi, ndërsa Xhehenemi është dëmi e tyre.”

“Salavati për Profetin, i fshin gjynahet më shpejt nga ç’e shuan uji zjarrin. T’i dërgosh selam atij (me dashuri dhe nderitet), është më e vlefshme se sa të lirosh disa skllëvër. Ndërsa, ta duash Resulullahun ﷺ është më sublime sesa të luftosh me nefsin apo të luftosh me shpatë në rrugë të Allahut.”

(Bagdadi, Tarihu Bagdad, VII, 161)

“Miqtë e Allahut ndahen në tre kategori (sipas karakterit) dhe në të tre kategoritë vërehen tri shenja:

- Në kategorinë e parë janë atë që ndodhen në **hauf**



(gjendje frike ndaj Allahut). Këta kanë cilësi të tilla:

1. Janë gjithmonë modestë.

2. Megjithëse mund të kenë bërë shumë të vepra të mira, ata i konsiderojnë të pakta.

3. Edhe gabimin më të vogël e shohin si të madh. (Sepse janë të vetëdijsëm se kundër kujt kanë bërë gjynah)

- Kategoria e dytë janë ata që zotërojnë **rexha** (shpresë tek Allahu). Cilësitë e tyre janë:

1. Me çdo fjalë dhe vepër të tyre, duke shpërndarë mirësi dhe urtësi, bëhen shembull për të gjithë.

2. Duke harxhuar pasurinë në rrugë të Allahut, ata bëhen njerëzit më bujarë.

3. Kanë gjithmonë mendim të mirë në lidhje me njerëzit e tjerë.

- Kategoria e tretë janë ata që e adhurojnë Allahun me dashuri dhe devotshmëri. Cilësitë e tyre janë:

1. Gjërat që i duan më shumë, i japin për hir të Allahut.


2. Me çdo fjalë dhe vepër synojnë kënaqësinë e Allahut, arsye për të cilën nuk hidhërohen prej qortimeve të injorantëve e nuk shqetësohen prej veprimeve të tyre të pasjellshme.

3. Me gjithë kundërshtimin e nefsit (egos), mundohen të bëjnë gjëra të cilat i vijnë rëndë nefsit. Me çdo fjalë dhe vepër, i binden urdhrave dhe ndalesave të Allahut.” (Ibn-i Haxheri’l Askalani, Munebbihat, faq. 94-95)

Ebu Bekri ﷺ ishte një personalitet i cili i kishte të përmbledhura në vetvete të trija këto kategori dhe i zotëronte të gjitha cilësitë e tyre. Allahu na bëftë prej atyre që përfitojnë nga këshi-



llat e tij të urta dhe të kemi begati prej tyre! Gjithashtu na bëftë hallka të zinxhirit të miqësisë së tij, sepse ata që arrijnë burimin e miqësisë së Allahut dhe Resultit të tij, janë Hulefa-i Rashidinët (kalifët e drejtë), sahabët e ndershëm, miqtë e Allahut dhe ata të cilët shkojnë pas gjurmëve të tyre, duke u bërë me mëshirën e Allahut prej udhëtarëve të lumtur të karvanit të pafundësisë.

Fjalëve tona u japim fund me këto lutje të sinqerta që rrjedhin prej zemrës së Ebu Bekrit :

**“Allahu im! Periudha më e mirë e jetës sime, le të jetë fundi; pjesa më e mirë e punëve të mia, le të jenë përfundimet; dhe dita ime më e mirë, le të jetë dita kur do të takohem me Ty!”** (Sujuti, Tarihu'l-Hulefa, faq. 103)

**“Allahu im! Mirësia e fundit që do të më falësh, le të jetë kënaqësia Jote (ndaj meje) dhe gradët e larta në Xhenetet Naim!”** (Sujuti, Tarihu'l-Hulefa, faq. 103)

**Amin!..**





## OMERI رضي الله عنه





Para se të hynte në fenë islame, Omeri ishte shembulli tipik i njerëzve të paditur që ishin të boshatisur nga mëshira dhe që nuk njihnin asnjë të drejtë të askujt, përveç forcës dhe të drejtës së tyre. Ndërsa kur ai u nderua me hyrjen në fenë Islame, u bë një njeri i kujdesshëm, altruist, i urtë dhe monument drejtësie. Omeri i para-islamit, me natyrë të egër e të ashpër, u shkri e humbi fare. Omeri u transformua në një njeri, sytë e të cilit ishin vazhdimisht të përplotur, zemra e të cilit ishte e mbushur me mëshirë dhe dhembshuri, i cili ruhej edhe nga bezdisja që mund t'i jepte një milingone, i cili mendonte vazhdimisht lumturinë e umetit mysliman dhe i cili ishte i pajisur me vetëdije të lartë përgjegjësie.





## OMERI

Edhe Omeri , kalifi i dytë, është një personalitet i Islamit, që eci në gjurmët e nurta të të Dërguarit të Allahut , që e vazhdoi me besnikëri rrugën e tij, dhe që me gjendjet dhe veprimet e tij u bë figurë monumentale e Islamit.

Para se të hynte në fenë Islame, Omeri ishte shembulli tipik i njerëzve të paditur që ishin të boshatisur nga mëshira dhe që nuk njihnin asnjë të drejtë të askujt, përveç forcës dhe të drejtës së tyre. Ndërsa kur ai u nderua me hyrjen në fenë Islame, u bë një njeri i kujdesshëm, altruist, i urtë dhe monument drejtësie. Omeri i para-Islamit, me natyrë të egër e të ashpër, u shkri e humbi fare. Omeri u transformua në një njeri, sytë e të cilit ishin vazhdimisht të përlotur, zemra e të cilit ishte e mbushur me mëshirë dhe dhembshuri, i cili ruhej edhe nga bezdisja që mund t'i jepte një milingone, i cili mendonte vazhdimisht lumturinë e umetit mysliman, i cili ishte i pajisur me vetëdije të lartë përgjegjësie.

Ai mbante vazhdimisht egon e tij në kontroll të rreptë e shpesh shprehej: *“I druhem gjykimit të Allahut qoftë edhe për humbjen e një qengji buzë Euftratit.”*<sup>20</sup> Ai arriti deri aty sa të

20. Ibn-i Ebi Shejbe, Musannef, VIII, 153.



dilte natën vonë me thes ushqimesh në shpinë për të qenë afër të varfërve dhe të dobtëve. Ai u bë mbështetja e jetimëve dhe njerëzve të vetmuar. Atij nuk i gjente shpirti qetësi pa i ngushëlluar, pa ia fshirë lotët, dhe pa ia kthyer buzëqeshjen atyre që kishin plagë në zemër. Ndjenja e tij e përgjegjesisë arriti deri në atë shkallë, sa kur ishte kalif, kalonte natë e ditë duke u angazhuar me problemet e ndryshme të umetit mysliman. Përkushtimi i tij në shërbimin ndaj popullit, i dukej vazhdimisht i mangët dhe i pamjaftueshëm. Për shkak të peshës së madhe të përgjegjesisë, ai asnjëherë nuk ndjeu qetësi dhe rehati sa ishte në detyrë, edhe pse ishte kulminacion në fushën e drejtësisë, rezistencës dhe vlerave. Kjo gjendje, vinte si pasojë e faktit se ai kishte marrë si shembull të jetës së tij Resulullahun ﷺ.

Kur ai ishte në gjendje të rëndë nga plagët që kishte marrë në atentatin që iu bë, i thanë:

“- Sikur të caktonit dikë në detyrën tuaj!”

Mirëpo, Omeri, i cili luftoi fort për të ruajtur drejtësinë dhe të vërtetën, u përgjigj:

*“A të mbaj përgjegjesi për ju edhe në botën tjetër ashtu siç e mbajta në këtë botë? Unë nuk pres asnjë shpërblim për udhëheqjen që ju kam bërë. Sa do të doja që sevapet që mund të kem marrë nga puna si kalif, të ekuilibronin gjynahet e mia! Mjafton që në ditën e Gjyqit të madh të mos qortohem!”<sup>21</sup>*

Kur iu propozua që në vend të tij të emërohej i biri, Abdullahu, ai u përgjigj:



“Mjafton një kurban nga një shtëpi!”

Ai zotëri ishte i pajisur me vetëdijen e përgjegjesisë ndaj



umetit mysliman dhe ishte i shkrirë me hallet e këtij umeti, kështu që kishte harruar hallet dhe problemet e tij. Preokupimi i tij kryesor ishte qetësia dhe shpëtimi i njerëzve dhe, për këtë kishte për shembull më të përsosurin, Resulullahun ﷺ. Ai nuk harronte vështirësitë dhe vuajtjet që Resulluahu kishte kaluar në rrugë të Allahut dhe e ndiqte atë ashtu siç ndiqen gjurmët e një njeriu mbi borë.

### Thjeshtësia

Një ditë, Omeri , u përлот kur në trupin e Profetit vërejti shenjat e rrogosit mbi të cilën ai flinte. Kur Resulullahu  e pyeti për arsyen e përлотjes, ai iu përgjigj:

“O i Dërguari i Allahut! Dihet se çfarë jete bëjnë Kisra dhe Kajseri! E ndërkohë që ti je i Dërguari i Allahut!”

I Dashuri i Allahut  u shpreh:

“O Omer! A nuk dëshiron që dynjaja të jetë e atyre dhe ahireti i joni?” (Muslim, Talak, 31)

Në kohën e kalifit Omer u çliruan Siria, Iraku, Palestina, Egjipti si dhe u përfshinë të gjitha tokat e Iranit në kufijtë e shtetit Islam. Thesaret e pasura shtetërore të Bizantit dhe Iranit filluan të orientoheshin nga arka e thesarit të Medinës së Përndritur. Niveli i mirëqenies së shoqërisë u rrit, por kalifi i myslimanëve qëndroi larg nga ky vërshim bollëku dhe pasurie. Ai vazhdoi t’i mbante ligjeratat me rroba të arnuara edhe pse arka e shtetit ishte e pasur. Për të ruajtur egon e tij nga fama e postit, ai zgjodhi një jetë krejt modeste. Gjatë udhëtimit me hyzmeqarin e tij për në Sham, ai i tha:

“-Erdhi radha jote tani, hajde hip në devenë time!”



Hyzmeqari refuzoi duke i thënë:

“O kalif, njerëzit kështu do të mendojnë se jam unë kalifi i tyre!” Por Omeri e hipi në deve, dhe vetë hyri në këmbë në Sham. Kështu, ai la një kujtim dhe një shembull të pashoq të vëllazërimit Islam që kapërceu shekujt.

Ai jetoi me vështirësi shumë të mëdha, ku shpesh merrte edhe borxh për nevojat e tij themelore.

Nga thesari i shtetit ai pranoi të merrte një pagë minimale me të cilën mbijetonte me vështirësi. Ata që nuk e njihnin, nuk arrinin ta dallonin kalifin në mesin e të tjerëve, sepse ai ishte krejt modest.

Paria e sahabëve nuk e duruan këtë gjendje dhe kërkuan t’ia rrisnin pagën kalifit. E patën të vështirë që këtë mesele ta ndanin direkt me Omerin prandaj shkuan tek bashkëshortja e Profetit ﷺ, e cila në të njëjtën kohë ishte edhe e bija e Omerit, pra tek nëna jonë Hafsa. Ata i kërkuan të shkonte tek babai i saj me propozimin që kishin menduar. Nëna jonë Hafsa, e ndau me të atin këtë propozim. Mirëpo, Omeri ﷺ, i cili kishte qenë dëshmitar i ditëve aq të vështira për Resulullahun, në të cilat Profeti nuk gjente as edhe një hurmë për të shuar urinë, e pyeti vajzën e tij Hafsa:

“O bija ime! A e di se si ushqehet dhe vishej Profeti ﷺ?”



“Aq sa t’i mjaftonte!” - iu përgjigj Hafsa.

Atëherë, Omeri ﷺ iu drejtua vajzës së tij të dashur duke i thënë:



*“Dy miqtë (Profeti dhe Ebu Bekri) dhe unë ngjajmë me udhëtarët e së njëjtës rrugë. I pari nga ne (Profeti) arriti në destinacion. Tjetri, pra Ebu Bekri, duke ecur në të njëjtën rrugë e arriti të parin. Unë, si i treti i tyre, përpiqem të arrij*




*shokët e mi. Në qoftë se nisem me shumë ngarkesë, nuk do të mund t'i arrij ata! Apo mos vallë ti nuk dëshiron që unë të jem i treti i kësaj rruge?*<sup>22</sup>


Qëllimi i vetëm i Omerit  ishte të fitonte kënaqësinë e Allahut. Ai i ishte përkushtuar kaq shumë këtij qëllimi, sa që të gjitha pengesat dhe vështirësitë ishin një hiç në sytë e tij. Ai kishte fuqi t'i përballonte ato me durim, pëlqim dhe dorëzim tek Allahu. Ai jetoi në mënyrë shumë të disiplinuar, edhe pse Profeti  e kishte përgëzuar disa herë me Xhenet.





### Dashuria e Tij ndaj të Dërguarit të Allahut

Një ditë, kur Omeri  po bëhej gati të nisej për Umre, Profeti  i tha me dashuri:

*“Mos harro të bësh dua edhe për ne!”*<sup>23</sup> Omeri u emocionua nga dashamirësia që tregoi Profeti  dhe, në lidhje me këtë moment është shprehur:

*“U gëzova aq shumë, sa që mu duk sikur e gjithë bota më ishte dhuruar mua.”*

Çdo vlerësim miqësor që vinte nga Profeti  vlente më shumë se çdo gjë e kësaj bote. Një shembull interesant që shpalos dashurinë e Omerit është edhe ky:

Në mesin e sahabëve të dashuruar pas Profetit  ishte edhe Firasi. Ai, nga dashuria që kishte për Profetin , dëshironte të kishte ndonjë gjë të tijën. Një ditë, tek Profeti  po hante, ai i kërkoi si dhuratë enën prej ku ai po ushqej. Profeti  ia dhuroi, pasi ai nuk ia kundërshtonte dëshirën askujt.

22. Shehbenderzade Ahmet Hilmi, *Tarih-i Islam* V. I, s 367.

23. Tirmidhi, *Deavat*, 109; Ebu Davut, *Vitr*, 23.



Omeri ﷺ shkonte shpesh në shtëpinë e Firasit dhe i thoshte:

“Na e sill atë enë të bekuar o Firas!” Atë enë, që kishte prekur Profeti me gishtat e Tij të bukur, e mbushte me ujë zemzemi dhe e pinte deri në ngopje. Ndërsa me pjesën që tepronte lante me kënaqësi fytyrën dhe sytë e tij. (Ibn-i Haxher, el-Isabe, III, 202)

### Omeru'l Faruk ﷺ

Omeri ﷺ, njihej edhe me për cilësinë e tij, **“Faruk”**, pra, aftësinë për të ndarë në mënyrë të shkoqur të mirën nga e keqja. Allahu i Lartëmadhëruar në Kuranin famëlartë shprehet:

**“O besimtarë! Nëse i frikësoheni Allahut, Ai do t’ju japë aftësinë e të gjykuarit drejt...”** (Enfal, 29)

Omeri, një personalitet që shënoi një kulminacion të kultivimit të frikës ndaj Allahut, jepte gjykime me probabilitet maksimal vërtetësie duke selektuar të vërtetën në një çështje të caktuar dhe duke orientuar të tjerët drejt saj, ndërsa pjesën e pavërtetë të çështjeve me të cilat ai përballej, e nxirte në pah duke këshilluar njerëzit që të largoheshin prej saj. Në shumë raste gjykimet e tij të mbështetura në logjikë përkuan me ajetet që u shpallën më pas. Në një hadith, ky tipar i tij është shprehur kështu:

*“Allahu i Lartëmadhëruar e ka vendosur të vërtetën në gjuhën dhe në zemrën e Omerit.”* (Tirmidhi, Menakib, 17/3682)

Në një hadith tjetër Profeti ﷺ është shprehur:

*“Në mesin umeteve paraardhëse ka pasur prej atyre njerëzve të cilëve Allahu u jepte frymëzime në lidhje me çështje të ndryshme. Në qoftë se nga umeti im mund të ketë një njeri të tillë, ai është pa dyshim Omeri.”* (Buhari, Ashabun-Nebi, 6)

Aftesitë e veçanta të Omerit janë vërejtur në shumë raste.



Ndër rastet më interesante të shfaqjes së këtyre cilësive, është ngjarja që do të shpjegojmë më poshtë.

Një ditë Omeri ﷺ duke mbajtur fjalimin e tij në foltore, tha me zë të lartë:

“O Sarije! Drejtohu nga mali, drejt malit!” Omeri ﷺ shqiptoi këto fjalë që s’kishin fare lidhje me temën rreth të cilës po fliste. Në këtë çast komandanti Sarije, në një distancë një mujore larg Medinës, po luftonte me armiqtë e Allahut. Mirëpo, me ndihmën e Allahut, zëri i Omerit u dërgua deri tek Sarije. (Ibn-i Haxher, el-Isabe, II, 3)

Omeri ﷺ, në jetën e të cilit u shfaqën shumë ndodhi të jashtëzakonshme, u bë një monument i atillë drejtësie dhe vërtetësie, sa që aty ku ndodhej ai, nuk mund të gjente strehë as shejtani që i nxit njerëzit në rrugën e shtrembër të gjynaheve. Kështu pra, pranë tij nuk fitonte dot gjallëri dhe jetë e keqja, dhuna dhe padrejtësia. Për këtë arsye Profeti ﷺ i pati thënë Omerit - radijallahu:

*“Betohem në Allahun, në dorën e të Cilit është shpirti im, në qoftë se shejtani do të të takonte rastësisht në rrugë, do të ndryshonte rrugën menjëherë.”* (Muslim, Fedailus-sahabe, 22)

### **Puna është pasqyra e njeriut...**

Sa këshillë e mrekullueshme është shprehja plot urtësi e Omerit ﷺ:

*“Tjetrit mos i shikoni namazin që fal apo agjërimin që mban, por shikoni;*

*-A thotë të vërtetën kur flet?*

*-A e respekton amanetin kur ujen koha për ta çuar në vend atë që i ke besuar?*



*-A kujdeset për hallallin dhe haramin kur merret me punët e kësaj bote?” (Bejhaki, Sunenu'l-Kubra, VI, 288; Shuab, IV, 230, 326)*

Fakti që namazet dhe agjërimet e kryera në mënyrën e duhur e mbrojnë njeriun nga çdo e keqe, është një vërtetë dhe një sihariq hyjnor. Besimtari që nuk punon për të përmirësuar egon e tij dhe nuk zbukuron etikën dhe veprimet e tij, jo vetëm që ka mbetur pa atmosferën shpirtërore që të japin ibadetet e ndryshme, por edhe nuk mund të mbrohet prej së keqes me anë të tyre.

Ata që thoshin “Ne i jemi dorëzuar Allahut” dhe e kalonin jetën në dembeli, duke mos bërë asnjë vepër, Omeri ؓ i qortoi me këto fjalë:

*“Ju nuk i besoni Allahut, por i besoni pasurisë së të tjerëve. Ai që vërtetë i dorëzohet Allahut, është ai që i dorëzohet Atij pasi e ka hedhur farën në tokë. (Ibn-i Rexhep, Xhamiu'l-Ulum, I, 441)*

Një ditë, një person po lavdëronte dikë në prezencën e Omerit. Në çast, Omeri ؓ e pyeti:

“A ke bërë me të ndonjë udhëtim, a ke pasur me të ndonjë marrëdhënie fqinjësie apo tregtie? Pasi personi iu përgjigj me “jo” çdo pyetjeje, Omeri i tha:

“Betohem në Allahun e Lartëmadhëruar se ti nuk e njeh atë.” (Gazali, Ihja, III, 312)

Ja pra, këto janë pikat nëpërmjet të cilave mund të vlerësohet një njeri. Të parët tanë kanë thënë:

*Pasqyra e njeriut është vepra, jo fjala!  
Niveli i mendjes së tij, dallohet në veprat e tij...*

Sipas kësaj thënieje, karakteri i njeriut dhe niveli i tij shpirtëror vërehen në marrëdhëniet sociale që ndërton me të tjerët, në natyrën dhe veprimet e tij.







Në lidhje me këtë temë, Omeri është shprehur:


*“Sa jam pa ju parë me sytë e mi, më i miri (ose më i dashuri për mua) prej jush është ai që ka emrin më të bukur. Nëse ju kam parë, atëherë më i miri (ose më i dashuri për mua) prej jush është ai që ka moral më të bukur. Kur ju vë në provë, më i miri (ose më i dashuri për mua) është ai që thotë vetëm të vërtetën.”* (Ibnu l-Xhevi, Menakib, fq.219)

### Një jetë e lartësuar me Kuran

Omeri  kishte një aftësi maksimale për t’iu përshtatur thellësisht Kuranit, fjalës së Allahut. Madje, shkaku për hyrjen e tij në Islam u bë dëgjimi i Kuranit në shtëpinë e motrës së vet, Fatimes.

Omeri  përpiqej shumë për të depërtuar sa më thellë në të vërtetat kuranore dhe që çdo hap në jetë ta hidhte në përshtatje me këto të vërteta. Kjo i jepte një kënaqësi të veçantë atij.

Sipas disa transmetimeve të sakta, ai e përsosi leximin e sures Bekare duke e kuptuar dhe duke e jetuar për dymbëdhjetë vite rresht. Pasi e kreu atë, në shenjë falënderimi ndaj Allahut të Lartëmadhëruar, bëri kurban një deve. (Kurtubi, el-Xhami, I, 40)

Përfundimisht, themi se Omeri  është një burim udhërrëfimi i denjë dhe një njeri me diapazon të lartë shpirtëror në qëndrueshmërinë e të jetuarit lidhur me Kuranin dhe Sunetin e Profetit, si dhe në përkushtimin e tij të sinqertë në rrugën e Allahut të Lartëmadhëruar.

Kur Omeri ndërroi jetë, Ibni Mesudi , pati thënë:

“Iku nga kjo botë nëntë e dhjeta e diturisë.”

Sahabët që ndodheshin aty, i thanë:

“Në mesin tonë ka ende dijetarë!”



Ai tha:

“Unë e pata fjalën për diturinë shpirtërore.”

Për të përfituar sa më shumë nga rrezatimi i diturisë shpirtërore të Omerit, nëna jonë Aisha është shprehur:

“*Zbukurojini kuvendet tuaja me salavatet ndaj të Dërguarit të Allahut dhe me përmendjen e Omer ibn Hattabit.*” (Ibnu'l-Xhevzi, Menakib, fq. 276)

Disa fjalë të urta që shpalosin botën shpirtërore të Omerit ﷺ, botë e cila u formua dhe konsolidua duke përvetësuar moralin e të Dërguarit të Allahut, duke mësuar diturinë dhe urtësinë e Resulullahut me ndjeshmëri zemre, janë këto:

### Fjalë të urta nga Omeri ﷺ

“*Të heqësh dorë nga një gjynah, është më e lehtë se të merresh me pendimin.*”

“*Unë dua më shumë atë që m’i tregon të metat e mia.*”  
(Sujuti, Tarihu'l-Hulefa)

“*Ai që flet shumë, gabon. Atij që gabon shumë, i zvogëlohet ndjenja e turpit. Atij që i zvogëlohet turpi, i humbet kujdesi dhe frika ndaj gjërave të dyshimta që të shpien në gjynah dhe haram. Atij që i humbet kujdesi dhe frika ndaj gjërave të dyshimta, i vdes zemra.*”

“*Duke mos pasur asnjë pretendim për njohjen e gajbit, do të dëshmoja për meritimin e Xhenetit për këto pesë grupe:*

1. *I varfëri (që jeton në gjendje falenderimi dhe sabri) që ka shumë fëmijë.*

2. *Bashkëshorti prej të cilit është i kënaqur bashkëshortja e tij e devotshme.*



3. Ajo grua që ia dhuron si lëmoshë bashkëshortit të saj mehri musemanë.

4. Ai prej të cilit është i kënaqur babai dhe nëna e tij.

5. Ai që pendohet për gjynahun e tij (duke e urryer atë, ose duke ndjerë neveri prej tij)..."

"I shëtita dhe i pashë të gjithë miqtë; nuk arrita të shoh mik më të mirë se ruajtjen e gjuhës.

I pashë të gjitha rrobat, nuk munda të shoh rrobë më të mirë se nderi dhe ruajtja e vetes.

I pashë të gjitha pasuritë, nuk arrita të shoh pasuri më të mirë se aftësinë për të qenë i kënaqur me atë që zotëron.

I pashë të gjitha mirësitë, vërejta se nuk ka mirësi më të madhe se këshilla."

"I provova të gjitha ushqimet e verejta që nuk kishte asgjë më të shijshme sesa durimi."

"Ndërtimi i miqësive të shëndosha me njerëzit, është gjysma e inteligjencës. Pyetja me vend, është gjysma e diturisë.

"E çfarë është dynjaja përballë ahiretit! Ajo është aq e parëndësishme, sa edhe kërcimi i një lepuri." (Ibn-i Ebi Shejbe, Musannef, VIII, 152)

"Atij që braktis fjalët e kota, i dhurohet urtësi.

Atij që ul shikimet, i dhurohet modesti.

Atij që braktis ushqimin e tepërt, i dhurohet kënaqësi në adhurim.

Atij që braktis të qeshurën e shumtë, i dhurohet qetësi shpirtërore.

Atij që braktis ironinë, i dhurohet madhështi.



*Atij që braktis dashurinë ndaj kësaj bote, i dhurohet dashuria ndaj botës tjetër.*

*Atij që nuk merret me të metat e të tjerëve, i dhurohet aftësia për të përmirësuar të metat e nefsit të vet.*

*Atij që nuk e drejton vëmendjen dhe kuriozitetin tek ato cilësi të Allahut që janë përtej botëkuptimit njerëzor, i dhurohet shpëtim nga çdo element hipokrizie.”*

*“Dhjetë gjëra nuk përmirësohen pa dhjetë të tjera:*

*Mendja pa ndershmërinë, virtyti pa diturinë, shpëtimi pa frikën, mbreti pa drejtësinë, fisnikëria dhe nderi pa edukatën, lumturia pa sigurinë, pasuria pa bujarinë, varfëria pa mjaftueshmërinë, lartësimi pa modestinë, lufta pa suksesin.”*

*“Ai që nuk mëshiron, nuk do të mëshirohet; atij që nuk mbulon të metat e të tjerëve, nuk do t’i mbulohen te metat; ai që nuk fal, nuk do të falet; ai që nuk përpiqet të ruhet nga gjynahet, nuk do të ruhet e nuk do të mund të arrijë në gradën e devotshmërisë.”* (Buhari, el-Edebul-Mufred, fq. 415, nr: 371)

*“Duaja qëndron ndërmjet qiellit dhe tokës. Pa dërguar salavate mbi Resulullahun, Allahu nuk e lartëson atë dua.”* (Tirmidhiu, Vitr, 21)

*“Në pazarin tonë, le të tregtojë vetëm ai që i njeh rregullat e tregtisë.”* (Tirmidhiu, Vitr, 21/487)


*“Të të laudërojnë në sy, është njësoj si të të mbysin duke të të prerë gurmazin”* (Ibn Kutejbe, el Mesail, fq.145)

*Letrat e Omerit drejtuar guvernatorëve të shetit Islam:*

*“Për mua, puna më e rëndësishme që ju mund të bëni, është falja e namazit. Kush e ruan çdo kohë të namazit, e ka ruajtur fenë e tij; kush nuk e zbaton dhe e humb atë, do ta*



*humbasë edhe fenë e tij në pak kohë.*” (Muvatta, Vukutus-Salat, 6)

Një ditë, Kadi Shurajh i shkroi një letër Omerit, ku e pyeste se si duhej të gjykonte në zonën e tij. Omeri  i ktheu këtë përgjigje me shkrim:

*“Gjyko me librin e Allahut. Nëse nuk e gjen dot aty përgjigjen, atëherë gjyko me Sunetin e të Dërguarit të Allahut. Nëse nuk e gjen as në Librin e Allahut, e as në Sunetin e të Dërguarit të Allahut, atëherë gjyko me gjykimet e vepërmirëve. Nëse nuk e gjen as aty gjykimin e nevojshëm, atëherë nëse dëshiron vazhdo e jep gjykimin tënd, e nëse nuk e dëshiron këtë, atëherë tërhiq fare nga gjykimi. Mendoj se të tërhiqesh është më e mirë për ty. Ves-selam.”* (Nesai, Kudat, 11/3)

*“Pasuria dhe varfëria janë njëlloj; të dyja janë mjete transporti. Për mua nuk ka fare rëndësi se kujt do të më duhet t’i hip.”*

*“Personi më i zgjuar është ai që di t’i vlerësojë si duhet veprat e njerëzve.”*

*“Nivelin e inteligjencës së një personi arrij ta kuptoj nëpërmjet pyetjeve që bëh.”*

*“Punën e sotme mos e lër për nesër.”*

*“Në qoftë se puna mbetet qoftë edhe një herë të vetme prapa, nuk mundet të ecë më përpara me ritmet e kërkuara.”*

*“Ai që nuk e njeh të keqen, bie në kurthin e saj.”*

*“Mos u jep shumë pas kësaj bote, që të jetosh i lirë.”*

*“Nëse nuk jetoni ashtu siç besoni, atëherë do të filloni të besoni ashtu siç jetoni.”*

*“Nëse dëshironi të përmirësoni njerëzit, duhet që fillimisht të përmirësoni gjëndjen tuaj.”*



“Injoranti më i madh në mesin e njerëzve është ai që shet ahiretin e tij në këmbim të dynjasë së një tjetri.”

“E bukura e një mirësie qëndron në të shpejtuarit e realizimit të saj.”

“Dëshmitari më i fshehur i një pune të keqe është ndër-gjegjja.”

Kur e pyetën Profetin ﴿﴾ se çfarë është mirësia, ai u përgjigj: “Konsultohu me zemrën! Mirësia është ajo vepër të cilën zemra e miraton dhe tek e cila zemra gjenë prehje e qetësi. Kurse gjynah është ajo që të shqetëson së brendshmi dhe, edhe nëse të thojnë të tjerët «Bëje», ajo gjithmonë të ngjallë dyshime dhe dilema të forta.” (Ibn Hanbel, IV, 227-228)]

“Ai që mban të fshehur sekretin, ia ka arritur të dominojë mbi vetveten.”

“Trego fuqinë tënde pa ushtruar dhunë dhe trego butësinë tënde pa shprehur dobësi.”

Omeri ﴿﴾, me gjithë nivelin e tij të lartë shpirtëror dhe devotshmërinë e tij të pjekur, i bënte vazhdimisht Allahut këtë dua:

“O Zoti im! Mos më zër në befasi, mos më lër në indiferencë dhe mos më bëj nga të pavetëdijshtit.<sup>24</sup>

Omeri e kishte bërë zakon vetllogarinë, aq, sa mbrëmjeve ai godiste këmbët e tij me kamxhik dhe i kërkonte llogari vetes duke thënë: **“Çfarë bërë sot o Omer?”**<sup>25</sup> , .


Pa asnjë dyshim, të gjitha këto urtësi janë modele të bukura udhëzimi që na kanë mbetur trashëgim nga Omeri ﴿﴾. Ashtu si Omeri ﴿﴾, edhe ne duhet t’i kërkojmë llogari vetvetes çdo ditë

24. Ibn Ebi Shejbe, Musannef, VII, 82.

25. Ihja, v. IV, fq. 728.



duke thënë: “**Çfarë bërë sot për hir të Allahut?**” Duhet të jemi të kujdeshsëm në kryerjen e detyrave tona materiale dhe shpirtërore pa i neglizhuar, pa rënë në dembelizëm apo përtaci dhe pa e humbur ndjenjën e përgjegjësisë. Para se të japim llogari para të Madhit Zot, duhet të japim llogari para vetvetes.

**Allahu na e lehtësoftë llogaridhënien në botën tjetër! Na i lumturoftë shpirtrat me lumturinë e botës së amshueshme, duke na bërë të jetojmë jetën e kësaj bote plot vepra të mira në atmosferën e besimit dhe moralit të bukur! Allahu i dhuroftë shpirtave tanë diçka nga cilësia “Faruk” që zotëronte Omeri .**

**Amin...**







## OSMANI ﷺ



*I ditur, i sjellshëm, bujar, zemërbutë, i urtë, i turpshëm, njeri i zemrës, modest dhe i dashur, e siç shprehjet edhe vetë Profeti ﷺ, “sahabi me karakterin më të ngjashëm me Profetin.”*

*Një ditë, teksa ishte agjërueshëm dhe po lexonte Kuran në shtëpi, Osmani u martirizua, duke u vrarë nga kryengritësit.*

*Gjaku i këtij dëshmori që i kish kaluar të tetëdhjetat, pikoi mbi ajetin kuranor që po lexonte:*

**“... Allahu të mjafton përballë tyre.  
Ai dëgjon dhe sheh çdo gjë.”** (Bakare, 137)



Osmani ﷺ është njëri prej katër kalifëve të mëdhenj dhe njëri prej sahabëve të zgjedhur, që i ka shërbyer Profetit ﷺ me tërë shpirtin dhe pasurinë e tij . Gjithashtu, ai ka patur edhe fatin të jetë dhëndëri i Profetit. Ai ka kryer shërbime të mëdha, si në kohën e Profetit ﷺ, ashtu edhe në kohën e Ebu Bekrit, Omerit dhe në kohën kur ishte vetë kalif.

## Zotëruesi i dy dritave

Osmani ﷺ, i cili pati nderin e madh të martohet me vajzën e Profetit ﷺ, të nderuarën Rukije ﷺ, u hidhërua shumë kur ajo ndërroi jetë. Kur Profeti ﷺ e pyeti se përse ishte hidhëruar aq shumë, Osmani ﷺ e shprehu kështu shkakun e hidhërimit të tij:

*“O Resulallah! Ajo që më ka ndodhur mua, nuk i ka ndodhur askujt. Me vdekjen e vajzës tuaj Rukije, u pre edhe lidhja farefisnore që kisha me ju...!”*

Me gjithë propozimet e të afërmve të tij për t’u martuar përsëri, Osmani ﷺ thoshte: *“E kë mund të shoh më si vje-hërr përveç Profetit!? Pas martesës me bijën e tij, me kë të martohem përsëri!?”*



Duke menduar shkëputjen e lidhjes familjare me atë familje të bekuar, ai zhytej në hidhërim të thellë.

Profeti ﷺ, i cili e shihte gjendjen e Osmanit ﷺ, u kënaq shumë nga dashuria dhe lidhja e veçantë që ai tregoi. Si rrjedhojë, ai i dha për bashkëshorte edhe vajzën e tij të vogël, Ummu Gulsumin. Pas disa kohësh, kur edhe Ummu Gulsumi ndërroi jetë, Resulullahu ﷺ tha:

*“Nëse do të kisha një vajzë tjetër, padyshim që do të ta jepja ty.”*<sup>26</sup> Me këto fjalë, Profeti ﷺ shprehu edhe njëherë dashurinë e veçantë që kishte ndaj Osmanit ﷺ.

Osmani ﷺ, ishte i ditur, i sjellshëm, bujar, zemërbutë, i urtë, i turpshëm, njeri i zemrës, modest dhe i dashur, e siç shprehet edhe vetë Profetit ﷺ, *“sahabi me karakterin më të ngjashëm me Profetin.”* Nuk ishte parë midis sahabëve asnjë që të fliste aq bukur sa Osmani ﷺ. Por për fat, ai fliste shumë rrallë.




### Simboli i njeriut të turpshëm

Osmani ﷺ ishte personalitet shembullor edhe nga ana e ndjenjës së turpës, aq sa edhe melekët kishin turp prej tij.<sup>27</sup> Një ditë, kur Resulullahu, ﷺ, ishte ulur me nënën tonë, Aishen ﷺ, Ebu Bekri ﷺ i kishte kërkuar leje dhe kishte hyr brenda. Pas tij hyri Omeri ﷺ dhe Sa'd ibni Maliku. Por në çastin kur Osmani ﷺ kishte kërkuar leje për të hyrë brenda, Profeti ﷺ kishte ndërruar pozicionin e uljes dhe i kishte thënë Aishes ﷺ: *“Mund të largohesh!”*


26. Shih. Usdul-Gabe, III, 586.

27. Ahmed, I, 71; VI, 155.




Osmani  kishte hyr brenda dhe pasi kishin biseduar për pak kohë, kishte kërkuar leje dhe kishte dalë. Pas kësaj Aisha  i kishte thënë Profetit .

“Kur hyri babai im Ebu Bekri dhe sahabët e tjerë, nuk e ndërruat pozicionin e uljes dhe nuk më kërkuat të largohem (Përse vepruat ndryshe kur erdhi Osmani)!?”


Resulullahu, , ishte përgjigjur:

*“E si të mos turpërohem nga njeriu prej të cilit turpërohen edhe melekët!? Beto hem në Allahun se melekët turpërohen prej Osmanit, ashtu siç turpërohen prej të Dërguarit të Allahut. Nëse ti do të ishe pranë meje kur të hynte, ai as do të fliste dhe as që do ta ngrinte kokën derisa të dilte.”<sup>28</sup>*

Osmani , i cili ishte simbol i ndjenjës së turp-it, thoshte: “Ruajtja e syrit prej haramit është perde e mirë ndaj epshit”, dhe gjithmonë mendohej të udhëzonte njerëzit në këtë çështje.

Sipas një transmetimi të Enesit , një ditë, kur po shkonte tek Osmani , pa në rrugë një grua, bukuria e së cilës i mbeti në mendje. Kur arriti tek Osmani , ai i tha:

“O Enes! Po hyn këtu ndërkohë që në sytë e tu ka gjurmë zinaje!”

Enesi , i habitur dhe i turpëruar prej këtyre fjalëve, e pyeti:

“Vallë, a mos vjen shpallje edhe pas Profetit?”

Osmani , tha:

**“Jo, kjo është mprehtësi dhe intuitë e drejtë.”<sup>29</sup>**

28. Shih. Muslim, Fedailu's-Sahabe, 26-27.

29. Kushejri, Risale, Beirut 1990, f. 238.



Vlera e lartë që ka tek Allahut morali i bukur i këtij sahabi të nderuar, shprehet shumë bukur në këtë hadith:

Një ditë, Aliu ﴿﴾ i solli ujë Profetit ﴿﴾ me qëllim që ai të merrte abdest. Ndërkohë e pyeti:

“O i Dërguar i Allahut! Kush do të jetë personi i parë që do të thirret për llogari në ditën e kiametit?”

Profeti ﴿﴾ iu përgjigj:

“Unë! Unë do të qëndroj përpara Allahut sa të dua. Pastaj do të dal prej aty i pastër nga gjithçka.”

Aliu pyet përsëri:

“Po pastaj kush e ka radhën?”

Profeti ﴿﴾ tha:

“Pastaj Ebu Bekri, (edhe ai) do të qëndrojë para Allahut sa të dojë dhe do të dalë prej aty i pastër nga të gjitha gjynahet.”

Aliu ﴿﴾ pyeti përsëri:

“Po pastaj?” Profeti ﴿﴾ u përgjigj:

“Pastaj Omer ibn Hattab. (Edhe ai) Do të qëndrojë përpara Allahut dhe do të dalë prej aty i pastër nga të gjitha gjynahet.” Aliu sërish pyeti:

“Po pastaj?”

Këtë herë, Profeti ﴿﴾ tha:

“Pastaj ti!”

Aliu ﴿﴾ tha:






“Po Osman ibn Affani ku është?”


I Dërguari i Allahut, ﴿﴾, u përgjigj:






*“Osmani zotëron ndjenjën e turpit. Dëshirova prej Zotit tim që të mos e marrë në llogari dhe Ai e pranoi dëshirën time”.* (Muhammed er-Rafii el Kazvini, *et-Tedvin fi Ahbari Kazvin*, 1/114)

### **Aty ku nuk pranohet i Dërguari i Allahut, nuk vij as unë!..**

Osmani  e donte Resulullahun, , më shumë se shpirtin e vet. Edhe një shenjë që ai bënte e konsideronte si urdhër dhe sakrifikonte çdo gjë për ta zbatuar. Kur ishin në Hudejbije, ai shkoi në Mekke si i dërguar i Profetit dhe u tregoi mushrikëve se qëllimi i tyre ishte vetëm të bënin umre. Mushrikët nuk i dhanë leje, por i thanë Osmanit  se nëse dëshironte, vetëm ai mund të bënte tavafin në Qabe. Mirëpo, Osmani , duke e treguar edhe njëherë besnikërinë ndaj të Dërguarit të Allahut , ju dha këtë përgjigje të mrekullueshme:

*“Nëse Profeti nuk e bën tavaf Qaben, as unë nuk mund ta bëj! Unë e vizitoj Bejtullahun (Shtëpinë e Allahut) vetëm pas tij. Në vendin ku nuk pranohet i Dërguari i Allahut  nuk vij as unë!..”* (Ahmed, IV, 324)

Në momentin kur në Hudejbije u përhap fjala se Osmani  ra dëshmor, Profeti  mori besën prej sahabëve, se nëse lindte nevoja do të luftonin me idhujtarët. Pastaj, vuri një dorë mbi tjetrën dhe duke shprehur dashurinë dhe rëndësinë që i jepte atij (Osmanit) tha: *“O Allah! Ky besatim është për Osmanin! Padyshim që ai është në shërbimin Tënd dhe të Dërguarit tënd.”*<sup>30</sup> Në ato çaste vjen një i dërguar prej idhujtarëve, me qëllimin për të lidhur një marrëveshje. Pak më vonë, Osmani  kthehet shëndosh e mirë.

30. Buhari, As'habun-Nebi, 7.



## Dielli i bujarisë

Osmani ﷺ, i cili zotëronte këtë besnikëri shembullore, shquhej edhe për bujarinë e tij të madhe. Ai ishte aq bujar, sa thoshte: *“Sundimi i pasurisë është falënderimi. Ndërsa falënderimi është të dhurosh me bollëk”*. Në këtë mënyrë, ai bëhej vet shembull në këtë çështje. Gjithashtu, për hir të Allahut ai liroi dhe u bë shkak i lirimit të qindra robërve.

Në një fushatë lufte të vështirë si lufta e Tebukut, Osmani ﷺ i dhuroi ushtrisë 300 deve të pajisura për luftë, e për më tepër fali edhe një mijë dinarë. Për këtë arsye, Profeti ﷺ e lavdëroi dhe i dha myzhdenë se: *“Këtëj e tutje Osmanin nuk do ta dëmtojë asgjë nga ato që do të veprojë!”*<sup>31</sup>



Një herë tjetër, kur Osmani ﷺ emigroi në Medinë, pa se myslimanët po vuanin për ujë, sepse uji i të gjitha puseve të Medinës ishte i hidhur, përveç ujit të pusit Rume, që i përkiste një hebreu, i cili jetonte duke shitur këtë ujë.


Profeti ﷺ urdhëroi:



*“Kush prej jush dëshiron të fitojë një pus më të mirë në Xhenet, duke e blerë Pusin Rume dhe duke barazuar kovën e vet me atë të myslimanëve të tjerë?”*. Pra, që do ta blejë pusin dhe që do të mund të përfitonte prej tij në mënyrë të barabartë me myslimanët e tjerë.

Osmani ﷺ, kërkoi menjëherë që ta blinte këtë pus. Mirëpo hebreu nuk pranoi. Më në fund arriti të merrte gjysmën e të drejtës së pusit duke përdorur një ditë myslimanët dhe një ditë hebreu. Më vonë ia doli mbanë ta blinte të gjithin. Profeti ﷺ e pyet Osmanin ﷺ:






“A e dhuron atë (pusin) me qëllim që njerëzit të pijnë ujë prej tij?”. E, ai me gjithë zemër e dhuroi pusin. Kështu që, prej mirësisë së Osmanit , myslimanët e Medinës shpëtuan nga vuajtjet për ujë.

Sipas një transmetimi, për të marrë ujë nga pusi që vetë dhuroi, Osmani  priste në radhë si gjithë të tjerët. Përsëri sipas këtij transmetimi, për shkak të sakrificës që tregoi Osmani  u zbrit ky ajet i Kuranit Famëlartë:

**“O ti shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty! Bashkohu me robërit e Mi dhe hyr në Xhenetin Tim!”** (Fexhr, 27-30)



Me përhapjen e shpejtë të Islamit dhe me shtimin e numrit të atyre që vinin në Medinë, Mesxhidi Nebevi (Xhamia e Profetit) u bë e pamjaftueshme. Për këtë shkak, një pjesë e njerëzve kishte ngritur çadra përreth mesxhidit. Prandaj Profeti  urdhëroi e tha:

*“Ai që e zgjeron mesxhidin qoftë edhe një krah hyn në Xhenet.”*

Osmani  tha:

“O Resulullah! Të qoftë falë pasuria dhe malli im. Zgjerimin e mesxhidit e marr unë përsipër.” Lidhur me këtë zbriti ky ajet i Kuranit:

**“Faltoret e Allahut i vizitajnë dhe i mirëmbajnë vetëm ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit, që falin namazin dhe japin zekatin e që nuk i frikësohen askujt, përveç Allahut. Sigurisht që këta janë në rrugë të drejtë.”** (Teube, 18)<sup>32</sup>



32. Shih. Ahmed b. Hanbel - Musned, 511, Muhibbu't-Taberi, er-Rjadu'n-nadra, II, fq. 122, 123,



Kur Aliu ﷺ, kërkoi të martohej me Fatmën, kishte dërguar parzomren e tij në pazar për shitje dhe paratë e parzmores do t'i përdorte për shpenzimet e dasmës. Mirëpo, kur Osmani ﷺ, e pa parzomren e Aliut në pazar, e njohu menjëherë atë dhe pyeti se sa para kërkonte i zoti i asaj parzmoreje. Sapo mësoi se ai kërkonte katërqind dirhem, mori parzmoren dhe i dorëzoi paratë. Më pas, i shtoi dhe katërqind dirhem të tjerë dhe ia dërgoi Aliut duke i thënë:

“Këtë parzomre nuk e meriton askush tjetër veç teje. Ndërsa këto dirhem shpenzoi për dasmën dhe na fal këtë herë.”<sup>33</sup>



Është shumë domethënëse edhe ngjarja e mëposhtme, e cila pasqyron moralin e lartë të atyre shpirtave ndriçues:

Në kohën e kalifatit të Ebu Bekrit ﷺ, qe një periudhë kur në Medinë pllakosi zia. Atë kohë, nga Shami erdhi një karvan i Osmanit ﷺ prej njëqind devesh të ngarkuara me grurë. Kur e panë karvanin, vrapuan menjëherë të gjithë për të blerë grurin. Madje kërkuan të jepnin edhe shtatë dirhem për një masë gruri që kushtonte një dirhem. Osmani ndërhyri dhe tha: Jo! Ka të tjerë që japin më shumë, do t'ua shes atyre.



Të pikëlluar, sahabët u larguan dhe shkuan te Ebu Bekri ﷺ për t'u ankuar. Ebu Bekri ﷺ e kuptoi dhe tha: “Mos mendoni menjëherë keq për Osmanin... Ai është dhëndëri i të Dërguarit të Allahut ﷺ dhe miku i tij në Xhenetin Me'ua. Me sa duket, ju e keni kuptuar gabim fjalën e tij.” Më pas, të gjithë së bashku shkuan te Osmani ﷺ, ku Ebu Bekri ﷺ iu drejtua Osmanit:

33. Shih. Muhibbu't-Taberi, er-Rjadu'n-nadra, II, 238; Kastalani, Meuahib, II, 116; Zurkani, Sherh Meuahib, II, 3; Ramazanoğlu, fq. 139; M. Asım Köksal, İslam Tarihi, IV, 50-52.





“O Osman! sahabët janë mërzhitur nga një fjalë e jotja!”  
Osmani vijoi:

“Po, o kalifja e të Dërguarit të Allahut! Ata japin shtatë për një, por ka të tjerë që japin shtatëqind për një. Ne ua dhamë grurin atyre që dhanë shtatëqind për një.”

Më pas grurin e ngarkuar në njëqind deve ua shpërndau të varfërve në Medinë për hir të Allahut. Ndërsa njëqind devetë i bëri kurban. Ebu Bekri  u gëzua shumë për këtë gjest të tij dhe e puthi Osmanin  në ballë, duke i thënë:

“E kuptova që në fillim se sahabët nuk e kishin kuptuar domethënien e fjalës tënde.”<sup>34</sup>

## I dashuruar pas Kuranit

Në themel të këtij morali të lartë të Osmanit  qëndron padyshim frymëzimi që ai kishte marrë nga i Dërguari i Allahut  dhe Kurani Famëlartë. Me të vërtetë Osmani ishte plotësisht **i dashuruar pas Kuranit.**

Tri gjëra më janë mësuar t'i dua në këtë botë: të ushqej të uriturit, të vesh këmbëzbathurit dhe të lexoj Kuran, - tha Osmani, i cili ndërkohë realizoi edhe një nga shërbimet më madhore:

Në kohën e kalifatit të vet, ai mori Kuranin e mbledhur në kohën e Ebu Bekrit, e radhiti sipas sureve, e shumëfishoi dhe në vitin 30 hixhri e shpërndau nëpër qendrat e rëndësishme të shtetit Islam. Kështu, ai u preu rrugën të gjitha mosmarrëveshjeve që mund të lindnin në lidhje me Kuranin.

Osmani e kishte bërë zakon që çdo mëngjes të puthte Kuranin, me t'u ngritur nga shtrati. Po ashtu, ai thoshte:

34. Ibn Kuddame, er-Rikka ue'l-Buka, fq. 190



“Nuk dua të kaloj qoftë dhe një natë të vetme apo edhe një ditë pa lexuar librin e Allahut.” (Kenz, I, 225) Kështu, si rezultat i leximit të shpesht që bënte, atij i qenë vjetëruar dy Kurane.

Abdurrahman ibn Osman et-Tejmi thotë:

“Një natë, Osmani e përfundoi namazin duke e bërë hatme Kuranin në një natë.”

### Zuhdi dhe Modestia

Ja pra, të tilla ishin parimet e veçanta të jetës, të cilat kanë bërë që sahabët e bekuar të shndërrohen në yje të qiellit shpirtëror. Me gjithë mundësitë materiale që kishin, ata bënë një jetë modeste duke u përpjekur t'i përngjanin të Dërguarit të Allahut ﷺ.

Osmani ﷺ vishte rroba mjaft të thjeshta dhe të lira. Në mesditë flinte në tokë dhe kur ngrihej i dalloheshin gjurmët e gurëve. Ndërkohë që njerëzve u jepte ushqimet më të këndshme, në shtëpi s'kishte gjë tjetër veçse uthull e vaj ulliri. Ditën agjëronte, ndërsa netët i kalonte me namaz. Me mendimin se natën është kohë pushimi për shërbyesit, netëve e përgatiste vetë ujin për abdest, për të mos i shqetësuar ata.

Ebu Furat tregon një ndodhi që transmeton përpikmërinë e madhe të Osmanit i cili ishte tepër strikt në respektimin e të drejtës së robit.

Osmani i drejtohet shërbyesit të tij duke i thënë:

Kohë më parë të kam tërhequr veshin. Tani mund të zbatosh kisasin<sup>35</sup> mbi mua! Shërbyesi e kapi për veshi, ndërsa Osmani i thoshte: “Shtrengoje mirë biri im! Kisasi është për këtë botë, sepse në botën tjetër nuk ka.”<sup>36</sup>

35. Kisas: Dënim i një faji në të njëjtën mënyrë dhe sasi.

36. Taberi 2/111.



## Dëshmori i pafajshëm


Kalifati i Osmanit, ka kaluar shumë begatshëm edhe nga pikëpamja e çlirimeve. Në kohën e tij, u morën vende të tilla si Qiproja, Trablusi, Taberistani dhe Armenia, kishte nisur tregtia detare, ishin organizuar fushata ushtarake në Kostandinopojë dhe në ishujt Rodos e Maltë. Flota më e madhe Bizantine ishte asgjësuar në Detin Mesdhe. Si rezultat i këtyre zhvillimeve, thesari i popullit dhe i shtetit ishte pasuruar.

Me rritjen e pasurisë, në shpirtin e disave ishte bërë e dukshme dëshira për anën materiale të kësaj bote. Trazirat që ndezën hipokritët hebrenj si Abdullah ibn Sebe, kishin përfshirë botën Islame. Osmani ishte rrethuar në shtëpinë e tij në Medinë nga rebelët e mbledhur prej zonave të ndryshme. Madje, ai ishte privuar edhe nga uji i pusit që e kishte blerë me pasurinë e vet dhe ia kishte dhuruar popullit. Ja si shprehet vet kalifi i myslimanëve lidhur me gjendjen e vështirë në të cilën ndodhej dhe çastet e vështira që kishte jetuar përballë rebelëve, duke aluduar edhe në trazirat që do të lindnin më vonë:

“Unë jam si babai i fëmijëve që nuk e dëgjojnë fjalën e të atit për sa kohë që ai jeton, dhe të cilët janë aq të prapë sa edhe kur është duke vdekur nuk e lënë të qetë.”

Osmani nuk i lejonte sahabët që kishin kërkuar të përdornin forcën kundër kryengritësve, sepse nuk dëshironte të derdhej gjak për shkakun e tij. Prandaj, ai u tha:

“Më mirë të vdes para se të derdhet gjak, se sa të vdes pasi është derdhur gjak për mua.”

Ndonëse i këshilloi shumë herë rebelët, ai përsëri nuk arriti t'i bindte, derisa një ditë, teksa ishte agjërueshëm dhe po lexonte Kuran në shtëpi, Osmani  u martirizua padrejtësisht nga



kryengritësit. Gjaku i bekuar i këtij dëshmori që i kish kaluar të tetëdhjetat, rrodhi mbi mus'hafin ku po lexonte, në ajetin:

**“... Allahu të mjafton përballë tyre. Ai dëgjon dhe sheh çdo gjë.”** (Bakare, 137)

Profeti ﷺ ka thënë:

*“Betohem në Allah, se Osmani do të ndërmjetësojë për shtatëdhjetë mijë persona të ymetit tim, të cilët janë gjykuar për Xhehenem, duke i futur që të gjithë në Xhenet.”* (Dejlemi, Firdeus, 4/360)

Le t'u kushtojmë pak vëmendje këtyre fjalëve domethënëse e të urta të Osmanit ﷺ, i cili është një ndër sahabët më të nderuar, duke shpresuar kështu që të përfitojmë sado pak dituri dhe urtësi nga bota e tij shpirtërore:

### Fjalë të urta nga Osmani ﷺ

*Njeriu më i mençur është ai, i cili i kërkon llogari vetvetes, që arrin ta menaxhojë mirë atë, që punon për jetën e përtejme dhe që do të meritojë dritën e Allahut në errësirën e jetës së varrit.*

*Le të frikësohet çdo njeri nga ringjallja e tij si i verbër, megjithëse sytë e tij kanë parë në këtë botë! Kush kupton nga urtësia, i mjafton një fjalë e urtë. Të shurdhrit shpirtëror nuk e dëgjojnë të vërtetën.*

*Pesë shenja të njerëzve të devotshëm:*

1. Shoqërimi me ata që përpiqen në çështjet fetare.
2. Pastrimi i nefsit dhe kontrollimi i gjuhës.
3. Të qenurit i vetëdijshëm se çdo gjë që i përket kësaj



bote dhe që sjell harresën e Zotit është diçka e dëmshme që të shpie në humbje, ndërsa çdo gjë nga feja e tij është pasuria e vërtetë.

4. Të mos e mbushë stomakun me gjëra të dyshimta, qofshin këto edhe hallall (të jetë sa më i përpiktë dhe i kënaqur në këtë drejtim).

5. Të mendojë se të gjithë njerëzit kanë shpëtuar, ndërsa vetëm ai ka humbur.

Besimtari i vërtetë i frikësohet gjashtë gjërave:

1. Frika se mos humb besimin.

Në ajet thuhet: **“Zoti ynë! Mos na i përthyej zemrat pasi të na udhëzosh në rrugë të drejtë!”** (Al-i Imran, 8)

**“O ju që besuat! Frikësohuni Allahut sikur të garoni me të dhe jepni shpirt vetëm si myslimanë!”** (Al-i Imran, 102)

2. Frika se në ditën e gjykimit do t’i shpalosen nga melekët gjërat që do ta turpërojnë. Në ajet thuhet: **“Dhe pikërisht atë ditë, me njoftimin e Zotit i tregon të gjitha ndodhitë.”** (Zilzal, 4-5)

3. Frika se mos puna e bërë shkon dëm për shkak të shejtanit. Në Kuran thuhet: **“Iblisi tha: ‘Zoti im, për shkak se më përzure (më largove) unë do t’ua zbukuroj të këqijat atyre sa të jenë në tokë dhe të gjithë ata do t’i largoj nga rruga e drejtë. Përveç robërve të tu, të cilët i ke bërë të sigurtë.”** (Hixhr, 39-40)

4. Frika se do ta gjejë meleku i vdekjes, Azraili, të papërgatitur në çdo çast. Në Kuran thuhet: **“Adhuroje Zotin tënd deri sa të afrohet vdekja!”** (Hixhr, 99)

Në hadith thuhet:



**Njeriu vdes ashtu siç ka jetuar dhe ringjallet siç ka vdekur!** (Muslim, Xhenet, 83; Munavi, V, 663)

Duke u bazuar në këto, edhe Osmani ﷺ jetoi me Kuranin, e vuri atë në jetë dhe ra dëshmor bashkë me të.

5. Frika se mos e habit kjo botë deri në atë masë sa të harrojë ahiretin. Në Kuran thuhet: “**...Jeta e kësaj bote s’është gjë tjetër veçse një vend mashtrimi.**” (Al-i Imran, 185)

6. Frika se mos neglizhon dhikrin teksa merret me familjen e tij. Në Kuran thuhet: “**Ta dini që fëmijët dhe pasuria janë një provë për ju. Shpërblimi i madh është nga Zoti.**” (Enfal, 28)

“Nuk ka dyshim se kjo botë është e përkohshme ndërsa përjetësia është në botën tjetër. Mos t’ju mashtrojë e përkohshmja duke ju shmangur nga e përhershmeja. Ju zgjidhni të përhershmen në vend të së përkohshmes. Bota është e fundme dhe kthimi pa rikthim është vetëm tek Allahu. Frikësojuni Atij.” (Ibn-i Ebi Dunya, Mevsua, 1, 77)

“Bëjeni menjëherë të mirën që keni në mendje sa është pa ju ardhur exheli.”



**Zoti na mundësoftë të veprojmë sipas këtyre këshillave plot urtësi, dhe të jemi pjesë e asaj besnikërie. Zoti na mundësoftë miqësinë e ngushtë dhe afrimitetin në ahiret, duke e qëndisur dashurinë e Tij në shpirtrat tanë!**

**Amin!..**







## ALIU رضي الله عنه



*“Bota së bashku me fenë do të kenë qetësi dhe paqe vetëm atëherë kur të sigurohet vazhdimësia e këtyre katër gjërave:*

- 1. Të pasurit që nuk janë dorështrënguar me pasurinë e tyre.*
- 2. Të diturit të cilët veprojnë me diturinë e tyre.*
- 3. Injorantët të cilët nuk krenohen me paditurinë e tyre.*
- 4. Të varfrit që nuk e shesin ahiretin për interesat e dynjasë.”*





## ALIU ﷺ

Aliu ﷺ, lindi brenda në Qaben e madhërueshme, gjë me të cilën nuk është nderuar askush tjetër në faqen e kësaj toke.<sup>37</sup> Ngase familja e tij ishte shumë e madhe, atë e mori Profeti ﷺ në kujdesin e tij, kështu që qysh në moshën pesë vjeç ai filloi të edukohet nga Profeti ﷺ. Kësisoj, pa u përlyer hiç me traditat e ndyra të periudhës së injorancës, ai u bë fëmija i parë që pranoi Islamin.

Pasi filloi t'i vinte shpallja, Profetit ﷺ shkonte çdo vit në panairin që bëhej rreth Qabes në periudhën e haxhit, për t'i ftuar njerëzit që të hynin në Islam dhe merrte me vete ose Aliun ﷺ ose Ebu Bekrin ﷺ. Kur ata e lini pas Aliun, ai shkonte në Qabe kur nuk gjendej askush dhe thyente disa idhuj. Më pas, ai kthehej sërish te Profeti ﷺ.

Në periudhën e hixhretit, Aliu ﷺ, bëri një sakrificë shumë të madhe. Për t'ua shpërqendruar vëmendjen atentatorëve që kishin rrethuar shtëpinë e Profetit dhe që kishin si qëllim ekzekutimin e tij, veshi rrobën me ngjyrë të gjelbër të Profetit ﷺ dhe u shtri pa frikë në shtratin e tij.

---

37. Hakim, Mustedrek, III, 549.



Më vonë, pasi kreu disa porosi që i kishte lënë Profeti ﷺ, Aliu ﷺ, u nis i përmalluar drejt Medinës. Udhëtimi ishte shumë i vështirë, sepse duhej bërë natën. Kështu, ai arriti me këmbë të enjtura tek profeti, aq i dashur për të.

Në vitin e dytë të hixhrit, me urdhër të Allahut, Aliu ﷺ, pati fatmirësinë të martohej me Fatimenë, duke u bërë dhëndri i nderuar i Profetit ﷺ dhe një nga pjesëtarët e **Ehli Bejtit**.

### Mbreti i Bujarisë

Aliu ﷺ, nuk u dha shpirtërisht asnjëherë pas kësaj dynjaje të rreme, sepse ai u edukua nga vetë Resulullahu ﷺ. Shfaqjet e vëllazërisë dhe të empatisë ishin të pranishme në jetën e tij si askund tjetër. Profeti Muhamed, ﷺ, ka thënë:

*“Kur Allahu ia do të mirën dikujt, e bën atë të përparojë në rrugën e shërbimit dhe të kryerjes së nevojave të të tjerëve.”* (Sujuti, II, 4/3924)

Me dëshirën për t’u përfshirë në sihariqin në fjalë të Profetit, Aliu ﷺ, është shprehur:

*“Ka dy mirësi prej të cilave nuk jam i sigurt se cila më gëzon më tepër. E para është ardhja e një njeriu tek unë me mendimin se mund ta ndihmoj në kryerjen e hallit të tij, pra të kërkuarit nga unë ndihmë me gjithë shpirt.*

*E dyta është kur Allahu më bën mua mjet për t’ia kryer nevojën atij, apo për t’ia lehtësuar atë hallin që ka. Më shumë preferoj të mund t’ia kryej një punë apo një hall një vëllai mysliman, sesa të kem si pasuri një dynja me ar apo serm.”*  
(Ali el-Muttaki, Kendhul-Ummal, VI, 598/17049)

Ja disa shembuj që tregojnë praktikisht moralin e tij të lartë.

Tregohet se një ditë, Aliu e pyeti bashkëshorten e tij të nderuar:

“Më ka marrë shumë uria! A ka diçka për të ngrënë në shtëpi?”

Fatimeja i tha Aliut se nuk ka asgjë për të ngrënë dhe se në shtëpi ka vetëm gjashtë akçe. Atëherë, Aliu mori gjashtë akçet dhe doli për të blerë diçka për të ngrënë. Gjatë rrugës vuri re se një njeri po grindej me një mysliman dhe po i thoshte:

“Më jep borxhin, ose eja të shkojmë bashkë tani në gjykatë!”

Pavarësisht se borxhliu kërkoi nga borxhdhënësi që t’ia shtynte pak afatin e pagesës, ky i fundit as që deshi t’ia dinte. Aliu, i cili u gjend krejt rastësisht pranë atyre që po grindeshin, i pyeti:

“Për çfarë shume po grindeni?”

“Për gjashtë akçe.” - u përgjigjën ata. Atëherë, ndonëse ishte edhe vetë nevojtar për ato gjashtë akçe që kishte, Aliu ia dha menjëherë borxhdhënësit, duke e nxjerrë myslimanin nga situata e vështirë në të cilën ndodhej. Pas kësaj filloi të mendonte se çfarë do t’i thoshte Fatimesë. Por, tekembramja, Fatimeja është vajza e profetit dhe sigurisht që do të tregojë mirëkuptim, - mendoi me vete dhe u drejtua për në shtëpi.

Kur arriti në shtëpi ia tregoi ndodhinë, Fatimesë. Zonja e nderuar tha:

“Shumë mirë paske bërë, el-hamdu lil-lah, paske shpëtuar një mysliman nga burgu. Neve na mjafton Allahu.” Por ajo edhe u mërzi. Aliu vërejti menjëherë mërzinë e Fatimesë e gjithashtu lotët në sytë e fëmijëve të uritur për vdekje. Ndjeu një shqetësim të brendshëm për gjithë çfarë ndodhi dhe doli jashtë me një mendim: “Po shkoj tek Profeti. Do ta harroj këtë vuajtje duke



parë fytyrën e nurtë të bukurisë së tij profetike”. Gjatë rrugës, teksa po ecte mendueshëm, Ai hasi në rrugë një njeri që kishte një deve të majme. Ky njeri i tha Aliut:

“Dua ta shes këtë deve. A dëshiron ta blesh?”

Edhe pse Aliu i tha atij që nuk kishte asnjë lek në dorë, ai ia shiti devenë veresie Aliut për njëqind akçe. Sapo Aliu u largua pak me devenë në dorë, në rrugë u shfaq një tjetër njeri, i cili e pyeti:

“A mund të ma shesësh këtë deve për treqind akçe?”

Aliu pranoi dhe ia shiti. Meqë devenë e shiti me para në dorë, shkoi në Pazar, bleu diçka për të ngrënë dhe pastaj u kthye në shtëpi. Me të mbërritur në shtëpi ia shpjegoi Fatimesë çfarë i kishte ndodhur. Ata hëngrën dhe të gjithë së bashku falënderuan Allahun me gjithë zemër. Më pas, Aliu doli nga shtëpia dhe shkoi tek Profeti ﷺ, i cili e pyeti:

“O Ali! A e din kush ta shiti dhe kush ta bleu devenë?”

“I Dërguari i Allahut e di më së miri.” - iu shpreh Hazerti Aliu. Profeti tha:

“Ai që ta shiti devenë ishte Xhebraili جبرائيل, ndërsa ai që ta bleu, ishte Israfili إسرافيل. Kurse deveja ishte një deve prej atyre të Xhenetit. Allahu i Lartëmadhëruar ta shpërbleu me pesëdhjetëfish në këtë dynja mirësinë që i bëre atij myslimanit. Kurse në botën tjetër do të të shpërblejë me aq sa vetëm Ai e di.”



Sipas një transmetimi të Ibn Abbasit, Atâ عنه ka thënë:

Një herë, Aliu ujiti për tërë natën një bahçe me hurma për të fituar një sasi të caktuar elbi. Kur gdhiu, mori atë sasi elbi që



ishte haku i tij i punës dhe shkoi në shtëpi. Një të tretën e sasisë së elbit që fitoi Aliu atë natë, e bluajtën të gjithë së bashku si familje, që të gatuanin një ushqim të veçantë që quhej “hazira”. Pasi përgatitën hazirën, u duk në derë një i varfër që kërkonte ushqim. Ata i dhanë ushqim nga ai që e kishin bërë gati. Më pas morën një të tretën e dytë të elbit që Aliu kishte fituar duke punuar tërë natën, e bluan dhe e gatuan për ta ngrënë. Atë çast ia behu një jetim, që kërkoi diçka për të ngrënë. Ata ia dhanë menjëherë jetimit atë që kishin përgatitur për të ngrënë vetë. Pastaj filluan të bluanin e të përgatisnin pjesën e mbetur të elbit. Kur ushqimi u bë gati, u shfaq në derë një idhujtar i zënë rob, i cili u kërkoi diçka për të ngrënë. Kështu, edhe sasinë e fundit të ushqimit ia dhanë atij, duke e kaluar të uritur atë ditë.

Sipas një transmetimi tjetër, kjo histori ka ndodhur kur Aliu së bashku me familjen e tij kanë qenë agjërueshëm. Tre nevojtarët, pra i varfri, jetimi dhe skllavi kanë ardhur në prag yftari. Ushqimi u është dhënë këtyre të varfërve të sipërpërmendur, ndërsa pjesëtarët e kësaj familjeje të nderuar e kanë bërë yftarin vetëm me ujë. Kjo ngjarje u bë shkak për shpalljen e këtyre ajeteve:

**“Ata i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënët rob edhe pse vetë janë nevojtarë, duke thënë: Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim! Ne i frikësohemi Zotit tonë në një Ditë të ashpër, që do t’i bëjë fytyrat të jenë të vrenjtura. Por Allahu do t’i ruajë ata nga tmerret e asaj Dite e do t’u japë shkëlqim dhe gëzim.”**

(Insan, 8-11) (Vahidi, Esbabu Nuzul, s. 470; Zemahsheri, el-Keshshaf, VI, 191-192; Razi, XXX, 244)

Për këtë arsye, në lidhje me Aliun, Profeti ﷺ, është shprehur se ai është **“Sultanu’l-Es’hija”** që do të thotë “Mbreti i Bujarëve”.



Aliu është shquar në mesin e sahabeve të tjerë sa për sakrificën dhe bujarinë, aq edhe për diturinë, edukimin shpirtëror, vendimet e tij të sakta, guximin dhe trimërinë.

### Luani triumfues i Allahut

Aliu mori pjesë në të gjitha luftrat dhe tregoi trimëri e heroizëm të pashoq. Vetëm në luftën e Tebukut nuk pati mundësi të merrte pjesë, sepse Profeti ﷺ, e la të ruante myslimanët që do të qëndronin në Medinë, si dhe të ruante Ehli Bejtin e të kujdesej për të. Ky sahab i nderuar dhe i njohur prej gjithkujt për trimërinë e guximin e tij, e pyeti me zë të mekur Profetin ﷺ:

“O i Dërguari i Allahut! A po më lë mua me gratë e fëmijët, që të kujdesem për to?”

Profeti ﷺ, e ngushëlloi duke i thënë:

*“O Ali! A nuk dëshiron të jesh për mua si Haruni për Musain, përjashto cilësinë si profet.”<sup>38</sup>*

Sipas traditës arabe, çdo ushtri nxirrte për dyluftim në fushë-betejë luftëtarët më fisnikë dhe më të shquar në trimëri dhe heroizëm. Profeti ﷺ, e nxirrte Aliun në çdo betejë ku ai ishte pjesëmarrës. Me ndihmën e Zotit, Aliu triumfonte përballë çdo luftëtari armik. Për të theksuar këtë cilësi që manifestohej tek Aliu me dëshirën e Allahut, ai është quajtur **“Esedullahi'l Galib”**, pra, Luani triumfues i Allahut)


Sigurisht, në themel të trimërisë së Aliut ﷺ qëndronte edukimi shpirtëror që Profeti i kishte dhënë atij që në fëmijëri. Profeti ka thënë:

*“I fortë, nuk është ai që fiton në dyluftim, por ai që përmban veten e tij kur zemërohet.”* (Muslim, Birr, 107)





Duke jetuar me vetëdijen se trimi i vërtetë është ai që del fitimtar në betejën me egon e tij, Aliu u bë shembulli i gjallë i këtij hadithi:

Gjatë një beteje, Aliu  kishte vënë poshtë një armik dhe po e vriste. Njeriu që po e shihte vdekjen me sy, bëri një gjest të shëmtuar duke e pështyrë Aliun në fytyrë.

Për Aliun, një pjesëtar trim i familjes profetike dhe i cilësuar luan i Allahut, nuk ishte e vështirë t'ia priste me një të rënë të shpatës kokën një armiku që e kishte vënë nën vete. Por, duke pasur frikë se, pas gjestit të armikut, vrasja e tij do të bëhej një fitore e egos së vet, u ndal, e uli shpatën që e kishte dhuratë prej Profetit dhe hoqi dorë nga vrasja e armikut.

Armiku u habit! Pas gjestit të ulët kundër Aliut, armiku priste që ai ta vriste me një zemërim shumë të madh për t'ia shpague fyerjen. Por nuk ndodhi siç e kishte menduar! Armiku u ndodh ballëpërballë me një të vërtetë të paimagjinueshme për të. Duke mos e kuptuar dot sjelljen e Aliut, heroit të Islamit dhe të zemrës, e pyeti me kureshtje:

“O Ali! Pse qëndrove? Pse s’po më vret? Pse u qetësove kështu, papritmas?..”

Aliu i tha kështu:

“Këtë shpatë që ma ka dhuruar i Dërguari i Allahut, unë e vërtis në rrugë të Allahut dhe për pëlqim të Tij ua pres kokën mohuesve dhe hipokritëve! Dhe në këtë punë kurrë nuk e ngatërroj veten, sepse unë jam luani dhe shpata e Allahut, jo e vetes, mendjemadhësisë dhe krenarisë sime! Duke më pështyrë në fytyrë, ti deshe të më fyesh dhe zemërosh dhe unë do të të vrisja ty për një shkak të thjeshtë që s’i ka hije kurrë muslimanit. Por unë kam dalë të luftoj jo për të kënaqur krenarinë time, por për hir të Allahut!”



Zemrës së jobesimtarit, iu hapën sytë ndaj së vërtetës Islame dhe hyri menjëherë në të vetmen fe të Zotit. Më pas, ky njeri mori pjesë në disa luftra së bashku me Aliun kundër jobesimtarëve. Ai që deri dje ishte jobesimtar, luftoi me gjithë shpirt kundër egos së tij e gjithashtu kundër armiqve të Islamit, pa e përzier zemërimin që i buronte nga Islami me zemërimin apo shqetësimin që i buronte nga egoja e tij.

Në fushëbeteja të ndryshme Aliu shfaqte trimëri dhe heroizma të jashtëzakonshme, por nga ana tjetër ai i kushtonte një rëndësi të veçantë përkushtimit në adhurim, duke kryer me qetësi e kënaqësi të madhe shpirtërore çdo obligim adhurimi. Në një-rën prej luftrave, Aliut i ngulet në këmbë një shtizë. Sado që shokët u përpoqën t’ia shqitnin nga këmba, prapëseprapë nuk arritën, pasi nuk i lejoi dhembja që i shkaktonte Aliut. Atëherë Aliu ﷺ, u tha:

“Unë po filloj të fal namaz dhe ju gjatë kohës që falem, më nxirni shtizën nga këmba!”

Ata bënë ashtu siç u tha Aliu dhe në këtë mënyrë mundën t’ia hiqnin shtizën nga këmba pa hasur vështirësi. Pasi dha selam duke përfunduar faljen e namazit, Aliu i pyeti shokët:

“Çfarë bëtë, pse nuk e hoqët?”

Shokët e tij iu përgjigjën:

“Ta hoqëm shtizën nga këmba teksa po faleshe!”



Aliu ﷺ, falej me aq shpirt e përkushtim tek i Madhi, saqë harronte krejtësisht dimensionin e tij fizik dhe zhvishej krejtësisht nga tokësorja...

### Prej Qabes në Mesxhidin e Kufes...

Pasi Profeti ﷺ ndërroi jetë, Aliu ﷺ, i ndihmoi kalifët që



u zgjodhën në krye të shtetit me aq sa pati mundësi. Ai është gjendur në kuvendimet e tyre dhe ka dhënë mendimet e tij të thella e të sakta, të cilat në shumicën e rasteve janë marrë në konsideratë.

Pas vrasjes së Osmanit , nga rebelët, Aliu  pranoi kalifatin me insistimin e shumë sahabëve. Me të marrë detyrën e kalifit, puna e parë që bëri Aliu, ishte transferimi i qendrës së shtetit nga Medina në Kufe. Të gjithë besimtarët ishin të mërzi-tur tek shihnin se Medina, një qytet i mbushur me kujtimet e të Dërguarit të Allahut po bëhej skenë e përlëshjeve politike. Aliu e mori këtë vendim për ta ruajtur Medinën e për ta lënë atë qendër diturie dhe paqeje. Atë pjesë jete që i kishte mbetur pasi shkoi në Kufe, e kaloi mes grindjeve, përçarjeve, intrigave dhe kaosit të përgjithshëm politik.

Një herë e pyetën:

“O prijës i besimtarëve! A më jepni leje që, me dëshirën time, të bëhem ruajtësi juaj?”

Ndërsa Aliu është përgjigjur:

*“Ruajtësi i njeriut është exheli i tij!”*

Disa ditë para se të ndërronte jetë, duke e parashikuar vdekjen e vet, ai ndërpreu ngrënien dhe pirjen. Atyre që e pyesnin se përse e kish ndërprerë ushqimin, u thoshte:

*“Dëshiroj që urdhri i Allahut të më gjejë të uritur.”*

Pa kaluar shumë kohë, teksa po falte namazin e sabahut në Mesxhidin e Kufes, Aliu plagoset për vdekje nga Ibn Mulxhem. Kur ndodhi kjo ngjarje, ai ishte në moshën 63 vjeçare.

Kur Aliu dergjej në shtrat nga plagët, Xhundeb ibn Abdullah afrohet dhe i thotë:



“O prijësi i besimtarëve! Allahu mos na lëntë kurrë pa ty, por nëse Ai ka vendosur të të marrë afër Vetes, atëhere ne të japim besën se do të pranojmë si kalife djalin tënd Hasanin.”

Aliu , ashtu sikurse pati vepruar edhe Omeri, u përgjigj:

“Në lidhje me këtë temë as nuk ju urdhëroj të bëni atë që më thoni, por as nuk ju ndaloj! Ju i dini më mirë punët tuaja!!”

Pastaj, ai i la këtë testament Hasanit dhe Hysejnit:

“Po ju lë testament devotshmërinë! Mos i jepni rëndësi jetës së kësaj bote! Mos e qani atë që humbni! Thoni vazhdimisht të vërtetën! Organizojini veprimet tuaja të jetës duke u mbështetur tek Libri i Allahut, Kurani! Jini armiq ndaj atij që bën padrejtësi dhe miq të atij që i bëhet padrejtësi! Mos i jepni rëndësi fjalëve të atyre që qortojnë vendimet e fesë!”

Më pas, Aliu shqiptoi shehadetin dhe me frymën e tij të fundit e mbylli librin e kësaj jete. Kur erdhi në jetë, i pati hapur sytë së pari në Qaben e Madhërueshme, ndërsa fundin e tij fizik e përjetoi në një mesxhid ku njerëzit i faleshin Allahut.

I bërë pishman për ngatërresat e tij me Aliun, në periudhën e fundit të jetës së tij Muavija është shprehur:

“Ah sikur të kisha qenë një nga Kurejshët që jetonte në punën e tij. Ah sikur të mos isha përzier fare në këto çështjet e drejtimit.” (Ibn Esir, el-Bidaje, VIII, 135)

Një nga dijetarët më të mëdhenj shpirtëror të fesë ka thënë:

“Sikur Aliu të gjente pak kohë e mundësi prej luftrave që përjetoi në të gjallë të tij, kushedi sa gjëra të mrekullueshme do të na mësonte në lidhje me dituritë Kuranore. Tekembramja, ai është kryetari i të urtëve. Ai ka thënë fjalë që askush tjetër nuk i ka thënë e nuk do të mund t'i kishte thënë.”



## Disa fjalë të urta nga Aliu

*“Qetësoni shpirtrat tuaj me fjalë të urta e me fjalë që të bëjnë të mendosh! Ashtu siç lodhen trupat, ashtu lodhen edhe shpirtrat.”*

*“Nuk ka mirësi në namazin që falet pa shpirt, në agjërimin që mbahet pa u larguar nga fjalët dhe veprat e kota, në leximin e Kuranit pa meditim, në diturinë që nuk depërton në zemër, në pasurinë që nuk nxit bujarinë, në vëllazërimin që nuk shfaqet në kohë të vështira, në nderin që nuk prodhon falenderim, në lutjen që nuk del nga shpirti e që nuk bëhet në mënyrë të sinqertë.”*

*“Njerëzit janë armiq të asaj që nuk e dinë.”*

*“Xheneti është vendi i bujarëve, ndërsa xhehenemi është vendi i të paditurve.”*

*“Nuk do t’u bëhet pyetja të paditurve “Pse nuk u bëtë të ditur?” pa u pyetur më parë të diturit: “Pse nuk e shpërndatë diturinë tuaj, ashtu që t’ua mësonit edhe të tjerëve?”*

*“Ai që dëshiron Xhenetin vrapon drejt punëve të mira. Ai që i frikësohet zjarrit, ruhet nga epshi i tij. Atij që beson se një ditë do të vdesë, i shuhet egoja.”*

*“Ndershmëria është zekati i bukurisë.”*

*“Edukata dhe bujaria në fe, është fryti i mendjes së pjekur.”*

*“Ai që është i plotë me mendtë e kokës, flet shumë pak.”*

*“Ai që është vetëdijësuar se edhe fjalët janë pjesë e veprave, flet krejt pak. Ai flet vetëm për çështjet që i interesojnë.”*



“Të heshtësh deri atëherë sa të të pyesin, është më mirë se të flasësh deri atëherë sa të të thonë “A po e mbyll gojën tani?”

“Mos mendo t’i kthesh përgjigje atij që flet fjalë të poshtra, sepse ai që flet në mënyrë të tillë, ka në fjalorin e tij shumë fjalë të poshtra për t’i kthyer përgjigje përgjigjes tënde.”

“Mos bëj shaka me njerëzit injorantë. Ata ta thyejnë zemrën me gjuhën e tyre të helmët.”

“Flituni njerëzve me atë që ata kuptojnë.”

“Hija e një gjëje të shtrembër është po ashtu e shtrembër.”

“Ai që nuk zotëron sunetin e Allahut, të të Dërguarit të Tij dhe njerëzve të devotshëm, nuk zotëron asgjë. Suneti i Allahut është të mbash të fshehur sekretin; suneti i Resulullahut është të udhëhequrit e njerëzve me drejtësi; ndërsa suneti i të devotshmëve është të tregohesh i durueshëm ndaj mundimeve që të japin njerëzit.”

“Nëse dëshiron të miqësohesh me ndonjë njeri, mbaj ndaj tij një distancë të mirëpërcaktuar. Në qoftë se ai sillet në mënyrë normale, atëherë vazhdoje miqësinë me të; në të kundërt hiq dorë.”

“Personi zemra e të cilit është e mbushur me armiqësi, nuk mund të bëjë punë të mira. Kjo sepse zemra nuk është aq e gjerë sa të përmbajë njëkohësisht dy gjendje aq të kundërta.”

“Besimtari e ka buzëqeshjen në fytyrë, ndërsa trishtimin në zemër.”

“Vdekja me besim është arritja e mirësisë së plotë.”



“Jeta e kësaj bote përbëhet nga dy ditë. Njëra prej tyre është në dobinë tënde, ndërsa tjetra është në dëmin tënd. Kur të jesh në ditën tënde të mirë mos u llasto; gjithashtu mos u zemëro e mos anko kur të jesh në ditën tënde të keqe.”

“Sot është dita e të vepruarit, nuk ka asnjë llogaridhënie. Ndërsa nesër është dita e llogarisë, nuk ka mundësi veprimi.”

“Çdo frymë është një hap i hedhur drejt vdekjes.”

“Bota së bashku me fenë do të kenë qetësi dhe paqe vetëm atëherë kur të sigurohet vazhdimësia e këtyre katër grupeve:

1. Të pasurit që nuk tregohen dorështrënguar me pasurinë e tyre.
2. Të diturit të cilët veprojnë me diturinë e tyre.
3. Injorantët të cilët nuk krenohen me paditurinë e tyre.
4. Të varfrit që nuk e shesin ahiretin për interesat e dynjasë.”

“Sa bukur është kur të pasurit tregojnë modesti duke shpresuar në shpërblimin e Allahut të Lartëmadhëruar. Por akoma më bukur është kur i varfëri, duke u mbështetur tek Zoti i Lartëmadhëruar, sillet syngopur ndaj të pasurve.”

“Mjerimi është shumë më i mirë sesa t’i mbetesh dikujt moralisht borxh për diçka gjithë jetën.”

“Ndërshmëria është stolia e të varfrit, ndërsa falënderimi është stolia e të pasurit.”

“Koprracia bart në vete të gjitha veset e këqija.”

“Kur të varfërohesh dhuro lëmoshë duke bërë tregti me



*Allahun e Lartëmadhëruar. Kur të të bjerë në dorë ndonjë pasuri, falëndero menjëherë Zotin! Kujdes! Mos e humb pasurinë tënde nëpërmjet falënderimit të paktë.”*

*“Nga mirësitë e dynjasë të mjafton Islami. Nga preokupimet e ndryshme të mjafton ai i adhurimit. Nga mësimet që mund të nxjerrësh të mjafton mësimi që nxjerr nga vdekja.”*

*“Dituria është trashëgimia më e mirë. Edukata është arti më i mirë. Devotshmëria është ushqimi më i mirë. Adhurimi është kapitali më i mirë. Vepra e mirë është udhërrëfyesi më i mirë. Morali i mirë është miku yt më i afërt. Butësia është ndihmësja jote më e madhe. Të jesh i kënaqur me atë që ke është pasuria më e madhe. Përkujtimi i vdekjes është edukuesi yt më i mirë.”*

*“Katër virtyte janë ndër punët më të vështira:*

- 1. Të falësh në gjendje zemërimi.*
- 2. Të tregohesh bujar kur je nevojtar.*
- 3. Të ruhesh nga dëmi i egos tënde në vende të mbyllura dhe të hapura.*
- 4. Të thuash të vërtetën përballë atij prej të cilit ke frikë apo ke ndonjë interes.”*

*“Allahu i dërgon fatkeqësi të mëdha atij që i zmadhon fatkeqësitë e vogla.”*

*“Pasuria është brumi i dëshirave të egos. Dëshirat (egoistike dhe tokësore) janë çelësi i vuajtjeve tona. Zilia po ashtu është një lodhje e kotë.”*

*“Dëshirat dhe shpresat që të kultivon jeta e kësaj e bote verbojnë edhe një njeri largpamës.”*





*“Një person ka vlerë aq sa dëshirat dhe ëndrrat e tij.”*

*“Ai që bëhet skllav i dëshirave dhe i ëndrrave të egos së tij, nuk ka si t’i ketë veprat e mira.”*

*“Nëse ti nuk e gjen rrugën për tek rrisku yt, atëherë është rrisku yt ai që e gjen rrugën për tek ti.”*

*“Në këmbim të shpirtit tuaj mos pranoni asgjë tjetër përveç Xhenetit. Prandaj shiteni shpirtin tuaj vetëm në këmbim të tij.”*

*“Miqtë e Allahut të Lartëmadhëruar janë ata njerëz të cilët, arrijnë të shohin planin e brendshëm të dynjasë, kur të tjerët shohin vetëm planin e jashtëm të saj.”*

*“Imani (besimi) i atij njeriu që nuk i beson më shumë punëve të Zotit sesa punëve të tij nuk është përsosur akoma!”*





# SHOQËRIA DHE UDHËHEQËSIT



*Vihet re se njerëzit që kanë udhëheqës, pamjet e tyre janë si pasqyra që reflektojnë njëra-tjetrën. Në bazë të kësaj, duke filluar që prej një familje të vogël, ose prej një xhemati, e deri tek kombet e mëdhenj, të gjitha shoqëritë marrin formë sipas nivelit materialo-shpirtëror të udhëheqësve të tyre dhe, po ashtu, edhe udhëheqësit marrin formë sipas meritës materialo-shpirtërore të shoqërisë.*



## SHOQËRIA DHE UDHËHEQËSIT

Allahu i Madhëruar, krijesave të Tij u ka falur një stil jete dhe një rregull shoqëror në përputhje me cilësitë e tyre. Zoti ynë, dëshiron që edhe njeriu, i cili është krijuar në mënyrën më të përsosur me bukuritë dhe aftësitë fizike e shpirtërore, të jetojë me pjekurinë e një zemre të nënshtruar ndaj harmonisë së manifestimeve të madhështisë dhe fuqisë hyjnore në gjithësi. Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

**“Ai e ka ngritur qiellin lart dhe ka vënë Balancën** (për çdo gjë)! (Prandaj) **Mos e prishni balancën.**” (Rahman, 7-8.)

Po ashtu, ndryshe nga krijesat e tjera, Allahu i Madhëruar i ka detyruar njerëzit të jetojnë më tepër nevojtarë ndaj njëri-tjetrit. Për këtë arsye, gjatë gjithë historisë, njerëzit nuk kanë jetuar të ndarë në individë, por janë prirë për të jetuar gjithmonë në shoqëri, që prej fiseve të vogla, e deri tek formimi i shteteve. Dhe, me qëllim që kjo prirje të marrë jetë brenda një rregulli harmonik, është kusht i domosdoshëm edhe prania e udhëheqësve/prijësve që orientojnë shoqëritë dhe sigurojnë ekuilibrin midis tyre dhe shoqërisë.

Nëse shihet me syrin e urtësisë, vihet re se njerëzit që kanë udhëheqës, pamjet e tyre janë si pasqyra që reflektojnë njëra-



tjetrën. Në bazë të kësaj, duke filluar që prej një familje të vogël, ose prej një xhemati, e deri tek kombet e mëdhenj, të gjitha shoqëritë marrin formë sipas nivelit materialo-shpirtëror të udhëheqësve të tyre dhe, po ashtu, edhe udhëheqësit marrin formë sipas meritës materialo-shpirtërore të shoqërisë. Aftësia dhe drejtësia e atyre që janë në krye, sjellin paqen dhe mirëqenien e shoqërisë. Ndërsa në të kundërtën e kësaj, paaftësia dhe padrejtësia e udhëheqësve, sjellin shkatërrimin e shoqërisë.

Nga ana tjetër, nëse shoqëria arrin të përmirësojë veten e saj, do të ketë udhëheqës të mirë. Por, nëse ajo i braktis virtytet e bukura dhe bie pre e dobësive morale, në krye të saj vijnë udhëheqës po aq të pamoralshëm të cilët punojnë vetëm për interesat personale. Kjo, sepse edhe udhëheqësit janë prodhim i shoqërisë, pra, dalin prej saj.

Nga kjo pikëpamje, për arritjen e paqes dhe lumturisë shoqërore, është kusht që, pikësëpari edhe udhëheqësit, edhe shoqëria duhet t'i kërkojnë të metat tek vetja, duke u përpjekur të përmirësojnë gjendjen e tyre. Pra, morali i tasavufit që synon, **“kritikën ndaj vetes dhe tolerancën ndaj të tjerëve”**, nuk është i domosdoshëm vetëm për paqen dhe mirëqenien e jetës shpirtërore, por edhe për atë të jetës shoqërore. Lidhur me këtë, në Kuranin fisnik urdhërohet:

**“...Me të vërtetë, Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata të ndryshojnë gjendjen e tyre!...”** (Ra'd, 11.)

**“Kjo, sepse Allahu nuk ia ndryshon kurrë mirësinë që ia ka dhënë një populli, derisa ata të ndryshojnë atë që kanë në veten e tyre!...”** (Enfal, 53.)

Siç urdhërohet edhe në ajetet fisnike, mirësitë dhe mëshira hyjnore që i janë dhënë një populli, varen nga vazhdimësia e



gjendjes së tyre të mirë. Por, kur braktisen virtytet me të cilat është i kënaqur Zoti ynë, atëherë mëshira dhe mirësitë e Allahut largohen nga ai popull dhe aty shfaqet anarkia. Siç shprehet në një hadith fisnik, atëherë, *“nëntoka bëhet më e mirë se mbitoka”*.

Nisur nga kjo, shoqëritë të cilat dëshirojnë që udhëheqësit në krye të tyre të jenë njerëz të mirë dhe të jetojnë në paqe e qetësi, si fillim duhet të bëjnë kujdes që gjendja e tyre të jetë në përputhje me kënaqësinë hyjnore. Në një hadith fisnik, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

*“Ashtu siç jeni, ashtu qeveriseni!”* (Sujuti, Xhamiu’s-Sagir, II, 82.)

Po ashtu, edhe kjo ndodhi kuptimplote, e shpreh më së miri këtë të vërtetë:

Kur Aliu ﷺ, u plagos rëndë na Ibn-i Mulxhem, njerëzit u mblodhën rreth tij dhe i thanë:

*“O prijësi i besimtarëve! Na cakto një udhëheqës!”* Mirëpo, Aliu ﷺ, u tha:

*“Unë po ju lë ashtu si ju la i Dërguari i Allahut ﷺ! Atë kohë, edhe ne i thamë atij: «O i Dërguar i Allahut! Sikur të caktoni një udhëheqës për ne!» Mirëpo, i Dërguari i Allahut ﷺ, na tha: «Nëse Allahu i Madhëruar sheh diçka të mirë tek ju, do t’ju japë udhëheqës prej të mirëve tuaj!»*

*Allahu ka parë mirësi tek ne, që na vuri në krye Ebu Bekrin ﷺ .”* (Hakim, III, 156/4698.)

Po ashtu, në kohën Kalifatit të Aliut ﷺ, u shfaqën shumë kundërshti dhe trazira. Një ditë, atij i drejtuan një pyetje të tillë:

*“Përse ndodhin të gjitha këto në kohën tënde, ndërkohë që në kohën e kalifeve para teje nuk ka pasur kundërshti të tilla?”* Aliu ﷺ, i cili ishte dera e qytetit të dijes dhe urtësisë, u përgjigj:

*“Ata ishin prijësit e njerëzve si unë, ndërsa unë jam prijës i njerëzve si ju!”*

Me këtë, ai deshi të shprehte se sjelljet e udhëheqësve, janë sipas nivelit shpirtëror të njerëzve që ata udhëheqin. Po ashtu, gjendja është e njëjtë edhe nëse shihet nga aspekti i udhëheqësve. Për rrjedhojë, lidhur me këtë çështje, Omeri رضي الله عنه, ka thënë:

*“Njerëzit ndjekin rrugën, metodën dhe qëndrimin që kanë udhëheqësit e tyre.”*

*“Nëse udhëheqësit janë në rrugë të drejtë, edhe njerëzit do të jenë në rrugë të drejtë!”* (Ibnu'l-Xheuzi, Menakib, fq. 223.)

Dhe me të vërtetë që populli, në përgjithësi imiton dhe ndjek njerëzit që ka në krye. Këto shembuj historik, e shpjegojnë shumë bukur faktin që gjendja e popujve është sipas gjendjes shpirtërore të udhëheqësve të tyre:

“Një prej kalifeve Emevit, Uelid ibn Abdulmelik, ishte shumë i dhënë pas ndërtesave të bukura. Po ashtu, edhe populli e ndoqi atë në këtë pasion. Madje, nëpër mbledhje diskutohej vazhdimisht për çështjet e ndërtimit. Ndërsa Sulejman ibn Abdulmeliku ishte shumë i dhënë pas ushqimeve. Për rrjedhojë, edhe njerëzit në kohën e tij e shpërdoronin kohën duke folur për ushqimet dhe pijet. Kurse Omer ibn Abdulazizi, ishte njeri i devotshëm dhe asket. Në kohën e tij, populli hyri në rrugën e adhurimeve dhe bindjes ndaj Allahut. Madje, ata vazhdimisht e pyesnin njëri-tjetrin në formë këshille: «Çfarë lutjesh ke bërë këtë natë? Sa ajete ke mësuar përmendësh prej Kuranit Fisnik? Sa ditë ke agjëruar këtë muaj? Sa të varfërve, të sëmurëve apo jetimëve u ke gëzuar zemrat?»”<sup>39</sup>

39. shih. Ahmed Xhevdet Pasha, Kisas-i Enbija ue Teuarih-i Hulefa, İstanbul 1976, V. 1, fq. 717; Taberi, Tarihu'l-Umem ue'l-Muluk, Kahire 1939, V, 266-267.






Dhe me të vërtetë që, gjendja shpirtërore e atyre që janë në krye të popullit, herët a vonë, reflektohet edhe në popull. Nisur nga kjo, punët e mira dhe të bukura që bëjnë udhëheqësit, bëhen shkas që në popull të formohet një atmosferë mirësie dhe bukurie e përgjithshme. Në të kundërtën, gabimet dhe paaftësitë që tregojnë udhëheqësit, bëhen shkas i përhapjes si trazirave në të gjithë shoqërinë. Për këtë arsye, edhe populli thotë: *“Peshku qelbet nga koka!”*.

Nisur nga ky fakt, duke filluar që prej kryefamiljarëve, kryetarëve të vakëfeve dhe shoqatave, e deri tek liderët e xhemateve dhe prijësit e popujve, të gjithë udhëheqësit janë të detyruar të sillen në mënyrë shumë të kujdesshme. Ata duhet të llogarisin rëndësinë e madhe të përgjegjësive që kanë. Lidhur me këtë gjendje shumë delikate, tregohet se i nderuari Shejh Edebali, e ka këshilluar Osman Gazin me këto fjalë:

*“Mos harro se ata që qëndrojnë sipër, nuk janë më të sigurt se ata që qëndrojnë poshtë!”*

Po ashtu, kur Omeri , i urdhëronte apo i ndalonte njerëzit për diçka, pikësëpari ai fillonte nga familja e tij. Ai e mblidhte familjen dhe u thoshte:

*“Unë e kam ndaluar këtë dhe këtë!.. Njerëzit do t’ju vëzhgojnë siç vëzhgon zogu grabitqar mishin. Nëse ju e shkelni këtë ndalesë, edhe ata do ta shkelin. Nëse ju ruheni dhe qëndroni larg, edhe ata do të veprojnë ashtu. Beto hem në Allahun se, nëse dikush prej jush nuk i bindet kësaj ndalese për shkak të afërsisë që ka me mua, unë do ta ndëshkojë më tepër atë! Tani, kush të dëshirojë le ta veprojë, kush të dëshirojë le të ruhet!”* (Ibnul-Xheuzi, Menakib, fq. 266.)

Nëse shihet koha kur popujt janë ngritur në çdo aspekt, vihet re se me sa kujdes dhe përkushtim të madh i kanë kryer detyrat e tyre ata që kanë qenë në postet udhëheqëse.



Sa bukur e reflektojnë këtë rigorozitet këto fjalë të rregullores që Sulltani Osman, Sulejman Kanuni i ka dërguar Gazi Bali Beut:

*“Kujdesu për popullin, sepse nëse bejlerët dhe përfaqësuesit janë njerëz të mirë, përmirësohet edhe gjendja e shoqërisë. Kjo, sepse populli reflekton gjendjen e atij që ka në krye.*

*Ka disa njerëz që ditën janë agjërueshëm, ndërsa natën kryejnë adhurime. Mirëpo, një pjesë e këtyre tregojnë dashuri të tepruar edhe ndaj pasurisë së kësaj bote. Kështu, ata bëhen adhuruesit e pasurisë së tyre. Asgjë nuk e harbon shoqërinë me tepër se dashuria ndaj pasurisë. Kujdes, mos ano edhe ti nga gjërat e përkohshme! Mirësitë që posedon, shpenzoi bujarisht mbi robërit e Allahut, hape dorën bujare dhe ruhu shumë prej smirës!..”*

Gjendja dhe sjelljet e Profeti ﷺ, janë shembuj shumë të bukur për udhëheqësit tanë. Ai interesohej personalisht me të gjitha hallet e sahabëve dhe, në kohët më të vështira, qëndronte në krye të tyre. Madje, edhe sahabët më trima, si Aliu ﷺ, janë shprehur se në momentet më të vështira dhe të rrezikshme: “Ne strehoheshim pas të Dërguarit të Allahut!”

Nga kjo pikëpamje, ata që u prijnë njerëzve duhet të dinë se është e domosdoshme që ata të jenë në krye duke sakrifikuar gjithmonë prej vetes së tyre dhe se shërbimi i pranuar nuk mund të kryhet asnjëherë me komandë nga larg.

Po ashtu, gjatë udhëtimeve, i Dërguari i Allahut ﷺ, për t'i ndihmuar të dobët të mbeteshin pas, ecte pranë tyre. Kjo, sepse një bari i mëshirshëm, nuk e braktis kurrë delen e sëmurë, por përkundrazi e bart atë në krahë dhe nuk e ndan prej tufës.

Nga na tjetër, ata që gjenden në krye të popujve, nuk duhet të lazdrohen nga pozitat që kanë. Por përkundrazi, ata nuk duhet



të harrojnë asnjëherë se janë si nëpunës administrimi në pronën e Allahut dhe se një ditë do të merren patjetër në llogari në Gjykatën hyjnore. Për rrjedhojë, Imam Maliku, me një letër drejtuar kalifit të kohës së tij, e këshillon atë në këtë mënyrë:

*“Omeri ؓ, e ka kryer dhjetë herë haxhin. Me sa di unë, gjatë çdo haxhi shpenzonte vetëm dymbëdhjetë dinarë. Ai nuk qëndronte në çadër por nën hijen e ndonjë peme. Kacakun e ujit e varte në qafë. Shëtiste pazarin, interesohej për hallet e nevojtarëve dhe ua plotësonte nevojat. Siç e dimë, kur u plagos, sahabët i shkuan pranë dhe filluan lëvdonin. Mirëpo, Omeri ؓ, u tha:*

*«Kush kaplohet nga këto lloj lëvdatash të përkohshme, është i mashtruar. Nëse do të kisha një dynja të tërë me ar, do ta kisha flijuar të gjithën për të shpëtuar prej tmerreve të ditës së mahsherit.»*

Imam Maliku, vazhdon kështu me këshillat e tij:

*“Omeri ؓ, vepronte saktë dhe me drejtësi. i Dërguari i Allahut e përgëzoi atë me Xhenet. E megjithatë, ai kishte frikë dhe përpqej shumë që t’i drejtonte sa më mirë punët e muslimanëve që kishte në përgjegjësi. E, përderisa ai mendonte kështu, atëherë si do vejë halli i të tjerëve!?”*

Po ashtu, edhe delikatesa e besimit dhe modestia e çliruesit të Andaluzisë, Tarik ibn Zijadit, është një shembull i mirë lidhur me këtë çështje:

Ushtria prej pesëmijë ushtarësh e Tarik ibn Zijadit, arriti të shkatërronte ushrinë spanjolle prej nëntëdhjetë mijë ushtarësh. Tariku, vendosi këmbën e tij mbi thesaret e mbretit dhe i tha vetes:

*“O Tarik! Dje ishe një skllav me qafore. Por, erdhi dita dhe Allahu të dha lirinë. Më pas u bërë komandant. Ndërsa sot, more*

Andaluzinë dhe tani gjendesh në pallatin e mbretit. **Dije mirë dhe mos e harro kurrë se, nesër do të dalësh para Allahut!**



Ata që gjenden në pozitën e drejtimit të popujve, duhet ta konsiderojnë veten si një lloj shërbyesi, i cili është ngarkuar me detyrën e përballimit të nevojave të popullit. Edhe babai im i ndjerë Musa Efendia -Allahu e mëshiroftë-, thoshte se ata që ndodhen në krye të një populli, duhet ta konsiderojnë veten si shërbyes të popullit dhe nuk duhet të kaplohen prej mendjemadhësisë dhe arrogancës për shkak të pozitës që kanë. Por, përkundrazi, ata duhet tregojnë gjithmonë butësi dhe mëshirë ndaj njerëzve dhe në mënyrë të veçantë, duhet ta kryejnë shërbimin e tyre me ndjenjën e modestisë dhe falënderimit:

*“Njerëzit që shërbejnë, duhet të jenë të vetëdijshëm se, mundësia për të shërbyer, është një mirësi prej Zotit tonë. Mirëpo, jo të gjithë e kanë fat këtë mirësi. Ka shumë njerëz që, edhe pse kanë aftësi për të shërbyer në çdo çështje, nuk e kanë fatin për të shërbyer për shkak të pamundësisë së kohës dhe vendit. Ata që shërbejnë, duhet ta konsiderojnë mirësi shërbimin që bëjnë dhe duhet ta shtojnë modestinë e tyre. Madje, ata duhet të punojnë me ndjenjën e falënderimit ndaj atyre të cilëve u shërbejnë, sepse ata janë bërë shkak që ai të jetë në atë pozitë.”*

Ja pra, në periudhat kur udhëheqësit kanë zotëruar një delikatesë të tillë shpirtërore, edhe popujt janë ngritur e gjallëruar në aspektin materialo-shpirtëror. Mirëpo, një nga virtytet më të rëndësishme të udhëheqësve të kohëve të tilla, ka qenë përlulja me edukatë të lartë ndaj kritikave dhe këshillave të dijetarëve dhe të urtëve dhe formimi i një këshilli me njerëz të aftë rreth vetes.

Nisur nga kjo, udhëheqësit nuk duhet të lejojnë të rrethohen



nga njerëz servilë dhe duhet të këshillohen me njerëz të ditur e të urtë të cilët do t'i raportojnë gjendjen e popullit në mënyrë të saktë dhe do t'i tregojnë rrugëzgjdhjet e duhura. Kjo, sepse këshillimi me njerëzit e duhur, është një sunnet profetik. Edhe pse i Dërguari i Allahut ﷺ, gëzonte mbështetjen hyjnore, ai këshillohej në çdo punë, gjë e cila përbën një shembull shumë të bukur për ne.

Nga ana tjetër, me qëllim që të ruhet paqja dhe siguria në shoqëri, edhe populli duhet të tregojë respekt dhe bindje ndaj autoriteteve udhëheqëse për sa kohë ato veprojnë me drejtësi. Përveç kësaj, ata duhet t'i inspektojnë vazhdimisht udhëheqësit dhe duhet të bëjnë kritikën e duhur me edukatë dhe respekt me qëllim që të ruhet rruga e drejtë.

Në kohën kur Omeri ﷺ, mori drejtimin e kalifatit, pyeti të pranishmit:

*“O njerëz! Çfarë do të bënit nëse unë do të devijoj nga rruga e drejtë dhe drejtësia?”* Një njeri prej popullit u ngrit dhe tha:

*“O Omer! Nëse ti devijon nga rruga e drejtë dhe drejtësia, do të të drejtojmë me shpatat tona!”* Kur dëgjoji këtë, Omeri ﷺ, shprehu kënaqësinë e tij dhe tha:

*“Elhamdulillah (Falënderimi i takon Allahut)! Paskam shokë të cilët do të më drejtojnë me shpatë nëse devijoj!..”*

Njëherë tjetër, Omeri ﷺ, ka thënë:

*“Njeriu që dua më shumë, është ai që më lajmëron për të metat dhe gabimet e mia!”* (Sujuti, Tarihu'l-Hulefa, fq. 130.)

Nisur nga kjo, edhe udhëheqësit duhet të jenë të hapur ndaj këshillave dhe kritikave të popullit. Madje, në vend që të shqetësohen për vënien në pah të gabimeve dhe të metave të



tyre, ata duhet të jenë të kënaqur dhe të përpiqen të përmirësojnë vetveten.

Gjithashtu, edhe populli duhet t'i qortojë udhëheqësit e tij me sinqeritet vetëm për hir të Allahut dhe, nëse është e nevojshme, ata duhet të tregojnë sakrifica në këtë çështje duke i vënë në plan të dytë interesat e tyre të përkohshme. Kjo, sepse përgjegjësia në lidhje me lumturinë dhe paqen e shoqërisë, nuk bie vetëm mbi udhëheqësit, por edhe mbi individët dhe të gjithë popullin.

Mbyllja e syve përballë gabimeve të udhëheqësve dhe mos qortimi i tyre për interesa të kësaj bote dhe, akoma më keq, mbështetja e tyre me qëllim që të vazhdojë sistemi i tyre i tiranisë dhe padrejtësisë, bëhet shkak i një dështimi të madh në botën tjetër. Ata që ndjekin liderët e këqij në këtë botë, do të shkojnë pas tyre në zjarr edhe në botën tjetër. Nga kjo pikëpamje, gjithsecili duhet të bëjë kujdes se pas kujt është duke shkuar.

Në Kuranin fisnik urdhërohet:

**“Ditën, kur Ne do t’i thërrasim të gjithë popujt me priësin e vet, ata, që do t’u jepet libri në anën e djathtë, do ta lexojnë librin e vet dhe nuk do të pësojnë as padrejtësinë më të vogël.”** (Isra, 71.)

**“Ai do ta udhëheqë popullin e tij në Ditën e Kiametit e do ta çojë në zjarr. Eh, sa vend i shëmtuar është ai, ku do të sillen ata!”** (Hud, 98.)

Nisur nga kjo, orientimi dhe udhëzimi i udhëheqësve tek e drejta dhe e mira, është një nga detyrat më të rëndësishme të besimtarëve. Imam Ebu Jusufi, në librin *“Kitabu’l-Haraxh”*, që e ka shkruar për kalifin Harun Rashid, jep këto këshilla:

*“Mos hezito të mbash në këmbë drejtësinë qoftë edhe një moment në hapësirën e sundimit që të ka falur Allahut i*



*Madhëruar! Sepse ditën e kijametit, bariu (udhëheqësi) më i lumtur tek Allahu, është ai prej të cilit është e kënaqur tufa (populli) e tij. Ti mos devijoj nga e drejta, përndryshe edhe populli yt do të devijojë! Ruhu nga urdhërimi sipas qejfit dhe gjykimi me zemërim. Kur të përballesh me dy mundësi, njëra prej së cilës lidhet me ahiretin, e tjetra me dynjanë, ti prefero atë të ahiretit përpara asaj të dynjasë, sepse ahireti është i përjetshëm, ndërsa dynjaja është e përkohshme!”<sup>40</sup>*

Për rrjedhojë, qëndrimet dhe sjelljet e njerëzve, janë të lidhura nga qëndrimet dhe sjelljet e atyre që kanë në krye. Natyrisht që edhe e kundërta e kësaj, pra, qëndrimet dhe sjelljet e prijësve të shoqërisë, janë të lidhura ngushtë me gjendjen edhe qëndrimet e popullit. Megjithatë të gjitha këto fjalë dalin në të njëjtin vend, në njëren bëhen kritika me qëllim që të përmirësohen sjelljet dhe qëndrimet e udhëheqësve, në tjetrën që të përmirësohen ato të popullit. Nisur nga këto, nëse udhëheqësit dhe të udhëhequrit dëshirojnë të përmirësojnë gjendjet materialo-shpirtërore të njëri-tjetrit në drejtimin e duhur, atëherë pikësëpari ata duhet të fillojnë nga përmirësimi i vetvetes.

Mjeshtëria e një riparuesi në profesionin e tij, reflektohet në sendin që ai riparon. Dhe sendi që riparuesi nuk mund ta riparojë, nxjerr në pah paaftësinë e tij. Në të njëjtën mënyrë, edhe udhëheqësit duhet ta konsiderojnë veten e tyre përgjegjës ndaj gabimeve të njerëzve që kanë nën përgjegjësi dhe duhet të bëjnë kujdes në elementet e dobësisë dhe të metave të atyre, të cilat kanë lidhje me ata si udhëheqës.

Në ditët tona, pothuajse nuk gjen askënd të mos ankohet prej gjendjes së vet dhe, pothuajse të gjithë i kërkojnë gabimet dhe të metat jashtë vetes. Mirëpo, qoftë udhëheqësit, qoftë të

40. Ebu Jusuf, Kitabu'l-Haraxh, Bulak 1302, fq. 3-4.



udhëhequrit, pikësëpari duhet të ankohen për të metat e veta. Nëse përpiqemi ta përmirësojmë veten tonë duke menduar në këtë mënyrë dhe nëse shtojmë njerëzit e mirë brenda shoqërisë, gjendja materialo-shpirtërore e popullit tonë do të orientohet në rrugën e mirë dhe padyshim se, -në sajë të mirësisë hyjnore- në krye do të vijnë udhëheqës edhe më të mirë. Nëse edhe udhëheqësit ankohen prej popullit, ata duhet të bëjnë të njëjtën vetllogari dhe të përpiqen të përmirësohen.

Kur Sulltan Muradi i I. hyri në luginën e Kosovës, u përball me një furtunë të madhe. Aq, sa sytë nuk shihnin më njëri-tjetrin. Sulltan Muradi, i cili kishte mbledhur në zemrën e tij sundimin material dhe sundimin shpirtëror, pasi fali dy rekat namaz, iu drejtua Zotit duke qarë:

*“O Zot! Nëse kjo furtunë ka filluar për shkak të gjynaheve të robit Tënd të dobët, Muradit, mos i dëno ushtarët për shkak të tij!.. O Zot! Mos më bëj shkak të shkatërrimit të gjithë këtyre ushtarëve myslimanë!..”*

Pas kësaj lutjeje të Sulltan Muratit të I., furtuna pushoi dhe lufta përfundoi me mposhtjen e armikut. Pas luftës, Sulltan Murati i I., doli të inspektojë fushëbetejën, ku edhe piu sherbetin e martirit nga një thikë e pabesë e një ushtari serb, i cili hiqej si i plagosur.

Ja pra, nëse edhe ne bëjmë një vetllogari dhe përpiqemi të përmirësojmë gjendjen tonë, -shpresohet- mund të arrijmë ndryshimin e gjendjes sonë shpirtërore. Po ashtu, në mënyrë paralele, këtë mund ta arrijmë edhe në planin shoqëror.

Megjithatë, në historinë njerëzore nuk mungojnë as fenomenet të cilat duken sikur nuk përputhen me këtë mendim të përgjithshëm. Për shembull, në kohën kur disa popuj kanë rënë në një degjenerim të madh, Allahu i Madhëruar ka dërguar profetë





me qëllim që të ndryshojë për mirë gjendjen e tyre. Për rrjedhojë, fakti që Profeti ﷺ, nxori nga bataku i tiranisë dhe i injorancës, në majat e qiellit të virtyteve një shoqëri gjysmë të egër, në një kohë kur njerëzit kishin degjeneruar aq thellë sa të adhuronin idhuj të shumtë dhe të varrosnin vajzat e tyre përsëgjalli, është shembulli më i bukur i kësaj të vërtete. Megjithëse kjo mirësi hyjnore nuk është e mundur të shpjegohet si një arritje që ka të bëjë me nivelin shpirtëror të shoqërisë, ekziston një ligj tjetër hyjnor mbi të cilën mund të mbështetet kjo. Ky ligj është manifestimi i cilësisë **“Latif/i Butë”** të Allahut të Madhëruar.

Megjithatë, tashmë për ne është e pamundur të presim një manifestim të tillë, sepse kjo derë është mbyllur përjetësisht me dërgimin e Profetit të Fundkohës. Për rrjedhojë, detyra jonë, është të përpiqemi të përmirësojmë gjendjen tonë me qëllim që të ngremë pozitën tonë shpirtërore. Dhe, mundësitë për përmirësimin e gjendjes dhe ngritjen e pozitës sonë shpirtërore, janë të shumta. Mirëpo, në ditët tona, në krye të punëve që duhen bërë lidhur me këtë çështje, është gjallërimi i institucioneve të cilat do të edukojnë liderët e së ardhmes. Siç shprehet edhe një mendimtar:

**“Dallimi më rëndësishëm midis popujve sundues dhe atyre të sunduar, është një grusht njerëzish të edukuar mirë!”**

Ja pra, përballimi i etjes materialo-shpirtërore të shoqërisë, eliminimi i terrorit dhe përhapja e drejtësisë, varet nga ky grusht njerëzish.

Çdo ideal ngrihet dhe merr formë sipas karakterit dhe personalitetit të atyre që e përfaqësojnë. Ata që i tërheqin masat pas vetes, janë njerëzit me karakter dhe personalitet të lartë. Në ngritjen e popujve, ka një vend të rëndësishëm edhe personaliteti monumental që qëndron në ballë të tyre. Nisur nga kjo, përpjekja



për të edukuar një grusht njerëzish, përbën një prej detyrave tona më të rëndësishme.

Domethënë, ne jemi të detyruar të edukojmë një brez me besim të fortë fetar, vetëdije historike dhe atdhedashës, i cili do t'i shërbejë popullit me vetëmohim. Përndryshe, Allahu mund të na i marrë ato mirësi që na ka falur, gjë e cila përbën një ligj hyjnor. Dhe, faqet e historisë janë të mbushura përplot me manifestime të këtij ligji hyjnor.

Nga kjo pikëpamje, nëse dëshirojmë të edukohen njerëz që e duan Allahun dhe të Dërguarin e Tij ﴿﴾, që sakrifikojnë veten për hir të popullit dhe që mund t'i prijnë shoqërisë, në radhë të parë, duhet të gdhendim në thellësi të shpirtave tanë dashurinë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij ﴿﴾ dhe duhet të shfaqim një personalitet të mbushur me virtytet e Kuranit dhe Sunetit. Në sajnin tonë, shoqëria duhet të shohë si duhet të jetë personaliteti i një myslimani të vërtetë.

**Zoti ynë u faltë vetëdije përgjegjësie të gjithë besimtarëve që kanë marrë përsipër detyrën e drejtimit, në çfarëdo pozite qofshin! Allahu e përmirësoftë me mirësinë e Tij gjendjen tonë si individë dhe si shoqëri! Po ashtu, Allahu na e bëftë të mundur të bëjmë përpjekje të sinqerta për t'u bërë shkak i ngritjes së pozitës sonë materialo-shpirtërore, duke edukuar breza besimtarësh të përkushtuar në shërbimet më të mira ndaj atdheut, popullit dhe të gjithë ummetit të Muhamedit ﴿﴾!**

**Amin!..**





# E DREJTA DHE DREJTËSIA

- 1 -



*Nuk duhet harruar se, Allahu i Madhëruar, i Cili i ka urdhëruar robërit e tij me të vërtetën dhe drejtësinë, është përherë pranë të shtypurve. Ata që pandehin se do të shpëtojnë duke shkelur të drejtat, ligjin dhe drejtësinë në këtë botë, një ditë do të japin llogari përpara Allahu të Madhëruar, i Cili është "Gjykatësi i gjykatësve"!*





# E DREJTA DHE DREJTËSIA - 1

Morali i Islam, i cili përmban të gjithë bukurinë dhe përsosmërinë njerëzore dhe ngre lart me virtyte shpirtin e njeriut, ka një thelb të veçantë dhe një themel të palëkundur edhe në çështjen e së drejtës dhe drejtësisë. Kjo, sepse paqja e njerëzimit mund të sigurohet vetëm me përhapjen e së drejtës dhe drejtësisë.

Por, çfarë është e drejta dhe drejtësia?

Me një përkufizim të përgjithshëm, mund të themi se e drejta dhe drejtësia është trajtimi i çdokujt dhe i çdo gjëje në mënyrën që meriton, gjykimi i saktë dhe sjellja me maturi dhe ekuilibër.

Nisur nga kjo, t'i japësh dikujt më tepër se ç'ë meriton, nënkupton shkeljen e së drejtës së të tjerëve. Po ashtu, edhe të japësh mangët, nënkupton grabitjen e së drejtës dhe shkeljen e drejtësisë. Besimtarët e vërtetë, ruhen jashtëzakonisht prej një të keqeje të tillë. Pra, besimtari është i detyruar t'i japë çdokujt të drejtën që i takon. Kjo, sepse Islami urdhëron drejtësinë në çdo fazë dhe në çdo situatë të jetës. Aq, sa bërja e një jete në përputhje me kënaqësinë Allahut, mund të realizohet vetëm duke respektuar ekuilibrin e së drejtës dhe drejtësisë. Pra, koncepti i drejtësisë, është në qendër të urdhrave dhe ndalesave hyjnore. Për rrjedhojë, besimtari, në fillim duhet të veprojë me drejtësi



kundrejt Allahut, pastaj ndaj të gjitha krijesave dhe më pas ndaj vetes së tij.

Kështu që, çdo besimtar është i detyruar të veprojë me drejtësi kur të masë e të peshojë, kur të gjykojë ndër njerëz, kur të flasë, kur të shkruaj dhe kur të dëshmojë! Përveç kësaj, ai është i detyruar të tregojë rëndësinë e duhur edhe ndaj të vërtetave hyjnore dhe adhurimeve, duke i respektuar ato maksimalisht, sepse kjo është një e drejtë e Allahut të Madhëruar dhe një detyrë e rob-it.

Nëse një besimtar jeton me këtë vetëdije brenda kritereve të së drejtës dhe drejtësisë, ai arrin gradën **“ahsen-i takuim”**, pra gradën e “krijimit më të bukur”, sepse e drejta dhe drejtësia, janë prej cilësive të Allahut. Emri hyjnor **“el-Adl”**, shpreh se Allahu i Madhëruar është pronari absolut i së drejtës dhe drejtësisë dhe Vet e drejta dhe drejtësia.

Ky emër madhështor i Allahu të Madhëruar, manifestohet në mënyrë të përhershme. Por, në mënyrë të veçantë, ai do të manifestohet me të gjithë madhështinë e tij ditën kur të ngrihet gjykata hyjnore. Lidhur me këtë, në një ajet fisnik urdhërohet:

**“Dhe në Ditën e Kiametit, Ne do të vendosim peshore të sakta e askush nuk do të pësojë asnjë padrejtësi. Ne do të sjellim (për gjykim) çdo vepër, qoftë kjo edhe sa pesha e një kokrre sinapi. Ne jemi të mjaftueshëm për llogaritje.”**

(Enbija, 47.)

Nuk duhet harruar se, Allahu i Madhëruar, i Cili i ka urdhëruar robërit e tij me të drejtën dhe drejtësinë, është përherë pranë të shtypurve. Ata që pandehin se do të shpëtojnë duke shkëlur të drejtat, ligjin dhe drejtësinë në këtë botë, një ditë do të japin llogari përpara Allahu të Madhëruar, i Cili është Gjykatësi i gjykatësve!



Mund të themi se, në lidhje me çështjen e së drejtës dhe drejtësisë, ndër të gjitha krijesat, llogarinë më të madhe do ta japi biri i njeriut, sepse njeriu është krijuar si më i nderuari i krijesave dhe të gjitha krijesat i janë vënë në shërbim atij. Për rrjedhojë, ai ka marrë përsipër edhe përgjegjësinë për të drejtat e tyre. Nisur nga kjo, njeriu nuk është ngarkuar vetëm me mbrojtjen e të drejtave të veta, por edhe me mbrojtjen e të drejtave të të gjitha krijesave. Domethënë se, edhe përgjegjësia për mbrojtjen e bimëve, të kafshëve dhe të sendeve i takon njeriut.

Nga kjo pikëpamje, edhe të dashurit e Allahut kanë treguar një kujdes shumë të veçantë në lidhje me respektimin e të drejtave të krijesave të tjera, duke u bërë shembull për të gjithë ne. Kjo ndodhi e shpreh shumë bukur këtë fakt:

Një prej të dashurve të Allahut, i nderuari Bejazid Bistami, gjatë një udhëtimi, ulet dhe pushon nën një pemë për të ngrënë. Më pas, ngrihet dhe vazhdon rrugën. Pasi ecën për njëfarë kohe, vë re se në trastën e tij ndodhej një milingonë dhe thotë me vete:

*“E paskam ndarë prej vendit të vet këtë krijesë të Allahut!”*  
Për këtë arsye, ai kthehet pas dhe e lë atë milingonë përsëri nën pemën ku pushoi më parë.

Ndërsa poeti Ebu'l-Kasim Firdeusi, shprehet kështu në vepërën e tij *“Shehname”*:

*“Mos lëndo qoftë edhe një milingonë që tërheq një kokërr ushqimi, sepse edhe ajo ka shpirt! Dhe shpirti është i ëmbël e i dashur.”*

Ditën e kijametit, bashkë me birin e njeriut do të ringjallen edhe krijesat e tjera, të cilat do të marrin të drejtat e tyre që u janë shkelur në dynja. Për këtë arsye, fetarisht, është e ndaluar t'i shkaktosh vuajtje një kafshe apo ta lodhësh tepër atë, ose të



këpusësh një degë peme të gjelbër pa shkak. Madje, edhe kur jemi të detyruar të vrasim një kafshë të dëmshme, nuk është e lejuar që t'i shkaktosh vuajtje e tortura. Për shembull, edhe kur vritet një gjarpër, jemi të urdhëruar ta vrasim me një të goditur pa e torturuar.

Me pak fjalë, çdo besimtar është i detyruar ta kuptojë në mënyrën më të bukur domethënien e thellë të së drejtës dhe drejtësisë dhe ta përdorë drejtë peshoren e drejtësisë gjatë gjithë jetës. Virtyti më i madh për besimtarin, është vënia në jetë e së drejtës dhe drejtësisë dhe përhapja e tyre. Ndërsa për robërit e mirë që përparojnë në rrugën e pjekurisë, ka edhe një virtyt më të lartë, që është:

### Virtyti i faljes në drejtësi...

Besimtarët e përsosur, të cilët kanë arritur horizonte të larta në besim dhe moral, gabimeve që bëhen kundrejt tyre, preferojnë t'u kundërpërgjigjen me falje dhe mëshirë, në vend që të kërkojnë drejtësi me hakmarrje. Kjo, sepse ata shpresojnë se në peshoren hyjnore, edhe Allahu i Madhëruar do t'i trajtojë me falje, mëshirë, butësi dhe mirësi, e jo me drejtësi (për t'i dënuar për shkak të gjynaheve). Ky moral i bukur, lavdërohet kështu nga Allahu i Madhëruar:

**“Nëse ndëshkoni, ndëshkoni aq sa jeni cenuar, por, nëse duroni, kjo është më e mirë për të durueshmit.”** (Nahl, 126.)



A nuk dëshirojmë që në ahiret të trajtohem me mirësinë dhe bujarinë e Allahut?

Për këtë arsye, robërit e mirë dhe të urtë, nuk i kundërpërgjigjen në të njëjtën mënyrë të këqijave që u janë bërë sot dhe nuk tentojnë të ndëshkojnë. Përkundrazi, ata e gëlltitin zemërimin






e tyre duke zgjedhur durimin për hir të Allahut. Po ashtu, ata gjithmonë zgjedhin rrugën e faljes. Në këtë mënyrë, duke i falur njerëzit vazhdimisht, ata përpiqen të meritojnë faljen hyjnore.

Po me këtë parim, edhe Ebu Bekri , e fali personin që hodhi shpifje ndaj vajzës së tij, Aishes  dhe vazhdoi t'i jepte sadaka si përherë. Sa kuptimplotë është ky ajet fisnik, i cili na motivon drejt këtij morali të lartë:


**“Njerëzit e ndershëm dhe të pasur ndër ju, të mos betohen se nuk do t’u japin të afërmve, të varfërve dhe të mërguarve në rrugën e Allahut; le t’i falin ata dhe të mos ua marrin për keq! Vallë, a nuk doni ju që t’ju falë Allahu?..”** (Nur, 22.)

Nisur nga kjo, njerëzit e urtë veprojnë në bazë të ajetit:

**“Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë.”** (Fussilet, 34.)

Një tjetër prej shembujve më të bukur të këtij morali në Kuranin Fisnik, është edhe Jusufi , i cili kaloi vuajtje të shumta për shkak të padrejtësisë që i bënë vëllezërit e tij. Mirëpo, pas një kohe të gjatë, kur vëllezërit e tij shkuan t’i kërkonin ndihmë (pa e ditur se kush ishte), ky profet i madh i Zotit, i ndihmoi ata dhe u fali shumë gjëra pa e prezantuar veten e tij. Por, kur ata e kuptuan se ai ishte vëllai i tyre Jusufi, u prekën jashtëzakonisht shumë prej këtij virtyti të lartë për të cilin dëshmuan dhe thanë:

**“...«Betohe mi për Allahun, vërtet që Allahu të ka ngritur ty mbi ne dhe ne paskemi qenë vërtet të gabuar!»”** (Jusuf, 91.)

Ndërsa Jusufi , duke treguar një sjellje shembullore, i fali ata dhe u tha:

**“...«Sot s’ka qortim për ju; Allahu do t’ju falë. Ai është më i mëshirshmi i mëshiruesve!»”** (Jusuf, 92.)



Përveç kësaj, duke u shprehur se, “**...shejtani futi ngatërrësë midis meje dhe vëllezërve të mi!..**” (Jusuf, 100) ai nuk ua hodhi fajin vëllezërve, por shejtanit. Më pas, i qetësoi vëllezërit e tij duke u thënë:

*“Unë u shita si një skllav. Por në sajën tuaj, në Egjipt u njoha se isha biri i një profeti.”*

Në këtë mënyrë, ai uli perden e faljes mbi padrejtësitë dhe të këqijat që i kishin bërë vëllezërit më parë dhe u tregua i butë me ta. Për rrjedhojë, në sajë të virtytit dhe moralit të lartë që shfaqti, ai ua fitoi zemrat atyre.

Nisur nga ky moral i lartë, mund të themi se shndërrimi i drejtësisë (ndëshkimit) në mëshirë ndaj fajtorëve dhe falja e tyre, është një metodë e veçantë përmirësimi dhe udhëzimi. Natyrisht, me kusht që fajtori ta kuptojë dhe të bëhet pishman për fajin e tij...

Nuk duhet harruar se, falja e një personi fajtor nëse ai pëndohet sinqerisht për të mos e vepruar më atë faj, është shumë më e mirë se sa ndëshkimi i tij. Mirëpo, të falësh një fajtor kur ai nuk tregon asnjë gram pendesë për fajin e tij, nuk është më virtyt, por shndërrohet në dobësi dhe paaftësi. Domethënë, këshilla për mëshirë dhe falje, jep rezultat në bazë të karakterit dhe gjendjes shpirtërore të personit fajtor.

Për shembull, të falësh gjynahqarin dhe zullumqarin që këmbëngul në veprën e tij të keqe, i jep ati kurajë në të këqijat dhe padrejtësitë që bën, madje, nuk bën asgjë tjetër përveçse e nxit më tepër atë. Kur situata është e tillë, nëse falja e gabimeve që bëhen ndaj një personi nuk ka gjasa të çojë drejt përmirësimit, kërkesa për ndëshkimin e fajtorit, është e drejta më e natyrshme e viktimës.

Nga ana tjetër, nëse çështja është individuale e personale,



falja e fajtorit me qëllim të përmirësimit të tij, është më afër me virtytin dhe devotshmërinë. Mirëpo, nëse çështja ka lidhje me interesa të përgjithshme, kërkohet vendosja e drejtësisë në vendin e vet. Përndryshe, fajet që mbeten të pandëshkuara, bëhen shkak i tërbimit edhe më të madh të fajtorëve. Dhe, prej kësaj dëmtohet e gjithë shoqëria.

Profeti ﷺ, i cili është edhe udhërrëfyesi i jetës sonë, i falte gabimet që bëheshin ndaj personit të tij. Mirëpo, ai nuk i toleronte padrejtësitë që bëheshin ndaj të tjerëve dhe nuk gjente qetësi derisa i shtypuri të merrte të drejtën e tij. Në këtë mënyrë, ai përpiqej të siguronte drejtësinë në formën më të përsosur. Ky është edhe kriteri i të qenit i drejtë.

Ja pra, njerëzit që mund të bëhen të drejtë në këtë mënyrë, do të priten me të njëjtën drejtësi. Domethënë, në marrëdhëniet tona me njerëzit, pikësëpari duhet të jemi vet të drejtë, që të kemi të drejtë të presim drejtësi edhe prej të tjerëve. Kjo, sepse paqja dhe lumturia e jetës njerëzore, varet nga mbajtja e peshores së të drejtës dhe drejtësisë në një ekuilibër reciprok.

Në fakt, koncepti i drejtësisë përreth gjithë këtyre të vërtetave, është një nevojë jetike e pazëvendësueshme për rregullin, harmoninë dhe paqen shoqërore. Mirëpo, ky koncept ka një përmbajtje shumë të ndryshme në vetëdijen dhe ndjenjat që biri i njeriut duhet të zotërojë kundrejt Zoti të vet.

Botëkuptimi i drejtësisë hyjnore, është një çështje shumë e rëndësishme, në lidhje me të cilën shumë njerëz gabojnë në ditët tona, sepse në këtë botë jo të gjithë kanë mundësi të barabarta. Dikush është i pasur dhe dikush i varfër, dikush lind me të meta dhe dikush i shëndetshëm, dikush jeton shumë dhe dikush tjetër pak... Dhe, Ai që i cakton këto është Allahu i Madhëruar. Nëse shihet nga jashtë me një logjikë dhe mendje të trashë, kjo gjendje



duket sikur bie ndesh me drejtësinë hyjnore. Mirëpo, nëse këto pretendime që duken si logjike, shihen nga dritarja e besimit dhe urtësisë, e gjithë çështja do të shfaqet qartë para syve, sepse:

### **Drejtësia fitohet me meritë!..**

Askush nuk është krijuar për shkak të meritës së vet. Krijimi i njeriut prej asgjësë, është një mirësi hyjnore aq e madhe, sa është e pamundur të falënderohet. Dalja prej asgjësë në botën e ekzistencës dhe krijimi jo si gjarpër apo insekt, gur apo dhe, bar apo gjethe, por si **“njeri”**, që është edhe krijesa më e nderuar ndër të gjitha krijesat e tjera, përbën një mirësi hyjnore të jashtëzakonshme.

Kjo mirësi dhe shumë të tjera të ngjashme, a nuk na janë dhuruar plotësisht si mirësi hyjnore pa paguar asgjë në këmbim të tyre? Vallë çfarë çmimi kemi paguar ne për të arritur këto mirësi?

E, meqenëse çështja është kështu, atëherë, ata që kërkojnë drejtësi ndërkohë që janë brenda një indiference të theksuar, duke u sjellë sikur po i kërkojnë llogari Allahut të Madhëruar (Allahu na ruajt) për shkak të disa vështirësive kalimtare të jetës, në fakt, dëshirojnë të asgjësohen! Kjo, sepse njeriu nuk ka asnjë të drejtë dhe kapital për gëzuar ekzistencën, që të ketë të drejtë të kërkojë drejtësi prej Allahut! E në fakt, drejtësia mbahet në këmbë vetëm me meritë, pra, duke punuar, fituar dhe paguar një çmim!

Duhet të mendojmë se:

“Çfarë çmimi kemi paguar ne për t’u krijuar si njerëz? Me cilat përpjekje dhe fitime jemi krijuar si njerëz?”

Përgjigja dihet:

“Asgjë! Një asgjë e madhe!..”



Atëherë, duhet ta kuptojmë mirë se:

Allahu i Madhëruar, i Cili ka dëshiruar që jeta të përbëhet nga dy faza, ajo e dynjasë dhe ajo e ahiretit, në të parën manifestohet qartë me cilësinë e Tij **“Latif”**<sup>41</sup>, ndërsa në të dytën me cilësinë e Tij, **“Adil”**<sup>42</sup>. Domethënë, cilësia hyjnore që ka krijuar njeriun dhe universin, nuk është emri i Allahut, **“Adil”**, por emri **“Latif”**. Gjithçka që zotërojnë krijesat që prej krijimit të tyre, është mirësi e Allahut.

Nisur nga kjo, mund të themi se, Allahu i Madhëruar nuk është i detyruar t’i japë mirësitë në mënyrë të barabartë për të gjithë. E në fakt, nëse edhe vetëm dy krijesa do të ishin krijuar të barabarta në kuptimin absolut, ekzistenca e njërës prej tyre do të ishte e pakuptimtë, pra, nuk do të kishte asnjë urtësi. Dhe, angazhimi me punë të kota, do të përbënte një mangësi për cilësinë **“Muteal”**<sup>43</sup> të Allahut të Madhëruar, i Cili e ka krijuar universin në ekuilibra jashtëzakonisht precizë. Mirëpo, Allahu është larg dhe i pastër nga çdo e metë.

Për rrjedhojë, askush nuk mund të thotë; “e ç’faj kam unë që jam trupshkurtër?”, “pse kam lindur në një familje të paditurish,

41. **Emri i Allahut el-Latif:** I Përmbajtur, i Butë: Ai është aq i Përmbajtur në v - primet e Tij, saqë Ai dallon të fshehtën dhe sekreten, dhe atë me çfarë janë të mbushura zemrat. Ai po ashtu percepton atë çfarë është në tokë nga drithërat dhe farat e bashkëmbyllura. Ai është Përherë-i-Butë me robërit e Tij të devotshëm dhe i bën gjërat të lehta për ta dhe i mban ata larg vështirësive. Ai e bën shtegun për tek Kënaqësia dhe Bujaria e Tij të lehtë për ta. Ai i mbron ata nga mënyrat që mund të shpijnë tek Hidhërimi i Tij. Kjo bëhet nëpërmjet mënyrave që ata mund t’i kuptojnë si edhe mënyrave që ata nuk i kuptojnë. Ai po ashtu vendos çështje për ta, të cilat ata nuk i pëlqejnë, me qëllim që atyre t’u jepet ajo çfarë dëshirojnë. Ai është i Butë ndaj tyre për sa u përket shpirtave të tyre, siç i udhëzon ata për tek mënyrat e mrekullueshme dhe krijesat fisnike të Tij. Ai është i Butë me ta, për sa u përket çështjeve që janë të dorës së dytë për ta, me çdo mirësi dhe drejtësi.

42. **el-Adil:** I Drejti.

43. **el-Muteal:** I Gjithëhartësuar. Ai i Cili është larg nga çdo e metë dhe gëzon përsosmëri absolute.



e jo në një familje intelektualësh?” ose, “pse kam lindur në një familje të varfër, e jo në një familje të pasur?”, etj. Kjo, sepse të gjitha këto janë për shkak të manifestimeve të ndryshme në shpërndarjen e mirësive hyjnore.

Këtë të vërtetë, e shpreh më së miri kjo ndodhi, që ka ngjarë në kohën e Profetit ﷺ:

Një person me emrin Salebe, shkoi tek Profeti ﷺ dhe i kërkoi t'i lutej Zotit që ta bënte të pasur. Mirëpo, Profeti ﷺ, i tha:

*“O Salebe! Pak pasuri për të cilën mund të falënderosh, është më e mirë se sa shumë pasuri për të cilën nuk mund të falënderosh!”* Madje, për ta bindur atë, Profeti ﷺ, i tha:

*“O Salebe! A nuk është gjendja ime një shembull i mirë për ty?..”*

Mirëpo, Salebe mbeti i verbër ndaj këtyre shenjave që i dha Profeti ﷺ dhe vazhdoi me këmbëngulje të kërkonte të ishte i pasur. Për rrjedhojë, i Dërguari i Allahut ﷺ, u lut që ai të bëhej i pasur. Salebe ishte kapluar aq shumë nga lakmia, sa të mos i kuptonte paralajmërimet e Profetit ﷺ. Mirëpo, edhe pse si përfundim u bë i pasur, ai nuk shpëtoi dot prej rënies në humnerën e mosmirënjohjes ku kishte rënë edhe Karuni. Për shkak se nuk i zbatoi këshillat që i dha Profeti ﷺ, ai përjetoi një hidhërim dhe keqardhje të fortë, aq sa kur ishte në shtratin e vdekjes, i penduar për lakminë që i shkatërroi jetën e përjetshme, thoshte:

*“Ah sikur t'i kisha dëgjuar këshillat e Profetit ﷺ.”<sup>44</sup>*

Nisur nga kjo, është e domosdoshme që të mos e harrojmë kurrë këtë ajet fisnik:

**“Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)!”** (Tekathur, 8.)



Të qenit i kënaqur me ato që i ka dhënë Allahu, është edhe përgjegjësi, edhe pjekuri për robin. Prandaj, duhet kuptuar mirë se, pabarazia në mirësitë e falura nga Allahu, nuk janë padrejtësi. Allahu i Madhëruar, një rob mund ta krijojë të shëndetshëm, e një tjetër me të meta. Njërin mund ta krijojë shumë të zgjuar, ndërsa një tjetër më pak të zgjuar. Një nga krijesat e krijon si gjarpër, e bën të zvarritet, ndërsa një tjetër si zog, e bën të fluturojë. Për rrjedhojë, asnjë krijesë nuk ka të drejtë të ankohet e të kundërshtojë.

Në fakt, për shkak se në botën e kafshëve mendja dhe ndjenjat ekzistojnë aq sa u duhet për të vazhduar jetën, të gjitha ato janë të kënaqura nga gjendja e tyre. Ato nuk kanë asnjë shqetësim tjetër përveçse të mbushin barkun dhe të kënaqin dëshirat e tyre të natyrshme. Për këtë arsye, është e pamundur që ato të ndihen të hidhëruara duke menduar se përse nuk janë krijuar si njerëz.

Ashtu siç një kafshë apo një bimë nuk ka të drejtë të thotë, “pse nuk jam krijuar si njeri”, edhe ata që vuajnë nga probleme siç janë të metat trupore, sëmundjet, varfëria, privimi, etj., nuk kanë të drejtë të akuzojnë Allahun e Madhëruar për padrejtësi, sepse kjo do të ishte kundër çdo logjike dhe ndërgjegjeje.

Përveç këtyre, në peshoren hyjnore në ahiret, do të bëhet e qartë se çfarë ka qenë më e mirë për njeriun, mirësitë e pakta apo të shumta. Kjo, sepse mirësia e paktë, ka më pak përgjegjësi, ndërsa mirësitë e shumta kanë më tepër.

Në fakt, për njeriun i cili nuk mund t'i kuptojë siç duhet urtësitë dhe të fshehtat e caktimit hyjnor, është më mirë që t'i dorëzohet caktimit të Allahut. Sa shembull i bukur është gjendja Ebu Talhas dhe gruas së tij, në lidhje me këtë çështje! Shkurtimisht, historia e tyre është kështu:



Djali i sëmurë rëndë i Ebu Talhasë ؓ, kishte ndërruar jetë, kur ai nuk ndodhej në shtëpi. Nëna, Ummu Sulejme ؓ, e pa që djali i saj kishte ndërruar jetë, e lau dhe e qefinosi atë. Më vonë, kur Ebu Talha ؓ, erdhi në shtëpi, pyeti si ishte djali. Ummu Sulejme ؓ, tha:

*“Djalit iu qetësuan dhimbjet dhe tani besoj se po rehatohet pak.”*

Në mëngjes, në momentin kur Ebu Talha ؓ, po bëhej gati të dilte nga shtëpia, Ummu Sulejme ؓ, e cila ishte një grua e zgjuar dhe e devotshme, i tha:

*“O Ebu Talha! Pa shiko ç'bëri ky fqinji ynë... Kur i kërkova amanetin që ia kisha dhënë për ta përdorur, ata s'deshën të ma jepnin.”* Ebu Talha ؓ, u përgjigj:

*“Jo nuk bën kështu! Ata nuk kanë vepruar aspak mirë!”* Pas këtyre fjalëve, Ummu Sulejme ؓ, tha:

*“O Ebu Talha! Djali yt ishte një amanet i Allahut tek ty dhe Ai e mori përsëri atë.”* Ebu Talha papritur u shastis, heshti dhe më pas tha:

**“Të Allahut jemi dhe padyshim se tek Ai do të kthehemi!”**<sup>45</sup>

(shih. Buhari, Xhenaiz 42, Akikal; Muslim, Edeb 23; Fedailu's-sahabe 107.)

Ja pra, kjo është vetëdija e amanetit që duhet të zotërojmë kundrejt mirësive të Allahut në këtë botë, që është vetëm një vend sprove... Kjo është gjendja e kënaqësisë dhe e dorëzimit që duhet të tregohet edhe kur Allahu ta jep një mirësi, edhe kur ta merr atë...

Në krye të kushteve më të rëndësishme për t'u bërë një rob i afërt i Allahut të Madhëruar, është që, pavarësisht sprovave të





ndryshme, të arrish të thuash ashtu siç tha Ibrahim عليه السلام, “Unë i jam dorëzuar Zotit të gjithësisë!”<sup>46</sup>

**O Zot! Na e bëj të mundur të jetojmë me një kënaqësi dhe dorëzim të tillë kaq të lartë, kuptimplotë dhe të vërtetë! Mos na ndaj prej së drejtës dhe drejtësisë! Dhe, ditën e mahsherit, përveçse me drejtësi, na trajto me mëshirën dhe faljen Tënde!**

**Amin!..**



46. shih. Bekare, 131.







## E DREJTA DHE DREJTËSIA

- 2 -



*Ashtu siç nuk kemi ardhur pa qëllim në këtë dynja,  
e cila është një vend sprove, ne nuk jemi lënë as pa  
kontroll në këtë vend. Dynjaja nuk është fusha e  
interesave dhe dëshirave egoiste. Nëse njeriu bëhet rob  
i dëshirave egoiste, pa e kuptuar kthehet në zullumqar.  
E në këtë mënyrë, ai e çon dëm jetën e tij të përjetshme!*





## E DREJTA DHE DREJTËSIA -2-

Ky univers madhështor brenda të cilit jetojmë, nuk është krijuar në mënyrë rastësore. Ai nuk është krijuar as si fusha e interesave dhe dëshirave egoiste. Por përkundrazi, ai është krijuar për një qëllim madhështor dhe, brenda këtij kuadri, është bërë vendi i sprovës për birin e njeriut. Për rrjedhojë, edhe kjo botë, edhe njeriu nuk janë krijuar kot, pra, pa asnjë qëllim, synim dhe urtësi. Kjo, sepse një prej emrave të Allahut të Madhëruar, është **“el-Hak”** dhe, Ai është i pastër prej çdo vepre të kotë, pa shkak, pa synim dhe pa urtësi. Çdo gjë që bën Ai, është absolutisht e drejtë. Në një ajet fisnik urdhërohet:

**“Ai është që i ka krijuar qiejt dhe Tokën me synim (të caktuar)!..”** (En`am, 73.)

Ja, universi, njeriu dhe qeniet e tjera, që janë nga një mrekulli të artit madhështor... Të gjitha janë krijuar me urtësi të panumërta, synime, masa dhe ekuilibra jashtëzakonisht precize. Çdo njeri me mendje të shëndoshë, është i detyruar t'i meditojë thellë-thellë këto manifestime të fuqisë dhe madhështisë hyjnore.

Allahu i Madhëruar, duke na tërhequr vëmendjen tek ky fakt në Kuranin Fisnik, na paralajmëron:

**“Ai e ka ngritur qiellin lart dhe ka vënë Balancën** (për çdo gjë)! (Prandaj) **Mos e prishni balancën.”** (Rrahman, 7-8.)



**“Ne nuk i kemi krijuar qiejt, Tokën dhe çfarë gjendet midis tyre, për t’u zbavitur! Ne i kemi krijuar ato me qëllim të plotë, por shumica e tyre nuk e dinë.”** (Duhan, 38-39.)

**“Vallë, a mendon njeriu se do të mbetet pa përgjegjshmëri?”** (Kijame, 36.)

**“Mos vallë, keni menduar që Ne ju kemi krijuar kot dhe që nuk do të ktheheshit te Ne (për t’ju gjykuar)?!”** (Mu’minun, 115.)

Siç shprehet qartë edhe në ajetet fisnike, ne nuk kemi ardhur pa asnjë qëllim në këtë botë, që është një vend sprove. Po ashtu, ne nuk jemi lënë as pa përgjegjësi. Zoti ynë, vullnetit tonë, të cilin mund ta përdorim edhe për mirë, edhe për keq, i ka vënë disa ndalesa dhe kufij dhe ka urdhëruar respektimin e këtyre kufijve. Mirëpo, njeriu, i cili nuk i merr parasysh këto dhe nuk tregon kujdesin e duhur ndaj këtyre kufijve hyjnorë në jetën e tij të kësaj bote, mund të shndërrohet lehtë në një zullumqar i cili bëhet rob i të keqes së egos së vet. Në këtë mënyrë, ai shkatërron edhe jetën e tij të përjetshme.

Ndërsa devotshmëria, që do të thotë, respektim i kufijve hyjnorë, në të vërtetë nënkupton mbrojtjen e vetvetes nga dënimi hyjnor. Përndryshe, njeriu bëhet shkak i dënimit të vetvetes, gjë e cila do të thotë se ai i ka bërë padrejtësi vetes. Nuk duhet harruar se:

### **E kundërta e drejtësisë, është padrejtësia...**

Në këtë ajet fisnik, Allahu i Madhëruar tërheq vëmendjen në këtë cilësi njerëzore:

**“...Me të vërtetë, njeriu u tregua i padrejtë me veten dhe i paditur.”** (Ahzab, 72.)



Padituria/injoranca, është një nga shkaqet kryesore që e çojnë njeriun drejt zullumit dhe padrejtësisë. Ndërsa e kundërta e paditurisë për të cilën flitet në ajetin fisnik, është dituria.

Dija e vërtetë, është ajo që e çon njeriun drejt njohjes me zemër të Allahut të Madhëruar. Për rrjedhojë, ashtu siç padituria e shpie njeriun drejt zullumit, ashtu edhe dituria e shpie njeriun drejt së mirës, të drejtës dhe drejtësisë.

Burimi i së drejtës dhe të vërtetave është Allahu i Madhëruar. Dhe, ajo çfarë na ka bërë të ditur Krijuesi dhe Sunduesi i gjithësisë në emër të së drejtës dhe të vërtetës, pikërisht ajo është e drejta dhe e vërteta. Në një ajet fisnik urdhërohet:

**“...Thuaj: «Udhëzimi i Allahut është i vetmi udhëzim i drejtë! Ne jemi të urdhëruar t'i nënshtrohemi Zotit të botëve!»**” (En'am, 71.)

Prandaj, indiferenca ndaj urdhrave dhe ndalesave të Allahut dhe të Dërguarit të Tij ﷺ, të cilat janë edhe udhërrëfyesit e lumturisë së përjetshme, do të thotë t'i bësh padrejtësi atyre të vërtetave madhështore, e për rrjedhojë edhe vetes. Dhe padrejtësia më tragjike, është të jesh i verbër ndaj të vërtetave hyjnore.

Për çdo padrejtësi ka një ndëshkim me peshë të caktuar. Mirëpo, ndëshkimi ndaj padrejtësisë që bëhet kundrejt të vërtetave hyjnore, është “një vuajtje e përjetshme”. Dhe kjo, tregon se pabesimi, që e bën njeriun banor të përjetshëm të Xhehenemit, është padrejtësia dhe zullumi më i madh.

Megjithëse në dukje zullumi është në dëm të të tjerëve, në fund ai do t'i kthehet të zotit dhe do ta çojë atë drejt një dënimi të hidhur. Pra, dëmi më i madh që shkakton zullumqari, është përsëri ndaj vetvetes. Për këtë arsye, në Kuranin Fisnik përdoret shpesh shprehja: **“ata që i kanë bërë padrejtësi vetvetes”**.



Ndërsa i nderuari Mevlana, drejtësinë dhe padrejtësinë i ka shpjeguar me këto shembuj të mrekullueshëm:

*“Çfarë është drejtësia? Të ujitësh pemët frutore! Çfarë është padrejtësia? Të ujitësh ferrat!”*

*“Njeriu që nuk e njeh drejtësinë, i ngjan dhisë që i jep gjë këlyshit të ujkut.”*

Pra, padrejtësia që ushqeun dhe rriti, një ditë do ta shkatërron edhe vet atë. Historia ka dëshmuar se ata që kanë shkelur të drejtën për hir të interesave të përkohshme, vetëm sa i kanë hapur gropën vetes, ku në fund, kanë rënë vetë e janë zhdukur përgjithmonë.

Prandaj, sado rëndë t’i vijë egos sonë, është e domosdoshme të veprojmë gjithmonë me drejtësi dhe të drejtën ta bëjmë udhërrëfyesen tonë.

Me pak fjalë, padrejtësi, do të thotë të shkaktosh dhimbje në mënyrë të padrejtë.

Njeriu është krijuar në pozitën më të nderuar ndër të gjitha krijesat. Atëherë, kujt do t’i pritët fatura e dënimit të përjetshëm të zhytjes në batakun e gjynaheve ku shkatërrohen vlerat dhe ndjenjat e larta për hir të kënaqësive të përkohshme, dëshirave egoiste dhe dashurive kalimtare!?

Në fakt, sjellja me drejtësi ndaj të tjerëve, pikësëpari, është domosdoshmëri e të qenit i drejtë dhe i mëshirshëm ndaj vetes. Dhe, shembulli më i bukur për ne në lidhje me realizimin e kësaj, është Profeti ﷺ.

### **Shembulli më i bukur në drejtësi**

Profeti ﷺ, i është falur të gjithë njerëzimit nga ana e Zotit





tonë të Madhëruar, si një personalitet shembullor. Të gjitha urdhrat dhe ndalesat e Tij, Allahu i ka vënë në zbatim në jetën e pastër të Profetit ﷺ, duke e bërë atë një shembull praktik për të gjithë ummetin.

Për rrjedhojë, feja jonë madhështore Islami, është fe e jetës, e cila mund të zbatohet në mënyrën më të bukur. Pra, parimet madhështore të Islamit, nuk janë si mendimet njerëzore, të cilat janë thjeshtë teori dhe nuk mund të zbatohen në jetë, sepse Allahu i Madhëruar, ia ka ofruar njerëzimit të gjitha gjykimet Islame me shembuj praktikë.

E në fakt, kur Profeti ﷺ, e urdhëronte popullin e tij me diçka, në fillim, atë e zbatonte vet bashkë me të afërmit e tij. Po ashtu, edhe kur ndalonte diçka, në fillim ruhej vet dhe u tërhiqte vëmendjen të afërmeve të tij. Ashtu siç nuk pranonte kurrë asnjë privilegj për veten përballë drejtësisë, ai nuk toleronte aspak as trajtimin e veçantë nga të tjerët të të pasurve ose të parisë së popullit.

Personaliteti shembullor i Profetit ﷺ, ashtu si në çdo çështje tjetër, edhe në çështjen e së drejtës dhe drejtësisë, është i mbushur plot me shembuj të virtyteve të larta, të cilat ngjallin admirim. Ja disa prej këtyre shembujve:

### **Edhe vajza ime Fatimja qoftë...**

Në kohën e Profetit ﷺ, një nga gratë e fisit Beni Mahzum kreu një vjedhje. Në bazë të sheriatit (ligjit Islam), duhej t'i pritej dora. Mirëpo të afërmit e saj, filluan të kërkonin dikë që të ndërhynte tek Profeti ﷺ, me qëllim që asaj të mos i pritej dora. Më në fund, vendosën të dërgojnë Usame ibn Zejdin ؓ, i cili ishte një nga sahabët më të dashur të Profetit ﷺ. Usame shkoi



tek Profeti ﷺ dhe i kërkoi që ta falte gruan që kishte vjedhur. Mirëpo, Profetit të Allahut ﷺ, i ndryshoi çehrija e fytyrës së tij të bekuar përballë kësaj kërkesë dhe, me një shikim qortues, e pyeti Usamen ﷺ, të cilin e donte aq shumë:

*“Ti po ndërmjetëson që të mos zbatohet një nga dënimet që ka vendosur Allahu?”*

Kur Usame ﷺ, e pa se sa u mërzi Profeti ﷺ, u bë pishman dhe, duke i kërkuar falje, tha:

*“O i Dërguar i Allahut! Bëj dua që të më falet (ky gjynah)!”<sup>47</sup>*

Pastaj, Profeti ﷺ, u ngrit në këmbë dhe iu drejtua njerëzve duke thënë:

*“Për këtë arsye u shkatërruan popujt para jush. Nëse dikush prej fisnikëve apo njerëzve me pozitë bënte vjedhje, e lëshonin, por nëse vidhte dikush që ishte i dobët e panjeri, ata menjëherë e dënonin. Beto hem në Allahun se nëse bija e Muhamedit, Fatimja do të vidhte, patjetër që edhe asaj do t’ia prisja dorën!”* (Buhari, Enbija 54, Megazi 53, Hudud 11, 12; Muslim, Hudud 8, 9.)

Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

**“O besimtarë! Bëhuni zbatues të palëkundur të drejtësisë, duke dëshmuar në emër të Allahut, qoftë edhe kundër jush, ose kundër prindërve dhe të afërmve tuaj. Qoftë i pasur ose i varfër ai (për të cilin dëshmoni), Allahu është vlerësuesi më i drejtë për ata. Dhe mos shkoni pas epsheve tuaja e të shtrembëroni drejtësinë!..”** (Nisa, 135.)

Në këtë mënyrë, Profeti ﷺ, jeta shembullore e të cilit është si komentimi i gjallë i Kuranit, me qëndrimin e tij të palëkundur,



me anë të të cilit deklaroi hapur se as familja e tij nuk është më e privilegjuar përballë drejtësisë, e ka kundërshtuar me një gjuhë të ashpër njohjen e privilegjeve qoftë edhe ndaj njerëzve të fuqishëm të shoqërisë.

### Mbajtja dhe ngritja e së drejtës

Profeti ﷺ, që para se t'i vinte shpallja hyjnore, ishte anëtar i një Shoqërie të quajtur **“Hilfu'l-Fudul”**, në të cilën kishte marrë pjesë me qëllim që të siguronte mbizotërimin e drejtësisë në jetën tregtare dhe shoqërore. Kjo Shoqëri ndihmonte të dobët dhe të huajt, të cilëve u grabitej e drejta dhe nuk kishin mundësi ta kërkonin atë, duke e marrë të drejtën e tyre prej të fortëve dhe duke ua dorëzuar të zotëve.

Shembujt e kujdesit ndaj së drejtës dhe drejtësisë, vihen re në të gjithë jetën e Profetit ﷺ. Madje, kjo gjendje reflektohet edhe në hadithet e tij fisnike:

*“...Një shoqëri ku të dobët nuk arrijnë të marrin të drejtën e tyre pa u cenuar, nuk ka rehati...”* (Ibn-i Maxhe, Sadakat, 17.)

*“...E si ta pastrojë Allahu atë shoqëri, ku e drejta e të pafuqishmëve nuk merret nga të fuqishmit?!”* (Ibn-i Maxhe, Fiten, 20)

*“Ditën e kijametit, njeriu më i dashur për Allahun e Madhëruar dhe ai i cili do të gjendet më afër Atij, është administratori (ose pushtetari) i drejtë. Ndërsa njeriu më i urryer për Allahun dhe ai i cili do të jetë më larg Atij, është administratori zullumqar.”* (Tirmidhi, Ahkam, 4/1329; Nesai, Zekat, 77.)

Po ashtu, në hadithin e fundit që është dëgjuar prej Profetit tonë ﷺ, kur ai ishte duke u ndarë nga kjo botë, thuhet:

*“Kujdes namazin dhe kini frikë Allahun në lidhje me ata që keni nën vete!”* (Ebu Daud, Edeb, 123-124/5156; Ibn-i Maxhe, Uasaya, 1.)

## Mashtrimi i drejtësisë: Një pjesë prej Xhehenemit

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

*“Unë jam vetëm një njeri. Ju vini tek unë për t’u gjykuar (në lidhje me kundërshtimet që keni ndër vete). E ndoshta njëri nga ju është më i aftë se tjetri për të sjellë prova dhe për ta shpjeguar atë që kërkon të thotë! Atëherë, unë vendos në favor të tij, sipas asaj që shoh dhe dëgjoj! Prandaj, për këdo që të kem dhënë vendim në favor të tij duke shkelur të drejtën vëllait tjetër, do të thotë se i kam ndarë atij një pjesë nga zjarri i Xhehenemit!”* (Buhari, Shehadat, 27; Muslim, Akdije, 4.)

Dhe, me të vërtetë që disa njerëz, në sajë të elokuencës së fjalës dhe zgjuarsisë së tyre të lartë, mund ta mbulojnë padrejtësinë që bëjnë në këtë botë, duke u dukur të drejtë, ndërkohë që janë të padrejtë. Mirëpo, ata nuk duhet të pandehin asnjëherë se kanë shpëtuar. Edhe nëse ata mendojnë se kanë shpëtuar duke e mashtruar drejtësinë njerëzore në këtë botë, në Gjykatën Hyjnore në botën tjetër, çdo gjë do t’ju dalë në shesh një nga një dhe haku i të drejtit do të merret nga i padrejti. Dhe kjo gjendje poshtëruese ku do të bien në botën tjetër, do të jetë shumë më e rëndë se poshtërimi i kësaj bote.

Nisur nga kjo, ai që kërkon të drejtën nga dikush tjetër përballë gjykatësit, duhet ta llogarisë mirë në ndërgjegjen e tij se, a është me të vërtetë në të drejtë.

Çështja e drejtësisë, nuk është e rëndësishme vetëm disa fusha të jetës, por në të gjitha fushat e saj, duke filluar prej tregtisë, edukimit, rrethit, e deri tek familja... Kështu, edhe brenda familjes duhet:



## Drejtësi ndërmjet fëmijëve

Të bësh dallime ndërmjet fëmijëve për shkak të ndryshime gjinore, është mungesë respekti dhe pëlqimi ndaj caktimit të Allahut të Madhëruar, që tregon dobësi në çështjen e dorëzimit ndaj Tij.

Është një fakt i njohur se vajzave u bëhen shumë padrejtësi duke i privuar ato nga shumë të drejta vetëm për shkak të gjinisë. Allahu i Madhëruar, ka shpallur hapur se i vetmi kriter i epërsisë, është “devotshmëria”. Për rrjedhojë, perceptimi i “gjinisë” si një kriter epërsie, është një padrejtësi dhe zullum ndaj të vërtetave hyjnore.

Njëherë, kur një sahab ishte ulur bashkë me Profetin ﷺ, pranë i erdhi djali i vogël, të cilin ai e përqafoi, e puti dhe e uli mbi gju. Pak më vonë i erdhi vajza e vogël. Mirëpo, ai nuk e uli mbi gju, por pranë vetes. Kur e vuri re këtë, i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

*“A nuk duhej të bëje kujdes në drejtësinë ndërmjet fëmijëve?”*

Me këto fjalë, i Dërguari i Allahut ﷺ, shprehu qartë se nuk duhet të bëhen dallime në sjellje ndërmjet fëmijëve për shkak të gjinisë, duke e preferuar njërin ndaj tjetrit.<sup>48</sup>

Numan ibn Beshir ؓ, tregon:

Babai më mori me vete tek Profeti ﷺ dhe tha:

*“Unë i dhashë djalit tim një shërbyes!”* i Dërguari i Allahut ﷺ, e pyeti:

*“Po fëmijëve të tjerë a u ke dhënë të njëjtën gjë që i ke dhënë edhe këtij djali?”* Babai im tha:

48. Tahaui, Sherhu Meani'l-Asar, Bejrut 1987, IV, 89; Bejhaki, Shuab, VII, 468; Hejthemî, VIII, 156.

“Jo, nuk u kam dhënë!” Pas kësaj përgjigjeje, i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

“Atëherë merre mbrapsht dhuratën që ke bërë!” (Buhari, Hibe 12, Shehadat 9; Muslim, Hibat, 9-18.)

### Përhapja e drejtësisë me përpikëri

Pas fitores së Hajberit, Profeti ﷺ, dërgoi atje Abdullah ibn Reuahan ﷺ, që të mblidhte taksat. Abdullahu ﷺ, llogariste me përpikëri të madhe sasinë e hurmave që duhej dhënë dhe vilte taksën. Mirëpo, hebrenjtë që shfrytëzonin tokën e Hajberit, i shqetësoi kjo përpikëri e Abdullahut ﷺ, në llogaritjen e taksës. Madje, njëherë mblodhën disa stoli të grave dhe i thanë:

“Këto janë tuat! Por gjatë llogaritjes së taksës vepro në favorin tonë dhe mbylle njërin sy për ne!” Abdullahut ﷺ, u tha:

“Për Allahun! Urrejtja që kam ndaj jush për shkak të shumë veprave tuaja të këqija, nuk më pengon të sillem me drejtësi ndaj jush! Por, kjo që po më ofroni është ryshfet dhe, ryshfeti është haram. Ne nuk e hamë atë!”

Pas kësaj, hebrenjtë, të cilët e kuptuan se nuk mund ta bindnin dot Abdullahun ﷺ, filluan ta lavdëronin atë duke thënë:

“Ja, me këtë drejtësi qëndrojnë në këmbë dhe me rregull edhe qiejt e toka!” (Muvatta, Musakat, 2.)

Në një ajet fisnik urdhërohet:

**“O besimtarë! Bëhuni të qëndrueshëm në urdhrat e Allahut dhe bëhuni dëshmues me drejtësi! Le të mos ju nxisë urrejtja ndaj njerëzve për të bërë padrejtësi. Bëhuni të drejtë, se kjo është më afër devotshmërisë...”** (Maide, 8.)



Sa madhështore është feja jonë, e cila na urdhëron drejtësi të përpiktë edhe ndaj armiqve të tanë! Myslimani respekton gjithmonë të drejtën dhe vepron me drejtësi, sepse e di, që për padrejtësinë do të merret patjetër në llogari, edhe nëse i bëhet një mohuesi të fesë. Lidhur me këtë, në një hadith fisnik, thuhet:

*“Ruhuni nga mallkimi i të shtypurit, sepse mes mallkimit të tij dhe Allahut nuk ka asnjë perde!”* (Buhari, Zekat 41, 63, Megazi 60, Teuhid 1; Muslim, Iman 29, 31.)

Po ashtu, në historinë Islame, një tjetër nga shembujt tipik të virtutit të treguar me një përpikëri të madhe në mbrojtjen e së drejtës dhe drejtësisë ndaj jomyslimanëve, është edhe ky:

Kur myslimanët morën lajmin se ushtria e Bizantit po vinte drejt tyre, ata i kthyen mbrapsht taksat që kishin mbledhur nga popullit të Humsit, duke u thënë:

*“Tani po kërcënohemi nga një sulm i madh dhe për këtë arsye nuk do të jemi në gjendje t’ju mbrojmë. Prandaj, jeni të lirë të veproni si të dëshironi.”*

Mirëpo, populli i Humsit u përgjigj:

*“Për Allahun! Qeverisja dhe drejtësia që keni treguar ju, ka qenë shumë më e mirë se gjendja e mjeruar dhe padrejtësia në të cilën gjendeshim më parë. Prandaj, ne do të bashkohemi me ju për të mbrojtur qytetin kundër Bizantit.”*

Po ashtu, edhe të krishterët dhe hebrenjtë e qyteteve të tjera me të cilët ishte vendosur paqja, vepruar në të njëjtën mënyrë. Si përfundim, kur ushtria myslimane korri fitore, ata ia dorëzuan përsëri qytetin myslimanëve dhe vazhduan të paguanin taksat si më parë duke jetuar të qetë e në paqe.<sup>49</sup>

49. Beladhuri, Futuhu'l- Buldan, Beyrut 1987, f. 187.



Ushtria Islame, këtë drejtësi nuk e ka shfaqur vetëm në Hums, por në të gjitha vendet që më parë i ka marrë nën administrim, e më pas është detyruar të tërhiqet. Për shembull, kur ra Plevne<sup>50</sup>, Gazi Osman Pasha e ktheu taksën e xhizjes që u kishte marrë të krishterëve në këmbim të mbrojtjes.



Dhe, për shkak të këtyre parimeve në lidhje me çështjen e së drejtës dhe drejtësisë, gjatë gjithë historisë, shumë mendimtarë të arsyeshëm jomyslimanët, janë detyruar të pohojnë madhështinë e drejtësisë Islame.

Më 1789, revolucionarët francezë kërkuan të përgatisnin një “deklaratë të të drejtave të njeriut”. Aristokrati francez Marquis de Lafajette, bënte pjesë në komisionin që zhvillonte kërkime në lidhje me të gjitha sistemet ligjore në botë për këtë çështje. Kur Lafajette kuptoi epërsinë e së Drejtës Islame, duke aluduar në Profetin ﷺ, tha:

**“O arab i lavdishëm! Ti ke gjetur vet drejtësinë!”**

Drejtësia është shtylla kryesore që mban në këmbë shtetet. Aq, sa edhe është thënë:

*“Mund të mbahesh me pafesi, por jo me padrejtësi!”*


Dhe, për të shprehur faktin se i gjithë drejtimi/qeverisja mbahen në këmbë me drejtësi, është thënë:

*“Drejtësia është themeli i pasurisë (drejtimit)!”*

Kombet dhe shtetet qëndrojnë në këmbë me qeveritarët që mbajnë në dorë forcën dhe pushtetin. Mirëpo, pranueshmëria e një force dhe pushteti, është në përpjesëtim të drejtë me respektin e tyre ndaj kritereve të së drejtës dhe drejtësisë. Një forcë e pri-





vuar prej të drejtës dhe drejtësisë, mund të lind vetëm padrejtësi dhe tirani. Lidhur me këtë, Ebu Bekri , ka thënë:


*“Drejtësia që nuk mbështetet në forcë është e paaftë. Forca që nuk mbështetet në drejtësi, është mizore!”*

Domethënë, forca e cila nuk kontrollohet me kriteret e drejtësisë, mund të jetë vetëm një mjet mizorie. Po ashtu, edhe drejtësia, mund të manifestohet me të gjithë madhështinë e vet, vetëm nëse është në duar të drejta dhe të afta për ta përhapur atë. Ndërsa në duar të dobëta e të paaftha, mund të kthehet në poshtërim dhe mjerim.

Sa bukur shprehet Jusuf Has Haxhibi në veprën e tij *“Kutadgu Bilig”*:

*“Padrejtësia është zjarr flakërues që djeg këdo që i afrohet. Kurse drejtësia është ujë, që nëse rrjedh, lind mirësi!”*

Pra, nëse uji i drejtësisë nuk mbërrin ndërkohë që një shoqëri është duke u djegur nga zjarri i padrejtësisë e mizorisë, do të thotë se ai ujë e ka humbur pastërtinë, rrjedhshmërinë dhe vlerën e tij. Kështu, edhe një sistem drejtësie që nuk i shuan vajet e të shtypurve, i ngjan ujërave të qelbur nga ndenja.

Kur Ebu Bekri , u zgjodh kalife, u ngjiti në minber dhe me një modesti të lartë, iu drejtua popullit me këto fjalë:

*“O njerëz! Jam zgjedhur kalifja juaj, megjithëse nuk jam më i miri prej jush. Nëse e kryej siç duhet detyrën time, më ndihmoni! Por, nëse veproj gabim, më tregoni rrugën e drejtë!..”<sup>51</sup>*

Për rrjedhojë, të qëndrosh me njerëzit e drejtë dhe t'i para-

51. Ibn-i Sa'd, III, 182-183; Sujuti, Tarihu'l- Hulefa, fq. 69, 71-72; Hamidullah, Islâm Peygamberi, II, 1181.



lajmërosh ata pa hezituar kur gabojnë, është një nga detyrat më të rëndësishme të besimtarëve.

### Qëndrimi përballë dhunës dhe padrejtësisë

Në një hadith fisnik urdhërohet:

*“Xhiahadi më i çmuar, është të thuash të vërtetën dhe të drejtën përballë sundimtarit mizor!”* (Ebu Daud, Melahim, 17; Tirmidhi, Fiten, 13.)

Aty ku hesht e vërteta, ngrihet e pavërteta. Të heshtësh ndërkohë që ke mundësi të mbrosh të vërtetën, të kthen në një shejtan memec. Heshtja përballë tiranit, do të thotë ta idhujtarizosh atë. Nisur nga kjo, njerëzit si Hamani që ishin pranë Faraonit dhe e inkurajuan atë aq sa të thoshte, *“Unë jam zoti juaj i lartë!”*, nuk janë gjë tjetër veçse shejtanë me fytyrë njeriu. Për shkak se ata u bën përkrahje e tiranisë së Faraonit, edhe ata pësuan të njëjtin shkatërrim të përjetshëm, sepse mbështetja e padrejtësisë për hir të interesave të kësaj bote, bëhet shkak i një poshtërimi dhe dështimi të përjetshëm.

Ndërsa ata që ia kushtojnë zemrën Allahut, frymëzohen prej forcës së të drejtës. Dhe, me dinjitetin e mbështetjes në Allahun, ata gjenden gjithmonë pranë së drejtës dhe kundër zullumqarit.

Kjo është edhe arsyeja që i nderuari Hasan Basriu nuk heshti përballë zullumqarit Haxhxhaxh, i cili ishte i njohur për mizoritë e tij, duke vazhduar të flasë dhe të përhapë të drejtën dhe drejtësinë me çdo kusht. Po ashtu, edhe Imam Adhami, Ebu Hanifja e pagoi me tortura dhe burg refuzimin e postit të gjykatësit të Bagdadit për shkak se nuk donte të bëhej vegël e veprimeve të padrejta të kalifit Xhafer Mansur...



Fjala e drejtë, është zëri i besimit. Ndërsa thënia dhe përhapja e së drejtës, është shenja dalluese e besimtarëve të përsosur. Për sa kohë të gjenden njerëz të cilët e thonë të drejtën dhe i shërbejnë asaj, rrugët e padrejtësisë do të mbeten të mbyllura.

Nisur nga kjo, ata që i binden egos dhe zhyten në padrejtësi, ose mbështesin të padrejtin, duhet ta dinë mirë se, e pavërteta dhe padrejtësia mund të triumfojë përkohësisht, mirëpo, ato nuk mund të kenë asnjëherë një triumf të përhershëm dhe të përjetshëm. Kjo, sepse fundi i padrejtësisë, është zhdukja. Mosnjohja e Allahut dhe shkelja e parimeve të së drejtës dhe drejtësisë, do të thotë kundërshtim dhe kryengritje ndaj Allahut të Madhëruar. Për këtë arsye, është e sigurt se zullumqarët, -herët a vonë- do të përballen patjetër me dënimin e ashpër të fuqisë hyjnore.

Historia e zullumit dhe padrejtësisë, është e mbushur me hakmarrjet e tmerrshme hyjnore. Lidhur me këtë, në një ajet fisnik urdhërohet:

**“...Ne kurrë nuk i kemi shkatërruar vendbanimet (pa shkak), por vetëm kur banorët e tyre kanë qenë keqbërës.”**

(Kasas, 59.)



Shkurtimisht, ata që bëhen robër të forcës mizore, duhet të dinë se, sado i shndritshëm të duket kreu i zullumit në sytë e tyre, në faqet e historisë është treguar në mënyrë të përsëritur se, fundi i tij (zullumit) është gjithmonë errësira e thellë. Nga ana tjetër, edhe drejtësia, sado e vështirë të duket, fundi i saj është i shndritshëm dhe i paqtë. Për rrjedhojë, një mysliman që vepëron gjithmonë me drejtësi në çdo vend dhe ndaj çdokujt, fiton dashurinë e Allahut dhe robërve të Tij. Po ashtu, ai do të jetë i nderuar dhe fatlum në të dyja botët.



Kurse ata që i binden egos dhe largohen prej drejtësisë, nuk mund të arrijnë asgjë. Edhe nëse në fillim sigurojnë disa mirësi mashtruese dhe kalimtare, në fund, ato s'kanë për t'i sjellë asgjë tjetër përveç dëmit, pendesës dhe dështimit.

**Zoti ynë i ruajt zemrat tona prej shtrembërimit për hir të interesave të përkohshme! Allahu na e mundësoftë të gjithëve të bëhemi prej robërve fatlumë dhe të lumtur, të cilët jetojnë mbi parimet e së drejtës dhe drejtësisë dhe dalin në prezencën hyjnore me ndërgjegje të qetë!**

**Amin!..**



## PËRGJEGJËSIA



*Kujdesi ndaj përgjegjësisë që lind prej vëllazërisë së besimit, është shumë i rëndësishëm. Edhe pse besimtarët janë në trupa të ndryshëm, ata janë të detyruar ta konsiderojnë njëri-tjetrin si organet e një trupi që jetojnë me një zemër të vetme. Ashtu siç i gjithë trupi e ndjen dhimbjen e një organi, edhe perceptimi i vuajtjeve të vëllezërve të fesë, është një provë ndërgjegjeje për të gjithë besimtarët.*



# PËRGJEGJËSIA

Njeriu është më i nderuari ndër të gjitha krijesat dhe stolia më e bukur e universit. Allahu i madhëruar i ka falur atij mirësi dhe aftësi të panumërta, të cilat nuk ia ka falur asnjë krijese tjetër. Por, në këmbim të këtyre mirësive dhe dhuntive, Ai e ka bërë atë një qenie të ngarkuar me përgjegjësi.

Për të na sprovuar neve, robërit e Tij, Allahu i Madhëruar i ka vendosur egot tona midis **“gjynahut”** dhe **“devotshmërisë”** dhe na ka dhuruar një vullnet të lirë që të zgjedhim midis këtyre të dyjave. Në këtë mënyrë, ai na ka falur njëfarë lirie në lidhje me orientimin e vullnetit tonë në të mirë ose në të keqe -me kusht që të jemi të kënaqur prej rezultatit-.

Po ashtu, si domosdoshmëri e sprovës së kësaj bote, Allahu ka caktuar kushte të ndryshme jete për çdo njeri. Domethënë, duke u mbështetur në urtësinë e vazhdimësisë së jetës shoqërore me rregull, harmoni dhe paqe, biri i njeriut është krijuar në nivele shumë të ndryshme në aspektet materialo-shpirtëror.

Nëse të gjithë njerëzve do t'u ishin dhënë të njëjtat aftësi profesionale dhe të njëjtat cilësi fiziko-shpirtërore, në shoqëri nuk të ishte e mundur të krijohej një hierarki dhe për rrjedhojë, nuk do të ishte i mundur as rregulli harmonik i jetës. Për këtë



arsye, njerëzit janë krijuar të nevojshëm ndaj njëri-tjetrit në jetën shoqërore, si dy duar që lajnë njëra-tjetrën dhe janë të detyruar të bëjnë një jetë midis dallimesh, si pjesët e një tërësie që plotësojnë njëra-tjetrën. Prandaj, fakti që njerëzit në këtë botë, e cila është një vend-sprove, kanë mundësi shumë të ndryshme, nuk është pa urtësi. Për më tepër, kjo gjendje lind disa të drejta dhe përgjegjësi në aspektin e besimit dhe ndërgjegjes ndërmjet besimtarëve.

Allahu i Madhëruar, robërit e Tij të dobët, të pafuqishëm, e të privuar nga disa mirësi, i ka urdhëruar të bëjnë durim me qëllim që të fitojnë shpërblimin e kësaj sprove. Ndërsa nga ana tjetër, robërit e Tij të fortë, të aftë e të pasur, i ka urdhëruar të mos lazdrohen me mirësitë që kanë, por të jenë gjithmonë falënderues.

Në fakt, falënderimi nuk bëhet vetëm me gjuhë. Falënderimi i vërtetë, realizohet duke u dhuruar prej mirësive që zotëron, atyre që janë të privuar prej saj. Kujdesi i vazhdueshëm ndaj të dobëtëve për hir të Allahut, përpjekja për të lehtësuar sadopak nevojat e tyre dhe fitimi i lutjeve të tyre të sinqerta, është shprehja më e bukur e këtij falënderimi.

Herë pas here duhet të pyesim veten: *“Pse filani është sakat, e unë jam i shëndetshëm? Pse filani është i varfër, e unë jam i pasur?”* Dhe, si përgjigje duhet t’i themi vetes: *“Sepse, Allahu i Madhëruar ma ka lënë mua amanet dhe më ka bërë përgjegjës për të! Prandaj, unë jam i detyruar të përpiqem që mundësitë e mia tua shpërndaj edhe atyre që janë të privuar nga këto mundësi!..”*

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

*“Nuk është prej nesh ai që nuk shqetësohet për hallet e vëllait të tij besimtar!”* (Hakim, IV, 352; Hejthem, I, 87.)





Kujdesi ndaj përgjegjësisë që lind prej vëllazërisë së besimit, është shumë i rëndësishëm. Edhe pse besimtarët janë në trupa të ndryshëm, ata janë të detyruar ta konsiderojnë njëri-tjetrin si organet e një trupi që jetojnë me një zemër të vetme. Ashtu siç i gjithë trupi e ndjen dhimbjen e një organi, edhe perceptimi i vuajtjeve të vëllezërve të fesë, është një sprovë ndërgjegjeje për të gjithë besimtarët.

Kjo ngjarje prej historisë sonë, tregon më së miri zemrën e butë të një besimtari:

Në kohën kur Kalaja Ozi ra në duart e armikut dhe populli i saj u ther me shpatë, Sulltani Osman, Abdulhamid Hani i I., i hidhëruar jashtë mase, tha:

*“Sa keq! Bijtë e mi ushtarë dhe populli im janë copëtuar!”*

Më pas, nga hidhërimi i madh, ai u paralizua dhe vdiq.

Kjo ngjarje është një shfaqje shembullore e ndjenjës së thellë të përgjegjësisë së një besimtari. Sa madhështore është ndjenja e besimit që e bëri atë sulltan të vajtonte dhe t'i treste zemrën aq sa i kushtoi edhe jetën!

Ja pra, kur humbi kjo ndjenjë besimi, nuk u respektua më e drejta e vëllait të fesë dhe për rrjedhojë, u shkel edhe përgjegjësia. Mirëpo, besimtarët duhet ta konsiderojnë për detyrë dashurinë, shërbimin dhe mbrojtjen e njëri-tjetrit për të arritur kënaqësinë hyjnore.

Po ashtu, besimtarët janë gjithmonë të nevojshëm ndaj njëri-tjetrit në mirësi dhe lutje. Besimtarët e dobët dhe të vuajtur, kanë nevojë për mirësitë e besimtarëve të fortë dhe të pasur. Ndërsa besimtarët që kanë mundësi të shumta, kanë nevojë për lutjet e sinqerta të të dobëtëve dhe të vuajturve.



Sa bukur e shpreh i nderuari Mevlana këtë të vërtetë:

*“Ashtu si bukuria që kërkon pasqyrë të pastër e të kulluar, ashtu edhe bujaria kërkon njerëz të varfër e të dobët. Fytyra e bukurisë shfaqet në pasqyrë, kurse bukuria e mirësisë dhe dhurimit, shfaqet tek të varfrit dhe të dobëtit.”*

Nga ana tjetër, edhe njerëzit që bëjnë jetë të vështirë në aspekte të ndryshme, nuk duhet t’i perceptojnë si dënim vuajtjet dhe vështirësitë, por duhet të dinë se këto janë pjesë e sprovës hyjnore. Për rrjedhojë, ata duhet të bëjnë durim e të falënderojnë në çdo situatë, me qëllim që të marrin shpërblimin e durimit të tyre.

Kjo është edhe arsyeja që të pasurit falënderues dhe të varfrit durimtarë janë të barabartë në fitimin e kënaqësisë hyjnore. I vetmi dallim ndërmjet tyre, është se njëri sprovohet me varfëri, ndërsa tjetri me pasuri. Si shembull të kësaj të vërtete, Allahu i Madhëruar na bën të ditur gjendjen e Sulejmanit dhe Ejubit عليه السلام.

Sulejmani عليه السلام, nuk u krenua asnjëherë, edhe pse i ishin dhënë mirësi të madha, sepse mirësitë e kësaj bote kurrë nuk zunë vend në zemrën e tij. Ai e falënderonte vazhdimisht Allahun e Madhëruar, i Cili është edhe pronari i vërtetë i të gjitha mirësive. Dhe, për shkak të kësaj, ai gëzoi edhe lavdërimet e Allahut të Madhëruar, i Cili e quajti: **“Një rob të mrekullueshëm”**<sup>52</sup>.

Nga ana tjetër, edhe Ejubi عليه السلام, i cili u sprovua me varfëri dhe sëmundje, u tregua gjithmonë i duruar dhe nuk u ankua asnjëherë, sepse ai e dinte se ato ishin sprova të caktuara nga Allahu i Madhëruar. Për rrjedhojë, për shkak të durimit dhe dorëzimit të tij ndaj caktimit të Allahut, edhe Ejubi عليه السلام, gëzoi



lavdërimet e Tij, njësoj si Sulejmani ﷺ, duke u përmendur si:  
**“Një rob i mrekullueshëm”**<sup>53</sup>

Nisur nga kjo, mund të themi se, e rëndësishme, nuk është se si sprovohet, por se si reagon rob i ndaj sprovës.

Për këtë arsye, besimtari i vërtetë, para së gjithash duhet ta përdorë vullnetin e vet në përputhje me kënaqësinë e Allahut. Dhe për ta rrënjëzuar këtë ndjenjë, duhet të marrë shembull prej atyre që janë më të virtytshëm se ai në çështjet shpirtërore dhe, përkundër kësaj, duhet ta shtojë falënderimin duke parë ata që janë më të nevojshëm se ai në aspektin material. Ai nuk duhet të ankohet prej privimit të caktuar nga Vet Allahu i Madhëruar, por, duhet t'i shohë të dyja botët si një tërësi dhe të ngushëllohet me mendimin se kjo gjendje do t'ia pakësojë përgjegjësitë në botën e përjetshme. Kjo, sepse ditën e gjykimit, Allahu i madhëruar do të kërkojë shumë llogari nga njerëzit të cilëve u ka dhënë shumë mirësi dhe pak llogari prej atyre të cilëve u ka dhënë pak mirësi. Pra, në botën tjetër do të ketë llogaridhënie sipas mirësive që janë gëzuar në këtë botë. Kjo pra është forma me të cilën do të manifestohet drejtësia hyjnore.

Për shembull, një person që ka lindur në një fis primitiv në Afrikë, ose një njeri që jeton në një shoqëri të paditur, nuk mund të ketë të njëjtat përgjegjësi në aspektin e pranimit të të vërtetave Islame me një njeri tjetër që jeton në një vend të civilizuar e fetar dhe gëzon kushte më të favorshme se ata. Prandaj, të gjitha mirësitë që i janë dhuruar robit, janë elemente që përcaktojnë kufijtë dhe sasinë e përgjegjësive të tij. Në një ajet fisnik urdhërohet:

**“Allahu nuk e ngarkon askënd përtej fuqisë që ka...”**

(Bekare, 286.)

53. shih. Sad, 44.



Domethënë, Allahu të ngarkon me përgjegjësi, për aq sa fuqi dhe mundësi të jep! Mirëpo, nga ky ajet nënkuptohet edhe se, robi ka përgjegjësi nëse nuk i kryen ato që ka mundësi. Pra, ne kemi përgjegjësi për mirësitë që kemi mundësi t'i bëjmë, por nuk i bëjmë, si për shembull, të urdhërojmë për të mirë, e të pengojmë nga e keqja. Kështu që, ne jemi të detyruar të kemi parasysh se do të merremi në llogari edhe për gjërat që nuk i bëjmë.

Në këtë pikë, shfaqet një çështje shumë e rëndësishme për ne besimtarët:

Është shumë e lehtë për ne të përcaktojmë sasinë e zekatit dhe të shpëtojmë nga përgjegjësia e saj materiale. Mirëpo, mirësitë materiale dhe shpirtërore që Allahu i Madhëruar i ka falur njeriut, lindin një përgjegjësi aq të madhe, sa është pamundur të përcaktosh sasinë e saj. Për shembull, përpjekja në rrugën e Allahut, është një përgjegjësi që Allahu ua ka ngarkuar të gjithë njerëzve (me mendje të shëndoshë). Mirëpo, ndryshe nga zekati, kjo çështje nuk ka një masë apo sasi të caktuar.

Ka njerëz, të cilët për shkak se gëzojnë pak mirësi, edhe përgjegjësinë e kanë të pakët, -le të themi- sa vëllimi i një "gote". Mirëpo, ka njerëz, përgjegjësia e të cilëve është më e madhe, -të themi- sa vëllimi i një "kazan". Pra, mirësitë që gëzojmë me caktimin e Allahut, na bëjnë përgjegjës në masa të ndryshme. Nëse dikush që zotëron një "kazan", bart një gisht ujë në fund të kazanit, do të thotë se e ka kazanin bosh. Ashtu si dikush që ka një miliardë dhe nuk mund të shpëtojë nga përgjegjësia e zekatit nëse jep vetëm 10 milion, ashtu janë edhe përgjegjësitë që lindin prej mirësive të tjera.

Nga kjo pikëpamje, për shkak se është e pamundur të dimë masën e saktë të përgjegjësive që lindin mirësitë që gëzojmë, atëherë nuk duhet të mbështetemi shumë në punët e mira që bëjmë, si namazi, duatë, bamirësitë, etj. Kjo, sepse vëllimi i enës



së përgjegjesisë sonë mund të jetë më i madh se sa pandehim dhe veprat e mira që bëjmë mund të jenë aq të pakta, sa ka rrezik të mos duken fare.

Në kohën e Profetit ﷺ, janë përjetuar shumë shembuj të tillë. Njëherë, erdhi një beduin dhe tha se do të bënte vetëm farzet e urdhëruara. Ndërsa i Dërguari i Allahut ﷺ, në lidhje me të tha:

*“Nëse e mban fjalën, ka shpëtuar!”<sup>54</sup>*

Kjo, sepse vëllimi i enës së atij personi ishte sa një gotë uji.

Përkundër kësaj, njërit prej sahabëve të tij më të zgjedhur, Muadhrit ﷺ, i Dërguari i Allahut ﷺ, i tha disa herë me radhë: *“Edhe kjo nuk mjafton!”*, duke e këshilluar atë që të bënte më shumë. E më në fund i tha:

*“A të tregoj për atë që është më e rëndësishme në të gjitha këto?”*

*“Po, më trego o i Dërguar i Allahut!”*, - tha Muadhi ﷺ. Më pas, Profeti ﷺ, kapi gjuhën dhe tha:

*“Ruaj gjuhën!”* Muadhi ﷺ, pyeti:

*“A do të merremi në llogari edhe për ato që flasim?”* Ndërsa i Dërguari i Allahut u përgjigj:

*“Allahu të dhëntë mirësi o Muadh! Por ajo që i zvarrit (më së shumti) njerëzit me fytyrë përtokë në Xhehenem, është vetëm ajo që del prej gjuhës!”<sup>55</sup>*

Shkurtimisht, në aspektin e vëllimit të përgjegjesisë, ne nuk mund ta dimë me siguri, nëse në dorë kemi një gotë, apo një kazan të madh. E në fakt, as egoja jonë nuk dëshiron që ne ta dimë këtë, sepse mbase mund të kemi “kazan”, por ne e mash-

54. shih. Buhari, Iman 34, Saum 1, Shehadat 26; Muslim, Iman 8, 9.

55. shih. Tirmidhi, Iman, 8; Ibn-i Maxhe, Fiten, 12.



trojmë veten duke menduar se “kemi një gotë dhe na mjafton kaq ujë”. Pra, mendojmë se aq vepra të mira na mjaftojnë për të shpëtuar! Në këtë mënyrë, shumë njerëz që posedojnë “kazanë”, e krahasojnë veten me ata që kanë vetëm një “gotë” dhe pandehin se e kanë mbushur enën e tyre (të përgjegjësive). Ndërsa shumë të tjerë, bëhen aq indiferentë, sa e krahasojnë Detin Mesdhe me Detin Marmara. Në këtë mënyrë, ata e ngushëllojnë veten duke e krahasuar gjendjen e tyre me atë të shoqërisë.

Mirëpo, mirësitë që Allahu i ka dhënë popullit, janë të ndara nga ato që i ka dhënë individëve. Për këtë arsye, ne asnjëherë nuk duhet t’i konsiderojmë të mjaftueshme veprat që kryejmë në rrugë të Allahut dhe nuk duhet të mendojmë se kemi arritur kufirin e atyre që mund të bëjmë. Për të plotësuar ashtu siç duhet përgjegjësitë që lindin mirësitë që zotërojmë, duhet të përpiqemi me të gjitha forcat tona deri në frymën e fundit.

Përveç kësaj, ne duhet të ruhem i shkuar mendimi i shkujdesur se jemi të përjashtuar nga përgjegjësia e përpjekjes në rrugë të Allahut për shkak se mund të jemi të privuar nga disa mirësi. Shembull i bukur në këtë pikë, është edhe gjendja e disa sahabëve vetëmohues. Për shembull, sahabiu Abdullah ibn-i Ummi Mektum رضي الله عنه, ishte përjashtuar nga përgjegjësia për të marrë pjesë në luftë për shkak se ishte i verbër. Por, megjithëkëtë, ai mori pjesë në luftën e Kadisijes duke thënë: *“Unë do të mbaj flamurin!”*

Po ashtu, edhe gjatë fushatës ushtarake të Tebukut, një sahab u përjashtua nga përgjegjësia e pjesëmarrjes në luftë, për shkak se nuk kishte kafshë udhëtimi. E megjithatë, edhe ky sahab nuk qëndroi pa vajtur në luftë. Ai i premtoi një kalorësi, se nëse fitonin dhe ktheheshin gjallë, do t’i jepte pjesën e tij të plaçkës së luftës në këmbim të përdorimit të përbashkët të kafshës së udhëtitimit.



Këto shembuj tregojnë se ata sahabë të bekuar, e dinin shumë mirë se vuajtjet dhe sakrificat që bëheshin për një vepër të mirë, do të bëheshin shkak i shumëfishimit të shpërblimit të tyre.

Të gjitha mirësitë e sinqerta që bëhen në kërkim të kënaqësisë së Allahut, janë tregues të pjekurisë së zemrës dhe shkak i afrimit me Zotin. Prandaj, edhe nëse përjetojmë gjendje sëmundjeje, gjymtimi apo varfërie, në vend që të tërhiqemi mënjanë duke thënë, “unë jam i arsyetuar...”, ne duhet të bëjmë çdo gjë që kemi mundësi në shërbim të fesë së Allahut, duke i eliminuar të gjitha pengesat e përkohshme në këtë rrugë. Në një ajet fisnik urdhërohet:

**“O besimtarë, nëse e ndihmoni Allahun, edhe Ai do t’ju ndihmojë dhe do t’ju bëjë të qëndroni fort në këmbët tuaja.”**

(Muhamed, 7)

### **Mos e hidhni veten në rrezik!..**

Në periudhën Emevite, ushtria Islame erdhi deri në Kostandinopojë me dëshirën që të bëhej pjesë e përgëzimit të Profetit ﷺ, për çlirimin e saj. Në këtë ushtri bënte pjesë edhe sahabiu Ebu Ejjub el-Ensari ؓ. Ndërkohë që bizantinët luftonin duke lënë muret e qytetit pas shpine, një sahab prej ensarëve u fut me kalin e tij deri në mes të ushtrisë bizantine. Kur një prej ushtarëve myslimanë e pa këtë, duke marrë shkas prej ajetit fisnik i cili urdhëron: **“Mos e hidhni veten në rrezik me duart tuaja!”**, tha:

*“La ilahe il-lallah! Shikojeni atë! Ai po e hedh veten në rrezik me vetëdije!”*

Ndërsa Ebu Ejjub el-Ensari ؓ, tha:

“O besimtarë! Ky ajet ka zbritur për ne ensarët. Kur Allahu



e ndihmoi të Dërguarin e Tij ﷺ dhe e bëri triumfuese fenë e Tij, ne thamë: «Tashmë do të qëndrojmë pranë pasurisë sonë dhe do të merremi vetëm me shtimin e saj!» Për këtë arsye, u zbrit edhe ajeti fisnik: **“Shpenzoheni pasurinë në rrugën e Allahut dhe mos e hidhni veten tuaj në rrezik me duart tuaja, por bëni të mira; Allahu me të vërtetë i do bamirësit.”**<sup>56</sup> Qëllimi i shprehjes **“mos e hidhni veten tuaj në rrezik me duart tuaja”**, në këtë ajet, është që ne të mos zhytemi në çështjet e kësaj bote dhe të merremi vetëm me vreshtari e kopshtari, duke braktisur apo neglizhuar përpjekjet në rrugën e Allahut.”

Nisur nga ky paralajmërim hyjnor të cilin ai e respektonte me gjithë sinqeritetin e tij, Ebu Ejjub el-Ensari ؓ, me qëllim që të çonte në vend të gjitha përgjegjësitë e tij të devotshmërisë, nuk i konsideroi kurrë të mjaftueshme veprat e tij dhe, për rrjedhojë nuk e braktisi asnjëherë as shërbimin në rrugën e Allahut. Ai dha jetën e tij dhe arriti gradën e dëshmorit në këtë luftë, ku mori pjesë me një entuziazëm të lartë besimi, në moshën tetëdhjetë e ca vjeçare.<sup>57</sup>

Po ashtu, edhe Omer ibn Abdulazizi, i cili la gjurmë të thella në historinë Islame edhe vetëm me dy vjet e gjysmë të kalifatit të tij, ishte vazhdimisht në një gjendje vetllogarie. Si përgjigje ndaj fjalëve të bashkëshortes së tij që mendohej ta ngushëllonte, tha:

“Oj Fatime! Si do të përgjigjem unë nesër në ditën e gjykimit nëse Zoti im më merr në llogari dhe i Dërguari i Allahut ﷺ, më qorton në lidhje me njerëzit për të cilët kam përgjegjësi?!”

Në Kuranin fisnik urdhërohet:

<sup>56</sup>. Bekare, 195.

<sup>57</sup>. shih. Ebu Daud, Xhihad, 22/2512; Tirmidhi, Tefsir, 2/2972.





**“O besimtarë! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!”** (Al-i Imran, 102.)

**“Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!”** (Hixhr, 99.)

**“Prandaj, kur të çlirohesh** (nga punët e ndryshme), **përpiqu fort** (në adhurim ose punë tjetër) **dhe vetëm ndaj Zotit tënd përkushtohu!”** (Inshirah, 7-8.)

Duke u nisur nga këto ajete, edhe ne duhet të përpiqemi me pasionin e shërbimit në rrugën e Allahut deri në fund të jetë sonë. Lidhur me këtë çështje, duhet të marrim shembull Profetin tonë të dashur ﷺ. Edhe pse atij i ishin falur të gjitha gjynahet e shkuara e të ardhme, ai falte namaz dhe kërkonte falje nga Allahu gjithë natën deri në mëngjes. Po ashtu, gjatë ndërtimit të xhamisë, ai bartte gurë në shpinën e tij të bekuar. Ndërsa kur dilnin për udhëtime, ai mblidhte dru për të gatuar ushqimin.

Kur ushtria myslimane po shkonte në betejën e Bedrit, myslimanët udhëtuan duke hipur tre veta me radhë në një deve. Sahabët me këmbëngulje donin t’ia linin radhën e tyre Profetit ﷺ, por ai nuk e pranoi këtë dhe tha:

*“Ju nuk jeni më rezistentë se mua në ecje. Përveç kësaj, edhe unë nuk jam më i panevojshëm se ju në fitimin e seapeve!”* (Ibn-i Sa’d, II, 21; Ahmed, I, 422.)

Me pak fjalë, për shkak se është e pamundur të përcaktojmë sasinë e zekatit të aftësive dhe mundësive që Allahu na falur neve, robërve të Tij, ne jemi të detyruar t’ia kushtojmë veten shërbimit në rrugën e Allahut deri në frymën e fundit, sipas fuqisë që kemi.



Nga ana tjetër, mënyra më e bukur e pagimit të borxhit të



falënderimit që lind prej mirësisë së besimit, është përpjekja për udhëzimin e njerëzve të privuar nga besimi ose gjynahqarëve, me gjuhë të butë dhe me shfaqjen e fytyrës së bukur të Islamit. Mirëpo, duhet të theksojmë edhe se, njerëzit gjynahqarë janë si zogj të plagosur. Ajo që do t'u bëjë dobi atyre, nuk është zemërimi, por mëshira. Pra, urrejtja ndaj gjynahut, nuk duhet të derdhet mbi gjynahqarët. Dhe, një ndjenjë e tillë e pastër dhe e thellë, mund të përfitohet -më tepër- në atmosferën e tolerancës së një rrethi i cili i ka përvetësuar siç duhet parimet e tasavufit.

Në ditët tona, për shkak se shumë njerëz kanë vullnet të dobët në aspektin fetar, ne duhet të gjendemi brenda në shoqëri si një doktor që shëtit korridoret e spitalit. Ofrimi i mënyrave të kurimit të sëmurit, është një përgjegjësi njerëzore dhe shpirtërore e doktorit. Në të njëjtën mënyrë, edhe ne jemi të detyruar të bartim përgjegjësinë e udhëzimit përballë njerëzve të kapluar nga sëmundjet shpirtërore. Lidhur me këtë, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

*“Feja është këshillë!”* (Buhari, Iman, 42.) Dhe për të theksuar domosdoshmërinë e kësaj këshille, ai e përsëriti atë tre herë.

### **Mos i beso punës tënde!..**

Vepra e një njeriu, nuk është plotësisht e mjaftueshme për të paguar borxhin e falënderimit ndaj mirësive që i janë falur. Për këtë arsye, njerëzit e mirë dhe të urtë, madje edhe vet profetët, kanë dëshiruar të merren në llogari jo vetëm me veprat e tyre, por edhe me faljen dhe mëshirën e Allahut.

Njëherë, kur i Dërguari i Allahut ﷺ, po i ftonte sahabët e vet të qëndronin larg ekstremeve dhe të bënin një jetë me devotshmëri të ekuilibruar, u tha:

*“Zgjidhni rrugën e mesme (në punët tuaja) dhe bëhuni të*



*drejtë! Dijeni se, askush prej jush nuk do të arrijë shpëtimin në sajë të veprave të veta!”* Thanë:

*“As ti nuk mund të shpëtosh, o i Dërguar i Allahut?”*

*“(Po) as unë nuk mund të shpëtojë. Por nëse Allahu më fal me mëshirën dhe bujarinë e Tij, atëherë ndryshon puna!”*

(Muslim, Munafikin 76, 78.)

Ndërsa në një hadith tjetër, ka thënë:

*“Nëse një njeri nuk do ta ngrinte kokën prej sexhdes që prej ditës që lind e deri në ditën që plaket e vdes, duke synuar kënaqësinë e Allahut, ditën e kijametit, përsëri veprat e tij do t’i dukeshin të pakta (me mendimin se ka qenë i dobët në falënderimin e Allahut për të gjitha mirësitë që i ka falur)”.*

(Ahmed, V. IV, s. 185)

Domethënë, edhe një besimtar i tillë do të kuptonte se veprat e tij nuk do të mjaftonin për të shpëtuar.

Po ashtu, edhe Profeti ﷺ, i cili megjithëse falte namaz nate derisa i ënjteshin këmbët, e shfaqte dobësinë absolute të njeriut në këtë çështje duke u lutur kështu:

*“O Allah! Unë jam shumë i dobët në laudërimin dhe madhërimin Tënd ashtu siç të takon! Ti je ashtu siç e ke lavdëruar dhe madhëruar Vetën Tënd!”* (shih. Muslim, Salat, 222.)

Për rrjedhojë, detyra jonë është që, përveçse të mos e braktisim asnjëherë përpjekjen, të mos e ngushëllojmë as veten tonë me ato punë që bëjmë, por të kërkojmë sa më shumë falje dhe bujari prej Allahut të Madhëruar.



Shkurtimisht, në ditët tona kur njerëzit po mbyten në kthetrat e kënaqësive të përkohshme, dëshirave egoiste dhe vorbullat e



problemeve shpirtërore, është më se e sigurt se mbi ne rëndojnë edhe më shumë përgjegjësitë hyjnore.

**Zoti ynë na e bëftë të mundur të tregojmë përpjekjet e duhura në përputhje me përgjegjësitë që kemi! Allahu na i faltë të gjithëve të metat dhe gabimet tona dhe na nderoftë me Xhenetin dhe bukurinë e Tij!**

**Amin!..**



# VETËDIJA NDAJ AMANETIT



Profeti ﷺ ka thënë se besimtarët kanë përgjegjësi ndaj njëri-tjetrit; ata duhet të jenë të lidhur me njëri-tjetrin si tullat e një muri. Ashtu si organet e trupit, edhe ata duhet të ndajnë të njëjtën dhimbje që ndjen njëri prej tyre; dhe se të flesh i ngopur ndërkohë që fqinji është i uritur, nuk përputhet aspak me moralin islam. Shkurtimisht, ai ka theksuar se besimtarët janë amanet i njëri-tjetrit.



## VETËDIJA NDAJ AMANETIT

Shprehja “mu’min”, që është edhe emri i përgjithshëm për të gjithë ata që besojnë Allahun, në të njëjtën kohë është edhe një nga emrat e bukur të Allahut, që shpreh se Ai është burimi i sigurisë, pra u jep siguri robërve të Tij ose i bën ata të besueshëm. Ai është që i pajisi edhe Profetët e Vet me cilësinë e “amanetit” dhe i bëri ata njerëz të besueshëm. Nisur nga kjo, një “mu’min”, është edhe besimtar, edhe i sigurt, edhe i besueshëm.

Ndjenja e respektimit të amanetit është një element që i jep jetë besimit të mu’minëve. Ky hadith shumë domethënës e shpreh shumë qartë këtë të vërtetë dhe në të njëjtën kohë është edhe një paralajmërim i fuqishëm Profetik:

*“Padyshim se, kur Allahu ﷻ, dëshiron të shkatërrojë një rob, e heq turpin prej tij. Kur ia merr turpin, ai rob bëhet prej të dënuarve. Kur dënohet, ai zhvishet nga besueshmëria. Kur i merret besueshmëria, ai bëhet tradhtar. Kur bëhet tradhtar, nuk mëshirohet më. Kur e humbet mëshirën (e Allahut), atë e zë mallkimi, bëhet i mallkuar. Dhe, kur e zë mallkimi e bëhet i mallkuar, këputet lidhja e tij me Islamin!” (Ibn Maxhe, Fiten, 27)*

Ashtu siç shprehet edhe në hadithin fisnik, ndjenja e amanetit është një nga kushtet e përsosmërisë së besimit. Prandaj,



për ta ruajtur atë me kujdes, Zoti ynë na e tërheq vëmendjen në mënyrë të shpeshtë:

**“...Nëse i besoni njëri-tjetrit (dhe i lini ndonjë amanet), ai të cilit i është besuar (amaneti) le t’ia kthejë atë të zotit dhe t’i frikësohet Allahut në këtë çështje...”** (Bekare, 283)

**“...Kush e tradhton amanetin (merr padrejtësisht), në Ditën e Kiametit do të vijë i ngarkuar me atë që ka tradhtuar (ka marrë padrejtësisht)...”** (Al Imran, 161)

**“O besimtarë! Mos e tradhtoni Allahun dhe të Dërguarin, e mos i tradhtoni amanetet me vetëdije.”** (Enfal, 27)

**“Allahu ju urdhëron që t’ua ktheni amanetet atyre që u përkasin dhe, kur të gjykoni midis njerëzve, të gjykoni me drejtësi...”** (Nisa, 58)

“Amanet” është një nga pesë cilësitë e Profetëve. Profeti ﷺ, kishte fituar aq respekt ndër arabët e kohës së inyorancës, sa që ata e thërrisnin me emrat “el-Emin” dhe “es-Sadik”. Madje, Ebu Xhehli, që ishte armiku më i egër i Rasulullahut ﷺ, një ditë i thotë:

“O Muhamed! Unë nuk po them se je gënjeshtar. Por nuk e pranoj këtë ftesë që më ke sjellë...” Me këto fjalë, ai e pranonte vërtetësinë e tij, por nuk mund ta pranonte ftesën e Islamit që i bënte Profeti ﷺ.

Kjo gjë shprehet edhe në një ajet fisnik, ku urdhërohet:

**“...Në të vërtetë, nuk je ti ai që po mohojnë ata, por keqbërësit po mohojnë shpalljet e Allahut.”** (En’am, 33)

Për sa i përket “amanetit” dhe “besnikërisë”, askush nuk mund të arrijë nivelin e Profetit ﷺ. Kjo ndodhi që ka transmetuar Abdullah ibn Ebi'l-Hamsa ؓ, është një shembull i bukur i gjendjes së Profetit ﷺ:





“Para se të bëhej Profet, unë kisha bërë një tregti me të Dërguarin e Allahut. Unë hyra në borxh tek ai dhe u largova me premtimin se nëse priste pak, do t’ia sillja menjëherë. Mirëpo, unë e harrova premtimin që i dhashë. Kur u kujtova pas tre ditësh dhe shkova në vendin ku e kishim lënë për t’u takuar, e gjeta atë duke pritur në po të njëjtin vend. i Dërguari i Allahut, pa më qortuar për sjelljen time, më tha vetëm kaq: «O djalosh! Më mundove, kam tre ditë që po të pres këtu». (Ebu Daud, Edeb, 82/4996.)

Profeti ﷺ, njihej nga të gjithë për karakterin e tij që ngjallte ndershmëri, drejtësi dhe siguri. Madje, edhe zonja fisnike dhe e ndershme mekase, nëna jonë Hadixhe ؓ, për shkak se i admironte këto cilësi të tij, i propozoi për martesë.

Përfshi edhe hebrenjtë që ishin armiq të Islamit, kur njerëzit binin në kundërshti mes njëri-tjetrit, shkonin tek ai për shkak se i besonin drejtësisë dhe ndershmërisë së tij. Ndërsa i Dërguari i Allahut ﷺ, ua zgjidhte mosmarrëveshjet që kishin midis tyre.

Kur mbretit të Bizantit, Herakliut, i arriti letra e ftesës Islame, Ebu Sufjani i cili në atë kohë ishte armik i përbetuar i Islamit, gjendej në Sham (Damask). Herakliu i bëri shumë pyetje Ebu Sufjanit në lidhje me Profetin ﷺ. Por në mënyrë të veçantë e pyeti se a ishte akuzuar më parë si gënjeshtar dhe a kishte ndodhur ndonjëherë që të mos e mbante fjalën. Edhe pse në atë kohë ishte armik i Islamit, Ebu Sufjani u detyrua të thoshte të vërtetën se ai kurrë nuk kishte gënjer dhe se gjithmonë e mbante fjalën e dhënë.

Kjo tregon se edhe ata që nuk e pranonin atë si Profet, nuk mund ta mohonin ndershmërinë dhe drejtësinë e tij. Kur Profeti ﷺ, emigroi (në Medinë), tek ai gjendeshin disa amanete që ia kishin lënë idhujtarët. Për këtë arsye, para se të largohej, Profeti ﷺ, i la Aliut ؓ, detyrën që t’u kthente amanetet të zotëve



të tyre. Shkurtimisht, myslimanë dhe jomyslimanë, të gjithë e respektonin atë. Ndjenja e drejtësisë e kishte brumosur zemrën e Rasulullahut ﷺ, në një mënyrë të tillë, sa që kur pa një grua që po thërriste fëmijën e saj duke i thënë: “Eja, shiko se çdo të jap!”, e pyeti menjëherë, se çfarë do t’i jepte. Kur gruaja tha se do t’i jepte disa hurma, ai tha:

*“Nëse nuk do t’i kishte dhënë gjë, do të quhej si gënjeshtër.”*

Këto ndjenja të Profetit ﷺ, nuk përfshinin vetëm njerëzit, por edhe kafshët. Njëherë, kur pa se një prej shokëve të tij po e ndillte kalin e vet duke u shtirur se kishte në dorë ushqim për të, u mërziqte aq shumë, sa që e thirri shokun e vet dhe e qortoi. (shih. Buhari, Iman, 24.)

Njëherë tjetër, kur ishin duke u kthyer nga një udhëtim, dy sahabë kishin marrë të vegjlit e një zogu nga foleja dhe po i ledhatonin. Kur zogu nënë nuk i gjeti të vegjlit e saj në fole, filloi të përpëlitej nga hidhërimi. Sapo e dëgjoji këtë ndodhi, Rasulullahu ﷺ, urdhëroi që të vegjlit të vendoseshin menjëherë në follenë e tyre dhe të mos e lëndonin zogun nënë. (shih. Ebu Daud, Xhihad, 112.)

Ndërsa Ibn-i Abbasi ؓ, tregon:

*“Një person, kishte shtrirë një kafshë për ta therur dhe po e mprichte thikën në sy të saj. Kur e pa, Rasulullahu ﷺ, i thotë: «A mos dëshiron ta vdesësh disa herë!? Ta kishe mprehur thikën para se ta shtrije!» (shih. IV, 257.)*

Për shkak se Profeti ﷺ, i shihte krijesat me syrin e mëshirës së Krijuesit, e kishte ndaluar edhe prerjen e një dege peme të njomë. Po ashtu, ai na ka njoftuar se një grua besimtare shkoi në Xhehenem për shkak se e kishte lënë të ngordhë prej urisë macen e saj; ndërsa një grua gjynahqare fitoi mëshirën e Allahut,



për shkak se i kishte dhënë ujë një qeni që po ngordhte nga etja. Kjo, sepse ai i shihte të gjitha krijesat si një amanet që i ka lënë Allahu i Madhëruar dhe dëshironte që besimtarët të jenë përfaqësuesit e sigurisë dhe paqes në tokë.

Nga kjo pikëpamje, çdo besimtar me vetëdijen se është umeti i një Profeti që gëzon virtytet “el-emin” dhe “es-sadik”, duhet të jetë besnik në fjalë e në vepër dhe njerëzit, madje të gjitha krijesat, duhet të jenë të sigurt prej dorës dhe gjuhës së tij. Ai duhet të shfaqë përreth vetes një karakter të fortë Islam, sepse njerëzit i admirojnë personat me karakter të fortë, të matur e shembullor dhe i ndjekin gjurmët e tyre.

Profeti ﷺ, i cili dëshironte që ndjenja e amanetit të bëhej identiteti i personalitetit të besimtarëve, në një hadith fisnik, thotë:

*“Ktheja amanetin atij që ta ka besuar. Mos e tradhto (as) atë që të ka tradhtuar!”* (Ebu Daud, Buju, 79/3534.)

Gjithashtu, Profeti ﷺ, tradhtinë ndaj amanetit e ka konsideruar si shkak shkatërrimi, i cili e kthen jetën e kësaj bote në një skenë kiameti. Një ditë, kur ishte duke biseduar me shokët e tij, dikush e pyeti:

*“Kur do të bëhet Kiameti?”*

*“Kur të humbasë amaneti, prite Kiametin!”, u përgjigj ai.*

*“Si do të humbë amaneti?”, pyeti ai përsëri.*

*“Kur punët t’u besohen njerëzve të paaftë, prite Kiametin!”*

(Buhari, Ilm, 2.)

Të gjitha mirësitë që i janë falur njeriut, janë nga një amanet më vete. Profeti ﷺ, në Hutben e Lamtumirës, ka thënë:

*“...Po ju lë një amanet të tillë, që po të kapeni fort pas*



*tij, nuk keni për ta humbur rrugën. Ky amanet është Libri i Allahut dhe Suneti i Profetit të Tij...*" (Hakim, I, 171/318.)

Nisur nga kjo, Kurani Fisnik dhe Suneti i Profetit ﷺ, janë amanetet më të mëdha që na ka lënë Allahu dhe i Dërguari i Tij.

Po ashtu, Profeti ﷺ, ka thënë se besimtarët kanë përgjegjësi ndaj njeri-tjetrit; ata duhet të jenë të lidhur me njëri-tjetrin si tullat e një muri; ashtu si organet e trupit, edhe ata duhet të ndjejnë të njëjtën dhimbje që ndjen njëri prej tyre; dhe se të flesh i ngopur ndërkohë që fqinji është i uritur, nuk përputhet aspak me moralin Islam. Shkurtimisht, ai ka theksuar se besimtarët janë amanet i njëri-tjetrit.

Fakti që të parët tanë të nderuar osman, shfrytëzuan të gjitha mundësitë e asaj kohe për t'u shkuar në ndihmë besimtarëve në anën tjetër të botës, në Açe, nuk mund të shpjegohet ndryshe përveçse me ndjenjën e amanetit, e cila është pjesë e moralit Islam. Po ashtu, edhe themelimi nga ana e tyre, i 26 mijë e më tepër vakëfeve për t'u shërbyer sa më shumë njerëzve, kafshëve, madje edhe bimëve, ishte si rezultat i konsiderimit të të gjitha krijesave si amanete hyjnore.

Të gjithë vëllezërit tanë në vendet myslimane, si Ballkan, Lindje të Mesme, Kaukaz dhe kudo që ka myslimanë, janë amanete të Zotit dhe të të parëve tanë Osman, si Sulltan Muradi, i cili ra dëshmor në Kosovë, si Sulltan Mehmet Fatihu, i cili çliroi Bosnjën, etj... Në luftën e Çanakalesë (Dardaneleve), gjyshërit tanë të këtyre vendeve erdhën dhe luftuan sup më sup me gjyshërit tanë në Çanakale dhe dhanë jetën për të njëjtin qëllim.

Nga ana tjetër, edhe atdheu ynë me shumë bukuri e mirësi, është një amanet shumë i rëndësishëm për ne. Jetësimi i fesë, ruajtja e nderit, dinjitetit e pronës dhe valëvitja e dëlirë e flamurit kombëtar është e mundur vetëm me mbrojtjen e atdheut. Midis



shumë urtësive të emigrimit të Profetit ﷺ, në Medine, është edhe sigurimi i një atdheu për të jetuar fenë të lirë.

Osmanët, të cilët njëherë e një kohë ishin vetëm një fis që përbëhej vetëm nga katërqind çadra, në sajë të respektit legjendar që treguan ndaj Kuranit Fisnik, u bën një shtet që u përhap në tre kontinente. Përveç kësaj, në kohën e Sulltan Javuz Selimit, “amanetet e shenjta<sup>1</sup>” u sollën në Stamboll, në Pallatin Topkapë, ku u vendosën nëpër dhoma të veçanta ku vazhdimisht lexohet Kurani Fisnik. Kjo traditë, është filluar prej vetë Sulltan Javuz Selimit, i cili qe i pari që lexoi Kuran në atë vend, ku do të vazhdojë të lexohet për shekuj të tërë. Të gjitha këto, tregojnë respektin e jashtëzakonshëm që kanë treguar të parët tanë. Ky është edhe një nga shkaqet që Osmanët arritën të gëzonin një mirësi të madhe hyjnore, duke sunduar me lavdi e madhështi për gjashtëqind e kusur vite.

Nuk duhet harruar se e fshehta që qëndron në themel të madhësisë në fushën materiale dhe të dukshme të kombeve, është respektimi i urtësive të botës shpirtërore. Madhështia gjashtëqindvjeçare e Osmanëve, të cilën nuk e ka gëzuar asnjë shtet tjetër Islam, ka buruar nga rëndësia e jashtëzakonshme që i kanë dhënë ata botës shpirtërore.

Nisur nga kjo, detyra jonë, është të edukojmë dhe rritim një brez me besim, të lidhur me vlerat shpirtërore dhe atdhetare, sepse mbrojtja e besimit, nderit, dinjitetit, jetës dhe pronës është e mundur vetëm me mbrojtjen e atdheut. Ashtu siç na i kanë lënë trashëgim këto toka të parët tanë që kanë jetuar në to dhe i kanë mbrojtur me jetët dhe gjakun e tyre, ashtu edhe ne jemi të detyruar që këto toka t’ua përçojmë brezave të mëvonshëm, të lira, me thirrjen e Kuranit, ezanëve dhe flamurin që valëvitet i dëlirë. Allahu i Madhëruar, urdhëron:



**“Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për mirësitë (e kësaj bote)!”**

(Tekathur, 8)

Mirësia më e madhe është feja jonë; është jetësimi i besimit tonë në një atdhe të lirë. Nëse nuk bëhet kujdes në vetëdijen e këtij amaneti, shembulli i gjendjes sonë do të jetë si gjendja e mjeruar dhe e hidhur e Palestinës dhe Mesxhdi Aksas, të cilat sot ndodhen në dhunën dhe pushtimin e armiqve. Sa bukur ia përkujtojnë këtë të vërtetë brezave dhe shekujve, këto vargje të të ndjerit M. Akif Ersoj:

*Atdheu pa zot, kapitullimin meriton,  
Por nëse ti i del zot, ky atdhe s'kapitullon!..*

Nga ana tjetër, popujt mund ta ruajnë vitalitetin e tyre në skenën e historisë në sajë të “kulturës” që u përshtatet strukturës së tyre. Në bazë të kësaj, edhe kultura është një amanet i rëndësishëm. Dhe, trekëmbëshi mbi të cilën qëndron ky amanet, është **feja, gjuha dhe historia**.

Feja është rregullatore e jetës midis djepit dhe varrit, pra përmbledhja e ligjeve hyjnore që e përgatit robin për lumturinë e botës tjetër. Gjuha është mjete i shprehjes së të vërtetave që nxjerr në pah feja. Ndërsa historia është një pishtar që ndriçon rrugët e të ardhmes së popujve, duke analizuar shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve brenda kuadrit të fesë dhe gjuhës. Për rrjedhojë, këto tri elemente nuk mund të mendohen kurrë të ndara nga njëra-tjetra.

T’i dalësh zot amanetit të trashëgimisë së fesë, gjuhës dhe historisë që na kanë lënë të parët tanë, pra amanetit kulturor, nuk do të thotë të merremi vetëm me restaurimin e veprave materiale që janë kthyer në gërmadha. E rëndësishme është rigjallërimi i shpirtit, entuziazmit dhe civilizimit të tyre, duke i përçarur këto edhe në brezat pasardhës.



Historia është dëshmitare se popujt dhe individët e organizojnë jetën e tyre në bazë të eksperiencave që kanë kaluar. Historia është kujtesa e popujve. Për këtë shkak, popujt gjithmonë kanë nevojë për të marrë mësim dhe udhëzim prej ndodhive historike. Nëse një popull e njeh historinë e tij të vërtetë dhe udhëzuesit e saj materialë e shpirtërorë dhe i respekton ashtu siç duhet, do të thotë se ai është një popull i përparuar dhe i madh. Nëse brezat e rinj e dinë historinë e tyre më mirë se të huajt dhe marrin mësimet e duhura prej të shkuarës, nuk kemi pse të shqetësohemi për të ardhmen. Kurse ata që nuk mbështeten në të shkuarën e tyre, kurrë nuk mund të jenë të sigurt për të ardhmen e tyre. Prandaj, rrënjët tona duhet të shtrihen në të shkuarën, ndërsa degët në të ardhmen.

Gjithashtu, të pandehësh se shkenca e historisë është vetëm një mullar me ngjarje të pakuptimta, është një gabim shumë i madh. Shkenca e vërtetë e historisë është një shkencë plot me urtësi, e cila tregon bazat reale të së vërtetës dhe të së kotës, të së drejtës e të gabuarës në të shkuarën plot me ngjarje të popujve të botës. Për ta rregulluar në mënyrë të përsosur të ardhmen e popujve, është kusht që këto baza të njihen mirë dhe të nxirren mësimet e duhura prej tyre. Sa bukur shprehet i ndjeri M. Akif Ersoj:

*“Përsëritje historike, thanë; Por a do të përsëritej nëse mësim do të ishte marrë!..”*

E shkuara jonë na porosit se luani nuk mund të futet në kafaz. Ashtu siç nuk e nxë kafazi luanin, ashtu edhe populli nuk robërohet nëse i ruan cilësitë e veta. Të parët tanë ishin një shoqëri e ngritur mbi themelet e besimit. Ata i mbrojtën me jetë vlerat e tyre materiale e shpirtërore dhe kurrë nuk u poshtëruan.

Kur ne të bashkohemi me vlerat shpirtërore të të parëve



tanë, atëherë do të mund t'i bartim me dinjitet amanetet e shenjta që ata na kanë lënë. Përndryshe, të rrimë e të shohim të heshitur shkatërrimin materialo-shpirtëror të vlerave tona, është një indiferencë e tmerrshme e cila do të përfundojë me humbjen e amanetit. Për mbrojtjen e amaneteve për të cilat janë sakrifikuar shumë jetë, duhet të përpiqemi sot me sa të kemi mundësi, me qëllim që nesër të mos jemi të detyruar të paguajmë përsëri çmime të shtrenjta. Është e vërtetë historike se amanetet që nuk janë ruajtur, kanë humbur dhe nuk janë rikthyer më derisa janë merituar përsëri.

**Zoti ynë na ndihmoftë ne dhe brezat e mëvonshëm në ruajtjen e amaneteve tona të shenjta! Po ashtu, na ruajtë edhe nga rënia në batakun e pavetëdijes në lidhje me këtë çështje dhe na bëftë të gjithëve prej atyre që e kryejnë siç duhet detyrën e tyre në ruajtjen e amaneteve që kanë mbi supe, duke shkuar tek Zoti ynë me zemër të pastër!**

**Amin!**







## MEDITIMI



*Nëse e shohim jetën dhe gjithësinë me syrin e urtësisë për të marrë mësim, do të përballemi me shumë pyetje, përgjigjet e të cilave ndodhen të fshehura në thellësinë e shpirtit tonë:*

*Përse kemi ardhur në këtë botë? Përse jemi krijuar? Çfarë është kjo botë? Në pronën e kujt jetojmë? Si duhet të jetojmë? Si duhet të mendojmë? Për ku udhëtojmë? Cila është e vërteta e jetës së përkohshme? Si zgjidhet enigma e realitetit të vdekjes? Si duhet të përgatitemi për të?..*



*Shpirti që zhvillohet me meditim, e kupton se:*

***“Kibla e trupit në adhurim, është Qabeja, ndërsa kibla e shpirtit në çdo frymë, është Allahu i Madhëruar!”***





# MEDITIMI

Meditimi është një aftësi jetike që nuk i është dhënë vetëm njeriut, por të gjitha krijesave. Çdo krijesë e përdor këtë aftësi brenda botës së vet dhe sipas natyrës së krijimit që ka. Ndërsa përqendrimi i tyre është më tepër në planin trupor dhe material. Pra, çështjet si ngrënia, pirja, jetesa më e mirë e më komode dhe vazhdimësia e llojit, janë në plan të parë. Dhe për këtë arsye, meditimi i një kafshe grabitqare, është e prirë vetëm një kapjen e gjahut dhe mbushjen e barkut. Përveç kësaj, ajo nuk ka asnjë lloj mendimi apo shqetësimi në lidhje me jetën, gjithësinë dhe të ardhmen. Kjo, sepse aftësia e meditimit që i është dhënë është e kufizuar vetëm në këto çështje.

Mirëpo, sa i përket njeriut... Gjendja e tij është plotësisht ndryshe...

## **Meditimi trupor dhe shpirtëror**

Për shkak se biri i njeriut është krijuar si më i nderuari ndër të gjitha krijesat dhe si bebjë e syrit të gjithësisë, edhe përgjegjësitë dhe detyrat e tij janë të mëdha. Dhe në bazë të kësaj, atij i është falur edhe një aftësi e madhe meditimi. Kjo, sepse njeriu nuk është pajisur me vetëdijen dhe dinjitetin njerëzor për shkak të



**meditimit trupor** në aspektin e ngrënies, pirjes, mbijetesës dhe vazhdimësisë së llojit njësoj si krijesat e tjera, por për shkak të **meditimit shpirtëror** që do ta zhvillojë atë dhe, për rrjedhojë, do ta bëjë të fitojë Xhenetin dhe shikimin e bukurisë hyjnore.

Mirëpo, nëse njeriun nuk e evoluon strukturën e tij shpirtërore, për fat të keq ai do ta shkatërrojë aftësinë e tij të meditimit në vorbullën e dëshirave egoiste. Një jetë e tillë indiferente, është vetëm lojë në fëmijëri, epsh në adoleshencë, moskokëçarje në rini dhe mall e pendesë në pleqëri për ato që tashmë kanë shkuar. Pra, është humbje e mirësisë së meditimit të falur nga Allahu i Madhëruar në vorbullën e dëshirave dhe kënaqësive egoiste si ngrënia, pirja dhe mbledhja e pasurisë.

Një mendimtar që ka arritur thellësinë shpirtërore, këtë të vërtetë e ka përmbledhur me këto fjalë:

*“Për të mençurit, kjo botë është soditje meditative e artit hyjnor, ndërsa për të marrët, është vetëm ushqim dhe epsh!”*

Nisur nga kjo, ajo që e bën njeriun njeri, është thellësia e meditimit shpirtëror që do ta bëjë atë të blerojë në atmosferën e vetëdijes. E në fakt, edhe Allahut i madhëruar prej robërve të Vet kërkon shfaqjen e një vetëdijeje dhe kuptimi të lartë, qoftë në besim, e qoftë në adhurime. Dhe kjo është e mundur vetëm në sajë të meditimit rreth manifestimit të fuqisë dhe madhësisë hyjnore.

### Zhvillimi shpirtëror

Thellimi në meditim dhe zhvillimi shpirtëror, është një nga përgjegjësitë më të rëndësishme të njeriut. Kjo, sepse vetëm në sajë të një meditimi që do të zhvillojë shpirtin është e mundur të



fitosh përkushtimin në adhurime, butësinë e zemrës, mirësjelljen në vepra dhe pjekurinë në moral.

E në fakt, nëse arrijmë t'i shohim veprat e fuqisë hyjnore me syrin e urtësisë për të marrë mësim, do të vërejmë tablo të panumërta urtësie. Për shembull, një elefant dhjetëra tonësh mund të tërhiqet nga një fëmijë dhjetëvjeçar... Ndërsa një mundës i fortë mund të përmbysset në shtratin e vdekjes nga një virus i vogël që nuk mund të shihet as me sy... Pra, kush është i fortë, e kush është i dobët? Cili është standardi i forcës dhe dobësisë, i ekzistencës dhe mosekzistencës?

Nëse e shohim jetën dhe gjithësinë me syrin e urtësisë për të marrë mësim, do të përballemi me shumë pyetje, përgjigjet e të cilave ndodhen të fshehura në thellësinë e shpirtit tonë:

Përse kemi ardhur në këtë botë? Përse jemi krijuar? Çfarë është kjo botë? Në pronën e kujt jetojmë? Si duhet të jetojmë? Si duhet të mendojmë? Për ku udhëtojmë? Cila është e vërteta e jetës së përkohshme? Si zgjidhet enigma e realitetit të vdekjes? Si duhet të përgatitemi për të?..

Ja pra, këto lloj meditimesh nën udhëzimin e Kuranit dhe Sunnetit, e bëjnë robin të kuptojë se është shumë i dobët dhe asgjë përballë manifestimeve të fuqisë dhe madhësisë hyjnore. Kjo i kujton njeriut, që është krijuar nga asgjëja, se është gabimi i madh të udhëhiqet nga egoja e tij.

Njeriu është gjithmonë i nevojshëm për Zotin e tij. Të gjitha gjallesat kanë nevojë për një fuqi të madhe për të ekzistuar dhe mbijetuar. Për rrjedhojë, edhe njeriu ka nevojë për të njëjtën fuqi. Mirëpo, të jesh i pavetëdijshëm për këtë, tregon një indiferencë shumë të thellë.

Ndërsa besimtari që arrin një pjekuri të lartë shpirtërore me anë të meditimit, arrin edhe një frymëzim të lartë shpirtëror në devotshmërinë dhe adhurimet e tij.



Shpirti që zhvillohet me meditim, e kupton se:

*“Kibla e trupit në adhurim, është Qabja, ndërsa kibla e shpirtit në çdo frymë, është Allahu i Madhëruar!”*

Kjo është edhe arsyeja që Aliu عليه السلام, ka thënë:

*“Adhurimit pa dije dhe leximit të Kuranit pa meditim, i pakësohet dobia!”*

E në fakt, adhurimet që bëhen me një zemër indiferente ndaj Allahut, e humbasin shkallë-shkallë vlerën e tyre, madje, ndonjëherë nuk janë gjë tjetër veçse një lodhje e kotë.

Për këtë arsye, robërit e dashur të Zotit kanë këshilluar përherë që namazi të falet sikur të ishte namazi i fundit dhe agjërimi të mbahet duke medituuar në vlerën e mirësive dhe vuajtjet e nevojtarëve. Pra, që të gjitha adhurimet të bëhen duke respektuar edhe aspektin e medimit.

Ebu Derda عليه السلام, ka thënë:

*“Një orë meditim, është më e mirë se dyzet net adhurim vullnetar.”* (Dejlemi, II, 70-71, nr: 2397, 2400.)

Një meditim i tillë, i thëllon ndjenjat duke e bërë më të lehtë adhurimin dhe duke shtuar përkushtimin dhe falënderimin.

Adhurimi duhet të jetë i plotë në fe, ashtu siç duhet të jetë edhe besimi. Mirëpo ajo që i bën të pranueshme adhurimet, është që ato të kryhen me një vigjilencë shpirtërore, delikatesë dhe elegancë në atmosferën e një meditim që ndikon thellë në zemër. Në këtë mënyrë, robi bëhet i afërt me Allahun. Cilësia më e rëndësishme e sahabëve fisnikë dhe e besimtarëve të devotshëm që i pasojnë ata me sinqeritet, është pikërisht zotërimi i kësaj pjekurie shpirtërore.

Abdullah ibn Mes'udi عليه السلام, miqve të tij të devotshëm u thoshte:



*“Ju falni më tepër namaz se sahabët dhe luftoni më shumë se ata. Por ata ishin më asket se ju ndaj kësaj bote dhe e dëshironin më shumë botën tjetër!”*

Zoti ynë i madhëruar, prej nesh, robërve të Tij, dëshiron që të meditojmë mbi fuqinë dhe madhështinë hyjnore, enigmat dhe urtësitë e rregullit të përsosur në gjithësi dhe mirësitë që Ai i ka falur robërve të Vet. Dhe, si rrjedhojë e këtij meditimi, të bëhemi robër të mirë e të devotshëm, që me modesti dhe përlulesi kuptojnë përkohshmërinë e kësaj bote dhe realitetin e botës tjetër.

### **Meditimi i të Dërguarit të Allahut ﷺ.**

Jeta shembullore e të Dërguarit të Allahut ﷺ, vë në pah qartësisht se sa i domosdoshëm është meditimi për arritjen e përsosmërisë shpirtërore që Allahu i Madhëruar dëshiron të shoh tek robërit e Vet. Ai e vazhdonte adhurimin e natës me devotshmëri dhe i mbytur në lot, derisa i ënjteshin këmbët, zemrën e kishte gjithmonë të zgjuar, edhe nëse sytë e tij flinin dhe, nuk qëndronte asnjëherë larg përmendjes së Allahut, meditimit dhe vetëkontrollit.

Nëna jonë Aishja ؓ, na transmeton një shembull në lidhje me butësinë e zemrës së Profetit ﷺ dhe horizontin e tij të meditimit:

*“Një natë, i Dërguari i Allahut ﷺ, më tha:*

*«Nëse më lejon, dëshiroj të ngrihem e të adhuroj Zotin tim!»*

*Unë thashë:*

*«Për Allahun, unë dua shumë të jem bashkë me ty, por e dua më shumë atë që të gëzon ty!»*



Më pas u ngrit, mori abdes, qëndroi në namaz dhe qau aq shumë, sa lotët i lagën mjekrën e bekuar, rrobën, e madje edhe vendin ku binte në sexhde. Ai vazhdoi në këtë gjendje derisa u gdhi dhe erdhi Bilali ﷺ, për të thirrur ezanin e sabahut. Kur e pa të Dërguarin e Allahut ﷺ, duke qarë, e pyeti:

«O i Dërguari i Allahut! Përse qani, ndërkohë që juve ju janë falur të gjitha gjynahet e shkuara e të ardhme?» Profeti ﷺ, i tha:

«A të mos jem një rob që e falënderon shumë Zotin e vet? Për Allahun, sonte më zbriti një ajet i tillë, që mjerë ata të cilët e lexojnë dhe nuk meditojnë mbi të!» Më pas, ai këndoi këtë ajet:

**“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për të zotët e mendjes, për ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjor ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës (duke thënë:)** «O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto - lartësuar qofsh (nga çdo e metë)! Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit!»<sup>58</sup> (Ibni Hibban, II, 386; Alusi, Ruhu'l-Meani, IV, 157.)

Ja pra, pikërisht natën kur zbritën këto ajete fisnike, i Dërguari i Allahut ﷺ, qau deri në mëngjes me lot të cilët do t'i kishte zili edhe vesa mbi trëndafil. Ndërsa lotët që do të derdhin besimtarët si rrjedhojë e meditimit të manifestimeve të fuqisë dhe madhësisë hyjnore, me mirësinë e Allahut, do të bëhen stolia e netëve të përkohshme, drita e errësirës së varrit dhe vesa e kopshteve të Xhenetit.

Në të vërtetë, Profeti ﷺ, kishte filluar ta ndiqte jetën e meditimit kur vetmohej për net të tëra në Shpellën Hira, që para se





t'i vinte urdhri hyjnor e të ngarkohej me detyrën e profetësisë. Adhurimi i tij në Hira, kishte formën e meditimit mbi krijimin e qiejve e të tokës dhe soditjes së Qabes.<sup>59</sup>

Njësoj si në ato ditë, edhe më vonë, Profeti ﷺ, ka qenë gjithmonë me karakter melankolik dhe në gjendje meditimi. E folura e tij ishte dhikër, ndërsa heshtja meditim. Lidhur me këtë çështje, Profeti ﷺ, ka thënë:

*“Zoti më ka urdhëruar që heshtja ime të jetë meditim!”*<sup>60</sup>

*“Meditoni mbi krijesat e Allahut!..”* (Dejlemini, II, 56; Hejthem, I, 81.)

*“Nuk ka adhurim si meditimi!”* (Ali el-Muttaki, XVI, 121.)

Ndërsa Ahmed er-Rifai, ka thënë:

*“Meditimi, është puna e parë e Profetit tonë ﷺ. Kjo, sepse adhurimi i tij para çdo farzi, ishte meditimi rreth krijesave dhe mirësive të Allahut. Atëherë, edhe ju kapuni fort mbas meditimit dhe bëheni atë mjet mësim!”*

Shkurtimisht, për të qenë një umet i merituar i Profetit tonë të dashur ﷺ, duhet të jetojmë në atmosferën e meditimit, duke ia kushtuar zemrën urtësive të thella që shfaqen në jetë dhe gjithësi.

## Thellësia e meditimit të një sahabiu të verbër

Sahabët e nderuar, ishin edukuar nën frymëzimin shpirtëror të Profetit ﷺ. Për rrjedhojë, edhe delikatesa e meditimit që kanë

59. shih. Ajni, Umdetu'l-Kari Sherhu Sahihi'l-Buhari, Bejrut, Idaretu't-Tibaati'l-Munirrije, ts, I, 61; XXIV, 128.

60. shih. İbrâhim Canan, Hadis Ansiklopedisi, XVI, 252, hadis no: 5838.



shfaqur ata në lidhje me jetën dhe ndodhitë, ka qenë e jashtëzakonshme. Ja një shembull i këtij fakti:

Kur ishin duke u bërë përgatitjet për fushatën ushtarake të Kadisijes, edhe Abdullah ibn-i Ummi-Mektumi رضي الله عنه, dëshiroi të bëhej pjesë e ushtrisë me një entuziazëm të lartë besimi. Mirëpo, kur iu bë e ditur se ishte përjashtuar nga përgjegjësia e pjesëmarrjes në luftë, ai sahab i madh, u mbyt në hidhërim. Kur meditoi pak mbi gjendjen e tij me horizontin e besimit dhe vetëdijen e devotshmërisë, atyre që i thanë se ishte përjashtuar nga përgjegjësia, -sipas transmetimit- iu përgjigj kështu:

*“Unë mund të jem i dobishëm për ju edhe në këtë gjendje që jam. Për shkak se jam i verbër, nuk i shoh shpatat e armikut dhe mund ta bart flamurin në krye pa u frikësuar aspak. Dhe, kur ushtarët myslimanë të shohin se unë po përparojë pa frikë në drejtim të armiqe, do t’u shtohet edhe më tepër entuziazmi dhe guximi.”*

Gjendja e sahabiut të verbër, Ibn-i Umm-i Mektumit رضي الله عنه, është një këshillë e jashtëzakonshme për ata që shohin dhe janë të shëndetshëm...

### **Leximi me meditim i jetës dhe gjithësisë**

Në gjithësi asgjë nuk është krijuar kot. Çdo atom e shpreh me gjuhën e vet urtësinë dhe qëllimin e krijimit të vet. Dhe meditimi i vërtetë, realizohet atëherë kur këto shprehje lexohen ashtu siç duhet.

Shikimi i krijesave në gjithësi, i jetës dhe i ndodhive vetëm me sytë e ballit, nuk është e mjaftueshme për një mendje të shëndoshë. Ky shikim duhet të realizohet në formën e soditjes me ëndje dhe me syrin e urtësisë për të marrë mësim, duke e



përsosur atë me meditim, që është edhe veprimtaria e përbashkët e mendjes dhe e zemrës. Vetëm në këtë mënyrë manifestimet e fuqisë hyjnore në gjithësi mund t'i japin shpirtit një gjallëri, forcë dhe përsosmëri të veçantë.

Në fakt, asgjë nuk mund ta kënaqë pasionin e meditim të njeriut, më tepër se njohja e ekzistencës së Krijuesit të gjithësisë dhe dashuria për Të. Siç bëhet e ditur edhe në këtë ajet:

**“...Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!”**

(Ra'd, 28.)

Zoti ynë i Madhëruar, çdo gjë dhe çdo ndodhi e krijon për një shkak të caktuar. Ndërsa shkenca merret me studimin e këtyre shkaqeve. Mirëpo, Musebbibu'l-Esbab, pra shkakun e shkaqeve, është Allahu i Madhëruar. Për rrjedhojë, çdolloj shkence dhe ideje që nuk e shpie mendimin e njeriut tek Allahu i Madhëruar, i Cili është edhe krijuesi i shkaqeve, është e mangët dhe nuk është asgjë tjetër veçse lodhje nëpër rrugicat pa krye.

Për të shpëtuar nga lodhja e kotë dhe rrugicat pakrye, pikë-sëpari duhet të kuptojmë me një meditim të mençur urdhrin **“Lexo!”** të Zotit tonë. Më pas, duhet që këtë urdhër ta zbatojmë në ndodhitë e të gjitha fushave e jetës, sepse kjo e çon njeriun tek shkakun e shkaqeve, duke e bërë të arrijë burimin e “urtësisë”. Këtu fillon të piqet mendimi dhe vetëdija. Ndërsa mendja dhe zemra arrijnë të kuptojnë qartë se çfarë synon Allahu i Madhëruar në çdo ndodhi.

Për rrjedhojë, është e domosdoshme që çdo gjë që ndodh në këtë botë të shihet me syrin e urtësisë nga dritarja e besimit dhe shpirti të zhvillohet me meditim. Si rezultat i kësaj, vezullimi i urtësisë në lidhje me qëllimet hyjnore në thelb të çdo ndodhie, me lejen e Allahut do të rrjedhë pikë-pikë në zemër.



## Tasavufi: Mënyra për t'u thelluar me urtësi

Në të vërtetë, edhe thelbi i tasavufit, që ka edukuar shumë personalitete shembullore, përbëhet nga përfitimi i një frymëzimi të tillë shpirtëror. Nga kjo pikëpamje, tasavufi është përparim në rrugën drejt Allahut, duke u thelluar në meditim. Ai nuk është aspak braktisje e kësaj bote. Siç thotë edhe Junus Emre, ai nuk është as mbështjellje me një rrobë dhe angazhim vetëm me lutje e dhikër. Pra, parasëgjithash, tasavufi është meditim në lidhje me përgjegjësitë tona, vetllogari dhe përparim në rrugën e kuptimit dhe mendimit.

Me pak fjalë, tasavuf do të thotë të shpëtolesh prej çdo mendimi egoist, të thellosh vetëm në meditimin shpirtëror dhe në sajë të këtij meditimi, të lartësosh shkallë-shkallë dhe në fund të arrish miraxhin.

Imam Gazaliu -Allahu e mëshiroftë- ka thënë:

*“Nëse dëshiron të bëhesh prej njerëzve të urtë, heshtjen duhet ta kesh meditim, shikimin mësim dhe dëshirën bindje! Këto tre cilësi janë shenjat e të urtëve.”*

Meditimi ka një rol të rëndësishëm edhe në realizimin e pjekurisë shpirtërore në tasavuf, sepse çështja nuk është vetëm të bësh vepra në mënyrë të thatë, por të mund t'ia ofrosh ato Allahut të Madhëruar me një zemër të butë dhe të pastër. Dhe, padyshim se kjo arrihet vetëm nëse zotëron një meditim të vetëdijshëm.

## Meditimi i vdekjes

Ringjallja e zemrës dhe zhvillimi shpirtëror, bëhen të mundura vetëm duke hequr dorë nga egoja.



Duke na mësuar metodën e kësaj, Profeti ﷺ, ka thënë:

*“Kujtojeni shpesh vdekjen, e cila ua asgjëson rrënjësisht të gjitha gëzimet dhe kënaqësitë!”* (Tirmidhi, Kiamet, 26.)

Në fakt, jeta e përkohshme e kësaj bote, është vetëm si një çast i shkurtër në krahasim me jetën e përjetshme të botës tjetër. Prandaj, cila mendje do të preferonte çastin në vend të pafundësisë, ose të çojë dëm lumturinë e përjetshme për hir të kënaqësisë së çastit?

Toka mbi të cilën shkelim dhe ecim, është e mbushur me kufomat e miliarda njerëzve të shndërruar në dhe, të cilët kanë ardhur deri më sot. Miliarda silueta të vendosura njëra mbi tjetrën... Edhe ata hynë nga një derë në këtë botë, e cila është si han me dy porta, ku më pas jetuan jetën e dynjasë që është si një korridor i ngushtë i mbushur me sjellje dhe ndjenja egoiste e shpirtërore dhe, më në fund kaluan përmes derës së varrit e shkuan në botën e përjetshme. Nesër, edhe ne do të jemi në të njëjtën gjendje. Do të vijë një ditë, e cila nuk do të ketë të nesërme! E, ajo është në ditë e panjohur për të gjithë ne!

Ja pra, meditimi i vdekjes, është përkujtimi i shpeshtë i vdekjes pa ardhur ende ajo ditë e panjohur për ne. Ajo është largim nga ekset egoiste dhe përgatitje e vazhdueshme në mënyrë të vetëdijshëm për daljen para Zotit tonë. Qëllimi; është të shpëtoj më veten nga tablotë e frikshme të vdekjes dhe zbukurimi i saj.

Deklarata e Zotit tonë është shumë e qartë:

**“Çdokush do ta shijojë vdekjen dhe në fund të ktheheni tek Ne!”** (Ankebut, 57.)

Shkurtimisht, jeta dhe gjithësia është një shkollë hyjnore ku merret mësim... Dhe, ajo që na takon neve, është të bëhemi nxënës të sinqertë dhe të zellshëm të kësaj shkolle, e jo të biem



në indiferencë, sikur do të qëndrojmë përjetësisht në këtë botë, ku jemi thjesht mysafirë kalimtarë...

Nëse njeriu arrin që në sajë të meditimit të vdekjes të kapërcëjë pengesën e egos dhe të përgatitet për botën tjetër, vdekja do të perceptohet si një kusht i domosdoshëm i takimit me Allahun e Madhëruar, i Cili zotëron madhështi dhe përsosmëri përtej çdo imagjinate. Në këtë mënyrë, ndjenja e vdekjes, e cila në përgjithësi bëhet shkak i drithërimave të ftohta tek njerëzit, do të kthehet në një entuziazëm takimi. Siç shprehet edhe një nga të mëdhenjtë e tasavufit, Mevlana Xhelaeddin Rumi, vdekje të tilla janë thjesht një “*sheb-i arus*”, pra një natë dasme...



Meditimi i vërtetë, është një nga cilësitë për të cilat kemi më tepër nevojë. Kjo, sepse zhvillimi i shpirtit, forcimi i besimit, kryerja e adhurimeve me përkushtim, orientimi i veprave tona në rrugë të drejtë dhe zgjerimi i horizontit të zemrës sonë përtej kësaj bote, varet nga përjetimi në mënyrën e duhur i cilësisë së meditimit.

**Zoti ynë i dhëntë pjekuri vetëdijes dhe mendjes sonë! I faltë zemrave tona frymëzim shpirtëror prej atmosferës së meditimit të Profetit ﷺ, sahabëve të nderuar dhe njerëzve të devotshëm! Po ashtu, Allahu u dhëntë paqen dhe qetësinë e ndjenjave të atyre zemrave dhe mendjeve që gjenden në kthetrat e mendimeve materialiste dhe egoiste! Allahu na e bëftë të mundur dhe na dhëntë sukses në zbatimin në jetën tonë me një meditim të urtë, të urdhrit hyjnor “Lexo!”, duke e shikuar jetën dhe ndodhitë me dritën e besimit dhe syrin e urtësisë!**

**Amin!..**





# VEZULLIME URTËSIE

NGA ATMOSFERA SHPIRTËRORE E RUMIUT



*Miqtë e Allahut nuk bëhen kurrë e shkuar,  
edhe pasi trupat e tyre të përkohshëm hyjnë nën tokë, sepse  
zemrat e besimtarëve të përsosur, nuk asgjësohen duke u kalbur  
nën tokë. Për këtë arsye, edhe veprat që burojnë nga shpirti i tyre  
bëhen të përjetshme. Për rrjedhojë, shumë miq të Allahut, të cilët  
e kanë vazhduar shërbimin e tyre të kësaj bote edhe në botën  
e berzahut, jetojnë ende sot midis nesh dhe na rrëfejnë udhën e  
drejtë. Por edhe pasi të vdesim ne, ata do të vazhdojë të jetojnë  
në zemra me udhëzimet e tyre.*







## VEZULLIME URTËSIE NGA ATMOSFERA SHPIRTËRORE E RUMIUT

Miqtë e Allahut, janë trashëgues të profetëve, të cilët e jetojnë me pasion besimin në Allahun. Ata janë njerëz fatlumë, të cilët i përsosin zemrat e tyre me moral dhe sjellje të bukura, duke u frymëzuar nga Kurani dhe Sunneti. Në të njëjtën kohë, ata janë personalitete shembullore për këdo që nuk ka arritur ta shohë Profetin ﷺ dhe sahabët e tij nderuar.


Miqtë e Allahut nuk bëhen kurrë e shkuar, edhe pasi trupat e tyre të përkohshëm hyjnë nën tokë, sepse zemrat e besimtarëve të përsosur, nuk asgjësohen duke u kalbur nën tokë. Për këtë arsye, edhe veprat që burojnë nga shpirti i tyre bëhen të përjetshme. Për rrjedhojë, shumë miq të Allahut, të cilët e kanë vazhduar shërbimin e tyre të kësaj bote edhe në botën e berzahut, jetojnë ende sot midis nesh dhe na rrëfejnë udhën e drejtë. Por edhe pasi të vdesim ne, ata do të vazhdojnë të jetojnë në zemra me udhëzimet e tyre. Jetëgjatësia e udhëzimeve të tyre, është në bazë të afërsisë së tyre me Allahun dhe i tejkalon epokat dhe viset. Po ashtu, fjalët e tyre të urta që i kanë shqiptuar me sinqeritet dhe veprat shpirtërore që kanë shkruar, janë si letra të dërguara në të ardhmen në adresa të panjohura. Këto letra, arrijnë deri në viset e zbuluara pas (vdekjes së) tyre.



Për shembull, dihet se në kontinentin amerikan, ndër veprat në lidhje me shpirtin njerëzor, të cilat kanë tërhequr më tepër interes, është edhe “Mesnevi”-a i Mevlanës së nderuar. Madje, për nder të 800 vjetorit të ditëlindjes së Mevlanës, viti 2007 u shpall nga UNESCO si viti ndërkombëtar i përkujtimit të Mevlanës, gjë që është një nga zhvillimet më interesante në këtë çështje.

Domethënë, ajo letër udhëzuese që ky mik i madh i Allahut ka shkruar me dashamirësi për njerëzimin shekuj më parë, sot reflektohet dhe ngjall emocione në të gjithë botën. Kjo, sepse Mesnevi-a pasqyron botën e brendshme të njeriut, duke e ndihmuar të njohë veten dhe të zgjidhë problemet e tij shpirtërore. Ajo i sjell paqe dhe qetësi botës shpirtërore të njerëzve që janë shtypur nën presionin e mentalitetit materialist të kohës sonë dhe bëhet shkak i udhëzimit (në rrugë të drejtë).

Allahu i Madhëruar u ka falur mirësi të ndryshme robërve të Tij të dashur. Pra, të dashurit e Allahut, në botën shpirtërore gëzojnë ndjesi të veçanta, si dashuria ndaj Allahut, madhërimi dhe bartja e Tij në zemër. Për rrjedhojë, ata bëhen udhëzues të njerëzimit sipas gradave të ndryshme që zotërojnë.

Disa prej të dashurve të Allahut kanë rënë në luginën e mahnisë përballë madhësisë hyjnore dhe kanë jetuar aske-tizmin e heshtjes, pa folur e pa bërë zë. Në këtë mënyrë, ata e kanë kaluar jetën e tyre të përkohshme brenda poetikës së një heshtjeje shpirtërore. Lidhur me njerëz të tillë, Ibn-i Abbasi , ka thënë:


*“Allahu i Madhëruar ka robër me elokuencë të atillë, sa që dashuria dhe madhërimi ndaj Tij i ka mbështjellë ata në heshtje!”*

Ka edhe një pjesë prej robërve të dashur të Allahut, që



preferojnë të flasin shumë pak. Ashtu si i nderuari Bahaeddin Nakshibendi, ata janë ngarkuar t'u rrëfejnë udhën njerëzve me mendje të shëndoshë përgjithësisht me anë të gjuhës shpirtërore.

Padyshim se vepra më e zgjedhur e të nderuarit Nakshibend, janë personalitetet shpirtërore që ai ka edukuar me metodën e reflektimit të gjendjes në bisedat e tij. Ato personalitete kanë lexuar për shekuj me radhë urtësitë në rreshtat e zemrës së tij, i kanë përçuar ato dhe vazhdojnë t'i përçojnë ende nga zemra në zemër me metodën e bisedave.

Në thelb të metodës së heshtjes, që i nderuari Nakshibendi e ka preferuar më tepër se fjalën, qëndron kjo porosi e Ebu Bekrit , prej frymëzimit shpirtëror të të cilit ai ka përfituar shumë:

*“Mendoje mirë se çfarë thua, kur e thua dhe kujt ia thua!”*

Përkundër kësaj, Allahu i Madhëruar ka nxjerrë edhe robër të tjerë që kanë qenë bilbila të dashurisë hyjnore, si Junus Emre. Po ashtu, dikë tjetër e ka bërë burim shpirtëror prej të cilit gufojnë urtësi si nga zemra, ashtu edhe nga gjuha e tyre, siç është Mevlana i nderuar.

Në mënyrë të veçantë, i nderuari i Mevlana përveç gjuhës shpirtërore, ka gëzuar edhe elokuencën e fjalës. Për këtë arsye, ky njeri i dashuruar pas Allahut, vazhdon prej shekujsh që me penën, fjalën, veprat shpirtërore dhe bisedat frymëzuese, të ringjallë zemrat që kërkojnë të vërtetën dhe janë të etur për Allahun.

I nderuari Mevlana, ka gëzuar mirësinë e elokuencës së fjalës që i ka falur Allahu i Madhëruar. Me anë të kësaj cilësie, ai është në pozitën e zëdhënësit të miqve të Allahut. Pra, dijen, kulturën, mençurinë dhe urtësinë që i ka dhënë Allahu i Madhëruar, e ka pasqyruar me fjalë në sajë të cilësisë së veçantë të të shpre-



hurit dhe të shpjeguarit që i ishte falur. Mirëpo edhe këtë, ai e bënte sipas lejes që ishte dhënë. Nga kjo pikëpamje, nuk duhet pandehur se enigmat dhe urtësitë hyjnore të zotëruara nga i nderuari Mevlana, kanë qenë vetëm aq sa ai ka pasqyruar me fjalë. Kushedi, në thellësitë e botës së zemrës si oqean të atij të dashuruari pas Allahut, mund të ketë edhe shumë perla të çmuara shpirtërore që kanë mbetur të fshehura nga shikimet.

Ashtu si të gjithë miqtë e Allahut, edhe burimi i frymëzimit të Mevlanës së nderuar, ishte padyshim Kurani dhe Sunneti. Këtë të vërtetë, ai ia bën të ditur gjithë botës në një strofë të tillë:

*“Sa të kem jetë, unë jam robi i Kuranit,*

*Unë jam dheu i rrugës së Muhamed Muhtarit ﷺ*

*Nëse dikush, jashtë kësaj (rruge) përcjellë qoftë edhe diçka të vogël prej fjalës sime,*

*Edhe prej atij, edhe prej fjalës së tij do të lëndohem e neveritem!”*

Me këtë deklaratë, Mevlana e prezanton qartë veten si, “robi i Kuranit dhe dheu i rrugës së ndritur të Profetit ﷺ”. Për këtë arsye, me frymëzimin shpirtëror që ka marrë prej Kuranit dhe Sunnetit, ai është bërë një dijetar me burim urtësie që i orienton zemrat në rrugën e drejtë dhe një i urtë që deshifron misteret.

Në një hadith fisnik, i Dërguari i Allahut ﷺ, na bën të ditura këshillat që Lukmani عليه السلام, i ka dhënë birit të tij:

*“Biri im! Qëndro me të diturit dhe përpiku të mos ndahesh prej tyre! Dëgjoji fjalët e të urtëve, sepse Allahu i Madhëruar i ringjall zemrat me dritën e urtësisë, ashtu siç e ringjall tokën me begatinë e shiut.”* (Hejthemi, I, 125.)

Ja edhe shprehjet e urta nga i madhi Mevlana, që janë në formë shpjegimi të kriterëve të Kuranit dhe Sunnetit në lidhje me moralin Islam:



## Edukata në durim dhe tolerancë

Në një ajet fisnik urdhërohet:

**“Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: «Paqe qoftë!»”** (Furkan, 63.)

I frymëzuar nga ky ajet fisnik, Mevlana i nderuar thotë:

*“Përball të paditurit, bëhu i heshtur si libër!”*

*“Bilbilat heshtin kur fillojnë të këndojnë sorrat.”*

*“Dije se, edukatë, do të thotë të durosh dhe të tolerosh paturpësinë e të paturpit.”*

[Durimi ndaj vuajtjeve, i përsos zemrat, sepse durimi është sprovë më e madhe e edukatës në botën e vuajtjeve. Aq, sa ky virtut është edhe kriter i besimit. Lidhur me këtë, i nderuari Mevlana ka thënë:

*“Pyeta mendjen time: «ç’është besimi?» Mendja u përkul tek veshi i zemrës sime dhe i pëshpëriti: «Besimi është edukatë!»”*

Ndërsa shembulli më i mirë i edukatës, është Profeti ﷺ. Sahabët e nderuar, janë shprehur se ai ishte më i turpshëm se një virgjëreshë.]

*“Aroma e këndshme e trëndafililit, ekziston në sajë të durimit të tij ndaj gjembave, sepse gjembi është miku i trëndafililit.”*

[Për zemrat e etura për Allahun, gjithësia është stolitur me njëmijenjë shembuj të heshtur e pafjalë. Trëndafilili e duron gjembin dhe është bërë mbreti i luleve, sepse lumturitë vijnë si rezultat i durimit ndaj vuajtjeve. Durimi ndaj dëshirave të ulëta të egos dhe sprovave të rënda të jetës, janë dera e lumturisë në të dyja botët.



Sëmundjet, fatkeqësitë dhe dëshpërimet, e kthejnë robin nga Zoti i vet dhe përherë e bëjnë të thotë: *“Aman o Zot!”*. Përkundër kësaj, njerëzit që i gjejnë një zgjidhje çdo derti që kanë, ose tregohen moskokëçarës ndaj halleve, e kanë egon të fryrë. Kjo, sepse egoja e njeriut i cili nuk e ka shijuar kurrë dëshpërimin në jetë, kthehet në një “kalë të egër”.

Njerëzit fitojnë forcë në aspektin shpirtëror, sipas pengesave që kapërcejnë. Vështirësitë dhe vuajtjet janë shkaqet më të rëndësishme të zhvillimit në edukimin shpirtëror. Për këtë arsye, edhe Allahu i Madhëruar i ka kaluar më tepër profetët përmes rrethit të vuajtjeve. Po ashtu, edhe biri i njeriut do të merret në llogari sipas mirësive që i janë dhënë. Çfarëdo t'i ketë dhënë Allahu i Madhëruar robit në këtë botë, me atë do ta sprovovë dhe për të do t'i kërkojë llogari.]

Gjithashtu, për njeriun që kërkon paqen, Mevlana shprehet se ai duhet ta kuptojmë mirë ekuilibrin e jetës:

*“Mos shit pasqyra në pazarin e të verbëve dhe mos recito poezi në pazarin e të shurdhëve!”*

[Shenja dalluese e një besimtari, është urtësia dhe largpamësia e tij. Ai e njeh njeriun prej fytyrës dhe gjendjes së tij, dhe flet me të sipas nivelit të tij. Lidhur me këtë, Aliu عليه السلام, ka thënë:

*“Flisni me njerëzit në mënyrën që kuptojnë (pra, sipas nivelit të kuptimit të tyre!)”* (Buhari, IIm, 49.)

Kjo, nuk do të thotë që të flisni me njerëzit aq sa kuptoni vet, por aq sa kupton mendja e tyre. Dhe, për të kuptuar nivelin e kuptimit të njerëzve, kjo shprehje e Mevlanës është një parim i mjaftueshëm:

*“Edukatën e një njeriu e kupton nga mënyra si qesh, ndërsa nivelin mendjes dhe zgjuarsisë nga arsyeja për të cilën qesh!”*]



## Kërkoni shkaqe për t'u afruar tek Allahu!

Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

**“O besimtarë! Frikësojuni Allahut dhe bëhuni me ata që janë të singertë (në fjalë dhe në vepra)!”** (Teube, 119.)

**“O besimtarë! Kini frikë Allahun, përpiquni që t'i afroheni Atij me vepra të mira dhe luftoni në rrugën e Tij për të shpëtuar!”** (Maide, 35.)

Ndërsa Mevlana i nderuar, i cili e merr frymëzimin shpirtëror prej Kuranit, shprehet:

“Njeriu çmohet duke parë se me çfarë merret dhe çfarë kërkon.”

“Të kërkosh diçka aty ku nuk gjendet, do të thotë të mos e kërkosh fare.”

“Mos lëviz pa lëvizur udhërrëfyesi! Kush lëviz pa krye, bëhet bisht!”

“Të bëhesh skllav i një miku të Allahut, është më mirë se të bëhesh kurorë në kokat e mbretërve.”

[Në kohën kur sulltani Javuz Selim Han ishte duke u kthyer nga një fitore e madhe, u frikësua se mos duartrokitjet dhe lavdërimet e njerëzve e bënin të ndihej krenar dhe, për të shprehur domosdoshmërinë e edukimit të egos, tha këtë bejte:

*Padishahu i botës të jesh, grindje e kotë paska qenë,*

*Një veliu po t'i shërbesh, më mirë se çdo gjë paska qenë!..]*

Mevlana i nderuar ka thënë:

“Stofa e urtësisë që humbet zemra, shkon në dorë të njerëzve të zemrës.”



*“Edhe nëse je gur i fortë, madje edhe mermer, po të gjesh një njeri të zemrës, bëhesh një perlë.”*

*“Zogu fluturon vetëm me zogjtë e llojit të vet.”*

*“Kush dëshiron të qëndrojë me Allahun, le të rrijë me miqtë e Tij. Nëse largohesh prej tyre, do të thotë se je i humbur.”*

*“Bëhu mik me njerëzit e mirë, që të shtohet karvani i besnikëve, sepse sa më i madh të jetë ky karvan, aq më lehtë thyhen kusarët në udhë.”*

[Sipas një transmetimi, fjala “*insan/njeri*”, ka të bëjë me fjalën “*uns*”, pra “*familjaritet*”. Kjo shpreh faktin se ai është pajisur me prirjen për të krijuar miqësi dhe familjaritet. Ja pra, këtë prirje, është e detyrueshme ta përdorim për njerëzit e mirë e besnikë, si zbatim i urdhrit të Allahut. Kjo, sepse njeriu gjendet midis dy zjarreve, që janë shejtani dhe egoja, dhe është vazhdimisht nën sulmin e tyre. Imam Shafiu -Allahu e mëshiroftë- ka thënë:

*“Nëse nuk e angazhon veten me të vërtetën, do të të pushtojë e kota.”*

Për këtë arsye, që njeriu të ruajë ndjesinë e devotshmërisë ndaj Allahut dhe nderin e tij, ai duhet të qëndrojë me besimtarë prej të cilëve mund të marrë frymëzim shpirtëror. Njeriu ka gjithmonë nevojë për një udhërrëfyes. Dhe, për arsye të kësaj nevoje, Allahu i Madhëruar, njeriun e parë e ka dërguar edhe si profetin e parë.

Shejh Sadi Shirazi, ndikimin e gjendjeve shpirtërore ndërmjet atyre që krijojnë miqësi e familjaritet, e shpjegon me këtë shembull të bukur:

*“Qeni i As’habi Kehfit / Shokëve të Shpellës, fitoi nder të madh për shkak se ishte bashkë me njerëzit e mirë dhe, fama*





*e tij u përmend në Kuran dhe në histori. Ndërsa bashkëshortet e profetëve Nuh dhe Lut ﷺ, ranë në mohim për shkak se qëndruan bashkë me njerëzit gjynahqarë.”*

Siç shihet, qëndrimi me indiferentët dhe gjynahqarët, bëhet shkak që me kalimin e kohës të afroresh me mënyrën e tyre të mendimit. Kjo afërsi mendore, pas një farë kohe kthehet në afërsi zemre, gjë e cila e çon njeriun drejt shkatërrimit shpirtëror dhe dështimit të përjetshëm.]

### Pastrimi i egos

Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

**“I shpëtuar është ai që pastrohet, që e përmend emrin e Zotit të vet dhe që fal namaz!”** (A’la, 14-15.)

**“Për shpirtin dhe për Atë që e ka përsosur, duke ia bërë të njohur atij të keqen e të mirën! Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë, ndërsa kushdo që e shtyp atë (me punë të këqija), do të dështojë.”** (Shems, 7-10.)

Ndërsa i nderuari Mevlana, i frymëzuar nga këto ajete fisnike, ka thënë:

*“O udhëtar drejt Zotit! Nëse dëshiron të mësosh të vërtetën, dije se as Musai e as faraoni nuk kanë vdekur, por jetojnë të fshehur brenda teje, brenda qenies tënde, duke vazhduar luftën e tyre në fushëbetejën e shpirtit tënd. Kjo është arsyeja përse ti duhet t’i kërkosh brenda vetes tënde këta dy kundërshtarë të përbetuar të njëri-tjetrit!”*

*“Njeriu i ngjan një pylli. Ashtu siç ka në pyll me mijëra derra, ujqër dhe kafshë të mira e të këqija, ashtu edhe tek njeriu gjendet çdolloj bukurie dhe shëmtie.”*



*“Mos u mundo ta ushqesh dhe ta frysh shumë trupin, sepse ai është një kurban që do t’i jepet tokës. Ti, në të vërtetë, mundohu të ushqesh zemrën, sepse ajo do të shkojë në lartësi dhe do të nderohet!”*

*“Shpirtit jepi ushqim shpirtëror dhe shërbeji mendim të pjekur, kuptim të mprehtë dhe mirësi shpirtërore, në mënyrë që të mbërrijë i fortë në vendin ku do të shkojë!”*

*“Nëse ti zhvishesh prej veseve të ulëta dhe egoiste, kur të vdesësh e t’i dorëzohesh Allahut, deti i enigmave do të të bartë mbi krye.”*

*“Asnjë pasqyrë nuk u kthye përsëri në hekur. Asnjë bukë nuk shkoi në shirje dhe u bë përsëri grurë. Asnjë rrush nuk është kthyer në papjekuri. Asnjë frut i pjekur nuk është bërë përsëri e papjekur. Piqu, maturohu dhe shpëto nga kalbja!”*

*“Nëse dëshiron të shpërndash dritë si dita, duhet ta dje-gësh egon që është si nata!”*

[Allahu i Madhëruar, na e ka falur vetëm njëherë mirësinë e jetës dhe ajo nuk përsëritet më (në këtë botë). Për këtë arsye ne duhet ta përdorim me kujdes kapitalin tonë, në atë mënyrë që ajo të na vlejë për të arritur pjekurinë shpirtërore e cila do të na afrojë me Allahun e Madhëruar. Kjo, sepse në jetën e kësaj bote, vetëm njerëzit që arrijnë pjekurinë e duhur shpirtërore kanë më pak humbje dhe firo. Indiferenca që shkakton robërimin ndaj dëshirave të egos duke qenë i privuar nga pjekuria shpirtërore, e bën njeriun fatkeq në të dyja botët, sepse një ego që nuk mbahet nën kontroll me edukim dhe pastrim, i ngjan një kali të egër. Dhe, një kalë i egër, në vend që ta çojë të zotin në vendin e dëshiruar, e hedh atë në humnerë dhe i merr jetën. Mirëpo, nëse një kalë është zbutur dhe stërvitur mirë, e bart të zotin në mënyrë të sigurt edhe në rrugët më të rrezikshme.]



## Lakmia: Kanceri i zemrës

Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

**“...Ata që grumbullojnë ar dhe argjend dhe nuk e shpenzojnë për hir të Allahut, paralajmëroji me dënim të dhembshëm. Do të vijë dita, kur (thesaret e mbledhura) do të digjen në zjarrin e Xhehenemit dhe me to do të damkoset balli, anët dhe shpina e tyre e do t’u thuhet: «Kjo është ajo që keni grumbulluar për veten; pra, shijoni atë që grumbulluat!»”**

(Teube, 34-45.)

Ndërsa i nderuari Mevlana, i frymëzuar nga këto ajete, ka thënë:

*“Sado i pasur qofsh, do hash aq sa mundesh. Nëse enën e zhyt në det, do marrësh aq ujë sa mban ajo, pjesa tjetër mbetet!”*

*“Ka shumë peshq, të cilët janë të sigurt nga çdo gjë brenda në ujë, por për shkak të lakmisë ata bien në grep.”*

*“Çfarë është dynjaja? Dynjaja është indiferencë ndaj Zotit.”*

*“Dynjaja (vendi i sprovaue), është si një magnet (i dëshirave të ulëta), që tërheq të gjithë kashtën. Prej saj shpëton vetëm gruri (pra, besimtari i mençur, bota e brendshme e të cilit është e mbushur me urtësi).”*

*“Kurthi i egos, është pasuria e kësaj bote. Dhe, pasuria e kësaj bote e mashtron atë të cilin e deh. Për këtë arsye ata që i kanë dhënë zemrën kësaj bote, e kanë syrin e zemrës të verbër, sepse ata pinë ujin e kripur dhe të hidhur të kënetës. (Për shkak se nuk e kanë shijuar lumturinë e botës shpirtërore, mjerimin e tyre e pandehin lumturi.)”*



*“Pangopësia dhe lakmia për të zotëruar mirësitë e kësaj bote, e shtyn njeriun të zgjasë dorën në gjërat të cilat nuk ka të drejtë t’i marrë.”*

[Lakmia për pasuritë e dynjasë, është një nga shkaqet më të mëdha të indiferencës. Lakmia e verbon zemrën në çështjet e së vërtetës dhe të kotës, e hallallit dhe haramit, e të drejtës dhe të gabuarës. I nderuari Mevlana me një shembull të veçantë, tregon se si e verbon syrin e zemrës lakmia e kësaj bote:

*“Edhe qeni e ha pa nuhatur një kockë apo një copë bukë që i hidhet.”*

Domethënë, njeriu, të cilit i është verbuar syri prej lakmisë, përballë mirësive të kësaj bote nuk tregon kujdes dhe hezitim qoftë edhe sa një qen. Kaq shkatërrimtare dhe tragjike është lakmia e dynjasë!

Ndërsa i Dërguari i Allahut ﷺ, na e shpreh me këto fjalë dobësinë e madhe që ka njeriu përballë dynjasë:

*“Nëse biri i Ademit do të kishte dy lugina me mall, ai do të kërkonte të tretën. Barkun e birit të Ademit nuk e mbush gjë tjetër përveç dheut.”* (Buhari, Rikak, 10; Muslim, Zekat, 116.)

Në fakt, ata që mposhten nga lakmia e kësaj bote, edhe nëse u jepet e gjithë bota, do të fillojnë të shqetësohen, vallë a mund të marr edhe ndonjë copë tokë në Hënë apo në Mars. Pavarësisht asgjësimit të shumë popujve (të mëhershëm), për fat të keq edhe sot në kohën tonë, lakmitë e shpirtrave të kalbur të botës materialiste nuk kanë të sosur. Kjo pra është tabloja e hidhur e dynjasë së sotme.

Fjalët plot urtësi të sahabiut të nderuar Ebu Dherit ؓ, e përmbledhin shumë bukur mënyrën se si ai i shikon mirësitë e kësaj bote:



“Një mall ka tre ortakë. I pari është i zoti i mallit, pra, ti. I dyti është kaderi (caktimi). Se çfarë do të të sjelli (ai mall), mirësi apo fatkeqësi, nuk të pyet ty. Ndërsa i treti, është trashëgimtari yt. Ai pret me padurim që ti ta vësh kokën në tokë (të vdesësh)! E, pasi të kesh vdekur, ai merr mallin tënd, kurse ti jep llogari për të. Nëse ke mundësi, mos u bëj më i dobëti i këtyre tre ortakëve!

Allahu i Madhëruar urdhëron: **“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni...”**<sup>61</sup>. Ja, kjo deve është pasuria ime që e dua më shumë dhe po e dërgoj (jap sadaka) para vetes (në ahiret që të më presë atje).” (Ebu Nuajm, Hilje, I, 163.)

Shkurtimisht, mirësitë e dynjasë janë amanet hyjnor dhe nuk dihet se deri në ç’kohë njeriu do të ketë të drejtë t’i menaxhojë. Ai mund t’i humbasë ato në çdo moment. Ndërsa kaderi (caktimi hyjnor) është një e panjohur, e mbushur me surpriza dhe nuk dihet se çfarë do të sjellë. Kurse vdekja, e vërteta e paevitueshme, është e lidhur pas një kohe të panjohur në kalendarin e kaderit. Prandaj, për të arritur lumturinë dhe shpëtimin e përhershëm, është e domosdoshme që mirësitë që zotërojmë t’i përdorim në rrugë të Allahut dhe çdo moment të përgatitemi për vdekjen.]



## Dhurimi: Shërimi i zehrës dhe lumturia e të dyja botëve

Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

**“Prandaj jepni prej atyre mirësive që ju kam dhënë Unë,**

61. Al-i Imran, 92.



**para se t'i vijë vdekja ndonjërit, e ai të thotë: «O Zoti im, sikur të më kishe lënë edhe një kohë të shkurtër në jetë, do të kisha dhënë lëmoshë dhe do të bëhesha ndër të mirët!»**

(Munafikun, 10.)

I frymëzuar nga ky ajet fisnik, Mevlana i nderuar ka thënë:

*“Zemrat e mbytura në varfëri e nevojë, i ngjajnë një shtëpie të kapluar nga tymi. Nëse dëshiron që t’ia dëgjosh hallin dhe t’u bësh derman, atëherë hap një dritare nga ku të dal ai tym, në mënyrë që edhe shpirti yt të zbutet e të edukohet!..”*

*“Çfarë ke, çfarë ke fituar? Çfarë perle ke nxjerrë prej fundit të detit? Kjo do të shihet ditën e vdekjes!”*

*“Të shkosh duarbosh për vizitë tek miqtë, është njësoj si të shkosh pa grurë në mulli!”*

*“Pa ardhur exheli (vdekja) e të marrë çfarë është dhënë, duhet të jepen ato që duhen dhënë!”*

[Lidhur me këtë çështje, poeti i njohur Nexhip Fazëll ka një bejte shumë kuptimplote:

*Argjendari i mirë, një tjetër qese qep për vetë!  
Çfarëdo paraje që vlen në varr, atë ndan më vetë!*



Shkurtimisht, të gjitha këto këshilla të urta, janë si uji i jetës për ringjalljen e zemrave tona. Ata që arrijnë t’i çmojnë si duhet këto thesare urtësie dhe t’i zbatojnë në jetën e tyre, duke i bërë kapital të lumturisë së përjetshme, janë besimtarë të përsosur.

**Zoti ynë na e mundësoftë të jetojmë në një atmosferë shpirtërore të etur për urtësi, të familjarizohemi me të vërtetën dhe të lexojmë ashtu siç duhet Kuranin, gjithësinë dhe njeriun, duke zbatuar me përpikëri urdhrin hyjnor “Lexo!”!**

**Amin!**





# RAMAZANI I BEKUAR

## EDUKIMI I NJË JETE SHPIRTËRORE



*Besimi Islam nuk është një rit i veçantë vetëm për muajin e Ramazanit, ose për ditë të caktuara, por një jetë e tërë në devotshmëri.*

*Ramazani është një shkollë devotshmërie, ndërsa bajrami është diploma e tij shpirtërore. Bajrami është një ditë e bekuar dhe manifestimi në këtë botë i ditës së takimit të lumtur, kur besimtarët do të dalin në prezencën hyjnore me suksesin e sprovës së devotshmërisë. Bajrami i vërtetë, është kënaqësia e Allahut ndaj nesh. Për këtë arsye, në mënyrë të veçantë në ato ditë gëzimi duhet të gëzojmë edhe jetimët, të vetmuarit, të varfrit dhe nevojtarët, me qëllim që të arrijmë mëshirën dhe faljen hyjnore.*







# RAMAZANI I BEKUAR

## Edukimi i një jete shpirtërore

Zoti ynë i Madhëruar, në kalendarin e jetës ka caktuar disa sezone të përfitimeve shpirtërore në të cilat gufon mëshira dhe falja hyjnore, me qëllim që robërit e Tij të arrijnë lumturinë e përjetshme. Më i begati i këtyre sezoneve, padyshim që është Ramazani i Bekuar. Kjo, sepse:

- Në këtë muaj të bekuar ka zbritur udhërrëfyesi i së vërtetës, Kurani Fisnik.

- Agjërimi, i cili bëhet shkak i një pjekurie shpirtërore të veçantë, është bërë farz pikërisht për këtë muaj.

- Nata e Kadrit, e cila është më e mirë se njëmijë muaj, ndodhet pikërisht në një nga netët e muajit të Ramazanit.

- Netët e këtij muaji janë begatuar me mirësitë e iftareve, taravive dhe syfyreëve.

- Zemrat e vuajtura që përpëliten nga nevoja dhe mungesa të ndryshme, gëzohen dhe mbushen me shpresë më së shumti me ardhjen e këtij muaji. Kjo, sepse adhurimet si zekati, sadakaja dhe dhurimi, pikërisht në këtë muaj i mbush me gëzim edhe fytyrat e shumë nevojtarëve që e kanë harruar buzëqeshjen.



- Në këtë muaj hapen dyert e lartësive dhe Xheneteve.

- Po ashtu, në këtë muaj mbyllen dyert e Xhehenemit me qëllim që robi të mbrohet prej gjynaheve dhe të heqë dorë prej të këqijave.

- Ndërsa shejtanët lidhen me zinxhirët e besimtarëve të devotshëm.

Pra, Ramazani, i cili i hap besimtarëve dyert e lumturisë së përjetshme, i çel dyert edhe mirëqenies së ummetit.

### Kurani dhe Ramazani

Allahu i Madhëruar urdhëron:

**“Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja). Pra kushdo nga ju që dëshmon këtë muaj, le të agjërojë!..”** (Bekare, 185.)

Në këtë ajet fisnik, pasi bëhet e ditur se Kurani ka zbritur (në qiellin e dynjasë) në Ramazan dhe se është një libër i mbushur me dritën e urtësisë dhe së vërtetës, i cili ndan të vërtetën nga e kota dhe të mirën nga e keqja, urdhëron që ata të cilët e arrijnë këtë muaj të bekuar, ta agjërojnë atë (muaj) nën edukimin e Kuranit Fisnik.

Nga kjo pikëpamje, është e domosdoshme të kuptohet shumë mirë lidhja e ngushtë dhe e thellë midis Kuranit dhe Ramazanit.

Abdullah ibn Abbasi رضي الله عنه, tregon:

“I Dërguari i Allahut صلى الله عليه وسلم, ishte më bujari i njerëzve. Kjo arrinte kulmin gjatë muajit të Ramazanit, kur atij i vinte dhe e takonte Xhibrili جبرئيل عليه السلام. Xhibrili e takonte Profetin صلى الله عليه وسلم, çdo natë gjatë



Ramazanit dhe i mësonte Kuranin. Kështu pra, i Dërguari i Allahut ﷺ, ishte më shpirtmadhi i njerëzve në mirësi, madje edhe më bujar se era e butë (e dërguar nga Allahu me përgëzime për shiun, në gatishmëri e nxitim për të bërë vepra mirësie).” (Buhari, Bed’u’l-Uahj 5, 6, Saum 7; Muslim, Fedail 48, 50.)

Ne duhet ta kuptojmë mirë porosinë shpirtërore që na jep kjo e vërtetë. Prandaj, për të përfituar sa më shumë prej frymëzimit shpirtëror dhe begatisë së Ramazanit, duhet të angazhohemi në mënyrë të veçantë me leximin e Kuranit në këtë muaj.

Në fakt, leximi i Kuranit, që duhet të ketë vendin e vet në njëzetekatërorëshin e besimtarit, duhet të shtohet edhe më tepër në këto ditë të bekuara. Përveç kësaj, ne duhet të hyjmë në atmosferën e tij shpirtërore, të punojmë në bazë të tij dhe të përpiqemi të korrigjojmë mangësitë tona, duke i peshuar sjelljet dhe qëndrimet tona në peshoren e këtyre urdhrave hyjnorë. Kjo, sepse paqja e individit dhe shoqërisë, realizohet duke hyrë në jetën shpirtërore të Kuranit, i cili është një dritë hyjnore që ndriçon botën e brendshme dhe të jashtme të besimtarit. Ai është një udhërrëfyes drejt lumturisë së përjetshme, i cili e çon njeriun tek Allahu duke e udhëzuar me mësim, urtësi dhe histori të ndryshme.

Kurani Fisnik është zëri udhëzues më i bindshëm, i cili e çon drejt paqes dhe qetësisë “udhëtarin e përjetësisë”, i cili është ngushtuar shumë për shkak të mistereve të jetës dhe të ardhmes dhe është tronditur nga problemet e filozofive të ngatërruara.

Po ashtu, asgjë tjetër përveç përmbajtjes së gjerë të Kuranit Fisnik nuk i ngushëllon më tepër ata që janë të mbytur në stres midis baticave dhe zbaticave të jetës së përkohshme dhe nuk i gostit dot me paqen e lumturisë së përjetshme mendjet që kanë ngecur midis dy gurëve të varrit.



## Mundësia e Ramazanit në dhuntinë e jetës

Në Kuranin fisnik, Zoti ynë i Madhëruar betohet në kohën. Ai na kujton se lumi i jetës sonë po rrjedh me vrull dhe jetët tona të përkohshme po konsumohen me shpejtësi të madhe. Po ashtu, Ai na bën të ditur se jeta e kësaj bote ka një afat kohor shumë të shkurtër dhe se jeta e vërtetë, është ajo e botës tjetër. Në këtë mënyrë, Allahu na paralajmëron që të zgjohemi prej indiferencës. Prandaj, besimtari:

- Duhet të meditojë thellë mi vlerën e mirësisë së kohës që i ka falur Allahu dhe duhet të përpiqet ta vlerësojë atë për qëllimet më të mira dhe në mënyrën më të begatshme.

- Duhet të kuptojë drejtë domosdoshmërinë e kalimit të jetës me vepra të mira e të sinqerta.

- Duhet të nxitojë në dua dhe pendesë pa mbaruar afati kohor i jetës.

Duhet menduar se, jeta e kësaj bote e cila përbëhet nga ditë të numëruara i ngjan shumë muajit të Ramazanit, i cili po ashtu edhe ai i ka ditët e numëruara. Nga kjo pikëpamje, është e domosdoshme që Ramazani i bekuar, që është një sezon i fitimeve dhe mirësive të veçanta shpirtërore, të kalohet me kujdes dhe përpikëri të madhe në aspektin shpirtëror.

Nëna jonë Aishja , tregon:

*“I Dërguari i Allahut, gjatë muajit të Ramazanit tregonte një zell të paparë në jetën e tij fetare dhe adhurimeve në krahasim me muajt e tjerë. Në mënyrë të veçantë, në dhjetë ditët e fundit të muajit të Ramazanit ai jepej edhe më shumë pas adhurimeve. Gjatë këtyre dhjetë ditëve, netët i kalonte zgjuar, e zgjonte familjen e tij dhe e kalonin kohën me adhurime.”*

(Buhari, Fadlu Lejleti'l-Kadr, 5; Muslim, Itikaf, 8.)



Ata që i kalojnë ditët dhe netët e muajit Ramazan ashtu siç i ka hije atij, përfitojnë begati të panumërta. Ata që tregohen moskokëçarës ndaj tij do të bien viktima të privimeve të tmerrshme në këtë jetë dhe në jetën tjetër, sepse në një hadith fisnik, Profeti ﷺ, thotë:


*“Mu shfaq Xhebraili dhe më tha: «Larg mëshirës qoftë ai që e mbërrin muajin e Ramazanit dhe nuk i falen gjynahet me këtë rast!..»* (Hakim, IV, 170/7256; Tirmidhi, Deauat, 100/3545.)

### Kapu pas agjërimit...


Çështja mbi të cilën duhet treguar më shumë kujdes dhe puna që duhet kryer siç i ka hije gjatë muajit të Ramazanit, është pa dyshim adhurimi i agjërimit. Agjërimi na kujton se jemi udhëtarë të botës tjetër, të cilëve do t'u merren nga duart mirësitë e përkohshme të kësaj bote.

Edukimi i egos që realizohet në sajë të frymëzimit shpirtëror të Kuranit me privimin nga disa begati të kësaj jete, është njëkohësisht sihariqi i begative të përhershme të Xhenetit.

Një ditë, Ebu Umame , i tha Profetit :

*“O i Dërguar i Allahut! Më këshillo një punë të atillë, për shkak të së cilës Allahu i Madhëruar të më shpërblejë!”* i Dërguari i Allahut , iu përgjigj:

*“Të këshilloj të kapesh pas agjërimit, sepse ai është adhurimi që nuk ka të ngjashëm për nga vlera dhe shpërblimi!”* (Nesai, Sijam, 43.)

Ndërsa në lidhje me vlerën e lartë të syfyreve, Profeti , është shprehur:

*“Bëni syfyre qoftë edhe me një gllënjë ujë!”* (Abdurrezak, Musannef, IV, 227/7599.)



*“Mos e lini pa ngrënë syfyryn, sepse në kohën e syfyrit zbret begatia!”* (Buhari, Saum, 20.)

Agjërimi i Ramazanit është një lloj trajnimi që na mëson se edhe gjërat hallall duhen përdorur në mënyrë të kontrolluar. Në të njëjtën kohë, kjo na mëson se sa shumë dhe me sa përpikëri duhet t’u shmangemi haramëve dhe gjërave të dyshimta.

Abdullah ibn Umer رضي الله عنه, ka thënë:

*“Nëse nuk shmangeni nga haramet dhe gjërat e dyshimta, Allahu nuk do t’jua pranojë adhurimet, edhe nëse dobësoheni e kërruseni duke falur namaz, edhe nëse treteni e bëheni si gozhdë duke agjëruar!”*

Lidhur me aspektin edukativ të agjërimin në çështjen e ruajtjes nga harami dhe gjërat e dyshimta, i nderuari Mevlana shprehet:

*“Agjërimi thotë: «O Allah! Ky njeri as kafshatën e fituar hallall nuk e hëngri, duke iu bindur urdhrin Tënd! As ujë nuk piu kur që i etur. E si mundet ky njeri të zgjas dorë drejt haramit?!”*

Pra, agjërimi është një disiplinim shpirtëror që bën zapt dhe lidh përbindëshin “ego” që ndodhet brenda çdo njeriu, dhe përgatit truallin për shfaqjen e ndjenjave të mëshirës dhe zemërbutësisë që janë të fshehura brenda natyrës njerëzore.

Me të vërtetë, agjërimi është një vetëdije e lartë devotshmërie që na mëson vlerën e begatëve, na shtyn drejt falënderimit dhe mirënjohjes (ndaj Zotit), na mëson të kuptojmë gjendjen e nevojtarëve, zgjon në zemra reflektimet e mëshirës përballë rënkimeve të nevojtarëve që thonë: “kini mëshirë!”, e vendos zemërbutësinë dhe mëshirën mbi të gjitha dashuritë e tjera të përkohshme dhe ngjall ndjenjën e ndihmës ndaj të papërkrahurve dhe të mjerëve.



Po ashtu, agjërimi është një shkollë e bukur edukimi, e cila shuan furtunën e lakmisë dhe pangopësisë në zemra dhe, më në fund të mëson virtytin e durimit.

Aspekti më i rëndësishëm i kësaj shkolle që edukon shpirt-rat nuk ka dyshim se janë një sërë sprovash me të cilat përballet njeriu. Ai arrin t'i afrohet të vërtetës së agjërimit aq sa arrin të përballet pozitivisht me këto sprovave dhe aq sa arrin të kalojë me durim pengesat që i dalin përpara. Për shembull, një nga këto sprova që duhen kaluar me durim, ndërkohë që jemi agjërueshëm, na bëhet e ditur në këtë hadith fisnik:

*“Askush nga ju të mos thotë ndonjë fjalë të pahijshme apo të grindet me kënd ditën që të jetë agjërueshëm. Nëse dikush e fyen apo kërkon të zihet me të, atëherë le t'i thotë: «Sot jam agjërueshëm!»”* (Buhari, Saum, 9.)

Në fakt, grindja dhe debati armiqësor mes njerëzve, janë dy sjellje të qortueshme në çdo kohë. Për më tepër, nëse një besimtar që agjëron përzihet në një vepër të tillë të shëmtuar, kjo e cenon aspektin shpirtëror të agjërimit që mban dhe e çon dëm frymëzimin e atij agjërimi. Qëndrimin që duhet të mbajmë përherë në këto raste, na e mëson Zoti ynë kur thotë:

**“Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: «Paqe qoftë!»”** (Furkan, 63.)

Për këtë arsye, adhurimi i agjërimit duhet të kryhet me një thellësi shpirtërore, duke hequr dorë nga gjërat e kota, me hijeshi dhe përpikëri. Mirëpo, vetëm qëndrimi me stomakun bosh, nuk mund të quhet agjërimit i përkryer. Një agjërimit i pranuar kërkon ruajtjen e të gjitha organeve të trupit nga haramet dhe gjërat e dyshimta dhe vënien nën kontroll të egos.

Skillavi i liruuar i Profetit ﷺ, Ubejdi , rrëfen:



“Dy gra kishin agjëruar. Aty nga koha e drekës erdhi një person i cili tha:

«O Dërguarit të Allahut! Aty janë dy gra që agjërojnë. Pothuajse janë duke vdekur nga etja. (Jepini leje ta prishin agjërimin.)»

I Dërguari i Allahut ﷺ, i ktheu shpinën dhe nuk i dha përgjigje. Personi e përsëriti sërish të njëjtën gjë:

«O Profet i Allahut! Për Zotin, pothuajse janë duke vdekur!»

Profeti ﷺ urdhëroi:

«*Thirri ato!*» Gratë erdhën dhe Profeti ﷺ, kërkoi t'i sillnin një enë. Më pas ai ia dha enën njërës prej grave dhe i tha:

«*Nxirre jashtë atë që ke brenda!*» Gruaja vulli gjak, copëza mishi dhe qelbi aq sa e mbushi gjysmën e enës. Kur Profeti ﷺ, e urdhëroi edhe gruan tjetër të bënte të njëjtën gjë, ajo vulli nga goja gjak dhe mish i freskët. Pas kësaj Profeti ﷺ, tha:

“*Këto gra e përmbajtën veten nga gjërat që Allahu i ka bërë hallall në jetën e përditshme duke mbajtur agjërim. Por, kur erdhi koha ta prishin agjërimin, ato e prishën atë me gjërat që Allahu ua ka ndaluar. Ato u ulën pranë njëra-tjetrës dhe filluan të përgojnë njerëzit.*” (Ahmed, V, 431; Hejthemi, III, 171.)

Domethënë, ashtu siç duhet të kemi kujdes që të mos fusim gjë në gojë ndërkohë që jemi agjërueshëm, në të njëjtën kohë duhet të bëjmë kujdes edhe për çdo fjalë që nxjerrim nga goja. Gjuha jonë nuk duhet të jetë gjemb që ngulet në zemër, por gjuhë që përhap mëshirë. Për të bërë një jetë të vërtetë dhe të mbushur me frymëzim hyjnor gjatë muajit të Ramazanit, duhet të zotërojmë një shpirt të ndjeshëm të mbujtur me urtësitë e Kuranit dhe një fytyrë të qeshur që reflekton fytyrën e vërtetë të mësimëve Islame.





## Sinqeriteti dhe devotshmëria

Ramazani i bekuar, në të njëjtën kohë është edhe edukim me një devotshmëri të mirë. Ata që nuk bëhen robër të Allahut me zemër të sinqertë, pësojnë një fund të keq, duke u bërë robër të robërve, gjë e cila është një turp i madh për dinjitetin dhe nderin njerëzor.

Muhamed Ikbali e shpreh kështu mjerimin e largimit nga Allahu dhe shndërrimin në robër të të tjerëve:

*“Asnjëherë nuk kam parë qoftë edhe një qen, që të përulet para një qeni tjetër!”*

Ja pra, perceptimi dhe ngjallja e Ramazanit ashtu siç i ka hije, varet vetëm nga thellimi në të vërtetën e tevhidit, duke jetuar me vetëdijen e një robërie vetëm ndaj Allahut. Për këtë arsye ne duhet të përpiqemi të ngremë nivelin e jetës sonë shpirtërore veçanërisht gjatë muajit të bekuar të Ramazanit, i cili është një sezon i mbushur me mirësi shpirtërore.

Dhe, monedha e vetme që pranohet në këtë çështje, është “sinqeritetit”, sepse vetëm zemra e pastër, qëllimi i kulluar dhe sinqeriteti e rrisin përsosmërinë e adhurimeve. Prej adhurimeve ku përzihen interesat personale dhe qëllime të tjera jashtë kënaqësisë së Allahut, nuk mund të shpresohet asnjë e mirë. Në një hadith fisnik thuhet:

*“Sa e sa agjërues nuk përfitojnë gjë nga agjërimi i tyre përveç qëndrimit me barkun bosh. Sa e sa besimtar që i kalojnë netët duke falur namaz, nuk përfitojnë gjë nga namazet e tyre përveçse pagjumësisë.”* (Ibn Maxhe, Sijam, 21.)

Kjo, sepse veprat që nuk të shpilen tek kënaqësia e Allahut dhe nuk shndërrohen në kapital të lumturisë së ahiretit vënë në rrezik ardhmërinë e përjetshme. Ndërkohë, të nisësh udhës për



në botën tjetër pa furnizim (shpirtëror) të çon në humbje dhe shkatërrimin të madh. Adhurimet që nuk kryhen me singëritet dhe përkushtim, e lënë njeriun duarbosh në botën tjetër. Ndërsa adhurimet gjatë muajit të Ramazanit, që është një sezon përfitimesh (shpirtërore), nuk duhet të bëhen vetëm për shkak të zakonit apo traditës së posaçme për këtë muaj, por duhet të kryhen me vetëdijen e një devotshmërie të singërtë ndaj Zotit. Në të kundërt, adhurimet e humbasin frymëzimin e tyre shpirtëror; agjërimi që mbajmë nuk shkon përtej një pehri, ndërsa namazet e teravive të falura me shpejtësi, nuk e vlejnë më shumë se një veprim për tretjen e ushqimit.

Mirëpo, ndaj adhurimeve duhet të tregohet një kujdes edhe më i madh, sidomos gjatë këtyre ditëve dhe netëve të mbushura me frymëzim shpirtëror. Namazet duhet t'i falim sikur jemi në një takim të veçantë me Allahun. Dhe, një namaz i falur me kuptimin e tij të vërtetë, kërkon që robi të pranojë mangësitë dhe dobësitë e veta dhe që të gjitha nevojat dhe kërkesat materiale e shpirtërore t'ia paraqesë Allahut të Madhëruar.

Po ashtu, edhe falja e namazit me xhemat nga meshkujt, është një porosi e rëndësishme e të Dërguarit të Allahut ﷺ, me qëllim që namazi të jetë i plotë dhe i pranuar. Kjo, sepse thellësia e ndjenjave të besimtarëve shtohen edhe më tepër kur janë në xhemat. E në fakt, edhe lutja në suren Fatiha, të cilën e përsërisim gjithmonë; **“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë!”**, nxit ndjenjën dhe vetëdijen e xhematit tek besimtarët.

Ndërsa duaja/lutja, e cila përbën edhe thelbin e adhurimeve, nënkupton strehimin e robit tek Zoti i vet duke u zhveshur nga egoja. Ajo është lidhja më e rëndësishme shpirtërore midis Allahut dhe robit. Ata që e këpusin këtë lidhje, humbasin edhe vlerën e tyre tek Zoti. Lidhur me këtë, në një ajet fisnik urdhërohet:



**“Thuaj: «Zoti im nuk do t’ju përfillte, sikur të mos ishte lutja juaj!..»”** (Furkan, 77.)

Nga ana tjetër, edhe syfyret janë një kohë edukimi shpirtëror që në një farë mënyre i bën besimtarët të përfitojnë prej frymëzimit shpirtëror të kohës para agimit. E në fakt, kohët para agimit, janë çaste të një ftese të veçantë të Allahut të Madhëruar drejtuar robërve të Vet. Prandaj, robi duhet ta konsiderojë si mirësi këtë ftesë të ardhur prej Zotit të vet dhe duhet ta presë me falënderim të madh. Në një ajet fisnik, këta robër përmenden me këto fjalë:

**“Ata që kërkojnë falje (për gjynahet) para agimit.”** (Al-i Imran, 17.)

Kohët para agimit, të cilat vlerësohen si mirësi nga të dashurit e Allahut, janë çaste kur duatë dhe përgjërimit janë më të pranueshme. Lidhur me këtë, Muhamed Ikbali shprehet:

*“Jashtë kupës së qiellit që mbulon botën, gjeta një rrugë, prej së cilës përgjërimi i njerëzve që thonë, «Ah!..» në kohën para agimit, fluturon tek Allahu edhe më shpejt se mendimi, duke përparuar drejt takimit.”*

Adhurimet dhe lutjet në kohën para agimit, i hapin zemrës horizonte misteresh dhe urtësish të veçanta. Lidhur me këtë, i nderuari Mevlana ka thënë:

*“Zgjohu netëve dhe ec drejt Zotit, sepse nata të rrëfen rrugën drejt vendit të mistereve. Ndërkohë që gjithkush fle, misteret e dashurisë hyjnore dhe kënaqësitë shpirtërore bien si shi i begatshëm në zemrën tënde, sepse netëve hapen dritaret e shpirtit dhe prej së përtejmes vijnë mirësi. Mirëpo, këto gjendje fshihen prej syve të të huajve.”*

Gjithashtu, në këtë muaj të bekuar duhet të shtohet edhe



përmendja e Allahut (dhikri), duke pastruar shpirtërisht edhe frymëmarrjet tona.

Domethënë, për të përfituar ashtu siç duhet nga muaji i Ramazanit, fillimi i të cilit është mëshirë, mesi falje gabimesh dhe fundi shkak për shpëtimin nga Xhehenemi, është e domosdoshme që adhurimet t'i kryejmë me sinqeritet e zemër të pastër dhe t'i shtojmë ato sa më shumë të mundemi. Kjo, sepse veprat që kryhen gjatë këtij sezoni të përfitimeve shpirtërore, mund të jenë furnizimi ynë më i vyer për udhëtimin tonë drejt botës tjetër. Në një hadith fisnik, Profeti ﷺ, na ka bërë të ditur se adhurimet do të jenë shoqëruesit tanë në varr:

*“Kur besimtari vdes, namazi do t'i rrijë mbi kokë, zekati në të djathtë, ndërsa agjërimi në të majtë.”* (Hejthemi, III, 51.)

Ndërsa Omer ibn Abdulazizi -Allahu e mëshiroftë- ka thënë:

*“Përgatituni për udhëtim (përtej vdekjes) ashtu si dëshironi që të jetë ai!”*


## Nata e Kadrit


Nata e Kadrit, është një prej thesareve shpirtërore më të pasura që ndër të gjithë ummetet e tjera, Allahu i Madhëruar ia ka dhuruar si një mirësi të veçantë vetëm ummetit të Muhamedit ﷺ. Madhështia, vlera dhe rëndësia e tij na është bërë e ditur në ajete dhe hadithe të ndryshme:

**“Ne e kemi zbritur (Kuranin) në Natën e Kadrit. E kush mund të ta shpjegojë ty se ç’është nata e Kadrit? Nata e Kadrit është më e mirë se njëmijë muaj. Melekët dhe Shpirti (Xhebraili), me lejen e Zotit të tyre, zbresin në këtë natë, me të gjitha vendimet. Paqe është ajo deri në lindjen e agimit.”**

(Kadr, 1-5.)



Nata e kadrit, është një natë e ndriçuar me zbritjen e Kuranit dhe e frymëzuar në mënyrë shpirtërore nga zbritja mbi Tokë e Xhebrailit  dhe melekëve të tjerë. Kjo është një natë dhuntish hyjnore më e vlefshme se njëmijë muaj, e mbushur me frymëzime dhe begati, ku zemrat e besimtarëve përshëndeten me selam nga melekët dhe ku shpërndahet paqja dhe falja për ata që i drejtohen Zotit të tyre me lutje dhe pendesë.

Për shkak të këtij virtyti të veçantë të Natës së Kadrit, i Dërguari i Allahut , e ka kërkuar atë natë midis netëve të Ramazanit dhe ka urdhëruar edhe ummetin e tij për të njëjtë gjë.

Fakti që koha e saktë e Natës së Kadrit, që është më e vlefshme se tetëdhjetetë vite, nuk është bërë e ditur, ka po ashtu një urtësi më vete. Sipas atyre që na bëhen të ditura në hadithet fisnike, Nata e Kadrit duhet të kërkohet në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit në netët teke dhe sidomos në natën e njëzeteshtatë.

## Bajrami

Ditët dhe netët e bajramit janë po ashtu të mbushura me manifestime të ndritshme që mund t'i perceptojnë vetëm shpirtrat dhe zemrat me ndjeshmëri të lartë. Në një hadith fisnik thuhet:

*“Zemra e atyre që i gjallërojnë me adhurim netët e bajramit të Ramazanit dhe të Kurbanit duke shpresuar shpërblimin prej Allahut, nuk do të vdesë -ditën kur të gjitha zemrat do të vdesin-.”* (Ibn-i Maxhe, Sijam, 68.)

Ramazani është një shkollë devotshmërie, ndërsa bajrami është diploma e tij shpirtërore. Bajrami është një ditë e bekuar dhe manifestimi në këtë botë i ditës së takimit të lumtur, kur besimtarët do të dalin në prezencën hyjnore me suksesin e spro-vës së devotshmërisë.



Bajrami i vërtetë, është kënaqësia e Allahut ndaj nesh. Për këtë arsye, në mënyrë të veçantë, në ato ditë gëzimi duhet të gëzojmë edhe jetimët, të vetmuarit, të varfrit dhe nevojtarët, me qëllim që të arrijmë mëshirën dhe faljen hyjnore. Në një hadith fisnik thuhet:

*“Mëshironi ata që janë mbi tokë, që t’ju mëshirojnë ata që janë në qiell!”* (Ebu Daud, Edeb, 58.)

Nuk duhet harruar se, bajramet asnjëherë nuk janë ditë lumturie individuale si pushime dhe argëtimet. Njeriu nuk mund të gëzojë bajramin i vetëm. Pra, ashtu siç nuk mund të imagjinohet një bajram për një tek person, ashtu nuk mund të mendohet as edhe një bajram i posaçëm vetëm për lumturinë e një personi apo një familjeje. Përkundrazi, bajramet janë ditë adhurimesh gjithëpërfshirëse në rang social, që shërbejnë për vizitat ndër të afërmit, përkujtimin me lutje të të parëve, gjallërimin e vëllazërisë Islame në planin shoqëror dhe kryerjen e shumë përgjegjësive të tjera.

Shkurtimisht, Ramazani është edukimi i një jete shpirtërore. Besimi Islam nuk është një rit i veçantë vetëm për muajin e Ramazanit ose për ditë të caktuara, por një jetë e tërë në devotshmëri.

Prandaj, ashtu siç e ka nderuar Zoti ynë gjithë vitin me muajin e Ramazanit, ashtu edhe ne duhet ta perceptojmë dhe ringjallim jetën tonë me hijeshi, elegancë dhe ndjesi të lartë, duke shpresuar në frymëzimin dhe begatinë e Ramazanit. Dhe për këtë, nuk duhet t’i harrojmë asnjëherë kujtimet shpirtërore që kemi kaluar nën edukimin e Ramazanit. Sado e gjatë të duket jeta në këtë botë, në krahasim me jetën e botës tjetër, ajo është edhe më e shkurtër se sezoni njëmuor i Ramazanit.



**sinqerta që kemi bërë dhe do të bëjmë! Allahu na e bëftë të mundur që muajt e Ramazanit që kemi përjetuar, t'i zgjasim deri në ardhjen e Ramazanit të vitit tjetër me qëllime të sinqerta dhe devotshmëri, në mënyrë që të kalojmë një jetë të tërë në frymëzimin shpirtëror të muajit të Ramazanit!**

**Amin...**









# SHPËRDORIMI NË BESIM DHE IBADET

- 1 -



*Shpërdorimi përfshin çdo gjë  
ku kalohen caqet. Dalja jashtë kufijve  
që ka vendosur Allahu është shpërdorim. Shpenzimi i  
mirësisë pa kriter është humbje.*





# SHPËRDORIMI NË BESIM DHE IBADET - 1

Të gjitha mirësitë e dhëna njeriut, si të dhuruarat ashtu edhe ato që i fiton me mundin dhe djersën e vet, janë një dhunti e Zotit pasi është vetë Zoti që i krijon ato dhe i jep forcë njeriut për t'i fituar ato, si nevoja kryesore për të. Nisur nga kjo, njeriu nuk duhet të harrojë se mirësitë janë dhunti e Allahut. Ai duhet të jetojë me vetëdijen se këto janë çështje për të cilat nesër do të japë llogari. Në një ajet Kuranor thuhet:

**“Ai ka vënë në shërbimin tuaj çka gjendet në qiej dhe në Tokë, të gjitha janë prej Tij. Me të vërtetë, në këto ka shenja për njerëzit që mendojnë.”** (Xhathije, 13)

Por kjo nuk do të thotë në asjë mënyrë që ne na lind e drejta e përdorimit pakriter e gjithë mirësive që n aka ofruar Krijuesi i gjithësisë. Në një ajet tjetër kuranor thuhet: **“Vallë, a mendon njeriu se do të mbetet pa përgjegjshmëri?”** (Kijame, 36)

Pra ndërsa përdorim mirësitë që na ka dhuruar Allahu jemi të detyruar të marrim në konsideratë kriteret hyjnore, me ndalesat dhe urdhëresat e saj. Nuk duhet të harrojmë asnjëherë që për çdo veprim të lejuar ka llogari dhe për çdo veprim të ndaluar ka dënim. Ndërsa distancohemi nga haramet duhet të kemi po



aq kujdes mos të biem në një haram tjetër duke shpërdoruar gjërat e lejuara. Sepse tejkalimi i kufijve, shpërdorimi pakriter i mirësive të Allahut është një mungesë e theksuar mosmirënjohje ndaj këtyre mirësive.

Termi shpërdorim megjithëse përdoret në kuptimin e përdorimit me tepri deri në keqpërdorim i të mirave materiale, ai në një kuptim më të gjërë shpreh përdorimin me tepri dhe mbi masën e lejuar të çdo gjëje qoftë kjo një e mirë materiale apo shpirtërore. Çdo tejkalim i kufijve hyjnor është shpërdorim. Dhe shpërdorimi i mirsisë sjell me vete humbjen. **Ijasi** thotë:

“Çdo tejkalim përveç urdhëresave të Allahut është shpërdorim.”

Njeri për shkak të egos është i prirur t'i justifikojë gabimet e veta. Madje edhe kriminelët më të mëdhenjë që kanë bërë krime të mëdha përpiqen t'i përligjin krimet e tyre me gjithëfare lloj arsyesh. Kur këta veprojnë në këtë mënyrë, imagjēno sa komod dhe rahat ndjehen shpërdoruesit. Për më tepër këta nuk arrijnë ta kuptojnë gjendjen e rëndë në të cilën ndodhen edhe për shkakun se e konsiderojnë shpenzimin si një mirësi. Prandaj është shumë e rëndësishme që të jemi të kujdesshëm dhe vigjilent ndaj shpërdorimit. Sipas fesë Islame ashtu siç është e ndaluar keqpërdorimi i mirësive materiale është e ndaluar edhe teprimi pa kriter i mirësive shpirtërore si imani, besimi, idadeti, dituria, koha dhe mendja. Madje këto janë këto janë konsideruar si një humbje e madhe sepse këto bëhen shkak për të humbur lumturinë në botën tjetër. Islami na mëson që të jemi mesatar në të gjithë aspektet e jetës duke filluar ne nevojat e përtitshme si ushqimi dhe veshmbathjet dhe duke përfunduar tek vlerat shpirtërore. Prandaj besimtari është i detyruar të rrespektojë këtë parim bazë të fesë Islame, ai duhet të bëjë një jetë midis dy pikave të baraslarguara.



Tani do të përmendim një pjesë të shpërdorimit i cili sjell fatkeqësi të mëdha në këtë botë dhe botën tjetër si dhe mënyrën për t'u mbrojtur nga ky lloj shërdorimi.

a. Shpërdorimi në besim dhe iman.

Ky është lloji më i rrezikshëm i shpërdorimit. Ky lloj shpërdorimi konsiston në devijimin e mendjes dhe zemrës nga natyrë e pastër dhe zhytjen e tyre në rryma filozofike, besëtytni dhe legjenda të kota. Ky lloj shpërdorimi sjell me vete humbjen e lumumturisë së përjetshme.

Dobësimi i imanit është një fatëkeqësi që vjen si pasojë e shoqërimit me njerëz të shturur. Allahu duke dashut të na tërheqë vëmendjen për të mos rënë në një gjendje të tillë, thotë në Kuran:

**“Kur t’i shohësh ata të nënçmojnë shpalljet Tona, largohu prej tyre, derisa të kalojnë në bisedë tjetër! E, nëse djalli të bën të harrosh, sapo të përmendesh, mos rri me keqbërësit!”** (En’am,68)

Sepse shoqërimi me njerëz të shturur me kalimin e kohës sjell afrimetet shpirtëror i cili nga ana e vet sjell dobësim të imanit dhe si përfundim dështim në jetën e përjetshme. Shkaqet kryesore të shpërdorimit të imanit në ajetin kuranor shprehen kështu:

**“Në kopshtet e Xhenetit pyesin njëri-tjetrin për keqbërësit: “Çfarë ju ka sjellë në Sekar?” Ata do të përgjigjen: “Nuk ishim nga ata që falnin namaz dhe as prej atyre që i ushqenin të varfrit, Ne lëshoheshim në biseda të kota me llafazanët dhe mohonim Ditën e Llogarisë.”** (Muddethir, 40-46)

**“Kurse rrugën për të mos rënë në këtë gjendje Allahu e shpreh kështu: “O besimtarë! Frikësojuni Allahut dhe bëhuni me ata që janë të singertë (në fjalë dhe në vepra)!”** (Mudethir,40-46)



Kurse në një ajet tjetër në tregon domosdoshmërinë e reflektimit dhe meditimit mbi ajetet Kuranor.

**“Edhe ata, që, kur paralajmërohen nga shpalljet e Zotit të tyre, nuk bëhen as të shurdhër, as të verbër.”** (Furkan,73)

Përdorimi i pasurive shpirtërore jasht qëllimit të tyre dhe indiferenca ndaj ajetëve kuranore është një lloj shpërdorimi i rëndë. Ajeti Kuranor e shpreh kështu përfundimin e dhimbshëm të shpërdoruesve:

**“Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë atë që e tepron me të këqija dhe është gënjeshtar.”** (Gafir,28)

Një nga devijimet më të thekësuar në besim është edhe lutja për plotësimin e nevojës nga të vdekurit. E duhura është medimit mbi veprat e tyre të mira dhe kërkimi nga Allahu për plotësimin e nevojave.

Po ashtu kërkimi i ndërmjetësimit pa kushte nga një njeri i mirë është devijim nga besimi i drejtë. Sepse Kurani thekson: **“Atë ditë kur Rrahmani të japë leje për shefat...”** (Taha, 109)

Pretendimi se njerëzit e mirë dinë gjithçka dhe mendimi se ata mund të lezojnë mendimet e njerëzve është i gabuar. Ata mund të dinë aq sa i tregon Allahu. As Profetët nuk dinë më tepër se sa i ka treguar Allahu.

Profeti ﷺ disa pyetjeve i është përgjigjur *“Pyetësi në lidhje me këtë temë është më i ditur se i pyeturi.*

Në rastin e ngjarjes së Ifkut Profeti ﷺ nuk e dinte të vërtetën deri sa erdhi shpallja pas një muaj.

Po ashtu edhe për tre personat që nuk morën pjesë në betejën e Tebukut duke paraqitur pretekse dhe arsye të paqena shpallja në lidhje me ta ka zbritur 50 ditë me vonesë.



Muadh ibn Osman ndërroi jetë në shtëpinë e një gruaje me emrin Ummul Ala. Kja grua tha: Dëshmoj për ty o Osman se Allahu po të shpërblet tani.

Profeti ndërhyri duke thënë:

Nga e di që Allahu është duke e shpërblyer?

Gruaja tha nuk e di.

Atëherë Profeti ﷺ tha:

Osmani vdiq. Unë personalisht shpresoj të shpërblehet nga Allahu. Por unë megjithëse jam një Profet nuk e di se çfarë do të ndodhë.

Ummul Ala pas kësaj thoshte asnjëherë pas kësaj ngjarje nuk folë më për njeri.

Në ajetin kuranoir thuhet

**Thuaju: “Unë nuk jam i pari i dërguar dhe nuk e di çfarë do të ndodhë me mua ose me ju. Unë ndjek vetëm atë që më është shpallur dhe kam për detyrë vetëm të jap paralajmërime të qarta”.** (Ahkaf, 9)

Një person i thotë Jakubit عليه السلام:

Si ka mundësi që e ndjeve aromën e këmishës së Jusufit ndërsa po vinte nga Egjippti dhe nuk arrite të ndjeshë kurthin e vëllezërve të tij dhe hedhjen në pus këtu para syve.

Jakubi عليه السلام i thotë:

Informacioni i jonë është i varuar nga shpallja hyjnore pra ndaj nga njëherë e shikojmë përmes syrit të zemrës në largësi të mëdha nga njëherë nga bllokohet shikimi për gjëra shumë pranë nesh.

Po ashtu komplimentet dhe lëvdimet pa arsye që i bëjnë



njerëzit njëri tjetrit është një lloj shpërdorimi. Profeti ﷺ në lidhje me këtë thotë:

*Nëse ju duhet të lëvdoni dikën dhe nëse ai i ka ato cilës të lëvdueshme të thotë filanin e njoh kështu, Allahu është i mjaftueshmë për të, unë nuk jap siguri për asnjë por mendoj se është kështu. (Buhari, Shehadet, 16)*

Përsosja e imanit arrihet përmes një mendje të përforcuar me shpallje kurse përsosja e mendjes është e varur nga pjekuria e besimit dhe botës shpirtëore. Mendimet dhe idetë e privuara nga drita hyjnore, të mbushura me besëtytni dhe legjenda janë si kandili pa vaj apo si llampa pa energji. Një mendje e jashtë kontrollit të shpalljes një ditë do të shkatërrohet.

## b. Shpërdorimi në ibadet

Ruajtja e ekuilibrit dhe matura në të gjitha çështjet përfshirë këtu edhe adhurimet është prej urdhëresave themelore të fesë Islame. Madje feja Islam kërkon që këtë ta shndërrojmë në pjesë të moralit tonë këtë parim bazë sepse nëse bëhet pjesë e sjelljes dhe moralit të tij ajo ashtu vazhdon deri në vdekje.

Një nga shpërdorimet më të shpeshta që ndodh në ibadete është shpenzimi i tepërt i ujit gjatë marrjes së abdesit apo gusulit.

*Një ditë kur Profeti ﷺ pa Sa'din duke marrë abdest i tha:*

*Ç'është ky shpnezim o Sa'd*

*Edhe përdorimi i tij për adbest konsiderohet shpenzim? pyeti Sa'di.*

*Po tha Profeti ﷺ madje edhe nëse je breg të një lumi.*

(Ibn Maxhe, Tahare, 48)





Mos falja e namazit me xhemat apo kryerja e tij larg një atmosphere shpirtëore është prel llojit të shpërdorimit në ibadet. Në lidhje me personin që e fal namazin larg atmosferës shpirtërore Allahu thotë në Kuran: **“Të mjerët ata që falin namaz të cilët nuk e marrin seriozisht namazin e tyre.”** (Maun,4-5)

Kurse Profeti ﷺ në lidhje me të njëjtën çështje thotë

*“Një person fal namazin por i shkruhet gjysma, një e treta, një e katërta, një e pesta, një e gjashta, një e shtata një e teta, një e nënta madje edhe një e dhjetta.* (Ebu Davud, Salat, 123.)

Allahu kërkon prej nesh të kryejmë një ibadet ku të jetë e pranishme zemra dhe shpirti. **“Bjerë në sexhde dhe afrohu.”** (Alak, 19) përmes kësaj urdhëresë kërkohet që ndërsa biem në sexhde ajo të shoqërohet me përqëndrim, përkushtim, lutje dhe prani shpirtërore. Sepse ajo që e bën njeriun një besimtar të përsosur unifikimi i veprimtarisë së mendjes dhe zemrës.

Në lidhje me ata që e falin namazin sic duhet Allahu në Kuran thotë:

**“Me të vërtetë, janë të shpëtuar besimtarët, të cilët janë të përgjithshëm në namazin e tyre.”** (Muminun, 1-2)

Dëmtimi i agjërimit i cili është një nga pesë shtyllat e Islamit me gënjeshtria, thashetheme dhe pëgojim është një tjetër lloj shpërdorimi i madh.

Në lidhje me këtë Profeti ﷺ thotë:

*Kush nuk braktis gënjeshtrenë Allahu nuk i jep asnjë vlerë sepse ai qëndron pa ngrënë dhe pa pirë.”* (Buhari, Saum, 8, Edeb, 51)

Agjërimi duhet të na bëjë ne të kuptojmë dhe vlerësojmë si duhet mirësitë e Allahut. Qëndrimi për një kohë të caktuar pa ngrënë duhet të na nxisë të kuptojmë sa të dobët jemi, agjërimi në të njëjtën kohë na ndihmon të kuptojmë gjendjen e vëllezërve



tanë të cilët nuk kanë mundësi ekonomike kurse kjo nga ana e saj duhet të na nxitë më tepër për bamirësi ndaj të varfërve. Në lidhje me këtë ajeti kuranor thotë:

**“A nuk e dinë ata se Allahu është Ai që pranon pendimin dhe bamirësinë nga robërit e Vet...”** (Teube 104)

Agjërimi në muajin e Ramazanit nga fillimi deri në fund është një muaj adhurime i mbushur me mëshirë, dhembshuri, bamirësi, pendim dhe falje. Profeti ﷺ na ka urdhëruar ta vlerësojme në mënyrë sa më të begatë muajin e Ramazanit pa e shpërdoruar atë.

Muaji i Ramazani gjatë natës duhet të shoqërohet me tehxhud, dhikër, meditim dhe lexim Kurani kurse ditën duhet të kryhen adhurime, bamirësi dhe vepra të mira, në kohën e iftarit duhet të përqëndrohet në pendim, falje dhe lutje kurse mbrëmjen duhet ta kalojë duke falur siç duhet namazin e Teravive. Mos vlerësimi siç duhet i muajit të Ramazanit sjell privimin nga shumë mirësi, kjo nuk është gjë tjetër veçse një shpërdorim i këtij muaj të begatë.

Nga ana tjetër mos respektimi i të drejtave të tjetrit, marrja me vepra të papëlqyeshme si përgojimi, thashethemet dhe fitimi në rrugë jo të pastra përbën shpërdorimin e ibadetit të Haxhit.

Profeti ﷺ thotë: Kush shkon në haxh me para të fituara haram kur të thotë Lebejk do t'i thuhet: *“Për ty nuk ka as lebejk as sadejk. Sepse fitimi jot është haram, ushqimi është haram, kafsha me të cilën udhëton është haram. Kthehu si gjynahar pa marrë asnjë shpërblim. Shqetësohu për përbaljen me gjëra që nuk i dëshiron.”* (Hejthemi, III, 209-210)

Shpërdorimi i zekatit dhe sadakasë konsiston në përmendjen e vazhdushme të mirësisë së bërë, në syfaqësinë dhe vetëmburrjnie e treguar për një të mirë që ke bërë. Allahu thotë në Kuran:



**“Fjala e mirë dhe falja e gabimit janë më të vlefshme se lëmosha që përcillet me fyerje. Allahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Butë. O besimtarë! Mos i çoni dëm lëmoshat tuaja duke ua kujtuar ato (atyre që ua keni dhënë) dhe duke fyer, siç vepëron ai që e shpenzon pasurinë e vet për sy e faqe të botës dhe nuk beson në Allahun dhe Ditën e Fundit.”** (Bekare,263-264)

Besimtari duhet të bëjë përpjekje për t’ia dhënë zekatin atij që e meriton. Allahu i lëvdon robërit e tij që tregojnë kujdes në dhënien e zekatit. **“Të cilët për të dhënë zekatin janë aktivë.”** (Muminun,4)

Dhënia e zekatit dhe sadakasë atij që e meriton është një arritje e madhe. Evidentimi me përpikëmi i nevojtarëve dhe njohja e tyre nga pamja është një nga urdhëresat e rëndësishme të Kuranit. Në fakt dhënia e pasurisë atij që e meriton ka lidhje direkt me mënyrën si është fituar ajo pasuri, thënë ndryshe vendi ku shpenzohet pasuria është një pasqyrë që tregon se si është fituar ajo.

Neglizhimi i leximit të Kuranit, mos reflektimi dhe mos respektimi i urdhëresave të tij është një shpërdorim kolosal. Është një shpërdorim i pa kriter i këtij thesari. Allahu e sqaron në këtë mënyrë në Kuran gjendje e atyre që përfitojnë nga Kurani.

**“Pastaj, Ne ua dhamë Librin robërve Tanë të zgjedhur (nga ndjekësit e Muhamedit ﷺ). Disa prej tyre i bëjnë dëm vetes (duke bërë vepra të ndaluara), disa janë në rrugë të mesme (duke kryer detyrimet dhe duke shmangur të ndaluarat), ndërsa disa, me lejen e Allahut, shkojnë përpara me të mira (përtej detyrimeve); kjo është dhuntia e madhe.”** (Fatir, 32)

Ymeti më i zgjedhur është ymeti i Muhamedit ﷺ dhe më i nderuari midis tyre është besimtari që e lexon Kuranin, e mëson dhe vepron sipas tij. Një pjesë e njerëzëve i bëjnë padrejtësi vetes



duke mos vepruar sipas tij megjithëse e lexojnë dhe mësojnë atë. Dhe ky është një shpërdorim i madh. Disa të tjerë janë të mesëm nga njëherë veprojnë sipas mësimëve të tij nga njëherë e neglizhojnë atë. Kurse një pjesë tjetër përparojnë në bamirësi të ndryshme.

Kurani është një thesar i pashtershëm për shpirtin e njeriut. Kurani është një mrekulli që i është bërë dhuratë njeriut për të fituar lumturinë në këtë botë dhe botën tjetër.

Zemrat e besimtarëve që lexojnë dhe veprojnë sipas Kuranit janë të mbushura plot me energji dhe lulëzojnë porsì lulet në pranverë. Besimtari që jeton më Kuranin e shikon veten si një univers në miniaturë dhe kjo i jep atij qetësi shpirtërore dhe lumturi. Për njerëzit e zemrës Kurani është një portë madhështore për të hyrë në botën e reflektimit dhe metditimit.

Gjatë leximit të kuranit është i domosdoshëm pastrimi i zemrës po aq sa pastrimi i trupit. Sepse sëmundjet e zemrës pengojnë përfitimin nga thesari i Kuranit. Ata që nuk përfitojnë nga mëshira, shërimi, dhe udhëzimi i Kuranit janë në një humbje të madhe. Personat që e kuptojnë më mirë Kuranin janë personat që janë më afër Allahut me devotshmëri. Prandaj për të përfituar nga Kurani dhe për pasojë për të arritur lumturinë në këtë botë dhe botën tjetër është e domosdoshme devotshmëria.

Një tjetër çështje që vlen për t'u theksuar është fakti që një shërbim i vogël por i sinqertë mund të jetë më i vlefshëm se shumë ibadete suplimentare. Kjo ngjarje në kohën e Profetit ﷺ e shpjegon shumë mirë këtë çështje.

Një ditë të nxehtë Profeti ﷺ kishte qëndruar në një vend të përshtatshëm. Një pjesë e sahabëve ishin me agjërim nafile. Ata që ishin me agjërim nga lodhja i zuri gjumi. Kurse ata që nuk agjëronin shkuan mbajtën ujë për abdest dhe ngritën çadrat për të krijuar hije. Kur erdhi koha e iftarit Profeti ﷺ tha:



*“Ata që nuk agjëruna morën më shumë shpërblim se agjëruesit”* (Muslim, Sijam, 100-101)

Po ashtu angazhimi me punë të dorës së dytë duke neglizhuar fitimin dhe për pasojë rënia në gjendje të mjerueshme ekonomike. Edhe kjo përbën një lloj shpërdorimi. Profeti ﷺ thotë: *“Allahu e do robin e tij i cili lodhet duke kërkuar fitimin hallall”* (Sujuti, Xamius Sagir, I, 65)

Po ashtu lutja e bërë në formë kori me zë të lartë, zgjatja e saj deri aq sa xhemati të humbë vëmendje është një shpërdorim i thelbit të ibadetit. Profeti ﷺ thotë: *“Mos e ngrini zërin gjatë lutjes sepse ju nuk po i luteni një të shurdhëri.”* (Buhari, Xhihad 131) pra lutje me zë të lartë e brita është e ndaluar. Këto lloj shpërdorimesh dëmtojnë atmosferën shpirtërore të ibadetit.

Në një hadith tjetër Profeti ﷺ thotë: *“Nga ky ymet do të dalë një grup që do ta teprojnë në pastërti.”* (Ebu Davut, Taharet, 45)

Allahu kërkon prej nesh të mos i kryejmë ibadetet në formë robotike, larg nga atmosfera shpirtërore. Por kërkon që t; i afrohem Atij me një zemër të mbushur me entuziazëm dhe me një vetëdije të kthjelltë.

**Kërkojmë prej Allahut të na mbrojë nga të gjitha llojet e shpërdorimeve në ibadet dhe na bëfte prej atyre që i kryejnë idadetet me pëkushtim, përqëndrim, qetësi dhe entuziazëm.**

**Amin...**





# SHPËRDORIMI I KOHËS

- 2 -



*Jeta është një mirësi tepër e vlefshme, të cilën Krijuesi i gjithësisë ia jep qenies për ta jetuar një herë dhe në kohë të caktuar. Është kusht i domosdoshëm ta shfrytëzojmë kohën me veprimet më pozitive, në përputhje me vlerat e saj. Në çdo moment ka shumë punë që mund të bëhen në jetë.*





## SHPËRDORIMI I KOHËS - 2

Të gjitha mirësitë e dhëna njeriut, si të dhuruarat ashtu edhe ato që i fiton me mundin dhe djersën e vet, janë një dhunti e Zotit pasi është vetë Zoti që i krijon ato dhe i jep forcë njeriut për t'i fituar ato, si nevoja kryesore për të. Nisur nga kjo, njeriu nuk duhet të harrojë se mirësitë janë dhunti e Allahut. Ai duhet të jetojë me vetëdijen se këto janë çështje për të cilat nesër do të japë llogari. Në një ajet Kuranor thuhet:

**“A menduat se Ne u krijuam kot dhe se nuk do ktheheni te Ne?”** (Muminun, 115)

Për rrjedhojë, duhet të mendojmë dhe gjykojmë se nuk jemi plotësisht të lirë në përdorimin e mirësive materiale dhe shpirtërore dhe se këto jemi të detyruar t'i përdorim në përputhje me urdhëresat hyjnore.

Në një tjetër ajet Kuranor na bëhet e ditur përsëri llogaria e madhe dhe na theksohet përgjegjësia që kemi: **“Pastaj, në atë ditë do të pyeteni për të mirat (e dynjasë).”** (Tekathur, 8)

Pra, ashtu siç ka përcaktuar rrugët e fitimit të mirësive të dhëna, Krijuesi i gjithësisë ka vendosur po ashtu disa rregulla dhe parime që duhen plotësuar në përdorimin e këtyre mirësive dhe dhuntive, të cilat i ka përmbledhur në “haramë dhe hallallë”.



Edhe shpenzimi i tepërt është një nga këto haramë që të çon në humbjen e mëshirës së Allahut dhe të nxit të marrësh dënimin hyjnor. Në një ajet Kuranor thuhet:

**“...Mos e teproni në shpenzim, pasi Allahu nuk i do ata që shpenzojnë tepër.”** (Enam, 141)



Një nga gabimet më të mëdha që bën njeriu në mungesë të vetëdijes, është shpenzimi i tepërt i kohës.

Jeta është një mirësi tepër e vlefshme, të cilën Krijuesi i gjithësisë ia jep qenies për ta jetuar një herë dhe në kohë të caktuar. Është kusht i domosdoshëm ta shfrytëzojmë kohën me veprimet më pozitive, në përputhje me vlerat e saj. Në çdo moment ka shumë punë që mund të bëhen në jetë. Por t'u japësh rëndësi atyre që janë më të rëndësishmet për momentin dhe t'i radhitësh të tjerat sipas shkallës së rëndësisë përbën një çështje me vlerë për të përdorur kohën ashtu siç duhet.

P.sh, të ushqyerit e fëmijës me qumësht është një veprim mjaft pozitiv i domosdoshëm për dhembshuri dhe mëshirë. Por të ushqyerit e fëmijës ndërkohë që në shtëpi bie flaka, është një veprim tepër negativ dhe ka një përgjegjësi të madhe. Në atë moment ajo duhet të përpiqet të shuajë zjarrin qoftë edhe me një kovë ujë, pasi kjo detyrë ka një rëndësi shumë më jetike se ajo e mëparshme. Por nëse nuk tregohet e shkathët, pas një farë kohe do ta gjejë veten dhe fëmijën në zjarr.

Të vlerësosh fenë e Allahut më shumë se gjërat e tjera për hir të kohës, është një përgjegjësi e kohës.

Momentet më kuptimplote dhe më të bukura të jetës për sahabët, të cilët e vlerësuan kohën në mënyrën më të mirë të mundshme ishin ato kohë në të cilat ata transmetonin tek nje-



rëzit mesazhin e tevhidit, njësisë. Një sahab i cili ishte në prag të dënimit me varje e falënderoi fatkeqin që i dha tre minuta kohë dhe i tha:

-Dmth kam edhe tre minuta kohë për të predikuar Zotin. Shpresoj të udhëzohesh.

Çdo besimtar e ka obligim moral dhe shpirtëror që t'ua transmetojë bukuritë e Islamit një pjese të njerëzve në ditët e sotme, të cilët kanë humbur në erozionin e imoralitetit dhe të mosbesimit, duke iu afruar atyre me një gjuhë mjaft të ëmbël.

Të shpenzosh me gjëra absurde kohën e cila është në vetvete një pasuri me vlera të pakontestueshme, do të thotë ta futësh në rrezik jetën e ahiretit. Prandaj koha është një dhunti me vlera ta pakrahasueshme me asgjë tjetër. Në suren Asr, Krijuesi i gjithësisë thotë:

**“Pasha kohën! Nuk ka dyshim njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin t’i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm.”** (Asr, 1-3)

Në këtë sure, e cila fillon me një betim për kohën flitet për një shpenzim të tepërt të kohës, e cila nuk është shfrytëzuar për ripërtëritjen e besimit, për punët e mira dhe këshillimin për të shkuar tek Zoti dhe se një gjë e tillë bëhet shkak për humbje të mëdha. Edhe fakti që flitet për raste të posaçme, për ata që nuk dinë ta vlerësojnë kohën me të drejtë është një e vërtetë e hidhur, gjë që tregon se ata janë të mashtruar në këtë drejtim.

Krijuesi i gjithësisë i këshillon robërit e vet që ta përdorin me kujdes kohën, në mënyrë që t’i shpëtojnë humbjes dhe të fitojnë shpërblimet hyjnore:

**“E kur ta kryesh (obligimin), atëherë mundohu me adhurim**



(Allahut). **Dhe, vetëm te Zoti yt përqendro synimin!**" (Inshirah, 7-8)

Pra, sapo të përfundojmë një punë të mirë dhe një adhurim, të kalojmë menjëherë në një punë tjetër dhe mos t'ia lejojmë vetes të na kalojë asnjë pjesë e kohës pa u shfrytëzuar. Jeta është një mirësi e dhunti që na është dhënë për të fituar lumturinë shpirtërore. Ndërsa vdekja është si afati i pagimit të një fature huaje, e cila tregon kohën e kryerjes së veprimit. Një tregtar i jep blerësit një faturë si parapërgatitje për larjen e huasë. Afati i përcaktuar këtu është për të përgatitur sasinë që do të paguhet në këtë kohë. Jeta e kësaj bote është një kohë që na është dhënë për të fituar ahiretin dhe pëlqimin hyjnor. Ashtu sikurse një tregtar i cili nëse nuk e merr seriozisht kohën e pagesës që do të bëjë, nëse nuk përgatitet gjatë kësaj kohe dhe si përfundim në fund vihet në siklet dhe telash, ashtu edhe njeriu është në humbje për sa kohë që nuk e përdor mirë kohën që i ka caktuar Allahu për të jetuar. Çdo njeri, që nga momenti kur vjen në jetë e ka një datë të vdekjes, koha e cila nuk dihet. Ky është pikërisht momenti i takimit me Azrailin. Edhe pse është e qartë data e pagesës, nuk dihet se kur do përfundojë jeta e njeriut. Kjo është një e vërtetë e hidhur që na bën të bëhemi gati në çdo moment për dhënien e llogarisë.

Një nga bazat themelore të etikës mistike shpreh qartë se është shumë e domosdoshme që koha si një mirësi e madhe që na është dhënë të përdoret sa më me kujdes. Çdo besimtar që dëshiron të pastrojë zemrën dhe shpirtin e tij duhet të mendojë që llogaria mund të vijë në çdo moment, përderisa nuk dihet ardhja e vdekjes (exhel) dhe nisur nga kjo kohën duhet ta shfrytëzojë me vepra të mira. Ti lërë punët e panevojshme dhe mos të flasë gjëra të pakuptimta, pra e thënë ndryshe me shprehjen e Mevlanës, duhet ta mbrojë gjuhën nga të qenurit "Maskara i



fjalës”. Kështu e shpreh Allahu i Lartëmadhëruar me shprehjen Kuranore cilësinë e besimtarëve “të shpëtuar”

“**Ata të cilët i shmangën të kotës** (fjalë a punë).” (Muminun, 3)

“(Robërit e Zotit janë) **Edhe ata që nuk dëshmojnë rrejshëm dhe kur** (rastësisht) **kalojnë pranë së keqes, kalojnë duke e ruajtur karakterin e vet.**” (Furkan, 72)

Besimtari i devotshëm duhet të jetë në çdo moment në dijeni për botën e tij të brendshme dhe të gjykojë se në ç’shkallë ka arritur pendimi, falënderimi dhe pëlqimi. Ai duhet të pendohet për ato kohë që ka kaluar ashtu në pavetëdije, duke bërë një përlllogaritje për mirësitë që i janë dhënë. Duhet të shpëtojë nga ankthet e panevojshme të së ardhmes duke i kushtuar kujdes vetëdijes dhe të merret me gjendjen e tij shpirtërore. Pra duhet të jetë një njeri i pjekur i cili ia di vlerën kohës që jeton, thënë ndryshe edhe “ibnu’l-vakt”, dhe të jetojë i përgatitur për botën tjetër. Harxhimi pa kriter i kohës është një humbje shumë e madhe. Vetë i Dërguari i Allahut ka thënë:

*“Njerëzit e Xhenetit nuk do ndjejnë mall për asgjë tjetër, por vetëm për kohën që kanë kaluar në këtë botë pa përmendur Allahun.”* (Hejthem, X, 73-74) Nëpërmjet kësaj thënieje na ka kujtuar se duhet ta vlerësojmë kohën me punë të dobishme, që do të jenë një pasuri e jona për jetën e përtejme. Nëse mirësitë të ikin nga dora, pendimi nuk ka më vlerë. Prandaj sa ta kemi mundësinë, le ta vlerësojmë jetën me punë të dobishme. Të përpiqemi t’i japim hakun çdo gjëje që kërkon falënderim. P.sh, mirësinë e të folurit le ta shfrytëzojmë me përmendjen e Zotit, si një shërim për zemrat tona.

Kështu e këshilloi Profeti ﷺ Hafsanë:

*-O Hafsa! Ki kujdes në të folurit e tepërt, pasi e folura e tepërt përveç përmendjes së Allahut e vret shpirtin. Përmende Zotin shumë! Kjo e ripërtërin zemrën!* (Ali el Muttaki, 1, 439/1896)



Allahu i Lartëmadhëruar na këshillon të jemi të kujdesshëm në dy çështje:

**“Dhe jepni nga ajo që Ne u kemi dhënë juve, para se ndonjërit prej jush t’i vijë vdekja, e atëherë të thotë: “O Zoti im, përse nuk më shtyve edhe pak afatin (e vdekjes), që të jepja lëmoshë e të bëhesha prej të mira!””** (Munafikun, 10)

Ajeti i mëposhtëm tregon qartë se si kthehen mbrapa vajtimet dhe pretekstet e atyre që e shkatërruan jetën e tyre:

**“Dhe ata do të klithin: “O Zot ynë, nxirrna e të bëjmë vepra të mira, e jo si ato që i bënim!” Po a nuk u dhamë juve jetë aq sa ai ka dashur të mendojë, ka mundur të mendojë gjatë asaj kohe, madje juve u ka ardhur edhe Profeti, pra shijoni, se për zullumqarët nuk ka ndonjë ndihmëtar.”** (Fatir, 37)

Një tjetër arsye e shpenzimit të tepërt të kohës, sikurse ndodh në të gjitha mirësitë e tjera në jetë është koshienca për të mos ta kuptuar vdekjen siç duhet apo për t’i qëndruar larg saj. Në një hadith thuhet:

*“Kujtojeni shumë vdekjen e cila zhduk rrënjësisht të gjitha dëshirat”* (Tirmidhi, Kijamet, 26) Ata të cilët vazhdojnë në të tyren pavarësisht këshillave Profetore, padyshim që do të kenë një fund të dhembshur.

Një ditë, i Dërguari i Allahut tha:

*-Nuk ka asnjë njeri që do të vdesë dhe nuk do të pendohet.*

Ashabët e pyetën:

*-Për çfarë të pendohet, o i Dërguari i Allahut?*

I Dërguari i Allahut iu përgjigj:

*“Do pendohet se një person bamirës nuk ka shpenzuar*



*më shumë, ndërsa keqbërësi që nuk ka hequr dorë nga të këqijat.”* (Tirmidhi, Zuhd, 59)

Kur njeriu sheh me syrin e zemrës rrjedhën e fuqisë hyjnore të pasqyruar në mbarë gjithësinë, e ndjen veten të detyruar të mendojë se si duhet të jetë në këtë jetë. E vërteta më e madhe që duhet ta lidh njeriun me jetën, është çështja e vdekjes. Sa pamje e mahnitshme për njeriun është ai moment lamtumire. Kush e njih vdekjen dhe e kupton se është udhëtar i ahiretit, nuk bëhet pre e lojërave të kësaj jete dhe nuk humbet kohë me to. Në Kuran thuhet:

**“Ne nuk krijuam qiejt e tokën dhe çka ndërmjet tyre, pa një qëllim. Por, Ne i krijuam të dyja me qëllim të caktuar, mirëpo shumica e tyre nuk dinë.”** (Duhan, 38-39)

Sikur të gjitha mirësitë e përkohshme të mblidhen tek një njeri, dhe sikur ky njeri të jetojë edhe një mijë vjet, ç’dobi ka! Në fund të fundit, vendi ku do të futet a nuk do të jetë kjo tokë të cilën e shkelim me këmbë?! Si nuk merr njeriu mësim, ndërkohë që këshillohet përherë gjatë gjithë kohës ku vepron çdo qenie e përkohshme. Sa mashtrim i frikshëm në emër të së ardhmes është të pandehësh se urimet që ushqejnë jetën shpirtërore të kësaj bote në të cilën jetohe në mënyrë të painformuar nga ahireti, janë të përhershme dhe se lojërat e kësaj jete janë të vërteta!.. Imam Shafiu thotë:

-A kanë leverdi karvanet të ndërtojnë shtëpi gjatë udhëtimit?

Një jetë e tillë nuk është gjë tjetër vetëm se një lojë në fëmijëri, një kënaqësi në rini, një papjekuri në moshë madhore, një mall për të shkuarën në pleqëri dhe një mijë e një përpjekje. Kurse vdekja e pret njeriun në çdo çast në pritë. Sa shpenzim i tepërt në jetë është gjendja e atyre që lodhen me kënaqësitë



e përkohshme deri në ditën e fundit, duke mos lënë mënjanë zbulimet e kësaj bote, vetëm e vetëm për të fituar qetësinë që të jep jeta larg mendimit për ahiretin!.. Sa mall do të ndjejnë një ditë për kohën e çuar dëm ata të cilët e shkatërruan kohën e tyre sikur nuk do të vdisnin asnjëherë!...

Ata të cilët e kanë dhënë veten e tyre pas kënaqësive epshore i shmangen vazhdimisht të menduarit për jetën e varrit dhe atë të përtejmen duke u përpjekur të jetojnë jetën e tyre mbi planin epshor. Prandaj vdekja për ta është një ankth për të ardhmen dhe një frikë e tmerrshme. Kjo pasi njeriu dëshiron të jetojë në një botë të cilën e ka imagjinuar dhe i ka dhënë shpirtin. A është e mundur që një njeri i cili ka shkatërruar ahiretin duke u përkujdesur për këtë botë, ta lërë vilën e tij luksoze dhe të kërkojë të jetojë në një rrënojë? E kundërta e saj a mund të konceptohet një besimtar i cili mendon thellësisht ahiretin dhe të trembet nga frika për varrin?

Kështu na e tregon Mevlana rrugën për të shpëtuar nga të fshehtat e kësaj bote dhe për të arritur lumturinë e përherëshme:

-Mos e përqafo shumë pasurinë, ashtu që kur të vijë koha ta kesh të lehtë ta lësh! Edhe e lë lehtë edhe fiton sevape! Mbështetiu fort Atij që të qëndron më afër, Ai është i Pari dhe i Fundit!

Shumica e njerëzve frikësohen nga vdekja fizike e tyre. Në fakt ajo që duhet të frikësohen më shumë është vdekja e shpirtit.

Për çdo qenie të gjallë ka një frymë të fundit, e cila nuk mund të shtyhet më tutje. Koha ecën me hapa të shpejtë sipas përcaktimit të Zotit. Në jetën e kësaj bote pak a shumë është e mundur të marrësh çdo gjë dhe të kthesh prapa shumë gjëra, por kohën e kaluar kurrë... Askush nuk mund të qëndrojë indiferent kur një copëz e vogël floriri hidhet në kosh, por sa e habitshme





është kur qëndrojmë indiferent ndaj kohës që kalojmë, për të cilën edhe po të japim miliona flori nuk mund ta marrim dot.

Feriduddin Attar thotë:

Janë katër gjëra që s' mund të të kthehen prapa pasi i ke humbur: fjala e dalë nga goja, shigjeta e gjuajtur, aksidenti i bërë dhe një jetë e harxhuar kot.

Një mik i ngushtë i Zotit për të kuptuar mirë vlerën e kohës dhe për ta vlerësuar atë sa më mirë jep këto këshilla:

Bëj vizita të herëpashershme në spital për të parë të sëmurët! Falëndero Zotin për gjendjen tënde shëndetësore dhe mendo edhe gjendjen e atyre të sëmurëve! Shko herë pas here në burgje dhe gjyko për jetën e përvuajtur të atyre njerëzve të burgosur! Mendoni për një çast se krimi është kryer për një moment të caktuar, në mënyrë të pavetëdijshme, nga ana tjetër ashtu i rrënuar shpirtërisht hyni në burg e mendoni që edhe ju mund të ishit në vendin e tyre! Falëndero Zotin që të mbrojti dhe ruajti për të mos rënë në këtë gjendje! Lutu edhe për shpëtimin e atyre që janë atje! Më pas shko në varreza, dije vlerën e kohës, duke menduar se nuk ka asnjë vlerë pendimi pasi të kesh humbur mirësinë e jetës! Lexo një Fatihë për të vdekurit dhe përpiqu ta shfrytëzosh këtë kohë të mbetur duke falënderuar Zotin tënd!

Kjo do të thotë që një besimtar duhet të përpiqet të bëjë një jetë të devotshme duke mos e harruar krijuesin e gjithësisë në asnjë kohë dhe vend. Allahu thotë:

**“E mos u bëni si ata që harruan Allahun, pra (All-llahu bëri që ata) harruan vetveten! Të tillët janë fasikët.”** (Hashr, 19)

Pasi shpjegon se çuarja dëm e kohës dhe harxhimi i tepërt i saj me njerëz që nuk kanë preokupime të tjera në jetë është një nga turpet më të mëdha të nefsit, Ebu Abdurrahman Sulemi tregon se si mund të kurohet një dukuri e tillë:



Ta kuptosh kohën si gjënë më me vlerë në jetë dhe ta shfrytëzosh atë me punët më të vlefshme siç është ajo vetë, pra duke përmendur Allahun, duke e adhuruar përherë dhe duke forcuar devotshmërinë në shpirtin tënd. i Dërguari i Allahut ka thënë: *“Lënia mënjanë e gjërave që nuk i interesojnë njeriut, është tregues i një myslimanizmi të mirë.”* (Tirmidhi, Zuhd, 11)

Hadithi njofton se është një detyrim moral i yni për ta ditur sa më mirë vlerën e kohës dhe më pas vijon:

*“Dija vlerën pesë gjërave para se të vijnë pesë të tjera: vlerën e rinisë para pleqërisë, vlerën e shëndetit para se të sëmuresh, vlerën e pasurisë para se të varfërohesh, vlerën e kohëve të lira para se të vijnë kohët e zëna dhe vlerën e jetës para se të vijë vdekja.”* (Hakim, el-Mustadrek, IV, 34, Buhari, Rikak, 3; Tirmidhi, Zuhd, 25)

*Në ditën e gjykimit robi nuk lëviz nga vendi pa u pyetur për katër gjëra:*

- 1 Për jetë, me çfarë e zhduku atë?
- 2 Për rininë, ku e kalbëzoi atë?
- 3 Për pasurinë, ku e fitoi dhe ku e shpenzoi?
- 4 Për diturinë, çfarë bëri me të? (Tirmidhi, Kijame, 1)

*Ka dy mirësi të cilat shumica e njerëzve mashtrohen kur i përdorin: Shëndeti dhe koha e lirë.* (Buhari, Rikak, 1)

Allahu na njofton në shumë ajete kuranore se në ahiret do të pyetemi për të gjitha mirësitë që na janë dhënë materiale-shpirtërore. Dijetarët Islamë kanë dhënë mendime të ndryshme për sa i përket mirësive më të rëndësishme për të cilat do merremi në llogari ditën e gjykimit. Ibn Mesud thotë se këta janë “Siguria, shëndeti dhe koha e lirë” Muavije ibn Kurre thotë: “Llogaria më e tmerrshme në ditën e gjykimit është ajo e kohës së lirë”

(Bursevi, X, 504)



Kjo këshillë e Gazaliut në lidhje me shpenzimin e tepërt të kohës, ka shumë domethënie:

“Bir! Mendo që sot ke vdekur. Sa do të mërzitesh për kohët që i ke kaluar ashtu i pavetëdijshëm. Ah sikur! Do të thuash, por pa kuptim.”

Xhunejd Bagdadi thotë:

Një jetë e kësaj bote është më me vlerë se një mijë vite të ahiretit. Fitorja dhe humbja i përkasin kësaj bote. Në Ahiret nuk ka të fitosh apo të humbësh.

Koha e humbur është një humbje e madhe që nuk zëvendësohet. Kjo pasi të gjitha dosjet e të kaluarës janë mbyllur. Të paktën të përpiqemi t'i zëvendësojmë ato nëpërmjet anës shpirtërore, duke bërë lutje dhe adhurime për krijuesin tonë.

Lumi i jetës rrjedh shumë shpejt. Ditët e kësaj jete të përkohshme të kufizuara nga vullneti hyjnor, janë si pikat e ujit në një gotë. Të mos harrojmë se për çdo ditë që kalon ndodh një pakësim i ujit në gotë, largohemi një ditë më shumë nga kjo botë dhe i afrohem një ditë më shumë jetës tjetër. Meqenëse exheli nuk dihet se kur vjen, duhet të kujtojmë se në çdo moment mund të takohemi me Azrailin, në mënyrë që në frymën e fundit të mos shohim dramën tonë. Nexhip Fazël thotë:

Në atë moment të frymës së fundit, kur perdet e jetës ulen dhe ngrihen, t'i themi Azrailit “Mirë se erdhe”!

**Zoti na mundësoftë ta kalojmë këtë jetë të mbetur me adhurime ndaj Zotit dhe ta japim frymën e fundit si myslimanë. Zoti na e mundësoftë ta kuptojmë mirësinë e kohës që na është dhuruar, në të cilën jetojmë botën tonë të brendshme dhe të jashtme, për të bërë kështu një jetë larg shpenzimeve të tepërta.**

**Amin!..**





# SHPËRDORIMI NË DITURI

- 3 -



*Shpirti i mbraujtur me diturinë e vërtetë  
nuk është ai që qëndron gjithë ditën mbi libra  
voluminoz por shpirti i besimtarëve të mirë që thellohet  
mbi urtësitë e Kuranit dhe i shërben me mëshirë  
njezimit.*

*Të dishë do të thotë të zgjidhësh  
enigëmën e qëllimit të krijimit,  
të përfitosh shpirtërisht nga krijimi i Allahut.*



## SHPËRDORIMI NË DITURI - 3

Zbukurimi i jetës me mirësjellje, modesti, shpirtshmëri, dhe kuptim bëhet i mundur duke qëndruar larg shpërdorimit dhe sjelljeve të tjera negative. Shpërdorimi është lajmëtar i fatkeqësisë në individ, famijle dhe shoqëri.

Të gjitha mirësitë që i janë dhuruar njeriut janë një amanet në dorën e tij. Nëse këto mirësi nuk shfrytëzohen në vendin e duhur por shfrytëzohen për të plotësuar kënaqësitë e egos atëherë Allahu e merr begatinë prej e aty.

Shpërdorimi nuk duhet të kufizohet vetëm me pasuritë materiale. Sepse ai në fakt ka të bëjë me të gjithë çështjet e jetës. Kalimi i kohës me punë boshe është shpërdorim, angazhimi me dituri të padobishme dhe përdorimi i saj për interesa vetjake është shpërdorim i madh.

### Shpërdorimi në dituri

Dituria është një aktivitet sublim që plotëson nevojën natyrale të njeriut për të mësuar. Dituria e cila qëndron në majë të aktiviteteve njerëzore i jep mundësi besimtarit ta njohë nga afër Krijuesin dhe ta adhurojë atë.

Niveli më i lartë i diturisë është njohja e Allahut. Të gjitha aktivitetet e njohurisë që nuk ndihmojnë njeriun në këtë botë



spovash dhe nuk e afrojnë me Allahun janë shpërdorime të mirëfillta. Dituria që nuk përçon urtësi është keqpërdorim i prirjes natyrale të njeriut për të mësuar.

Termi dituri në Kuran përmend në si cilësi që e afron dhe e bën më të devotshëm njeriun ndaj Allahut. Ajeti kuranor thotë:

**“A mund të krahasohet ai që falet natën, duke bërë sexhde dhe duke qëndruar në këmbë e që ruhet prej jetës tjetër dhe shpreson në mëshirën e Zotit të tij (me jobesimtarin)?! Thujaj: “A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?! Vetëm mendarët i pranojnë këshillat!”** (Zumer,9)

Ky ajet i vlerësuar në kontekst na jep një përkufizim shumë të qartë të diturisë dhe injorancës njëkoësisht. Për të qenë pjesë e grupit që e njohin në thelb urtësinë dhe të vërtetën duhet të bëjnë kujdes në këtë çështje:

1. Të falin rregullisht namazin e natës dhe të këndojnë Kuran sepse të dyja këto janë mënyra komunikimi me Krijuesin e gjithësisë.

2. Të bëjnë kujdes në çdo moment për sjelljet duke pasur parasysh që për çdo veprim do të japet llogari në ditën e gjykimit.

3. T’i luten vaxhdimisht Allahut duke shpresuar mëshirën dhe faljen e Tij.

4. Të bërit një jetë që të afron tek Allahu, pra një jetë në gjendje devotshmërie dhe qëndrimit larg veprimëve që cenojnë devotshmërinë.

5. Zhvillimi i vetëdijes se në çdo moment dhe vend jemi nën vëzhgimin e Allahut.

6. Përpejkja e vazhdueshme për të mbrojtur zemrën nga ambiciet e sëmura.





Kurse cilësitë kryesore **të paditurve** janë

1. Mosbesim dhe mosmirënjohje
2. Kur janë në gjendje të mirë e harrojnë Allahun, kujtohen për Të vetëm kur janë në vështirësi.

3. Rënia pas dëshirave dhe ambicieve personale dere në shkallën e vetëpëlqimit. Allahu në Kuran thotë: **“A e ke parë ti atë që epshin e vet e ka marrë për zot?...”** (Furkan, 43)

Të gjitha shkencat janë zbulim dhe evidentim i ligjeve që Allahut ka vendosur në univers. Zhvillimi i shkencës është i lidhur më rritjen e zbulimeve të këtyre ligjeve që ka vendosur Allahu. Por thjesht zbulimi i ligjeve të Allahut në unives nuk përbën diturinë që të çon në njohjen e urtësisë dhe qëllimit të krijimit. Dituria në kuptimin e plotë të saj është njohja e urtësisë së ardhjes dhe largimit nga kjo botë.

**Dituria** është të përfitosh shpirtërisht nga madhështia e Krijimit të Allahut.

**Dituria** është të gjesh atë që ke nevojë dhe sipas Kuranit ajo për të cilën kemi nevojë është të vdesësh duke qenë musliman.

**Dituria** është sëpari shpëtimi i nga skllavëria e egos dhe vetëllogari para se të gjykohesh nga gjykata hyjnore.

Rrumiu i zhytur në të vërtetë e diturisë dhe detin e njohjes kur ndodhej në nivelin literal të diturisë tha “isha i papjekur” kur filloi që nga zemra t’i buronin urtësi tha “U poqa” dhe kur arriti pjekurinë, etapë në të cilën urtësitë e universiut iu shfaqën si në një libër tha “U dogja”

Në fakt një person që thellohet në dituri i shtohet modestia dhe urtësia. Njeriu sa më shumë thellohet në urtësi aq më shumë e kuptonë dobësinë e tij përballë fuqisë hyjnore. në këtë mënyrë



ai kupton paftësinë e vet, njeh veten e vet dhe duke njohur veten njeh Krijuesin.

I dituri njeh zotëruesin e vërtetë të krijesave. I do dhe ushqen mëshirë dhe dashuri për krijesat për hir të Krijusit të tyre.

I dituri fal, duron, dashuron, sakrifikon dhe kërkon devotshmërinë

I dituri nuk fyen, nuk lëndon, nga gjuha e tij buron vetëm mirësi.

I dituri gjithmonë përpiqet të jetë afër Allahut. Ai e përmend atë kur është në këmbë, ulur, shtrirë apo duke ecur.

I dituri është gjithmonë në gjendje meditimi mbi madhësitinë e krijimit.

I dituri është njeri zemre.

I dituri është i lumtur në çdo vend dhe çdo gjendje.

I dituri ndjen përgjegjësi për ymetin.

I dituri ndjen përgjegjësi për atdheun, kombin dhe flamurin. Sepse ruajtja e dinjitetit është i mundur përmes ruajtjes së atdheut dhe kombit.

I dituri për të shpëtuar nga prangat e egos i jep rëndësi jetës shpirtërore.

I dituri nuk mashtrohet nga kënaqësitë e përkohshme të kësaj bote.

I dituri e shpëton veten nga sëmundjet e zemrës si smira dhe fama.

I dituri arrin një gjendje shpirtërore që nuk i hyn në sy asnjë gjë nga bukuritë dhe kënaqësitë e kësaj bote.

I dituri kupton dobësinë e vetë përballë madhësisë hyjnore dhe vetëdijësohet për njohurinë e pakët.



I dituri kupton se çfarë i duhet në jetë.

I dituri është në gjendje shërbimi, modestie dhe mëshire karshi krijesave të tjera.

I dituri mahnitet nga mrekullia e krijimit

I dituri kupton gjuhën universale. Sepse me të diturin flet gjithkëka.

I dituri e ka zemrën dhe mendjen në ekuilibër të plotë.

I dituri është në gjendje entuziazmi prej imanit.

I dituri arrin nivelin e gnosës.

I dituri mendon jo mbi shkakun por mbi krijuesin e shkakut.

Ai që njeh Allahun është më i dituri. Kurse kush nuk njeh Atë nuk di asgjë. Një zemër që nuk njeh Allahun është e verbër.

Profeti ﷺ thotë:

Sikur të dinin atë që di unë do të qeshnit pak dhe do të qanit shumë... Por do t'i luteshit Allahut në shkretëtirë me përgjërime të thellë. (Ibn Maxhe,19)

Kur vdiq Omeri ﷺ Abdullah ibn Mesudi tha:

Nëntë e dhjeta e diturisë iku.

Sahabët thanë:

Akoma kemi dijetarë në mesin tonë

Ibnu Mesudi ia ktheu:

E kam fjalën për diturinë e gnosës.

Ajeti Kuranor thotë:

**...Në të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët...** (Fatir, 28)



Siç kuptohet edhe nga ajeti dituria që nuk zgjon ndjenjën e frikës dhe devotshmërisë ndaj Allahut nuk është dituria për vlerën e së cilës flasin Kurani dhe Hadithi. Një tjetër problem shqetësues është neglizhenca ndaj një sërë urdhëresash me pretekstin se janë në kërkim të diturisë. Kjo nuk është gjë tjetër përveç se një vetëmashtrim i qartë.

Nuk ka dyshim që dituria tokësore është e domosdoshme. Vlera e saj rritet kur përdoret si duhet, kur përdoret në dobi të njerzëve. Këto lloj shkencash janë shumë të rëndësishme sepse edhe këtë japin kontributin e tyre për të sjellë argumente nga madhështia e krijesave të Allahut. Përmes këtyre shkencave arti dhe mrekullia e Allahut në univers kuptohet më mirë dhe qartë. Zhvillimi teknologjik, astronomia, shkenca e gjenetikës dhe çdo aktivitet tjetër shkencor çdo ditë e më tepër po i ofron njrëzëve madhështinë e fuqisë hyjnore.

Ajeti kuranor thotë:

**Ne do t'u tregojmë atyre shenjat Tona në hapësirat tokësore e qiellore, si dhe në vetvete, derisa t'u bëhet plotësisht e qartë se ai (Kurani) është e vërteta. Vallë, a nuk të mjafton ty që, Zoti yt është Dëshmues i çdo gjëje?!** (Fusilet, 53)

Në fakt ajo që synohet të arrihet përmes diturisë është zbulimi i enigmave në botën fizike dhe metafizike për të arritur sa më të plotë njohjen e Allahut. Dituria përmes zbulimëve që arrin në fusha të ndryshme duhet t'i shërbejë zemrës për të arritur një gradë më të lartë shpirtëror. Çdo zbulim i ri është një argument më tepër për ekzistencën dhe madhështinë Krijuesit. Por fatkeqësisht megjithëse shkenca çdo ditë e më shumë po zbulon dhe sjellë argumente të ekzistencës së Zotit përsëri shumë zemra janë neglizhente dhe indiferente përballë gjithë këtyre mrekullive që Allahu ka vendosur në univers.



Ata që e përdorin diturinë për qëllime të këqia duke dëmtuar në këtë mënyrë njerëzit në të vërtetë kanë tradhëtuar diturinë dhe për pasojë kanë rënë në një shpërdorim dhe keqpërdorim masiv të kapaciteteve mendori dhe shpirtërore. Prandaj është e domosdoshme që shkencën të jetë nënkontrollin dhe të udhëhiqet nga drita e Kuranit dhe Sunetit. Shkencë është është e privuar nga kjo dritë është e destinuar të kthehet në dëm të njeriut.

Fatkeqësisht sot vlerësohet vetëm aftësia intelektuale e njeriut. Kurse gjendja e botës shpirtërore e tij është apo jo e aftë për ta përdorur në mënyrë të dobishme diturinë, nuk vlerësohet dhe nuk e jepet rëndësi fare. Por për të arritur lumturinë në këtë botë dhe botën tjetër nuk mjafton vetëm shkencën.

Një person që është shumë i aftë në fushën e jurisprodecës por që nuk ka arritur sa duhet pjekurinë shpirtërore në vend që të japë drejtësi i bën padrejtësi njerëzëve. Po ashtu edhe një mjek në vend që të jetë një burim shërimi mund të shndërrohet në një kasap të vërtetë. Një prijës të cilit i mungon mëshira dhe dashuria sa do i aftë të jetë ai do t'i shtypë të gjithë të tjerët që kanë nën sundim. Këto dëme të cilat nuk mund t'i bëjë një injorant arrin t'i bëjë një një i shkolluar dhe i arsimuar. Përdorimi i diturisë në mënyrë të gabuar sjell humbjen e madhë në botën tjetër.

Rrumu në vepërën e tij të famshme Mesnevi e përshkruan kështu këtë të vërtetë:

*“Personi i ditur dhe i aftë është i mirë por nxirr mësim nga Iblisi dhe mos i beso shumë diturisë tëndë. Mos harro që Iblisi i cili është i dëbuar nga mëshira e Allahut ishte një nga më të afërmit e Tij, ishte prijësi i engjëjve por u filloi të mburrej nga dituria dhe pozita që kishte. Filloi ta shihte më përçmim Ademin ﷺ dhe si përfundim është poshtërua vetë dhe u privua përgjithmonë nga mëshira e Allahut.”*



Një dituri që e bën njeriun mendjemadh edhe nëse është në dukje e dobishme ajo nuk i jep asnjë përfitim përveç humbjes së sigurtë. Prandaj Profeti ﷺ kur lutej për dituri gjithmonë lutej kështu:

*“O Zot më jep dituri të dobishme dhe më mbro nga dituria e padobishme.”* (Muslim, Dhikër, 73)

Ashtu si mësimi i njohurive themelire të fesë është farzi ajn edhe mësimi i veprave të zemrës si sinqeriteti, durimi, syfqësia, mburrja është farzi ajn. Anashakilimi i këtyre sjell humbje të sigurtë në botën tjetër. Nëse nuk je i pajisur më dituri të dobishme sa do i ditur të jeshë përfundimi do të jetë dështim.

Imam Gazaliu në lidhje me shpërdorimin e kohës dhe përpjekjes gjatë mëimit të diturisë jep këto këshilla:

Dituria që mëson duhet të jetë e atilla që i japin lulëzim zemrës dhe bukuri moralit. Për shembull nëse mëson që do keshë edhe një javë jetë menjëherë angazhohesh në mësimin e diturisë së dobishme. Kontrollon zemrën, ndërpret të gjitha lidhjet me interesat materiale dhe përpiqesh të bësh vepra të mira. Por njeriut mund t’i vijë vdekja në çdo moment. Prandaj dituria me të cilën angazhohesh duhet të jetë e atilla që të lartësojë shpirtërisht.

Dituria kërkon përpjekje të jashtëzakonshme. Thelbi i diturisë bëhet i dukshëm përmes zbatimit të saj. Dituria e pazbatuar siç e përshkruan edhe Kurani është si një kafshëm që mbart në shpinë libra. Dituria konsiderohet e tillë kur e çon personin tek njohja e Krijuesit të gjithësisë, në vepra të mira dhe devotshmëri. Përndryshe edhe shejtani ishte shumë i ditur, po ashtu edhe Karuni ishte shumë i ditur por nuk u vlejti. Ajo dituri i bëri mendjemëdhenjë çka u solli një përdundim të dhimbshëm.

Pra nëse dituria nuk shndërrohet në vepër, nuk bëhet pjesë



e moralit, nuk e pajis njeriun me cilësi të larta shpirtërore të gjitha përpjekjet e dhënë për të arritur atë janë shpërdorim dhe humbje kohe.

Nuk duhet të harrojmë që Allahu të gjitha sekretet e njeriut dhe universit i ka përmbledhur në Kuran. Thelbi i gjithë diturisë është në Kuran.

**“Ai i ka çelësat e së padukshmes dhe vetëm Ai i njeh ato. Ai e di ç’ka në tokë dhe në det; asnjë gjeth nuk bie, pa e ditur Ai dhe nuk ekziston asnjë kokërr në errësirën e tokës, as e njomë, as e thatë, që të mos jetë shënuar në Librin e qartë (Leuhi Mahfudh).”** (En’am, 59)

Po ashtu në suren Rrahman thotë: **“I Gjithëmëshirshmi ua ka mësuar Kuranin (robërve të Tij), ka krijuar njeriun dhe i ka mësuar atij të folurit e qartë.”** (Rrahman, 1-4)

Kurani është mesazhi i fundit i Allahut për njerëzimin.

Ajo që ka më shumë nevojë ymeti ilamë është dituria e Kuranit. Prandaj duhet t’i japim më shumë rëndësi mësimit dhe thellimit në Kuran dhe shkencat e tij. Për ta kuptuar drejt Kuranin duhet një atmosferë e caktuar shpirtërore, duhet një përfshirje shpirtërore në vetë Kuranin. Kurani i tërheq vëmendjen besimtarëve duke i thënë:

**“Edhe ata, që, kur paralajmërohen nga shpalljet e Zotit të tyre, nuk bëhen as të shurdhër, as të verbër.”** (Furkan, 73)

**“Vërtet, Ne u kemi sjellë njerëzve shembuj në këtë Kuran për çdo gjë, për t’ua vënë veshin.”** (Zumer, 27)

Prandaj është e domosdoshmë që gjatë angazhimit me Kuran të krijojmë një lidhje shpirtërore me të. Aq sa është e rëndësishme pastërtia fizike është e rëndësishme edhe pastërtia shpirtërore. Përsëri në Kuran thuhet:



**“Vallë, a nuk përsiatin ata për Kuranin apo i kanë zemrat të kyçura?!”** (Muhamed, 24)

**“Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë.”**  
(Shems,9)

Kurani i cili është udhërrëfyese ynë na fton në meditim dhe reflektim. Ata që janë të devotshëm e kuptojnë më mirë Kuranin. **“...prandaj ruajuni Allahut! Allahu ju mëson ju...”** (Bekare, 282)

Kurse në një ajet tjetër u tërheq vëmendjen në këtë mënyrë besimtarëve:

**“Ne e kemi zbritur (Kuranin) në gjuhën arabe (për të qenë) si gjykim (për njerëzit). Por, nëse ti ndjek dëshirat e tyre, pas dijes që të ka ardhur, ti nuk do të kesh as ndihmës, as mbrojtës prej Zotit.”** (Rad,37)

Ajeti kuranor tregon prioritetet që duhet të kenë besimtarët në rrugën e diturisë. Prioriteti i tyre i parë duhet të jetë kultura e Kuranit. Nuk mund të imagjënohet një dituri pa Kuran. Fatkeqësisht në ditët tona disa njerëz e kanë kaluar në plan të dytë madje në plan të tretë kulturën e Kuranit.

Fakti që besimtarët i dërgojnë fëmijët vetëm gjatë pushimëve të verës për të mësuar Kuran tregon mungesën e seriozitetit, është fatkeqësi dërgimi i fëmijëve në Kurset e Kuranit thjesht për të mbushur kohën e lirë. Një tjetër problem është mos dhënia e rëndësisë së duhur kuptimit të Kuranit. Nuk mjafton thjesht leximi i Kuranit krahas leximit duhet me patjetër të thellohemi në kuptimin e tij.

Mosdhënia e rëndësisë së duhur Kuranit i cili është dhurata më e madhe që Allahu i ka falur njeriut. Dhënia rëndësi e diturive të tjera duke anashkaluar Kuranin është kërkmi i suksesit dhe





të ardhmes në rrugë të gabuar. Njeriu ka nevojë më shumë për ushqim shpirtëror se sa ushqim material.

Mos u lodh shumë duke ushqyer stomakun sepse ai është një kurban që do t'i dorëzohet tokës. Ti interesohu më shumë të ushqesh zemrën. Ajo të dërgon në lartësitë qiellore. Jepi shpirtit ushqim shpirtëror. Jepi zemrës mendim të pjekur në mënyrë që të shkosh i fortë në destinacionin përfundimtar.

Dëshirat dhe kënaqësitë tokësore janë në rolin e prangave për jetën shpirtërore. Nuk shkohet tek Zoti me një zemër të dobët. Prireja ndaj kënaqësive është si një gurë i rëndë gjatë rrugëtimit shpirtëror. Me një gurë të tillë as nuk notohet as nuk fluturohet. Nëse njeriu nuk angazhohet me punë të mirë, puna e keqe fillon të angazhohet me të.

Allahu thotë në Kuran:

**“Allahut i takojnë thesaret e qiejve dhe të Tokës, ndonëse hipokritët nuk kuptojnë.”** (Munafikun,7)

Nuk duhet të harrojmë që shpirti që do të ndriçojë dhe edukojë shoqërinë nuk është shpirti i cili thjeshtë është i dhënë pas librave por shpirti i besimtarëve të mirë i cili që është thelluar dhe mbrujtur me urtësitë kuranore.

**Allahu na ruajtë nga mbajtja e ngarkesës së rëndë të zemrave të sëmura, që janë shkatërruar për shkak të privimit nga Kurani. Na bëftë të gjithëve prej robërve të lumtur, që takohen në shërimin, udhëzimin dhe mëshirën e Kuranit dhe që vrapojnë të qetë drejt takimit hyjnor...**

**Amin!..**





# SHPËRDORIMI NË VLERAT MORALE

- 4 -



*Zoti ynë urdhëron që gjithë jetën tonë ta jetojmë brenda kornizës së moralit të bukur, me një zemër të ndjeshme dhe në një mënyrë që i ka hije dinjitetit njerëzor. Kjo, sepse Allahu i Madhëruar i ka falur njeriut aftësi morale. Ndërsa për krijesat e tjera nuk mund të bëhet fjalë për moral.*

*Është e pamundur të mendohet një jetë fetare e privuar prej bukurive morale. Një besim që nuk zbukurohet me vlera morale është si një dritë qiriu pa mburojë. Ai (besimi) është gjithmonë nën rrezik të madh përballë furtunave të egos dhe shejtanit.*



# SHPËRDORIMI

## NË VLERAT MORALE - 4

Morali, është një prej cilësive të bukura që Allahu i Madhëruar kënaqet kur e sheh te ne, robërit e Tij. Ai është një prej sukseseve më të mëdha të birit të njeriut, sepse sipas hadithit, “*Pajisuni me moralin e Allahut!*”<sup>62</sup>, morali i bukur është manifestimi i cilësive të bukura të Allahut në zemrën e besimtarit.

Nga kjo pikëpamje, pajisja me moral të bukur, si një prej detyrave tona më të rëndësishme të devotshmërisë, është një nga treguesit më të qartë të afërsisë sonë me Allahun. Morali i bukur është një vlerë e lartë që kurorëzon jetën tonë të devotshmërisë.

Morali përbën dinjitetin dhe nderin e njeriut dhe vë në pah identitetin e tij më të qartë. Për këtë arsye, morali është një cilësi e lartë që i takon njeriut ndër të gjitha krijesat.

Njeriu i përsosur, është një monument krijimi, i cili bart manifestimet e elegancës dhe delikatesës së artit hyjnor në këtë botë sprovash. Lloji njerëzor është krijuar si një shembull i veçantë i finesës së paarritshme dhe thellësive pafund. Dhe, këtë vlerë

---

62. Munau, et-Tearif, fq. 564.



të lartë, ai mund ta ruajë vetëm duke bërë një jetë të devotshme të frymëzuar me vlera morale.

Ndërsa zemra, e cila është si një lloj mburoje e moralit, është krijuar me aftësinë për të gëzuar një nder të lartë si “vend-shikimi hyjnor”. Për rrjedhojë, nëse njeriu bën një jetë në planin material duke rendur vetëm pas dëshirave të egos dhe nuk e zbulon botën e zemrës me aftësi morale, atëherë ai është duke e tradhtuar dinjitetin njerëzor dhe atë devotshmërisë, duke e humbur pozitën e lartë që ka tek Allahu i Madhëruar. Kjo do të thotë se njeriu, i cili është krijuar në formën më të bukur ndër të gjitha krijesat dhe është nderuar me një respekt të veçantë hyjnor, e çon dëm këtë vlerë të lartë duke e shpërdoruar në mënyrë të tmerrshme.

Qëllimi i moralit, është t’i japë njeriut vetëdijen se ndodhet gjithmonë nën vëzhgimin e kamerave hyjnore, duke e pastruar atë prej cilësive primitive për ta ngritur në nivelin e “njeriut të përsosur”, që është edhe tipi ideal për Islamin. Përveç kësaj, morali ka për qëllim të qëndisë në esencën njerëzore në mënyrë të natyrshme cilësitë e larta si mirësjellja, delikatesa, edukata, turpi, bujaria, dhembshuria dhe mëshira. Nga kjo pikëpamje, morali është një pjesë e pandarë e fesë dhe besimit, madje, është shpirti dhe thelbi i tyre. Për rrjedhojë, edhe Profeti i Allahut ﷺ, i cili u dërgua si mëshirë për botët dhe udhërrëfyesi ynë drejt udhëzimit, detyrën e dërgimit të tij si profet e ka përmbledhur me këto fjalë:

*“Unë jam dërguar për të plotësuar moralin e bukur.”*

(Muvatta’, Husnu’l-Hulk, 8)

Është e pamundur të mendohet një jetë fetare e privuar prej bukurive morale. Një besim që nuk zbulohet me vlera morale është si një dritë qiriu pa mburojë. Ai (besimi) është gjithmonë



nën rrezik të madh përballë furtunave të egos dhe shejtanit. Për këtë arsye, ne jemi të detyruar ta marrim nën mbrojtje fenë dhe besimin tonë me anë moralit të bukur si me një mburojë shpirtërore. i Dërguari i Allahut ﷺ, në një hadith fisnik ka thënë:

*“Xhibrili ﷺ, më ka thënë, se Allahu i Madhëruar, ka urdhëruar: «Kjo fe, është ajo që Unë kam zgjedhur për Vetën dhe me të cilën jam i kënaqur. Kësaj (feje), i shkon vetëm **bujaria dhe morali i bukur**. Për sa kohë të jetoni si mysli-manë, ngrijeni këtë (fe) me këto dy virtyte!»* (Hejthemi, VIII, 20; Ali el-Muttaki, Kenz, VI, 392.)

Ja pra, morali i bukur ka një rëndësi jetike për jetën fetare. Një jetë e pavetëdijshme për vlerat morale, është një shpërdorim i hidhur i asaj jete. Ndërsa zemrat që kanë përfituar prej këtyre vlerave, kanë gëzuar fatin të provojnë kënaqësinë dhe shijen e vërtetë të besimit. Kjo ndodhi, e shpreh shumë bukur faktin se, morali i bukur është një urë shpirtërore që e lidh njeriun me atmosferën e besimit dhe udhëzimit:

Në kohën e Profetit ﷺ, jetonte një sahab me moral të bukur me emrin Hakim ibn Hizam. Ky sahab ishte njëkohësisht edhe i afërm i nënës sonë Hadixhes ﷺ. Ai ishte shumë bujar, zemërbutë dhe bamirës. Në kohën para Islame, ai i shpëtonte nga vdekja dhe i mbronte vajzat e mitura të cilat baballarët e tyre donin t'i varrosnin të gjalla (për shkak të zakoneve injorante). Një ditë, ai shkoi tek i Dërguari i Allahut ﷺ dhe e pyeti:

*“Përpara se të përqafoja Islamin, bëja vepra të mira, duke dhënë bamirësi, duke liruar skllevër, si dhe duke mbajtur marrëdhënie të mira me të afërmit dhe farefisin. A do të kem shpërblim për këto vepra?”* Profeti ﷺ, i tha:

*“Në fakt, ti për hir të këtyre veprave të mira je nderuar me Islam!”* (Buhari, Zekat, 24; Muslim, Iman, 194-196.)



Ashtu si ky shembull, ka edhe shumë të tjerë të cilët tregojnë se sa lidhje madhështore ka morali i bukur me besimin. Një nga këto shembuj është edhe ai i magjistarëve që sfiduan Musain عليه السلام, me urdhër të Faraonit mizor i cili ishte kapluar aq shumë nga madhështia dhe pushteti që zotëronte, sa pretendonte se ishte Zot.

Këta magjistarë, më parë jetonin pa pasur asnjë dituri në lidhje me besimin e vërtetë. Mirëpo, edhe ata ishin njerëz fatlumë të cilët përfituan prej moralit të bukur që u bë çelës i besimit për ta. Para se të fillonte sfida, ata treguan respekt për Musain عليه السلام, duke i ofruar të drejtën për të filluar i pari. Mbase me këtë veprim ata kanë fituar kënaqësinë e Allahut të Madhëruar dhe, që në atë moment, në zemrat e tyre ka filluar të lulëzojë dashuria për besimin e vërtetë. Më pas, kur dëshmuar edhe manifestimet e mrekullive hyjnore, ata shijuan nderin e besimit në zemrat e tyre. Ai ishte një besim aq i përsosur, sa ata nuk hoqën dorë prej tij qoftë edhe në këmbim të jetës së tyre...

Në fakt, mrekullinë që u bë shkak i besimit të magjistarëve, e pa edhe Faraoni bashkë me ndjekësit e tij. Mirëpo, ata u zhytën edhe me më tepër inat në mohim. Si përfundim, magjistarët u martirizuan në mënyrë çnjerëzore nga Faraoni. Këta njerëz të mëdhenj u treguan të palëkundur në besimin e tyre dhe pinë sherbetin e dëshmorit. Për këtë arsye, historia e tyre është përmendur në Kuranin Fisnik dhe do të vazhdojë të mbetet si kujtim madhështor për të gjithë besimtarët deri në ditën e kijametit, gjë e cila është një mirësi tjetër hyjnore për ta.

Ja pra, kjo është begatia madhështore e vlerave morale si mirësjellja, delikatesa, zemërbutësia, bujaria dhe mëshira... Duhet menduar se, nëse morali i bukur, i cili ka një vlerë kaq të madhe tek Allahu i Madhëruar, bëhet shkak i nderimit me besim, që





është mirësia më e madhe e kësaj jete, kushedi se në cilat grada të larta e ngre besimtarin...

Nga ana tjetër, shpërdorimi i vlerave morale bëhet shkak i degjenerimit shoqëror dhe, si përfundim të çon drejt katastrofave të mëdha, gjë që është një humbje e madhe për botën tjetër. Paqja dhe qetësia individuale e shoqërore, është e mundur në sajë të edukimit të një brezi me moral të bukur, fetar, atdhedashës, me shpirt të butë e të mirë. Siç shprehet edhe Muhamed Ikbali: *“Myslimani është përgjegjës për rrjedhën e botës!”*

Për këtë arsye, Zoti ynë na ndalon nga ndjekja e rrugës së atyre që kanë rënë në çmendurinë e shpërdorimit duke i kaluar të gjitha kufijtë. Në një ajet fisnik urdhërohet:

**“Dhe mos dëgjoni urdhrat e atyre që e teprojnë në të keqe dhe të cilët bëjnë ngatërresa në Tokë e nuk sjellin përmirësim!”** (Shuara, 151-152.)

Ndërsa në një ajet tjetër urdhërohet:

**“Ata që duan të përhapen shpifjet e turpshme (ose imoraliteti) ndër besimtarët, i pret një dënim i dhembshëm në këtë botë dhe në tjetrën; Allahu i di të gjitha e ju nuk i dini.”** (Nur, 19.)

Privimi prej mirësive që janë në krye të vlerave morale, si turpi dhe edukata, buron nga dobësitë dhe mangësitë në fe dhe besim. i Dërguari i Allahut ﷺ, na ka bërë të ditur se këto vlera morale kanë një lidhje të rëndësishme me besimin duke thënë: *“Turpi është prej besimit!”* (Buhari, Iman, 3.)

Nisur nga kjo, ata që dëshirojnë që imoralitetet si paturpësia të përhapen në shoqëri, kanë bërë krimin më të madh ndaj besimit të asaj shoqërie. E në fakt, synimi kryesor i të gjitha feve qiellore, është që pasi të sigurojnë mbizotërimin e besimit



monoteist në tokë, të ndërtojnë një strukturë të fortë shoqërore, të mbrujtur me moral të bukur.

Historia njerëzore ka dëshmuar shumë manifestime të hakmarrjes hyjnore që janë përjetuar për shkak të imoralitetit dhe degjenerimit. Për rrjedhojë, ajo është e mbushur me skena shumë mësimdhënëse për njerëzit me mendje të shëndoshë. Dhe, për ta kuptuar këtë, mjafton të shëtitësh mbi tokë me syrin e urtësisë për të marrë mësim. Në një ajet fisnik urdhërohet:

**“Vallë, a nuk kanë udhëtuar ata nëpër botë, që zemrat e tyre të mendojnë dhe veshët të dëgjojnë? Në të vërtetë, atyre nuk u janë verbuar sytë (në këto gjëra), por u janë verbuar zemrat e veta në kraharor.”** (Haxh, 46.)

Kaplimi i shoqërive prej çmendurisë së shpërdorimit duke i kaluar kufijtë në imoralitet, është një prej shenjave të kijametit, që do të thotë shkatërrim i tërësishëm i kësaj bote. Dhe kjo, vë në pah cilësinë asgjësuese të shpërdorimit në vlerat morale. Imoralitetet dhe kalimi i kufijve që do të shfaqet në kohën afër kijametit na bëhen të ditura në shumë hadithe fisnike në këtë mënyrë:

*“Për njerëzit do të vijë një kohë e tillë, kur të gjitha shqetësimet dhe përpjekjet do të jenë për barqet e tyre. Nderi i tyre do të matet me pasurinë e tyre, kibla e tyre do të jenë gratë, ndërsa feja e tyre do të jetë dërhemi dhe dinari (paraja). Pikërisht këta janë krijesat më të këqija dhe, tek Allahu nuk kanë asnjë vlerë.”* (Ali el-Muttaki, Kenzu'l-Ummal, XI, 192/31186)

*“Do të vijë një kohë e tillë, kur njeriut nuk do t'i interesojë aspak se si e ka fituar pasurinë, hallall apo haram!”* (Buhari, Buju, 7.)

*“Do të vijë një kohë e tillë, kur ai që thotë të vërtetën do të përgënjeshtrohen, ndërsa gënjeshtarët do të besohen.*



*Njerëzit e besueshëm do të konsiderohen tradhtarë, e tradhtarët do të konsiderohen të besueshëm. Njeriu do të dëshmojë pa iu kërkuar të dëshmojë dhe do të betohet pa iu kërkuar të betohet...*” (Taberani, el-Mu’xhemu’l-Kebir, XXIII, 314.)

*“Do të vijë një kohë e tillë, kur njerëzit nuk do të këshillojnë të mirën dhe nuk do të pengojnë nga e keqja.”* (Hejthem, Mexhmau’z-Zeuaid, VII, 280.)

Gjithashtu, në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

*“Për njerëzit do të vijë një kohë e tillë, kur zemra e besimtarit do të shkrihet siç shkrihet kripa në ujë.”* Kur u pyet se:

*“Përse do të shkrihet, o Dërguari i All-llahut?”* Ai u përgjigj:

*“Sepse do t’i shohë të këqijat dhe nuk do të ketë fuqi t’i ndryshojë ato.”* (Ali El-Muttaki, Kenz, III. 686/8463).

Po ashtu, edhe ky transmetim i Abdullah ibn Omerit رضي الله عنه, është një shembull shumë i qartë, se çfarë shkatërrimi shkaktojnë dobësia dhe shpërdorimi në vlerat morale:

I Dërguari i Allahut ﷺ, u drejtua nga ne dhe tha:

*“O muhaxhirë! Janë pesë gjëra që nëse jepen pas tyre, strehohem tek Allahu që ju të mos i arrini këto gjëra:*

1. *Kur në një popull përhapet zinaja dhe prostitucioni, e më në fund ata e kryejnë këtë gjynah publikisht, tek ta do të shfaqet patjetër sëmundja e murtajës dhe sëmundje të tjera që nuk janë parë në popujt që kanë jetuar para tyre.*

2. *Populli që mat dhe peshon mangët, patjetër që do të ndëshkohen me uri, vështirësi jetese dhe padrejtësitë e kryetarëve të tyre.*



3. Çdo popull që i ikën pagesës së zekatit të pasurisë së tyre, patjetër që do të privohet nga shiu dhe, po të mos jenë kafshët e tyre, atyre nuk do t'u lëshohet fare shi.

4. Çdo popull që braktis urdhrat e Allahut dhe sunnetin e të Dërguarit të Tij, patjetër që Allahu do t'u vërsul një armik që nuk është prej tyre, i cili do të marrë një pjesë të atyre që zotëron ai popull.

5. Udhëheqësit (e një populli) që nuk punojnë me Librin e Allahut, por zgjedhin ato që u vijnë përshatë nga gjykimet e tij, Allahu do t'i ndëshkojë duke i përplasur me njëri-tjetrin (përfshihen nga trazirat dhe anarkia).” (Ibn-i Maxhe, Fiten, 22; Hakim, IV, 583/8623.)

Gjithashtu, edhe Allahu i Madhëruar na ka paralajmëruar shumë herë në Kuranin Fisnik për të na ruajtur nga rënia në këtë gjendje:

**“Dhe, për çdo fjalë që ai thotë, ka pranë vetes një mbikëqyrës të gatshëm (për ta shënuar atë).”** (Kaf, 18.)

Me këtë ajet, Allahu na ka bërë të ditur se ne nuk jemi lënë të livadhisim në qejfin tonë, por vëzhgohemi vazhdimisht për çdo gjë që veprojmë. Në këtë mënyrë, Ai na ka ftuar drejt një vigjilence të zemrës, duke kërkuar nga ne të respektojmë kufijtë hyjnorë në sjelljet tona, të qëndrojmë larg ekstremeve dhe të mos e shpërdorojmë jetën tonë me gjëra të kota. Për rrjedhojë, në Kuran gjenden shumë ajete fisnike që këshillojnë moralin e bukur duke urdhëruar maturinë në sjellje. Disa prej këtyre janë:

**“(Kanë shpëtuar besimtarët) të cilët shmangen nga fjalët e kota.”** (Mu'minun, 3.)

**“Ec me kujdes e i përmbajtur dhe fol me zë të ulët; se zëri më i vrazhdë është zëri i gomarit!”** (Lukman, 19.)



Dhe me të vërtetë që, një nga mënyrat kryesore të sjelljes që e shpien njeriun drejt shpërdorimit moral, është “vulgariteti”, i cili nënkupton braktisjen e bukurive morale si delikatesa dhe mirësjellja. Ashtu siç ngjasohet me shembullin e gomarit në Kuran, vulgariteti është si mohim i natyrës njerëzore dhe lamtumirë e virtyteve.

Mënyra e të folurës që i ka hije njeriut, është gjuha e butë, e cila në Kuran shprehet me fjalën, “*Kaul-i lejjin*”<sup>63</sup>. Kur Allahu i Madhëruar e dërgoi Musain ﷺ, tek Faraoni, e urdhëroi të fliste me një gjuhë të butë edhe ndaj tij. Gjithashtu, Allahu i Madhëruar ka urdhëruar që kur të flasim me njerëzit të respektojmë rregullat e mirësjelljes:

**“Thuaju, robërve të Mi, që të flasin atë që është më e miral!..”** (Isra, 53)

Ndërsa në një ajet tjetër, duke na folur në emër të Profetit tonë ﷺ, Allahu i Madhëruar na ka bërë të ditur këto rregulla të mirësjelljes:

**“Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje!”** (Al-i Imran, 159.)

Nga ana tjetër, ashtu si në çdo çështje, edhe në sjelljet morale është kusht të respektohet maturia. Përndryshe, shumë sjellje morale që janë të pranueshme kur bëhen me maturi, nëse kryhen në mënyrë të tepruar, pra me shpërdorim, ato mund ta çojnë njeriun në ekstreme.

Për shembull, “modestia” është një sjellje e bukur morale. Por, nëse teprohet me të, ajo mund të kthehet në një lloj mburrjeje indirekte, gjë e cila çon në shpërdorimin e modestisë. Dhe,

63. shih. TaHa, 44.



me të vërtetë që disa njerëz mbajnë qëndrime modeste me qëllim që të kënaqin egon e tyre kur të dëgjojnë të tjerët që i përmendin si njerëz “modest”. Kjo sjellje jo e sinqertë dhe për sy e faqe, nuk është gjë tjetër veçse një mburrje nën maskën e modestisë.

Për shembull, fjalë të tilla si, “unë jam i dobët në besim, por njëherë në tre ditë e lexoj komplet Kuranin”, ose “unë jam i varfër, por arrita ta ndërtoj një xhami dhe kam ndihmuar kaq të varfër”, nuk janë gjë tjetër veçse shfaqje e mburrjes dhe syefaqësisë nën perden e modestisë. Po ashtu, edhe shfaqja e tepruar e modestisë para një njeriu mendjemadh, duke poshtëruar veten, është një lloj tjetër i shpërdorimit të moralit.

Gjithashtu edhe teprime të tjera si, kaplimi prej mendjemadhësisë në emër të ruajtjes së seriozitetit ose kalimi i kufijve në miqësi, duke u sjell pa teklif në marrëdhëniet njerëzore, shoqërore, e veçanërisht në ato të jetës familjare, janë humbje që lindin prej teprimit apo shpërdorimit në sjelljet morale. Kjo do të thotë se, matura në sjelljet morale dhe kalibrimi i duhur i mirësjelljes në situata të ndryshme, është një kusht i domosdoshëm për të mos rënë në shpërdorimin e moralit. Për shembull, i Dërguari i Allahut ﷺ, duke treguar një delikatesë dhe kujdes të madh, ka porositur kështu në lidhje me sjelljen ndaj skllevërve dhe shërbyesve:

*“Askush prej jush të mos thotë (skllevërve apo shërbyesve) «skllavi im, robëresha ime», sepse të gjithë jeni robër të Allahut. Po ashtu edhe gratë tuaja janë robër të Allahut. Kur t’i drejtoheni (skllevërve apo shërbyesve), u thoni, «biri im, bija ime, trim!»”* (Muslim, Elfaz, 13.)

Përkundër kësaj, atyre që e humbasin botën e zemrës mes të këqijve dhe gjynaheve dhe tërheqin mbi vete zemërimin hyjnor, Profeti ﷺ, ka porositur që t’u drejtoheni në këtë mënyrë:



*“Dyftytyrëshit mos i thoni «zotëri»! Nëse do ta konsideroni atë si zotëri, do të tërhiqni mbi vete dënimin e Zotit tuaj që është Fuqplotë dhe Fisnik.”* (Ebu Daud, Edeb, 83; Ahmed, V, 346.)

Domethënë, përdorimi i kritereve si modestia dhe mirësjellja në marrëdhëniet njerëzore në të njëjtën mënyrë dhe në çdo vend, si syze pa numër, të çon në shpërdorimin e moralit. E në fakt, dashuria ndaj atij që e meriton, urrejtja ndaj atij që e ka hak dhe sjellja në mënyrën që kërkohet, është një domosdoshmëri morale. E rëndësishme është që ashtu si në çdo çështje, edhe në çështjen e moralit, të respektohen kriteret hyjnore, duke ruajtur ekuilibrin e maturisë dhe duke shfaqur karakterin e një besimtari të pjekur.

Vetë Profeti ﷺ, e ka jetuar moralin Islam me një delikatesë dhe edukatë të lartë dhe ia ka porositur edhe ummetit të vet këto metoda me anë të personalitetit të tij të lartë që cilësohet si “usue-i hasene / shembulli më i bukur”. Për rrjedhojë, edhe nëse e dinte fajtorin në një grup njerëzish, i Dërguari i Allahut ﷺ, nuk ia përplaste fajin në fytyrë. Ai bënte të ditur se ajo sjellje nuk ishte e hijshme, duke ia atribuar vetes mangësinë me këto fjalë: *“Çfarë po ndodh me mua që ju shoh në këtë mënyrë!”*<sup>64</sup>

Po ashtu, duke shfaqur të njëjtën metodë edukuese plot delikatesë, njëherë, kur ndodheshin në xhami, u ndje një erë e rëndë (gazra), me ç’rast i Dërguari i Allahut ﷺ, tha: *“Ata që kanë ngrënë mish deveje le të marrin abdes!”*. Në këtë mënyrë, me qëllim që të mos e ulte personin me faj, Profeti ﷺ, e përgjithësoi çështjen duke e porositur edhe bashkësinë të ruhet nga ky veprim. Si përfundim, për të mbuluar veprimin e pavullnetshëm të një personi, ai i urdhëroi të gjithë sahabët të merrnin abdes.

64. shih. Buhari, Menakib, 25; Muslim, Salat, 119.



Morali profetik, nxit gjithmonë të jesh i mëshirshëm, i mirë-sjellshëm, delikat dhe zemërbutë. Për këtë arsye, njerëzve të vrazhdë që vinin nga shkretëtira dhe bërtisnin vazhdimisht, “O Muhamed! O Muhamed!”, i Dërguari i Allahut ﷺ, i drejtohej çdo herë me një mënyrë të butë duke ju thënë, “Urdhëroni, çfarë dëshironi?”<sup>65</sup>.

Nga kjo pikëpamje, në punët e virtytshme, si qortimi dhe udhëzimi i njerëzve që gabojnë, është e domosdoshme të llogaritet edhe niveli i botëkuptimit të tyre, e sidomos, të respektohet kjo mirësjellje dhe edukatë profetike.

Po ashtu, një kusht i domosdoshëm i virtyteve të “bujarisë” dhe “dhurimit”, të cilat përbëjnë manifestimin më të rëndësishëm të moralit të bukur, është edhe respektimi i metodës dhe edukatës së duhur. Përndryshe, gabimet gjatë kryerjes së një mirësie, si vrazhdësia, thyerja e zemrës, mendjemadhësia etj., bëhen shkak i humbjes së shpërblimit të këtyre mirësive, e për rrjedhojë edhe i shpërdorimit të këtyre virtyteve. Kjo është edhe arsyeja që të parët tanë, me qëllim që të mos pësonin dobësim moral, kanë treguar një kujdes tepër të veçantë gjatë bamirësive që bënin.

Të parët tanë, për të ruajtur edhe dinjitetin njerëzor të të sëmurëve mendorë, në lidhje me ta përdornin shprehjen, “të nderuarit e dobët”. Ndërsa për lebroset e braktisur nga shoqëria, kanë ndërtuar strehimore të cilat i kanë quajtur “teqeja e të dobëtëve”.

Po ashtu, ata kanë formuar edhe vakëfe për të ruajtur nderin e grave të moshuara e të vetmuara, të cilat për shkak të turpfit dhe dinjitetit, nuk ua shfaqnin nevojat e tyre të tjerëve. Këtyre grave të moshuara u është siguruar lesh i pastër, i larë dhe i krehur, të cilin ato e kanë tjerë dhe më pas u është blerë me





çmim të lartë, në mënyrë që ato të kishin mundësi të siguronin të ardhurat me djersën e tyre.

Me qëllim që ata të cilët jepnin sadaka dhe ata që merrnin të mos përballeshin me njëri-tjetrin, pranë xhamive janë ndërtuar disa vende të posaçme që quheshin “gurë sadakaje”. Ndërsa ushqimet për të varfrit, shpërndaheshin natën në errësi në enë të mbyllura, me qëllim që ata të mos turpëroheshin.

Nëna Sulltaneshë Bezmialem ka ngritur një vakëf me qëllim që të paguante sendet e thyera apo dëmet që mund të shkaktonin shërbyesit që punonin pranë njerëzve të vrazhdë e të egër. Dhe kjo, vetëm e vetëm që ata të mos qortoheshin dhe të mos poshtëroheshin nga punëdhënësit e tyre.

Allahu i Madhëruar, nuk e pëlqen aspak përcëimin e robërve të Tij dhe cenimin e zemrave të tyre, që është edhe vend-shikimi hyjnor. Të parët tanë e kanë kuptuar shumë mirë këtë. Për rrjedhojë, me edukatën, mirësjelljen, delikatesën dhe kujdesin që kanë treguar gjatë vënies në jetë të moralit Islam, ata u bënë shembuj të mirë edhe për ne.



Shkurtimisht, Zoti ynë urdhëron që gjithë jetën tonë ta jetojmë brenda kornizës së moralit të bukur, me një zemër të ndjeshme dhe në një mënyrë që i ka hije dinjitetit njerëzor. Kjo, sepse Allahu i Madhëruar i ka falur njeriut aftësi morale. Ndërsa për krijesat e tjera, nuk mund të bëhet fjalë për moral. Për rrjedhojë, nëse njeriu e çon dëm këtë aftësi, duke i ngjarë krijesave të tjera, madje duke rënë në një nivel edhe më të ulët se ato, kjo është një humbje e hidhur në emër të dinjitetit njerëzor dhe një shpërdorim i çmendur e tragjik...

**Zoti ynë na ruajttë prej çdo lloj të keqeje dhe shpërdorimi që mund të na e çojnë dëm jetën në botën tjetër! Po ashtu, i**



**bëftë zemrat tona të përfitojnë prej begatisë së këtyre lutjeve që kanë dalë nga zemra e Profetit tonë të dashur ﴿﴾:**

***“O Allah! Zbukuroma moralin ashtu siç më ke zburuar krijimin!”***

***“O Zot! Bëmë ta arrij moralin më të bukur! Pa dyshim, vetëm Ti je Ai që mund të më bësh ta arrij atë!”<sup>66</sup>***

**Amin!..**



# SHPËRDORIMI NË MEDITIM

- 5 -



*Meditimi i vërtetë, fillon në pikën ku takohen mendja dhe zemra e frymëzuar me shpalljen.*

*Të dashurit e Allahut, të cilët kanë një botë shpirtërore shumë të gjerë, i vëzhgojnë veprat e artit hyjnor, sikur shohin në një pus të thellë. Dhe prej aty, ecin drejt atmosferës shpirtërore. Fjalët nuk mjaftojnë dhe gjuha është e pafuqishme të shprehë gjendjen e një shpirti që dëgjon dhe të një zemre që sheh. Ja pra, ata që e shohin gjithësinë me këto ndjenja shpirtërore, arrijnë të shijojnë artin hyjnor në mrekullitë e panumërta që Zoti ynë i shfaq në natyrë.*



## SHPËRDORIMI NË MEDITIM -5-

Allahu i Madhëruar, i ka falur njeriut cilësi të larta, si mendjen, logjikën dhe meditimën, duke e ngritur atë më lart se krijesat e tjera. Po ashtu, duke përdorur të gjitha llojet e shembujve në Kurani Fisnik, Ai i drejtohet të zotëve të mendjes. Kjo, sepse Ai ka dëshiruar që robërit e Tij të jenë gjithmonë në meditim dhe t'i shohin të gjitha krijesat me syrin e urtësisë për të marrë mësim. Për këtë arsye, shpesh herë në ajetet fisnike i fton robërit e Tij në meditim me shprehje si: **“A nuk mendoni?”**, **“A nuk kuptoni?”**, **“A nuk meditoni?”**, **“Me shpresën që të mendoni!”**, **“Merrni mësim!”**, etj.

Kurani Fisnik, i drejtohet mendjes që e gjen vlerën e vërtetë të përmbajtjes së shpalljes hyjnore, duke i thënë gjashtë herë; **“Ja ulil el-bab”**, pra, **“o të zotët e mendjes”**. Prandaj, njerëzit e mençur që dëshirojnë të bëjnë një jetë dinjitoze në përputhje me vlerat njerëzore, janë të detyruar të hyjnë në botën e medimit që ka ndriçuar Kurani.

Nëse nuk do ekzistonte horizonti i medimit që i tregoi Islami njerëzimit, shumë të vërteta, as nuk do të mund t'i kuptonim dhe as nuk do të mund t'i shprehim vetëm me mendjen tonë. Mbi të gjitha, mirësinë e medimit do t'ia kushtonim interesave të egos sonë. Nisur nga kjo, ne kemi nevojë për udhëzimin dhe porositë e



Kuranit dhe Sunetit, sepse udhëzuesi i vetëm që i jep një orientim të drejtë meditimit njerëzor dhe përcakton parimet për të jetuar në rrugën e drejtë, është Kurani Fisnik dhe Suneti.

Meditimi, është një nga adhurimet më të rëndësishme. Për të bërë një jetë me devotshmëri të pranuar, kërkohet njohja e urtësive dhe fshehtësive të gjithësisë dhe të ndodhive në të. Dhe, për të arritur këtë, duhet që bota e zemrës të thellohet në meditim. Përpjekja për t'i përshtatur me kënaqësinë hyjnore të gjitha mendimet me të cila angazhohet mendja, ndjenjat në zemër, madje edhe frymëmarrjet, duhet të jetë horizonti dhe synimi i çdo besimtari. Kjo, sepse Allahu i Madhëruar, na ka krijuar për të adhuruar vetëm Atë. Të gjitha mendimet dhe sjelljet në kundërshtim me këtë urtësi të krijimit tonë, hyjnë në kufijtë e shpërdorimit.

Mendja, që është edhe një nga mirësitë më të mëdha që i është dhuruar njeriut, nuk mjafton e vetme për ta çuar njeriun tek e vërteta. Vlera e meditimit të njeriut, varet nga funksionimi i trurit dhe zemrës në mënyrë të ekuilibruar dhe harmonike. Nëse i jepet vlerë vetëm trurit dhe mendjes, mbase mund të dalë në pah një njeri i mirë për këtë botë, pra një njeri interesi. Por për t'u bërë një besimtar i përkryer, duhet që edhe zemra, e cila është qendra e ndjenjave, të marrë edukimin e duhur shpirtëror dhe të bëhet udhëzuese e mendjes. Kjo, sepse zemra që është edhe epiqendra e ndjenjave, orienton meditimin; ndërsa meditimimi, orienton vullnetin. Kjo, do të thotë se, shkaktari kryesor i të gjitha veprave të vullnetshme është zemra; pra, ndjenjat që vendosen dhe zënë vend aty. Nga kjo pikëpamje, përshtatja e saj brenda kornizës së urdhrave hyjnore, është më e rëndësishme se përshtatja e organeve të tjera.

Mendja e njeriut, bota e zemrës së të cilit është ndriçuar me



dritën e Kuranit dhe Sunetit, njihet lehtë me të vërtetën. Mendja dhe zemra, janë krijuar në mënyrë që ta shpjen njeriun tek e mira dhe e vërteta, nëse ato frymëzohen nga burimi hyjnor. Prandaj, meditimi i vërtetë, fillon në pikën ku takohen mendja dhe zemra e frymëzuar me shpalljen.

Të përpiqesh të meditosh rreth çështjeve që janë jashtë fuqisë së mendjes, është një lloj shpërdorimi i meditimit. Meditimi i shfaqjeve të attributeve të Allahut, i Kuranit, i gjithësisë dhe çështjeve të tjera në lidhje me strukturën e vetë njeriut, është një proces i domosdoshëm. Por të përpiqesh të meditosh çështje që janë jashtë fuqisë njerëzore, si të mendosh rreth Esencës së Allahut, të mundohesh të zgjidhësh gjithçka rreth të fshehtave të kaderit (caktimit) dhe urtësive, është një lloj shpërdorimi i mendjes.

Kjo gjendje, është e ndaluar edhe nga Kurani e Suneti, sepse ashtu sikur syri që ka një distancë të kufizuar shikimi dhe veshi një distancë të kufizuar dëgjimi, ashtu edhe mendja ka një fuqi të kufizuar kuptimi. Për këtë arsye, mendja merr vlerë vetëm brenda shpalljes. Nisur nga kjo, ashtu sikur mosmeditimi i të vërtetave hyjnore bëhet shkak shkatërrimi, ashtu edhe mosnjohja e kufijve të mendjes dhe angazhimi me çështje që e kalojnë fuqinë e saj, e çon njeriun në shpërdorim dhe si përfundim e shpie në humbjen e botës tjetër.

Meditimi i mendjes së sulmuar nga sëmundjet e zezës si arroganca dhe mendjemadhësia që burojnë nga dëshirat e egos dhe e privuar nga udhëzimi i zezës së pastër, devijon nga udha e vërtetë dhe e shpie njeriun në tërbim e perversitet, njësoj si shejtani. I nderuari Mevlana, thotë:

*“Nëse shejtani do të kishte dashuri aq sa ka zgjuarsi, nuk do të binte në këtë gjendje që është sot.”*



Domethënë se, mendja, e vetme nuk ka asnjë vlerë. Orientimi i saj me ndjenja shpirtërore është një kusht i domosdoshëm. Nëse arrihet që ndjenjave të zemrës t'u jepet një edukim shpirtëror, ato arrijnë të marrin në dorë timonin e mendjes dhe t'i japin asaj drejtimin e duhur. Marrja e ndjenjave nën kontroll, është shumë e vështirë. E megjithatë, është kusht që ne të përpiqemi t'i përshtatim ndjenjat tona me kënaqësinë hyjnore. Dhe, mënyra për ta arritur këtë, është meditimi nën atmosferën e Kuranit dhe Sunetit. Në horizontet ku ngrihesh me një meditim të tillë, në sajë të mirësive dhe dhuratave të Allahut, ashtu si bota e mendimit tonë, edhe bota e ndjenjave tona përshtatet me kënaqësinë hyjnore.

Zemra, e cila është vendi i ndjenjave, në të njëjtën kohë është edhe qendra e besimit, sepse besimi, është një ndjenjë e lartë, një ndjenjë madhështore. Në fund të fundit, besimi nuk aprovohet me mendje, por me zemër. Po ashtu, edhe të fshehtat hyjnore në gjithësi, mund të zbulohen vetëm në sajë të një mendjeje të lidhur me një zemër besimtare. Kjo është edhe arsyeja që çështja më e rëndësishme dhe më delikate e fesë, është besimi, sepse besimi asnjëherë nuk pranon dobësi; pra, një tolerancë që buron prej egos. Nëse në një xham do të kishte krisje sa qimja e flokut, me kalimin e kohës ajo krisje do të zmadhohej dhe si përfundim xhami do të thyhej. Kështu që, për të mos lejuar njolla të zeza në botën e zemrës, pra për të mos lejuar formimin e krisjeve, është e nevojshme të jemi të zgjuar e vigjilentë.

Përkushtimi në adhurime, bëhet shkak i shtimit të shpërbli-meve, ndërsa shkujdesja, bëhet shkak i pakësimit të tyre. Mirëpo, animi i meditimit nga interesat egoiste, shkakton krisje në zemër, duke e rrezikuar rëndë besimin. Shkujdesja në çështjen e besimit, -Allahu na ruajttë- ia rrëshqet këmbën njeriut.





Një prej shembujve të panumërt të kësaj gjendjeje, është edhe Karuni, i cili në të shkuarën e tij, kishte qenë njeri i mirë dhe Allahu i Madhëruar i fali pasuri të madhe. Mirëpo, atij i hyri vetja në qejf, i kaloi kufijtë, u mashtrua dhe në fund filloi të pretendonte se pasurinë e tij e kishte fituar në sajë të zgjuarsisë së vet. Madje, duke shkuar edhe më larg, ai tentoi të mbante qëndrim të kundërt me Musain عليه السلام. Por Allahu i Madhëruar, e fundosi atë me gjithë pasurinë e tij në fund të dheut. Në lidhje me përfundimin e tij, Kurani Fisnik shprehet:

**“Ne e fundosëm atë (Karunin) dhe pallatin e tij në tokë dhe, përveç Allahut nuk kishte kurrkush që ta ndihmonte atë, e as vetë nuk mundi të mbrohej (prej dënimit të Allahut).”**

(Kassas, 81)

Shkarja e zembrës prej themelit të besimit, është njësoj si ai që duke prerë bukën, për shkak të pakujdesisë i rrëshqet thika dhe pret dorën. Rrëshqitja e thikës, është diçka momentale. Por, edhe ndjenjat përnjëherësh zhvillohen. Organi më i pavarur i trupit, është qendra e ndjenjave, zemra. Prirjet e zembrës mund të ndryshojnë nga çasti në çast. Zemra ndodhet midis dy gishtave të Allahut. Ashtu siç ka fuqinë për të udhëzuar, Allahu ka edhe fuqinë për të devijuar. Nuk dihet se kur njëra prej tyre do të mbizotërojë ndaj tjetrës.

Një shembull tjetër, është edhe ndodhia mësimdhënëse e Bel'am ibn Baurës, e transmetuar në Kuran. Këtë njeri, e shkatërroi një moment i animit kah egoja e vet. Dikur edhe ai kishte qenë një prej robërve të mirë të Allahut. Ai bënte gjëra të jash-tëzakonshme dhe duatë e tij pranoheshin. Por animi për një moment nga dëshirat e egos, pra lënia e mendjes nën drejtimin e egos, u bë shkak i shkatërrimit të tij. Gjendja e tij, në Kurantin Fisnik tregohet kështu:



**“Dhe lexoju atyre tregimin e atij që patëm dhënë dituritë Tona, ndërsa ai u zhvesh prej tyre dhe atëherë atë e shoqëroi shejtani dhe kështu ai u bë prej të humburve. E sikur të donim Ne, do ta ngrinim lartë me (dituri), por ai nuk iu largua tokës (dynjasë) dhe shkoi pas epshit të vet. Shembulli i tij është si ai i qenit, të cilin nëse e përzë ai e nxjerr gjuhën, po edhe nëse nuk e përzë, ai sërish e nxjerr gjuhën. Ky është shembulli i atyre që i konsideruan të rreme argumentet Tona. Ti rrëfeju tregimet (umetit tënd) në mënyrë që ata të mendojnë.”** (A'raf, 175-176.)

Ashtu siç thuhet edhe më sipër, të tentosh ta përdorësh mendjen jashtë kuadrit të shpalljes, në shërbim të dëshirave të egos, e bën njeriun budalla; pra, e shpie atë në çoroditjen që tregohet në ajet. Për këtë arsye, Profeti ﷺ, në duatë e tija thoshte: *“O Zot! Mos më lër në dorë të egos sime, qoftë edhe sa një hapje mbyllje sysh!..”*<sup>67</sup>, duke dashur të na tregojë gjendjen shpirtërore që duhet të ketë një besimtar shembullor.

Domethënë, se për të mbrojtur besimin tonë, jemi të detyruar ta edukojmë veten me një ndjenjë midis frikës dhe shpresës, duke i dhënë drejtimin e duhur meditimit tonë. Dhe, me qëllim që në frymën tonë të fundit të japim shpirt me besim, duhet që zemra jonë të jetë e butë dhe vigjilente gjatë gjithë jetës. Allahu i Madhëruar, në një ajet fisnik, urdhëron: **“O ju që besuat, kini frikë Allahun me sinqeritet të vërtetë dhe mos vdisni përveçse si myslimanë!”** (Al-i Imran, 102.)

Për shembull, nëse edhe ndjenjat e dashurisë dhe urrejtjes nuk janë për hir të Allahut; nëse ndjehet dashuri për atë që duhet urreyer, e urrehet ajo që duhet dashuruar, kjo bëhet shkak i shkatërrimit shpirtëror. Pra, është kusht që dashurinë t'ia falësh



atij që e meriton, ndërsa urrejtjen atij që e ka hak. Nisur nga kjo, dashuria për njerëzit e mirë, të dhuron lumturi. Në një ajet fisnik urdhërohet:

**“O besimtarë! Frikësojuni Allahut dhe bëhuni me ata që janë të sinqertë (në fjalë dhe në vepra)!”** (Teube, 119)

Nga ana tjetër, nëse ndjehet dashuri për një armik të fesë, kjo gjë sjell shkatërrim. Në lidhje me këtë, në një ajet fisnik urdhërohet:

**“...mos rri me keqbërësit!”** (Enam, 68)

Domethënë se, për ta mbështetur meditim tonë në një themel të pranueshëm, duhet që edhe ndjenja tona të edukohen duke marrë frymëzim prej burimit hyjnor.

Në një ajet tjetër, urdhërohet:

**“Ne ua ofruam përgjegjësinë qiejve, Tokës dhe maleve, por ato nuk pranuan ta marrin përsipër dhe u frikësuan ta pranojnë atë. Kurse njeriu e pranoi. Me të vërtetë, njeriu u tregua i padrejtë me veten dhe i paditur.”** (Ahzab, 72)

Për shkak se njeriu nuk e vlerësoi si duhet peshën e amanetit hyjnor që pranoi mbi supe, në ajetin e mësipërm, ai përmendet si “*dhalum*” i padrejtë dhe “*xhehul*” i paditur. Në të njëjtën kohë, kjo bëhet për të treguar peshën e amanetit, duke i ftuar njerëzit të tregohen të kujdesshëm. Shpëtimi prej cilësive “*Dhalum*” dhe “*Xhehul*”, arrihet me “vepra të mira” dhe shndërrimin e dijeve fizike e metafizike në urtësi me anë të medimit. Në suren *el-Asr*, Zoti ynë na bën të ditur se, për të shpëtuar prej humbjes, njeriu duhet të besojë, të bëjë vepra të mira dhe duhet të marrë pjesë në adhurimet e përbashkëta, duke këshilluar të vërtetën dhe durimin. Për shkak të të vërtetave thelbësore e të thella që përmban, Imam Shafiu -rahmetullahi alejh-, në lidhje me këtë sure ka thënë:



“Nëse njerëzit do të meditonin ashtu siç duhej në lidhje me suren *el-Asr*, kjo do t’u mjaftonte atyre.” (Ibn-i Kethir, Tefsiri i Sures *el-Asr*)

Zoti ynë, në Kuranin Fisnik na paraqet një horizont të gjerë meditimi. Në lidhje me këtë, në një ajet fisnik, urdhërohet:

**“Ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjor ose shtrirë dhe që meditojnë në krijimin e qiejve dhe të Tokës (duke thënë): “O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto; lartësuar qofsh (nga çdo e metë)! Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit.”** (Al-i Imran, 191)

Shfaqjet e fuqisë hyjnore në lidhje me hapësirën, si tokën dhe qiejt dhe në lidhje me kohën, si natën dhe ditën, konsiderohen si ftuesit më të mirë për të zotët e mendjes, me qëllim që t’i afrohen Allahut të Madhëruar. Ai dëshiron që ne të mësohemi me gjuhën e universit, sepse të gjitha krijesat flasin me njeriun, zemra e të cilit është e etur për bukuritë hyjnore. Çdo gjë, që prej grimcës e deri tek trupat më të mëdhenj, i kujtojnë njeriut madhësitinë e Zotit të tij.

Meditimi rreth shfaqjeve të madhësisë hyjnore në gjithësi, e shpie robin në atmosferën e modestisë dhe “hiç”it. Po ashtu, edhe pjekuria e një besimtari, varet nga njohja e dobësisë dhe kufijve të vet përballë Allahut të Madhëruar. Pranimi nga ana e njeriut i dobësisë dhe qenies një “hiç” përballë Zotit të tij, e ndihmon atë në luftën dhe eliminim e sëmundjes së arrogancës dhe mendjemadhësisë. Nisur nga kjo, Profeti ﷺ, në duatë e tija, thoshte: “O Zot! Ne nuk mundëm të të njohim ashtu siç e meriton Ti...”<sup>68</sup> dhe më pas kërkonte falje prej Tij.

Egoja e njeriut që nuk e ka shijuar kurrë dobësinë dhe dësh-



përimin në jetën e tij, kthehet në një kalë të tërbuar, si shembulli i Faraonit, Nemdrudit, Karunit, Hamanit etj... Njerëzve të tillë, krimet dhe padrejtësitë u duken si një melodi e ëmbël dhe e këndshme.

Nga ana tjetër, nëse njeriu merr mësim prej sëmundjeve, fatkeqësive, etj., të cilat e bëjnë të ndihet i dobët, në të vërtetë, për atë njeri kjo do të ishte mirësi, sepse këto e fusin atë në atmosferën e dobësisë, modestisë dhe dëshpërimit, në saj të të cilave ai rënkton duke thënë: *“Të lutem o Zot!”*.

Gjithashtu, njeriu arrin pjekuri shpirtërore dhe fiton forcë, aq sa vuajtje dhe vështirësi kalon në jetën e tij. Në bazë të kësaj urtësie, Allahu i Madhëruar i ka kaluar të gjithë Profetët dhe njerëzit e mirë në rrethin e vuajtjeve sipas gradës së tyre. Dhe kjo, për ta është bërë një shfaqje mirësie shumë e veçantë, duke u bërë shkak i përkryerjes së tyre shpirtërore.

Shejh Sadi Shirazi, thotë:

*“Për të zotët e mendjes, çdo gjethë peme është një libër i detajuar në lidhje me çështjen e njohjes së Allahut (me zemër). Ndërsa për njerëzit e pavetëdijshtëm, të gjitha pemë nuk vlejnë as sa një gjethë.”*

Me qëllim që ndjenjat dhe aftësia jonë e të kuptuarit të kthehen në deshifruar të të fshehtave hyjnore në gjithësi, kërkohet një aftësi kuptimi dhe thellësi shpirtërore e gatuar me meditim. Shfaqjet e fuqisë hyjnore në gjithësi, janë si poezi hyjnore të heshtura e pafjalë. Këto poezi hyjnore, thellohen në varësi të ndjenjave në zemra. Të dashurit e Allahut, të cilët kanë një botë shpirtërore shumë të gjerë, i vëzhgojnë veprat e artit hyjnor, sikur shohin në një pus të thellë. Dhe prej aty, ecin drejt atmosferës shpirtërore. Fjalët nuk mjaftojnë dhe gjuha është e pafuqishme të shprehë gjendjen e një shpirti që dëgjon dhe të një zemre që



sheh. Ja pra, ata që e shohin gjithësinë me këto ndjenja shpirtërore, arrijnë të shijojnë artin hyjnor në mrekullitë e panumërta që Zoti ynë i shfaq në natyrë. Ata shohin gjethet dhe lulet shumëngjyrëshe të bimëve që dalin nga e njëjta tokë, natyrën e tyre, frutat e ndryshme në ngjyrë, aromë, shije e formë dhe dizajnin e mrekullueshëm në krahëve e fluturave, që nuk kanë më tepër se dy javë jetë. Po ashtu, ata u vënë veshin edhe ligjërimeve të mistershme të krijesave. Për njerëz të tillë, i gjithë universi është si një libër i gatshëm për t'u lexuar.

Ndërsa të pavetëdijsmit, bota e mendjes dhe e zemrës së të cilëve është e thatë dhe e cekët, shohin vetëm pjesën e jashtme të çdo gjëje dhe nuk i vërejnë kurrë perlat shpirtërore brenda tyre. Sa bukur e shpreh Melvana i nderuar këtë gjendje:

*“Ata që dashurohen mbas kësaj bote, i ngjajnë gjahtarit të hijeve. E si mund të bëhet hija pronë e tyre? Një gjahtar pamend, u gënjye nga hija e zogut dhe deshi ta kapte atë. Mirëpo, edhe vetë zogu mbi degë, u habit me këtë budalla-llëk.”*

Një i dashur i Allahut ka thënë:

*“Kjo botë, për të mençurit është vend ku mund të shihen me zemër misteret dhe arti hyjnor, ndërsa për njerëzit pamend, është vetëm ushqim dhe epsh.”*

Me të vërtetë që, zemrat e urta që e shohin këtë botë me syrin e urtësisë për të marrë mësim, në çdo gjë ndjejnë një ligjëratë të ndryshme dhe prej kësaj bote mbledhin urtësi. Ndërsa të pavetëdijsmit, thonë; *“Hajt ta shijojmë këtë botë, se nuk do të vijmë më këtu!”*, duke e shtuar edhe më tepër nxirjen dhe plasaritjen e zemrës.

I nderuari Mevlana, na fton t'i thërrasim mendjes dhe duke medituar në lidhje me gjendjen tonë, na këshillon të mendojmë rreth urtësisë së ekzistencës sonë me këto fjalë:



*“Shikoje dhe merr mësim prej kësaj shoqërie njerëzore!.. Ti i sheh mirë shfaqjet e fuqisë hyjnore në këtë botë ku jeton. Atëherë përse verbohesh e tregohesh pamend? Pse të duket sikur interesat dhe dëshirat trupore janë të mëdha si male, ndërsa meditimi i pastër të duket si milingonë? O “esfel-i safilin”; ti që ke rënë më poshtë se të poshtrit! Ashtu sikur guri që nuk ia ka haberin asgjëje, edhe ti nuk ia ke fare haberin botës së meditimit. Sa keq që e ke çuar dëm meditimin dhe je privuar nga kënaqësia më e madhe!”*

Sa gjë e hidhur është kur mirësia e meditimit përdoret veç për dëshirat e egos. Mosmeditimi, është tregues i marrëzisë dhe i dembelizmit të zemrës; ndërsa pandjeshmëria, tregon verbimin dhe shurdhimin e zemrës. Pandjeshmëria e zemrës përballë gjithë këtyre shfaqjeve hyjnore, nuk përputhet aspak me dinjitetin njerëzor. Pavetëdija, që e bën njeriun ta shohë këtë univers me një çehre të varur e të vakët, është një fatkeqësi e madhe shpirtërore. Në Kuranin Fisnik, kjo gjendje shprehet me këto fjalë:

**“Vallë, a nuk kanë udhëtuar ata nëpër botë, që zemrat e tyre të mendojnë dhe veshët të dëgjojnë? Në të vërtetë, atyre nuk u janë verbuar sytë, por u janë verbuar zemrat e veta në kraharor.”** (Haxh, 46)

Mevlana, përdorimin e mirësisë së meditimit në mënyrë të gabuar, e përmngjan me “vendosjen e plehrave në një enë floriri”. Kjo, do të thotë që mirësitë e meditimit dhe të ndjeshmërisë, që janë edhe më të çmuara se floriri, t’i shpërdorosh për hir të dëshirave vulgare e të ulëta. Shkurtimisht, meditimi duhet të bëhet në mënyrë të drejtë dhe në bazamente të sakta. Përndryshe, meditimet që nuk gjejnë orientimin e duhur, e shpien njeriun në humbje. Ata që i mbyllin veshët ndaj paralajmërimeve hyjnore dhe e shpërdorojnë mirësinë e meditimit për hir të dëshirave



egoiste, do të pendohen shumë në botën tjetër. Në lidhje me këtë, në një ajet fisnik, urdhërohet:

**“Atje, ata do të thërrasin: “O Zoti ynë! Nxirrna se do të bëjmë vepra të mira e jo nga ato që kemi bërë.”** (Atyre do t’u thuhet): **“Vallë, a nuk jua zgjatëm jetën aq sa të mund të mendohej ai që donte të kujtonte (Allahun)?! Madje juve ju erdhi edhe paralajmëruesi? Andaj, shijojeni (dënimin)! Për keqbërësit nuk ka kurrfarë ndihmësi!”** (Fatir, 37)

Domethënë, se për të gjetur shpëtimin në botën e përjetshme, është e domosdoshme që në këtë botë, ta përdorësh mendjen në mënyrën e duhur. Ndjenjat dhe mendimet tona, nuk duhet të frymëzohen nga dëshirat djallëzore dhe egoiste, por nga burimi hyjnor. Mevlana i nderuar, na tërheq vëmendjen duke na këshilluar të jemi vigjilentë në lidhje me këtë çështje:

*“Mendimet djallëzore, imagjinatat dhe tundimet që lindin brenda nesh dhe na shqetësojnë, janë gjemba të padukshëm që ngulen në zemrën tonë. Këto gjemba, nuk vijnë e na ngulen në zemër vetëm nga një person, por nga mijëra persona.”*

Nisur nga kjo, është e domosdoshme që të ruhemi prej tundimeve të egos dhe të shejtanit të cila e prishin harmoninë shpirtërore të zemrës sonë dhe shkatërrojnë aftësitë tona të meditimit dhe ndjeshmërisë. Ashtu sikur një radio që nuk jep zë të qartë kur nuk pozicionohet në frekuencën e duhur, ashtu edhe zemra si rezultat i ndjenjave të gabuara dhe pakujdesisë, bie në shkatërrim. Peshqit në sajë të detit dhe gjallesat e tokës në sajë të ajrit mund ta vazhdojnë jetën e tyre. Pra, edhe shpirti njerëzor, mund ta gjejë lumturinë vetëm në atmosferën e ndritur të Kuranit dhe Suneti.

Padyshim se, horizonti më i rëndësishëm i meditimit, që e shpëton njeriun nga bukuritë mashtruese e djallëzore dhe dehja e





kënaqësive të egos, duke i falur atij një zemër të urtë e vigjilente, është meditimi i vdekjes. Në një ajet fisnik urdhërohet:

**“Agonia e vdekjes do të vijë me siguri. (Ja pra o njeri) Kjo është ajo prej së cilës ikje prej kohësh.”** (Kaf, 19)

Ndërsa një hadith, thuhet:

*“Kujtojeni shpesh vdekjen që jua prish nga rrënjët të gjitha kënaqësitë!”* (Tirmidhi, Kijamet, 26.)

Njerëzit e pjekur, e zgjidhin gjëegjëzën e nëntokës sa janë ende në këtë botë dhe përgatiten mirë për botën tjetër. Nëse meditimet dhe përpjekjet nuk thellohen në të panjohurën e nëntokës, nuk mund të zbulohet e fshehta e vendit të ardhmërisë. Kuptimi i këtij udhëtimit të shkurtër midis djepit dhe varrit me një vigjilencë shpirtërore dhe në atmosferën e meditimit, është diçka e domosdoshme për çdo njeri që zotëron mendje të shëndoshë. Zgjidhja e kësaj nyje në lidhje me të ardhmen, është e pamundur të kuptohet vetëm me meditimin njerëzor. Prandaj, është e domosdoshme që t'i vëmë veshin edhe udhëzimeve të shpalljes hyjnore. Përndryshe, të ikësh prej vdekjes me një frikë të thatë, do të thotë të lodhesh kot. Allahu i Madhëruar, na fton ne robërit e Vet në Xhenetin e Tij. Për këtë arsye, Ai na paralajmëron duke urdhëruar:

**“A keni menduar se ju kemi krijuar kot dhe se nuk do të ktheheni te Ne?”** (Mu'minun, 115)

Nisur nga kjo, Profeti ﷺ, duke kërkuar mbrojtjen e Allahut prej humbjes së meditimit dhe ndjenjave në robërinë e kësaj bote, është lutur:

*“...O Allah! Mos e bëj këtë botë as mendimin e përpjekjen tonë më të madhe dhe as cakun e fundit ku mund të arrijë dija jonë!..”* (Tirmidhi, Deauat, 79)



Gjithashtu, edhe duatë që Profeti ﷺ, ka bërë para se të flinte, na ftojnë në meditim. Madje, në duatë e tij shohim edhe domosdoshmërinë e mendimit rreth gjendjes së nevojtarëve dhe falënderimit të vazhdueshëm ndaj Allahut të Madhëruar:

*“Elhamdulil-lahi’l-ledhi etamena ue sekana ue kefana ue auana fe kem mim-men la kafije lehu ue la mu’uije / Falërnderimi i takon Allahut, i Cili na jep të hamë, të pimë dhe na strehon. Sa njerëz ka që nuk gjejnë strehim!”* (Muslim, Dhikir, 64.)

Me të vërtetë, që para se të bie në gjumë, njeriu e ka për detyrë të meditojë rreth mirësive që zotëron dhe të falënderojë Allahun për të gjitha këto. Duhet menduar se, të flesh i ngopur ndërkohë që në botë ka shumë njerëz të uritur e të etur apo të jesh i sigurt e me nevoja të plotësuar ndërkohë që me mijëra njerëz ndodhen në rrezik e në nevojë, është një mirësi shumë e madhe dhe në të njëjtën kohë, edhe një përgjegjësi e madhe. Prandaj, një llogari e tillë çdo natë para se të flemë, duhet të zërë një vend të paneglizhueshëm në jetën tonë të meditimit.

Omeri ﷺ, i cili ka thënë: *“Llogariteni veten tuaj para se të llogariteni!”*, çdo natë e pyeste veten duke i kërkuar llogari ndërgjegjes: *“Nëse një dele në breg të lumit Dixhle (Tirgër) bie në ujë e mbytet, Allahu do t’i kërkojë llogari Omerit.”* *“Çfarë ke bërë sot për Allahun, o Omer?”*.

Vallë, po ne sa herë i kemi përjetuar këto ndjenja? Sa net e kemi nënshtruar ndaj një llogarie të tillë zemrën tonë të lodhur nga telashet e jetës gjatë ditës? Sa e vëmë dorën në tëmtha duke menduar se, përse jemi krijuar, nga kemi ardhur e ku po shkojmë dhe sa e drejtë është rruga e jetës që bëjmë? A mendojmë ndopak se sa e jetojmë fenë tonë, në çmasë reflektojnë urdhrat e Zotit në jetën tonë, sa kemi mundur të hyjmë në kulturën dhe botën



shpirtërore të Kuranit, i cili është edhe mesazhi që Allahu na ka dërguar, sa i ndjekim gjurmët e Profetit ﷺ, i cili në jetën e tij ishte një Kuran i gjallë që ecte mbi tokë dhe në çmasë i ngjajnë sjelljet dhe qëndrimet tona jetës së tij, që është edhe shembulli më i mirë për ne? Sa na shqetësojnë mangësitë tona në lidhje me këto çështje? Apo mos vallë e kemi humbur brenda vetes thesarin tonë më të çmuar të meditimit?

Kurani Fisnik, na jep disa shembuj të atyre, që për të shpëtuar besimin e tyre i bënë ballë gurëzimit si Habibi Nexhari, u dogjën në zjarr duke u hedhur nëpër hendeqe si Ashab-i Uhud dhe duruan torturat më çnjerëzore pasi u udhëzuan në rrugë të drejtë, si magjistarët e Faraonit. Nisur nga këto shembuj, duhet të mendojmë se sa e kuptojmë vlerën e besimit që na ka falur Allahu?

**Allahu i Madhëruar na ruajttë nga mosmeditimi dhe nga shpërdorimi i mirësisë së meditimit! Gjithashtu, i bëftë zemrat, mendjet, ndjenjat dhe mendimet tona të jenë në përputhje me kënaqësinë hyjnore!**

**Amin!**





# SHPËRDORIMI NË SIGURIMIN E JETESËS DHE DHURIM

- 6 -



*Dihet se në themel të problemeve shpirtërore që përjetojnë shpesh në kohën tonë, qëndrojnë fitimi i padrejtë, shkelja e të drejtave të robit, pakënaqësia dhe lakmia. Prandaj, për të eliminuar këto probleme, është e domosdoshme të respektohen rregullat Islame, të cilat i ndalojnë njerëzit nga shkelja e të drejtave të të tjerëve dhe i nxit ata drejt fitimit hallall.*



*Ta konsiderosh veten bujar me pak ndihmë që jep, duke u krahasuar me nivelin e ulët të bujarisë së njerëzve në shoqëri, është një ngushëllim i thatë. Në fakt, nivelin e bujarisë sonë duhet ta matim me atë të sahabëve fisnikë.*



## SHPËRDORIMI - 6

### Në sigurimin e jetesës dhe dhurim

Kjo botë në të cilën jetojmë me qëllimin e një sprove hyjnore, është e stolisur me mirësi të panumërta të mbushura me urtësi të manifestimeve të fuqisë dhe madhështisë së Allahut të Madhëruar. Këto mirësi mund ta ngrenë robin në nivele të larta të devotshmërisë ndaj Allahut, ashtu siç edhe mund të bëhen shkak i një humbje, si rezultat i indiferencës së tij ndaj tyre. Secila prej këtyre mirësive është nga një amanet hyjnor. Prandaj, nëse ato përdoren jashtë qëllimit të tyre për hir të synimeve egoiste dhe djallëzore, është një çmenduri e madhe në shpërdorim.

Allahu i Madhëruar ka vënë në shërbim të njeriut çdo gjë që ka në qiell dhe në tokë. Mirëpo, Ai ka bërë të ditur se njeriu do të japë edhe llogari për këto mirësi në ditën e gjykimit. Lidhur me këtë, në Kuranin fisnik urdhërohet:

**“Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)!”** (Tekathur, 8.)

**“Ju, me siguri, do të sprovoheni me pasurinë dhe jetën tuaj...”** (Al-i Imran, 186.)

**“Mos vallë, keni menduar që Ne ju kemi krijuar kot dhe që nuk do të ktheheshit te Ne (për t’ju gjykuar)?!”** (Mu’minun, 115.)



Shpërdorimi më i keq, që shpreh teprimin dhe kalimin e kufijve në shpërdorimin e mirësive, është shndërrimi në dështim të pafundmë i lumturisë së përjetshme të ahiretit duke shkelur kufijtë hyjnorë që ka vendosur Allahu i Madhëruar.

Për shkak të indiferencës që e karakterizon, në përgjithësi, biri i njeriut shpërdorim konsideron vetëm shpenzimet pa kriter që bëhen në mirësitë materiale. Në këtë mënyrë, ai e burgos konceptin e shpërdorimit brenda një kornize të ngushtë në mendjen e tij. Mirëpo, ashtu siç është bërë haram shpërdorimi në mirësitë materiale, në të njëjtën mënyrë është bërë haram edhe shpërdorimi në mirësitë shpirtërore. Madje, shpërdorimi që bëhet në mirësitë shpirtërore, është një gjynah më i rëndë dhe meriton dështim.

Një nga shpërdorimet më të rëndësishme materiale dhe shpirtërore, i cili mund të shkaktojë humbjen e lumturisë në botën tjetër, është shpërdorimi që ndodh gjatë sigurimit të jetesës, në shpenzimet ditore dhe në dhurime.

Allahu i Madhëruar e ka caktuar furnizimin/rrizkun e të gjithë robërve të Tij. Për rrjedhojë, në ajetet kur bëhet e ditur se rrizku është nën garancinë hyjnore, urdhërohet:

**“Xhinët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë. Unë nuk kërkoj prej tyre furnizim, e as nuk dëshiroj që të Më ushqejnë. Vërtet, Allahu është Furnizuesi i vetëm, i Fuqishmi, i Plotpushtetshmi.”** (Dharijat, 56-58.)

**“Sa krijesa ka që nuk e mbajnë dot veten me ushqim! Allahu u jep atyre dhe juve! Ai dëgjon dhe di gjithçka.”** (Ankebut, 60.)

**“S’ka asnjë gjallesë në Tokë që të mos i ketë mjetet e jetesës prej Tij. Ai di vendbanimin e saj dhe vendin e vdekjes. Të gjitha këto janë (të shënuara) në Librin e qartë.”** (Hud, 6.)





Në këto ajete fisnike, Allahu i Madhëruar na bën të ditur pakufishmërinë e dijes, fuqisë dhe mëshirës së Tij. E në fakt, ndërkohë që ne as që mund ta imagjinojmë numrin e gjallesave që jetojnë në errësitat e tokës dhe në thellësitë e deteve, tek Allahu i Madhëruar ndodhen informacionet e detajuara të çdo-njerës prej tyre. Madje, Ai ka vendosur nën garancinë hyjnore edhe furnizimin dhe jetesën e tyre, gjë e cila është një manifestim madhështor i fuqisë hyjnore.

Nga kjo pikëpamje, ndërkohë që ne rendim pas furnizimit, është e domosdoshme që ne të meditojmë se sa thellë në zemër e ndjejmë afërsinë me Allahun e Madhëruar, i Cili na furnizon...

Fakti që Allahu i Madhëruar është garantues i rizikut të robërve, shprehet shumë bukur edhe në këto hadithe fisnike:

*“Për sa kohë që kokat tuaja të lëvizin, mos u shqetësoni në lidhje me rrizkun. Edhe pse nëna e lind njeriun të zhveshur dhe pa gjë mbi trup, më pas Allahu i Plotfuqishëm dhe Fisnik, e furnizon atë me çdolloj rrizku.”* (Ibn-i Maxhe, Zuhd, 14.)

*“Allahu është i pasur. Ato që hanë, pinë dhe shpenzojnë njerëzit, nuk pakësojnë asgjë prej thesarit të Tij. Ai është bujar dhe dhuron pandërprerë natë e ditë. Mendo pak për ato që ka dhuruar Allahu që prej krijimit të qiejve dhe tokës! Këto nuk pakësojnë asgjë prej pasurisë së Tij...”* (Buhari, Teuhid, 22.)

Nga kjo pikëpamje, shqetësimi i tepërt në lidhje me sigurimin e rizikut dhe kalimi në ekstreme, është një lakmi e egos, prej së cilës duhet të ruhesh. Detyra jonë është të përpiqemi të fitojmë në rrugë hallall rrizkun që na ka caktuar Allahu, duke u kapur pas shkaqeve. Pas kësaj përpjekjeje, ne duhet ta konsiderojmë si mirësi caktimin e Allahut në lidhje me ne dhe të jetojmë të kënaqur. Harrimi i Razzakut (Furnizuesit) duke u kapluar nga shqetësime të panevojshme dhe devijimi në rrugë haram me lakminë për të



fituar sa më shumë, do të thotë të shkelësh kufijtë hyjnorë dhe të biesh në shpërdorim në çështjen e sigurimit të jetesës.

Allahu i Madhëruar, në Kuranin Fisnik na bën të ditur gjendjen tragjike në botën tjetër të atyre që i kalojnë kufijtë në lakmi dhe koprraci në çështjen e sigurimit të jetesës dhe ia japin zemrën pasurisë së kësaj bote:

**“(Mjerë për atë) që grumbullon pasuri dhe e ruan, duke menduar se ajo pasuri do ta bëjë të pavdekshëm! Jo, aspak! Në të vërtetë, ai do të hidhet në torturën shkatërruese. E kush mund të ta shpjegojë ty se çfarë është tortura shkatërruese? Ajo është zjarri i Allahut i ndezur fort, i cili depërton deri në zemrën e njeriut. Ai do t’i rrethojë ata nga çdo anë, në shtylla të gjata flakëruese.”** (Humeze, 2-9.)

Ndërsa i Dërguari i Allahut ﷺ, e ka shprehur me këto fjalë shqetësimin e tij në lidhje me faktin se ummeti i tij mund ta humbasë maturinë duke rënë në shpërdorim gjatë sigurimit të jetesës:

*“Kam frikë se pas meje do t’ju hapen mirësitë dhe stolitë e kësaj bote, e ju do t’ia jepni zemrën atyre!”* (Buhari, Zekat, 47.)

Ashtu siç nuk është i lejuar angazhimi me punë aq sa të neglizhohen adhurimet dhe shërbimet ndaj shoqërisë, ashtu është e ndaluar edhe moskokëçarja dhe dembelizmi që do të shkaktojë mjerimin dhe varfërinë e familjes. Fitimi hallall që i sjell lumturinë familjes, që nuk shkakton neglizhencë të adhurimeve dhe shërbimeve ndaj shoqërisë, që nuk të streson dhe ka një sistem pune të ekuilibruar, është një rrugë larg shpërdorimit, e pëlqyeshme dhe e begatshme.

Nga ana tjetër, pasuria e kësaj bote duhet të fitohet me synimin e arritjes së paqes shpirtërore dhe lumturisë në botën tjetër, duke bërë bamirësi ndaj të dobëtëve të shoqërisë, të vet-



muarve dhe nevojtarëve, duke filluar prej më të afërmve. Kjo, sepse bujaria dhe mëshira, duhet të jenë virtyte të natyrshme të besimtarit.

Mëshira është fryti më i rëndësishëm i besimit. Ndërsa manifestimi më i rëndësishëm i mëshirës, është rendja në ndihmë të nevojtarëve me të gjitha mundësitë për të plotësuar nevojat e tyre. Pra, të dhurosh prej të mirave që ka falur Allahut, atyre të cilëve janë të privuar nga ato.

I nderuari Mevlana shprehet:

*“Jeta e dynjasë është veç një ëndërr. Të jesh i pasur në dynja, i ngjan gjetjes së thesarit në ëndërr. Ndërsa pasuria e dynjasë, mbetet po në dynja duke u trashëguar nga brezi në brez!”*

Nisur nga kjo, të mos dhurosh aspak prej pasurisë, duke ia lënë të gjithë atë trashëgimtarëve -të cilët nuk kanë marrë edukatë shpirtërore dhe s’dihet se si do ta shpenzojnë atë-, do të thotë t’i ngarkosh vetes një llogari të rëndë për botën tjetër. Dhe kjo nuk është aspak e logjikshme për një mendje të shëndoshë. Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

**“...Ata që grumbullojnë ar dhe argjend dhe nuk e shpenzojnë për hir të Allahut, paralajmëroji me dënim të dhembshëm!”** (Teube, 34.)

Një ditë, i Dërguari i Allahut ﷺ, i pyeti sahabët:

*“Cili prej jush e do pasurinë e trashëgimtarëve të vet më shumë se pasurinë e vet?”* Të pranishmit iu përgjigjën:

*“O i Dërguari i Allahut! S’ka asnjë mes nesh që të mos e dojë më shumë pasurinë e vet!”* Profeti ﷺ, u tha:

*“Pasuria e njeriut është gjithçka që ai shpenzon gjatë jetës së tij në çdo vepër të mirë për hir të Allahut, ndërsa pasuria*



*e trashëgimtarëve të tij është gjithçka që ai lë pas vdekjes.”*  
(Buhari, Rikak, 12.)

*“Mos pandeh se do të ngrihesh duke bërë para! Uji që nuk rrjedh mban erë të keqe dhe thahet. Prandaj përpigu të japësh e të rrjedhësh vazhdimisht! Ujin që rrjedh e ndihmon qielli. Lëshon shi, dërgon përrenj dhe e bën det!”*

*“Njerëzit e mençur e marrin pasurinë dhe pronën me vete kur shkojnë në botën tjetër. Ndërsa koprracë, janë ata që ikin duke e lënë këtu!”*

Ebu Hurejre رضي الله عنه, rrëfen:

“Një person erdhi tek i Dërguari i Allahut صلى الله عليه وسلم dhe e pyeti:

«O i Dërguari i Allahut! Cila sadaka e ka shpërblimin më të madh?»

I Dërguari i Allahut صلى الله عليه وسلم, tha:

*«Sadakaja me shpërblimin më të madh, është ajo që jep ndërkohë që je i fortë-i fuqishëm, i shëndetshëm, koprrac, ke frikë nga varfëria dhe të pëlqen shumë pasuria. Mos e shty sadakanë tënde duke pritur të të vijë shpirti në fyt, e pastaj të thuash, kjo pasuri është për filanin, e kjo për filanin, sepse ajo pasuri (tashmë) është bërë e këtij apo atij trashëgimtari.»*  
(Buhari, Zekat, 11.)

Abdullah ibn Shihhir رضي الله عنه, rrëfen:

“Një ditë, profeti صلى الله عليه وسلم, po lexonte suren et-Tekathur. Kur e mbaroi së lexuari tha;

*«Biri i Ademit rri veç duke thënë, pasuria ime, pasuria ime. O biri i Ademit! A mos ke pasuri tjetër përveç asaj që ha dhe konsumon, asaj që vesh dhe e vjetëron dhe asaj që e dërgon në botën tjetër si shpërblim që ke fituar duke dhënë sadaka (lëmoshë)!?»* (Muslim, Zuhd, 3-4.)



Po ashtu, në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

*“Kushdo prej jush që gdhihet i sigurt në jetën dhe pasurinë e vet, me shëndet të plotë dhe furnizim për një ditë, është sikur t’i jetë dhënë e gjithë dynjaja.”* (Tirmidhi, Zuhd, 34.)

*“Lum ai që udhëzohet në rrugën e drejtë të Islamit, ka të ardhura të mjaftueshme dhe është i kënaqur me këtë!”* (Tirmidhi, Zuhd, 35.)

*“Ai që është mysliman, i është dhënë furnizim i mjaftueshëm dhe është i kënaqur me mirësitë që i ka falur Allahu, ka arritur shpëtimin (e vërtetë).”* (Muslim, Zekat, 125.)

Ebu Umame Ijas ibn-i Sa’lebe رضي الله عنه, ka thënë:

“Një ditë, sahabët folën në lidhje me këtë botë pranë të Dërguarit të Allahut ﷺ. Për këtë arsye, ai رضي الله عنه, tha:

*“A nuk dëgjoni? A nuk dëgjoni? Jeta e thjeshtë është prej besimit; të bësh një jetë të thjeshtë është prej besimit!”* (Ebu Daud, Terexhxhul, 2.)

Një person i quajtur Salebe, i cili më parë ishte njeri i devotshëm, u kaplua nga lakmia për këtë botë dhe dëshiroi të bëhej i pasur. Ai shkoi tek Profeti ﷺ, t’i kërkonte të lutej për të. Mirëpo, më vonë, edhe pas paralajmërimeve dhe këshillave të Profetit ﷺ, ai u tregua indiferent dhe, i dehur nga pasuria që i fali Allahu, pësoi një përfundim shumë të hidhur, i cili është një shembull shumë mësimdhënës për të gjithë besimtarët.

I Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

*“Biri i Ademit nuk ka të drejta përveç këtyre: Shtëpia ku do të banojë, rroba me të cilën do të mbulojë trupin dhe ena me të cilën do të hajë ushqimin e do të pijë ujin.”* (Tirmidhi, Zuhd, 30.)



I Dërguari i Allahut ﷺ, dëshironte që besimtarët të bëjnë një jetë larg shpërdorimit, të kënaqur me çfarë kanë dhe modestë, gjë të cilën e zbatoi personalisht në jetën e vet, duke u bërë shembull për ummetin e tij. Kjo gjendje e tij, është pasqyruar shumë bukur në këtë lutje:

*“O Allah! Fali familjes së Muhamedit furnizim të mjaftueshëm!”* (Buhari, Rikak, 17.)

Dihet se në themel të problemeve shpirtërore që përjeto-  
hen shpesh në kohën tonë, qëndrojnë fitimi i padrejtë, shkelja e të drejtave të robit, pakënaqësia dhe lakmia. Prandaj, për të eliminuar këto probleme, është e domosdoshme të respektohen rregullat Islame, të cilat i ndalojnë njerëzit nga shkelja e të drejtave të të tjerëve dhe i nxit ata drejt fitimit hallall.

Në fakt, mënyra se si robi e fiton jetesën, haram apo hallall, ndikon shumë në adhurimet dhe veprat e tij. Për rrjedhojë, ajo përfshihet në kaderin/fatin e tij. Ky është edhe faktori kryesor që qëndron në themel të sjelljeve pozitive apo negative të fëmijëve tanë. Pra, nëse dëshirojmë që fëmijët tanë të jenë të mirë dhe të qëndrojnë larg ndikimeve negative dhe të ulëta, në fillim duhet të bëjmë kujdes që fitimet tona të jenë hallall.

Nëse zemrat janë të bindura ndaj urdhrave të Allahut dhe sunnetit të Profetit ﷺ, trupat bëhen burim frymëzimi dhe mirësie. Ndërsa trupat që përzihen me dyshime dhe harame, bëhen burime të së keqes.

Nga kjo pikëpamje, ata që e duan Profetin ﷺ, i vënë veshin këshillave të Tij dhe bëjnë kujdes në fitimin e rrizkut hallall, duke u ruajtur kështu nga shpërdorimi dhe koprracia. Në këtë mënyrë, ata do të ecin në rrugën e tij të ndritur dhe, në jetën e përtejme do të shijojnë lumturinë e të qenit bashkë me të.

Nga ana tjetër, çdo kohë ka kërkesa dhe nevoja të ndryshme.



Dhe këto nevoja duhen plotësuar sipas nivelit të rëndësisë së tyre. Nëse një ndihmë e dhënë nuk ka për synim të plotësojë nevojat, edhe ajo konsiderohet një lloj shpërdorimi për shkak të gabimit në qëllim.

Për shembull, të bësh shpenzime për nevoja jo urgjente, ndërkohë që populli ka nevojë për njerëz me besim, të kujdeshëm dhe atdhedashës... Dhe, nevoja më e rëndësishme në një kohë kur jeta fetare, morali dhe ndjenjat shpirtërore janë dobësuar, është t'i japësh rëndësi këtyre dhe të përpiqesh të ngresh nivelin e edukimit fetar, moral dhe shpirtëror.

Allahu i Madhëruar, na tërheq vëmendjen në faktin se kur të dëshirojmë të dhurojmë diçka, është e domosdoshme të gjejmë atë më nevojtarin dhe se është shumë e rëndësishme që aftësia për t'i njohur nevojtarët, të jetë një intuitë e natyrshme e besimtarit:

**“(Lëmosha) u takon të varfërve, të cilët kanë hyrë në rrugën e Zotit e nuk janë në gjendje të udhëtojnë (për të fituar). Kush nuk i njeh ata, kujton se janë të kamur, për shkak se ata nuk lypin. Do t’i njohësh nga pamja e tyre...”** (Bekare, 273)

Po ashtu, shpërdorim konsiderohet edhe nëse u jepet përtej nevojave atyre që i kemi më të afërt, ndërkohë që gjenden njerëz që kanë më tepër nevoja. Për këtë arsye, është e domosdoshme që të varfërve t’u japësh sipas nevojave që kanë. Lidhur me këtë, i nderuari Mevlana ka thënë:

*“Ka shumë të pasur, të cilët është më mirë të mos u japin atyre që nuk e meritojnë. Për këtë arsye, pasurinë që të ka dhënë Allahu shpenzoje vetëm sipas urdhrit të Tij! Dhurimi pavend, është njësoj sikur një skllav i pabindur t’u japë kusa-rëve pasurinë e të zotit me pretendimin se po bën mirësi.”*

Në mënyrë të veçantë, përgjegjësit e institucioneve të bami-



rësisë, siç janë vakëfet dhe shoqatat, duhet ta kenë parasysh këtë çështje gjatë shpërndarjes së ndihmave dhe të veprojnë në mënyrë të kujdeshme.

Përveç këtyre, duhet pasur kujdes edhe fakti se, qëndrimi i dikujt, që mund të konsiderohet shpërdorim ose koprraci, për dikë tjetër mund të mos konsiderohet i tillë. Kjo, sepse çdonjëri prej atyre që gëzon mirësi materialo-shpirtërore mund të ketë mundësi të ndryshme.

Për këtë arsye, në përgjegjësitë dhe detyrimet e robit para Allahut, është vendosur “kriteri i mundësisë”. Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

**“Allahu nuk e ngarkon askënd përtej fuqisë që ka...”**

(Bekare, 286.)

Kjo tregon qartë se në peshoren hyjnore askush nuk ka përgjegjësi dhe detyrime të barabarta me të tjerët.

Prandaj, të përpiqesh të japësh më tepër se mundësitë që ke, është domosdoshmëri e një besimi të përsosur. Në fakt, njeriu do të jetë në borxh të madh përballë peshores hyjnore, për shkak të mirësive që nuk i bën edhe pse ka mundësi.

Nga ana tjetër, ta konsiderosh veten bujar me pak ndihmë që jep, duke u krahasuar me nivelin e ulët të bujarisë së njerëzve në shoqëri, është një ngushëllim i thatë. Për këtë arsye, ne besimtarët, në çështjen e dhurimit duhet ta krahasojmë veten me Profetin ﷺ dhe sahabët e tij fisnikë dhe të përpiqemi t’i arrijmë ata. Kjo, sepse nëse marrim për bazë botëkuptimin e përgjithshëm të njerëzve në lidhje me ndihmën dhe bujarinë, mbase mund të konsiderohemi bujarë dhe dorëdhënë edhe nëse japim pak gjë në krahasim me mundësitë që zotërojmë. Por, tek Allahu mund të konsiderohemi gjynahqarë dhe koprracë.





**Allahu i Madhëruar na e bëftë të mundur të ruhem prej haramit dhe të dyshuarave në çdo çështje! Po ashtu, Allahu i ruajt zemrat tona prej shpërdorimit dhe koprracisë dhe na e bëftë të mundur të dalim para Tij me faqe të bardhë dhe qetësi shpirtërore, duke i përdorur mirësitë që na ka falur në përputhje me kënaqësinë hyjnore!**

**Amin!..**







## SHPËRDORIMI NË SHËNDET DHE USHQIME

- 7 -



*Në lidhje me ngrënien dhe pirjen në jetën e përditshme dhe veçanërisht nëpër dasma e gosti, bëhen shumë shpenzime e shpërdorime.*

*Teprimet, si përgatitjet e gostive pompoze për mburrje, mendjemadhësi dhe shfaqje force, nxitja e grykësisë me ushqime të tipit “bufe e hapur” dhe veshja e rrobave të markave të shtrenjta për t’u krekosur, nuk ka dyshim se në botën tjetër do të kthehen në pendesë.*

*Kjo, sepse e gjithë llogaria e këtyre do të na sillet përpara mbi peshoren hyjnore.*





## SHPËRDORIMI NË SHËNDET DHE USHQIME - 7

Mirësia e shëndetit është një nga dhuratat hyjnore, të cilën njeriu nuk e ka vlerësuar asnjëherë ashtu siç duhet. Duke dashur të theksojë shkujdesjen dhe neglizhencën e përgjithshme në këtë çështje, Profeti ﷺ, ka thënë:

*“Janë dy mirësi, vlerën e të cilave shumica e njerëzve nuk e çmon: shëndeti dhe koha e lirë.”* (Buhari, Rikak, 1) Me anë të këtij evidentimi, Profeti ﷺ, na ka paralajmëruar ne si umetin e tij të mos i çojmë dëm këto mirësi të mëdha që na janë dhuruar dhe si përfundim, të bëhemi pishman për këtë.

Ibn Omeri رضي الله عنه, ka thënë:

*“Kur të arrish mbrëmjen, mos e prit mëngjesin, kur të arrish mëngjesin, mos e prit mbrëmjen. Sa të kesh shëndet, merr masat për sëmundjen dhe sa të kesh jetë merr masat për vdekjen.”* (Buhari, Rikak, 3)

Trupi ynë është një amanet i Allahut dhe si i tillë ka të drejtat e veta ndaj nesh. Kjo, sepse për të bërë një jetë të devotshme, është e mundur vetëm në sajë të një trupi të shëndetshëm, si nga ana e jashtme, ashtu edhe nga ana e brendshme. Edhe adhuret bëhen më të qeta me një trup të shëndetshëm. A është e



mundur të falësh një namaz të qetë apo të agjërosh, nëse nuk ke shëndet? Shumë adhurime dhe shërbime që e afrojnë robin tek Allahu, realizohen gjithmonë në sajë të mirësisë së shëndetit. Kur humbet shëndeti, edhe adhurimet e shërbimet e humbasin cilësinë e tyre. Prandaj, për sa kohë që gëzojmë shëndet të mirë, duhet ta çmojmë këtë mirësi, duke falënderuar në mënyrën më të bukur, duke kryer adhurime dhe duke vrapuar në punë të mira.

Ashtu si të gjitha mirësitë e tjera, edhe shëndeti nuk mund t'i shpëtojë shpërdorimit, nëse nuk zbatohen urdhrat hyjnore. Një nga format më të frikshme të shpërdorimit të kësaj mirësie, është edhe shkatërrimi i shëndetit me anë të duhanit që duket diçka shumë e thjeshtë në kohën tonë dhe me harame të tjera nga më të ndryshmet. Përveç kësaj, ta ruash shëndetin nën udhëzimin e mendjes dhe urdhrave hyjnore, jo vetëm në aspektin e ushqyerjes, por edhe ndaj disa faktorëve si të nxehtit, të ftohtit dhe aksidenteve rrugore për shkak të pakujdesisë, është një detyrë e domosdoshme për të parandaluar shpërdorimin e kësaj mirësie të madhe.

Feja jonë madhështore, Islami, na ka ofruar shumë mënyra në aspektet fizike e shpirtërore për të marrë masat e duhura në mbrojtjen e shëndetit tonë. Ajo na ka urdhëruar të jemi të matur në ngrënie dhe pirje, të mos hyjmë në vende ku ka sëmundje ngjitëse dhe të mos dalim prej aty ku ndodhen këto sëmundje. Në shumë këshilla dhe urdhra të ngjashme me këto, feja ka përcaktuar kriteret themelore të mjekësisë mbrojtëse. Përkrah këtyre masave mbrojtëse në aspektin fizik, është këshilluar edhe aplikimi i masave mbrojtëse në aspektin shpirtëror, si dhënia e lëmoshës dhe dhurimi për hir të Allahut, me qëllim që të mbrohemi prej fatkeqësive. Po ashtu, për mbrojtjen e shëndetit me anë të masave në aspektin shpirtëror, Profeti ﷺ, ka thënë:



*“Çdonjëri prej jush, duhet të japë çdo ditë nga një sadaka për çdo gjymtyrë të tij. Për këtë arsye, çdo tesbih, është një sadaka, çdo hamd/falënderim, një sadaka, çdo tehli/la ilahe il-lallah, një sadaka dhe çdo tekbir/Allahu Ekber, një sadaka. (Po ashtu) Edhe këshillimi për punë të mira, por edhe pengimi nga punët e këqija, janë sadaka. Dy rekate të namazit të duhasë i zëvendësojnë të gjitha këto.” (Buhari, Sulh, 11)*

Me të vërtetë që shëndeti i mirë është një mirësi e cila kërkon falënderimin ndaj Allahut. Ky falënderim mund të bëhet edhe në aspektin material me anë të sadakasë, por edhe në aspektin shpirtëror me anë të dhikrit, adhurimeve dhe çdo pune të mirë apo shërbimi që bëhet për hir të Allahut Teala.

Sahabët fisnikë, të cilët për shkak të virtyeteve të tyre të larta dalin në pah si brezi më shembullor për ne<sup>1</sup>, u përpoqën me të gjitha forcat dhe mundësitë, që mirësitë të cilat ua fali Allahu Teala, t'i përdornin për të fituar botën tjetër. Prandaj edhe Allahu Teala, u fali begati këtyre përpjekjeve të zellshme dhe entuziaste që vërshuan si lumenj. Konsumi i tepërt, grykësia, luksi dhe mania për t'u dukur, të cilat janë disa nga sëmundjet morale më problematike të kohës sonë, përbëjnë një mënyrë jetese, që brezi i sahabëve nuk e ka njohur kurrë. Kjo, sepse ata jetonin me vetëdijen se; **“Vendbanimi tjetër pas vdekjes, është varri”**.

Parë nga një këndvështrim tjetër, nëse trupit, i cili na është dhënë amanet për një kohë të caktuar, -qoftë për shkak të koprracisë, qoftë për shkaqe të domosdoshme- nuk i jepen ushqime në sasi të mjaftueshme, padyshim që do të përballet me dobësi dhe sëmundje të ndryshme. Por, edhe nëse e ngopim atë tej mase, do të ketë të njëjtin përfundim. Kjo gjendje mund të shkaktohet edhe për arsye të konsumimit të tepërt të ushqimeve hallall/ të lejuara, edhe për arsye të konsumimit të ushqimit haram/të



palejuar, gjë e cila së bashku me shëndetin fizik, shkatërron edhe shëndetin shpirtëror.

Në bazë të nivelit shpirtëror ndryshon edhe kujdesi i njerëzve në lidhje me ushqimin. P.sh., sipas sheriatit, shpërdorim konsiderohet, “ngrënia pas ngopjes”, sipas tasavufit, konsiderohet, “ngrënia deri në ngopje”, sipas hakikatit/të vërtetës, konsiderohet “ngrënia e mjaftueshme, por larg vetëdijes ndaj prezencës së Allahut”, ndërsa sipas marifetit/urtësisë, përveç këtyre, shpërdorim konsiderohet edhe “nëse hahet pa medituat rreth mirësive të Allahut”.

Këto fjalë të Hidrit عليه السلام, gjatë vizitës së njërit prej të dashurve të Allahut, Abdulhalik Guxhduvani (Allahu e mëshiroftë), janë shumë domethënëse për sa i përket ndjeshmërisë shpirtërore në lidhje me ngrënin dhe pirjen:

Hidri عليه السلام, nuk e hëngri ushqimin me të cilin e gostiti Abdulhalik Guxhduvani dhe tërhiqet nga sofrat. Izoti i shtëpisë, habitet dhe thotë:

- Ky është ushqim hallall, përse nuk hani?

Hidri عليه السلام, përgjigjet:

-Po, ushqim hallall është; mirëpo ai që e ka gatuar ka qenë i zemëruar dhe i pakujdesshëm ndaj Allahut.”

Siç shihet, përveç kriterit hallall-haram të ushqimit, në gjendjen shpirtërore të njeriut, në veprat dhe në adhurimet e tij, ndikon edhe atmosfera shpirtërore në të cilën janë gatuar ato. Kjo gjë e tregon qartë qëndrimin që duhet të mbajmë ndaj ushqimeve. Në përgjithësi, në ditët tona për fat të keq, nuk mendohet aspak për dëmet që i shkaktojnë anës sonë shpirtërore ushqimet që shiten në vende të hapura, pa u kujdesur për të drejtën e syrit të shumë nevojtarëve dhe për të cilat nuk dihet se si janë gatuar. Prandaj,





nuk duhet të harrojmë se gjendja shpirtërore në sigurimin e ushqimit ndikon shumë edhe në ndjenjat tona.

Në procesin e pastrimit të zemrës, kafshata hallall zë një vend shumë jetik. Abdulkadir Gejlani (Allahu e mëshiroftë), thotë:

*“Ushqimi haram e vret zemrën. Ndërsa ushqimi hallall, e ngjall atë. Ka kafshata që të lidhin me këtë botë, ka kafshata që të lidhin me botën tjetër. Po ashtu, ka edhe kafshata që të bëjnë të dashur tek Allahu Teala.”*

Ndërsa Mevlana i nderuar, thotë:

*“Mos u mundo ta zbukurosh trupin duke e ushqyer së tepërmi, sepse në fund të fundit, ajo është një kurban që do t'i jepet tokës. Më mirë mundohu të ushqesh shpirtin, sepse ai do të shkojë e do të nderohet në lartësitë madhështore. Trupit jepi pak yndyrna dhe pak të ëmbla, sepse kush e ushqen më shumë se sa duhet, në fund do të bëhet rob i dëshirave të nefsit dhe do të përfundojë i poshtëruar.”*

Të mbash një qëndrim kaq moskokëçarës në lidhje me një çështje kaq delikate, natyrisht që nuk përputhet aspak me personalitetin e një besimtari.

Të parët tanë selefë, duke u shprehur se: *“Allahu e ka mbledhur të gjithë mjekësinë në një ajet: “...Hani e pini, por mos shpërdoroni!..”* (A'raf, 31) kanë theksuar rëndësinë e faktit se për të bërë një jetë të shëndetshme, si në aspektin fizik, ashtu edhe në atë shpirtëror, duhet qëndruar larg shpërdorimit në ngrenie dhe pirje.<sup>69</sup>

Në një hadith fisnik, tregohen qartë kufijtë e lejuar në sigurimin e nevojave njerëzore:

69. shih. Ibn Kethir, *Tefsir*, II, 219.



*“Hani, pini, vishuni dhe jepni sadaka, pa u zhytur në shpërdorim dhe mburrje.”* (Buhari, Libas, 1)

Ndërsa në një hadith tjetër, thuhet:

*“Të hash çdo gjë që ta do xhani, padyshim se është shpërdorim!”* (Ibn Maxhe, Et’ime, 51)

Kjo gjendje, e cila në gjuhën popullore quhet “grykësi”, është e ndaluar edhe nga feja jonë. Po ashtu, në hadithin e mësipërm nënkuptohet edhe fakti se të kesh mundësi, nuk do të thotë që është e lejuar të konsumosh çfarë dhe sa të duash. Kur Omeri رضي الله عنه, u takua me Xhabirin رضي الله عنه, i cili kishte në dorë një copë mishi, tha:

- Çfarë është ajo?

Xhabiri رضي الله عنه, u përgjigj:

- Është në copë mishi, të cilën e bleva se ma donte xhani.

Omeri رضي الله عنه, e qortoi me këto fjalë:

- Ti blen çdo gjë që dëshiron? A nuk ke frikët se bëhesh prej atyre që përmenden në ajetin; **“...Ju kenë shfrytëzuar gjithë të mirat në jetën tuaj tokësore...”** (Ahkaf, 20) (Ibn Hanbel, Zuhd, fq.124)

Sa bukur i ka përshkruar Profeti صلى الله عليه وسلم, kriteret që duhen respektuar në ushqyerje dhe ndikimin e madh që ka kjo gjë mbi shëndetin tonë:

*“Askush nuk ka mbushur një enë më të keqe se stomakun e tij. Njeriut i mjaftojnë disa kafshata që ta mbajnë në këmbë. Por nëse dikush, patjetër duhet të hajë shumë, atëherë le ta ndajë një të tretën e stomakut për ushqim, një të tretën për pije dhe një të tretën për ajër!”* (Tirmidhi, Zuhd, 47)

Po ashtu, edhe kjo ndodhi e Epokës së Lumturisë e tregon më së miri begatinë e respektimit të këtyre parimeve profetike



në lidhje me ngrënien dhe pirjen:

Sundimtari i Aleksandrisë së Egjiptit, së bashku me shumë dhurata të ndryshme i kishte dërguar edhe një doktor Profetit ﷺ. Ai ﷺ, iu drejtua doktorit dhe i tha:

*“Ti mund të kthehesh tek familja jote, sepse ne jemi një popull që nuk ha pa e marrë uria. Por edhe kur hamë (jemi të kujdesshëm), nuk hamë deri në ngopje.”* (Halebi, Insanu'l-Ujun, III, 299)

Në këto thënie profetike, ndodhet receta e kurimit ndaj shumë sëmundjeve që ka shkaktuar çmenduria e konsumit të tepërt dhe shpërdorimit.

Omeri ﷺ, në lidhje me këtë çështje, këshillon:

*“Ruhuni nga tejmbushja e barkut tuaj me ushqim dhe pije. Kjo e dëmton trupin, shkakton sëmundje dhe e bën njeriun përtac ndaj namazit. Në ngrënie dhe pirje ndiqni rrugën e mesme! Nëse veproni kështu, është më e dobishme për trupin dhe kështu do të jeni të ruajtur prej shpërdorimit.”* (Ali el-Muttaki, Kenz, XV, 433/41713)

Thevenot, një orientalist francez, i cili në vitin 1665 ka botuar në Paris ditarin e tij të udhëtimit, në lidhje me pastërtinë, thjesh-tësinë, maturinë në ngrënie e pirje dhe ndikimin e këtyre në jetën e përditshme të të parëve tanë, të cilët për shekuj me radhë kanë mbajtur lart flamurin e Islamit, shprehet:

*“Myslimanët jetojnë të shëndetshëm dhe sëmuren shumë pak. Tek ata nuk ka sëmundje të veshkave dhe shumë sëmundje të tjera që kemi ne në vendet tona. Madje, këtyre sëmundjeve nuk ua dinë as emrin. Mendoj se një nga shkaqet kryesore të këtij shëndeti, është larja e shpeshtë dhe matura në ngrënie dhe pirje. Ata hanë shumë pak. Por edhe ato që hanë, nuk janë*



ushqime të përziera.”

Në një fjalë të urtë, thuhet: “Njeriu nuk duhet të jetojë për të ngrënë, por të hajë për të jetuar!” Ky parim, në të njëjtën kohë, shpreh edhe një cilësi të rëndësishme të besimtarëve. Kjo ndodhi mësimdhënëse i shpreh shumë qartë kriteret e moralit Islam në lidhje me këtë çështje: Një ditë, tek Rasulullahu ﷺ, kishte ardhur një mysafir, i cili nuk ishte bërë ende mysliman. Profeti ﷺ, kërkoi që të merrte një dele për të. Mysafiri e piu të gjithë qumështin që i sollën shtatë herë me radhë. Ditën tjetër, ky mysafir u bë mysliman. Rasulullahu ﷺ, përsëri kërkoi t’i sillej qumësht. Mysafiri e piu tasin e parë dhe, kur Profeti ﷺ, i solli të dytin, ai nuk arriti ta mbarojë. Për këtë arsye, Profeti ﷺ, tha:

“Besimtari pi me një zorrë, ndërsa mohuesi pi me shtatë zorra.” (Muslim, Eshribe, 186)

Allahu Teala dëshiron që ne të veprojmë me maturi në ngrënie e pirje dhe të qëndrojmë larg mënyrës së ngrënies së jobesimtarëve. Prandaj, Ai na paralajmëron me këto fjalë:

“...(në këtë botë) **Mohuesi kënaqen dhe hanë si bagëtia.**  
(Por) **Vendbanimi i tyre do të jetë zjarri!**” (Muhamed, 12)

Po ashtu edhe të gjitha sjelljet që e largojnë begatinë e ushqimit, konsiderohen si shpërdorim. P.sh., të fillosh ushqimin pa larë duart e pa përmendur emrin e Allahut (Bismilah) dhe të ngrihesh nga sofa pa e falënderuar Allahun për mirësitë që të ka dhuruar, hyjnë në kategorinë e shpërdorimit. Profeti ﷺ, ka thënë: “Begatia e ushqimit është në larjen e duarve para dhe pas tij.” (Tirmidhi, Et’ime, 39)

“Kush i ka duart të përlyera me ushqim dhe fle pa i larë ato, të mos fajësojë askënd tjetër përveç vetes, nëse i ndodh ndonjë gjë e keqe!” (Ebu Daud, Et’ime, 53)

Po ashtu edhe kujdesi i veçantë që kanë treguar të parët





tanë në lidhje me larjen e duarve para dhe pas ushqimit, është për t'u admiruar. Në shekullin e shtatëmbëdhjetë, një qatip/sekretar i quajtur Ricaut, i cili punonte në ambasadën angleze në Stamboll dhe që ishte një armik i përbetuar i osmanëve, rrëfen kështu në lidhje me kujdesin e veçantë që tregonin të parët tanë ndaj pastërtisë:

“Larja e duarve para dhe pas ushqimit është bërë një zakon aq popullor tek myslimanët, saqë faktin se Allahu i paska krijuar ushqimet për të motivuar njerëzit në larjen e duarve, e përmendin si një çështje shumë të rëndësishme.”

Ky kujdes që është treguar ndaj pastërtisë në ngrënie dhe pirje, së bashku me begatinë e mirësive, bëhet shkak i qetësisë dhe shëndetit fizik e shpirtëror. Përveç kësaj, ushqimet që fillohen me “Bismilah” dhe mbarohen me falënderim ndaj Allahut, janë burim shërimi. Ndërsa, ushqimet që hahen pa “Bismilah” dhe pa falënderime, bëhen shkak pakujdesie dhe vuajtjeje. Në bazë të kësaj urtësie, Profeti ﷺ, ka thënë:

“Nëse njeriu hyn në shtëpi dhe fillon të hajë me Bismilah, shejtani u thotë ushtarëve të vet: “Këtu as nuk mund të kaloni natën e as nuk mund të hani”. Nëse ai njeri nuk bën Bismilah kur hyn në shtëpi, shejtani u thotë atyre; “Gjetët një vend për të kaluar natën”. (Po ashtu) Nëse ai njeri nuk bën Bismilah kur fillon të hajë, shejtani u thotë përsëri ushtarëve të vet: “Gjetët edhe strehë edhe ushqim”.” (Muslim, Eshribe, 103)

Aishja , tregon:

Njëherë, i Dërguari i Allahut , po hante ushqim së bashku me gjashtë prej sahabëve të tij. Në ato momente, erdhi një beduin dhe e mbaroi ushqimin në dy kafshata. Për këtë arsye Profeti , tha:

“Nëse ky do të thoshte “Bismilah”, ushqimi do të na



*mjaftonte të gjithëve. Prandaj, kur dikush prej jush të hajë ushqim, le të thotë “Bismilah”. Nëse harron ta thotë këtë në fillim të ushqimit, le të thotë “Bismilah për në fillim dhe në fund”!* (Ibn Maxhe, Et’ime, 7)

Gjithashtu, edhe gjatë pirjes duhet thënë “Bismilah”, duke mos pirë me një frymë, por me tri ndalesa. Ndërsa në fund, duhet thënë “Elhamdu lilah”. Profeti ﷺ, ujin dhe pijet e tjera i pinte me tri ndalesa dhe në lidhje me këtë çështje, ka thënë:

*“Mos pini me një frymë si deveja. Pini duke marrë frymë dy ose tre herë. Kur të pini diçka, thoni Bismilah; pasi ta keni pirë, thoni Elhamdu lilah!”* (Tirmidhi, Eshribe, 13)

Gjithashtu, Profeti ﷺ, e ka ndaluar edhe fryrjen mbi atë që pihet për çfarëdo shkaku qoftë. Kur dikush e pyeti:

- Çfarë të bëj kur të shoh se në enën e ujit ka rënë diçka e papastër?- Profeti ﷺ, tha:

- *Derdhe atë që ka rënë!*

Këtë herë, njeriu tha:

- Kur pi ujë me një frymë, nuk më shuhet etja.

Ndërsa Profeti ﷺ, duke aluduar që të pinte me tri ndalesa, ia ktheu:

- *Atëherë, hiqe enën e ujit nga goja!* (Tirmidhi, Eshribe, 15)

Po ashtu, edhe ngrënia vetëm e ushqimit e largon begatinë e tij dhe për rrjedhojë, bëhet shkak shpërdorimi. Profeti ﷺ, i cili thotë: *“Uniteti është mëshirë, ndarja është dënim.”* (Munavi, III, 470)

, ka këshilluar që edhe gjatë ngrënies të jemi së bashku.

Sipas një transmetimi të Uahsh ibn Harb ؒ, disa sahabë thanë:



- O Rasulullah! Hamë ushqim, por nuk ngopemi.

I Dërguari i Allahut ﷺ, ua ktheu:

- *Me sa duket hani veç e veç!*

- Po, ashtu bëjmë!- thanë ata.

Atëherë i Dërguari i Allahut ﷺ, tha:

- *Hani së bashku, duke thënë Bismilah, që t'u begatohet ushqimi!* (Ebu Daud, Et'ime, 14)

Përsëri, në një hadith tjetër, Profeti ﷺ, thotë:

*“Kur dikujt prej jush t'i bjerë kafshata në tokë, le ta pastrojë pjesën e ndotur dhe ta hajë kafshatën! Të mos ia lërë atë shejtanit!”*. Pastaj, duke urdhëruar që pjata të fshihet mirë e mirë, vazhdon fjalën duke thënë: *“Nuk mund ta dini se në ç'pjesë të ushqimit ndodhet begatia.”* (Muslim, Eshribe, 136)

Në lidhje me ngrënien dhe pirjen në jetën e përditshme dhe veçanërisht nëpër dasma e gosti, bëhen shumë shpenzime e shpërdorime. Aq sa është e pamundur për një njeri të mbajë llogarinë e tyre. Nëse marrim si kriter vetëm shpërdorimin në konsumin e bukës në shoqërinë tonë dhe t'a krahasojmë me shpërdorimet e tjera të panumërta, shifrat që do të dalin, do të jenë shumë rrëqethëse.

Teprimet, si përgatitjet e gostive pompoze për mburrje, mendjemadhësi dhe shfaqje force, nxitja e grykësisë me ushqime të tipit “bufe e hapur” dhe veshja e rrobave të markave të shtrenjta për t'u krekosur, nuk ka dyshim se në botën tjetër do të kthehen në pendesë. Kjo, sepse e gjithë llogaria e këtyre do të na sillet përpara mbi peshoren hyjnore.

Dasmat dhe gostitë janë elemente të rëndësishme, të cilat forcojnë ndjenjat vëllazërore. Mirëpo për fat të keq, ceremonitë



që zhvillohen me kritere të përqendruara në “ego”, përveçse nuk mund t'i forcojnë ndjenjat vëllazërore ashtu siç dëshirohet, duke i nxitur njerëzit në ndjenja të këqija, si mburrja, mendjemadhësia, zilia dhe smira, ato përfundojnë me humbje të rënda. Shoqëri të tilla, janë larg mëshirës dhe begatisë hyjnore.

Me një fjalë, fundi i një jete egoiste të zhytur në shpërdorime është një humbje aq e madhe, sa Allahu Teala ka urdhëruar: **“Shpërdoruesit, me të vërtetë janë vëllzërit e djallit dhe djalli është mosmirënjohës ndaj Zotit të tij.”** (Isra, 27)

Po ashtu, edhe Profeti ﷺ, duke dëshiruar të na zgjojë nga shkujdesja, na përkujton se në botën tjetër do të japim llogari për të gjitha mirësitë dhe amanetet që na janë dhënë:

*“Në Ditën e Kiametit, asnjë rob nuk do të lëvizë nga vendi pa u pyetur se ku e ka shpenzuar jetën, çfarë ka punuar me diturinë e tij, si e ka fituar e si e ka shpenzuar pasurinë dhe ku e ka konsumuar trupin e tij.”* (Tirmidhi, Kijamet, 1)

Nisur nga kjo, nuk duhet të harrojmë kurrë se kalimi i kufijve në ngrënie dhe pirje, keqpërdorimi i mirësisë së shëndetit dhe çuarja dëm e jetës duke e kaluar kot, janë shpërdorime shumë të mëdha. Po ashtu, edhe mosruajtja e amaneteve materiale dhe shpirtërore që zotërojmë dhe orientimi i gabuar i mendimit dhe i ndjenjave tona, konsiderohen shpërdorim. Veçanërisht në fushën e edukimit, nëse nuk e edukojmë njeriun në kahun e duhur, me qëllim që ai të ndërtojë personalitetin e tij dhe të bëhet krijesa më fisnike, konsiderohet një nga shpërdorimet më të mëdha.

Padyshim se edukimi i fëmijëve nga ana e prindërve në atmosferën e Kuranit dhe Sunetit, është një detyrë shumë e domosdoshme, për të mos lejuar shkatërrimin e jetës shpirtërore të fëmijëve të tyre. Në të njëjtën kohë, kjo tregon edhe nivelin e lidhjes dhe dashurisë ndaj Kuranit dhe Profetit ﷺ, i cili ka thënë: *“Po ju lë dy amanete; Librin (Kuranin) dhe Sunetin...”*.





Trashëgimia më e çmuar që mund t'u lëmë fëmijëve tanë, është kultura e Kuranit dhe e Sunetit. Ne duhet të përpiqemi vazhdimisht që fëmijët tanë të përvetësojnë moralin profetik, që do të thotë, të digjen nga pasioni për Kuranin Kerim dhe nuk duhet ta shkatërrojmë ardhmërinë e tyre të përjetshme për shkak të shqetësimeve për ardhmërinë e përkohshme.

Nga kjo pikëpamje, nëse i duam fëmijët tanë, nëse duam t'i ruajmë nga çdo lloj fatkeqësie dhe, nëse dëshirojmë të jemi së bashku me ta në botën tjetër, është kusht të përpiqemi, me qëllim që ata të rriten dhe edukohen me besim. Këto përpjekje janë shkak për lumturinë në botën e amëshuar, në lidhje me të cilën Allahu Teala urdhëron:

**“Ne do t'i bashkojmë besimtarët e vërtetë me ata pasardhës të tyre, që i ndjekin në besim dhe nuk do t'u pakësojmë asgjë nga shpërblimi për veprat e tyre...”** (Tur, 21)

Besimtarët dhe pasardhësit e tyre me besim, të cilët kanë arritur ta gëzojnë këtë mirësi hyjnore (besimin), do jenë së bashku edhe në botën tjetër. Kjo është një mirësi që Allahu Teala ua ka dhënë që ata të jetojnë së bashku me fëmijët e tyre në Xhenet. Në këtë mënyrë, plotësohet edhe lumturia dhe gëzimi i prindërve. Ja pra, rruga për të arritur këtë mirësi hyjnore, kalon nga edukimi i brezave me besim në atmosferën e Kuranit dhe Sunetit. Për t'u ruajtur nga shpërdorimi kryesor, që është “shpërdorimi i njeriut”, duhet të kryejmë detyrat dhe përgjegjësitë tona ndaj fëmijëve tanë.

Nëse marrim për bazë të gjitha llojet e shpërdorimit që u përmendën këtu dhe analizojmë të gjitha fushat e jetës, shohim qartë se sa i gjerë është koncepti i “shpërdorimit”. Është fakt se shpërdorimi është përhapur pothuajse në çdo fushë të jetës, që nga urrejtja e dashuria e deri tek pompoziteti i ceremonive dhe



gostive të ndryshme. Këtu u munduam të ceknim disa kritere të domosdoshme për të gjetur rrugën e drejtë vetëm mbi disa çështje themelore. Mirëpo, nuk duhet të harrojmë që kriteret dhe logjikën të cilat u munduam të japim këtu, nuk duhet t'i kufizojmë vetëm në këto çështje, por jemi të detyruar t'i zbatojmë në të gjitha fushat dhe veprimtaritë e jetës, duke u ruajtur prej çdo lloj shpërdorimi e koprracie.

**Allahu Teala na ruajtë prej ekstremeve në çdo çështje dhe na ndihmoftë të bëjmë një jetë të devotshme, me të cilën Ai është i kënaqur! Gjithashtu, na e bëftë të mundur t'i përdorim me maturi dhe kujdes të gjitha mirësitë që na ka dhuruar dhe ta kryejmë ashtu siç duhet falënderimin ndaj tyre!**

**Amin!**





**NJË REPORTAZH NË LIDHJE ME ÇËSHTJET  
DELIKATE TË MYSLIMANIT NË FUSHËN E PUNËS...**

## **“KUFIJTË E HALLALLIT DHE HARAMIT NUK DUHET TË SHKELEN ME ASNJË PRETEKST”**



*Një pasuri kancerogjene e akumuluar nga favoret dhe ryshfetet, e cila është si një tullumbace që fryhet përnjëherësh në dorën e njeriut. Disa prej këtyre tullumbaceve do të plasin në këtë botë, e disa të tjera do të çahen në ditën e gjykimit. Rritja e dukshme e këtyre fitimeve, janë si një melodi e këndshme për njeriun. Mirëpo, ana shpirtërore e tij, është fund e krye humbje dhe dështim i përvetshëm.*





Një reportazh në lidhje me çështjet delikate të myslimanit në fushën e punës...

## “KUFIJTË E HALLALLIT DHE HARAMIT NUK DUHET TË SHKELEN ME ASNJË PRETEKST”

**- Sot po diskutohen tema si Islami, kapitalizmi dhe kapitalizimi i myslimanit. Çfarë mund të thuhet në lidhje me këto diskutime në plan të përgjithshëm?**

- Fusha ku kapitalizmi ka gjetur vend dhe ka lulëzuar, janë ato ambiente ku janë dobësuar ndjenjat e mjaftueshmërisë dhe mbështetjes në Allahun dhe ku në përgjithësi është shtuar lakmia, ambicia dhe fitimi i padrejtë. Nisur nga kjo, zemrat besimtare duhet ta edukojnë veten e tyre në lidhje me lakminë dhe ambicien, gjë e cila mund të realizohet vetëm duke qenë i kënaqur me çfarë zotëron dhe duke u mbështetur tek Allahu. Të jesh i kënaqur, është pasuria e vërtetë që i shpëton të gjithë nga robëria e lakmisë për pasuri. Për rrjedhojë, nëse një mysliman nuk e pastron egon dhe nuk e purifikon zemrën, do të shkatërrohet mes kurtheve të kapitalizmit që nuk njeh kufi tjetër përveç parasë.



Si në sistemin kapitalist, ashtu edhe në atë socialist, nuk ka vend për virtyte dhe aftësi shpirtërore. Njëri pretendon se pasuria është e individit, ndërsa tjetri, se është e shoqërisë. Por, tek të dy sistemet mbizotëron mentaliteti i interesit personal dhe i shfrytëzimit. Ndërsa individët konsiderohen si dhëmbëzat e një ingranazhi.

Në Islam, pasuria dhe sundimi i takon Allahut. Ndërsa interesi dhe shfrytëzimi nuk ekzistojnë. Ekonomia Islame fillon me zgjidhjen e problemit të njeriut. Ndarja (e pasurisë) dhe ndihma ndaj të tjerëve, e në veçanti ndaj nevojtarëve, është kusht dhe detyrim. Madje, Allahu i Madhëruar e ka shpallur këtë si një e drejtë e të varfërve:

**“Në pasuritë e tyre (njerëzve të devotshëm) ka pasur pjesë për lypësit dhe nevojtarët.”** (Dharijat, 19)

Ky parim, është edhe një edukim në lidhje me përdorimin e parasë, por edhe një faktor i solidarizimit të zemrave. Pra, në Islam, paraja nuk është burim lakmie, por një amanet që duhet të shpenzohet në vendin e vet. Nëse ky amanet përdoret në vendin e vet, shpenzohet aty ku duhet dhe tregohet kujdes në lidhje me të drejtën e nevojtarëve dhe skamnorëve, atëherë shndërrohet në një burim të madh adhurimi. Mirëpo, për të arritur diçka të tillë, është shumë e rëndësishme të bëhet kujdes se ku dhe si fitohet ajo para. Kjo, sepse çdo gjë që fitohet, ka mënyrën e vet dhe në bazë të asaj mënyre, merr formë edhe zemra e njeriut. Për rrjedhojë, edhe shpenzimet realizohen në atë formë. Nga kjo pikëpamje, është jashtëzakonisht e domosdoshme të bëhet kujdes në mënyrën e fitimit.

**- Çfarë lloj mënyrash fitimi preferojnë njerëzit?**

- Lidhur me këtë çështje mund të flitet për dy lloj fitimesh në kuptimin e përgjithshëm:



I pari është fitimi që arrihet brenda kritereve të fesë dhe ndërgjegjes. Këtu tregohet respekt ndaj kritereve hyjnore. Ka një moral tregtie, ku hallalli është një parim i pazëvendësueshëm. Ndërsa interesat egoiste dhe mashtrimi nuk ekzistojnë. Edhe pse në dukje ky fitim nuk ka rritje të madhe, përfitimet shpirtërore të tij janë vazhdimisht në rritje, sepse dhurimet dhe bamirësitë e kësaj pasurie janë të shumta. Kjo e çon individin drejt mëshirës dhe paqes shpirtërore. Njerëz të tillë janë të mëshirshëm dhe të butë ndaj të gjitha krijesave. Kjo mëshirë, është shkaku i vetëm që edhe ne mëshirohemi. i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

*“Mëshironi ata që janë në tokë, që t’ju mëshirojnë ata që janë në qiell!”* (Tirmidhi, Birr, 16.)

Prejardhja e parasë, ndikon në ndjenjat e njeriut. Një shprehje e urtë thotë: *“Paraja është si gjarpër, del prej asaj vrime nga është futur!”* Prandaj për të kuptuar se një pasuri është fituar në rrugë të drejtë, mjafton të shihet se ku shpenzohet ajo.

#### **- Po i dyti?**

I dyti është fitimi i arritur përreth një autoriteti apo force të caktuar. Në përgjithësi ky është një fitim i padrejtë. Një pasuri kancerogjene e akumuluar nga favoret dhe ryshfetet, e cila është si një tullumbace që fryhet përnjëherësh në dorën e njeriut. Disa prej këtyre tullumbaceve do të plasnin në këtë botë, e disa të tjera do të çahen në ditën e gjykimit. Rritja e dukshme e këtyre fitimeve, janë si një melodi e këndshme për njeriun. Mirëpo, ana shpirtërore e tij, është fund e krye humbje dhe dështim i përjetshëm. Për rrjedhojë, ky fitim nuk shpenzohet lehtë në dhurime dhe bamirësi. Mbase vetëm një pjesë e vogël e tij...

Për fat të keq, mënyra e dytë e fitimit është më joshëse për këdo, ndërsa sistemi kapitalist e nxit edhe më tepër këtë. Është për të ardhur keq se edhe shumë zemra besimtare janë kapluar nga kjo rrymë. Shumë prej tyre, më primare kanë hallin



dhe ambicien e fitimit. Mirëpo, primare duhet të jetë shqetësimi në lidhje me llogarinë që do të jepet në botën tjetër për fitimin e arritur. Kur zemra ngurtësohen prej lakmisë dhe bota tjetër harrohet, biri i njeriut mund të shndërrohet në një qenie grabitqare dhe të pamëshirshme që s'njeh të drejta. Domethënë, kapitalizmi i shtyn njerëzit nga lakmia, në egërsi. Dhe, për ta kuptuar më mirë këtë realitet, mjafton t'i hedhësh një sy atyre që ndodhin në botë. Cilat parime njerëzore i pranojnë abuzimet dhe mizoritë që bëhen sot për hir të parasë? Hidhet një bombë dhe shkatërrohet gjithçka pa bërë dallim, në janë fëmijë apo të rritur, të sëmurë apo të moshuar, bimë apo kafshë!.. S'ka as mëshirë dhe as dhembshuri! Cilën njerëzi do të ndërtojë paraja e përlayer me gjakun e të pafajshmëve dhe viktimave?

Kapitalizmi i pamëshirshëm, çdo ditë e më tepër e robëron njeriun vetëm pas parasë, duke e shndërruar paranë në një idhull.

**- Po Islami çfarë parimesh këshillon?**

- Ashtu si në çdo çështje, edhe në çështjen e pasurisë, Islami i ngarkon përgjegjësi njeriut para Allahut. Kjo, sepse Allahu çdo gjë ia ka dhënë njeriut si amanet. Në një ajet fisnik urdhërohet:

**“Pastaj, atë Ditë do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)!”** (Tekathur, 8.)

Domethënë se, pasuria duhet të fitohet brenda këtyre kritereve të llogarisë dhe përgjegjesisë. Asnjë hap i gabuar nuk mund të ketë një arsye apo qëllim të drejtë. Sidomos shkëlja e kritereve të haramit dhe hallallit duke thënë, “unë i fitoj që të bëj mirë më vonë”, është veprimi më i keq dhe një mashtrim e egos. Kjo, sepse Islami nuk e pranon aspak një botëkuptim i cili thotë, “fito dhe shpenzo si të duash!”. Po ashtu, Islami e refuzon kategorikisht edhe logjikën “lëreni të veprojë, lëreni të kalojë!”, e cila përbën themelin e kapitalizmit.







Në kohët tona, kur njeriu është i dhënë më tepër pas materiale, myslimani e ka të detyrueshme të ketë një strukturë morale më të fortë se në çdo kohë tjetër, të veprojë me frikën ndaj Allahut, të tregojë kujdes të jashtëzakonshëm ndaj të drejtave të robit dhe të jetë i vetëdijshëm për përgjegjësitë që ka.

Për shembull, përballë vështirësive dhe pengesave tregtare që përjetohen, ai nuk duhet të përzihet në sigurimin e financimeve të padrejta (si kamata). Ai duhet t'i kapërcejë këto lloj vështirësish me anë të institucioneve financiare. Çfarëdo që të ndodhë, ai nuk duhet të përzihet me kamatën, gjë e cila është një çështje shumë e rëndësishme në aspektin përgjegjësive dhe paqes sonë në të dyja botët.

Përveç kësaj, një pikë tjetër ku duhet të bëjmë kujdes për ta mbajtur të pastër edhe veten edhe pasurinë tonë në aspektin shpirtëror, është ruajtja nga ryshfetet që jepen në formën e bakshisheve nëpër tendera. Emri i tyre mund të ndryshojë, por qëllimi është i njëjtë. Emrat e ndryshëm e joshës që i vihen harameve, janë ngushëllime false që verbojnë ndërgjegjen tonë dhe shkëlqime të Xhehenemit.

Abdullah ibn Amr , ka thënë se i Dërguari i Allahut , e ka mallkuar edhe atë që merr, edhe atë që jep ryshfet.<sup>70</sup> Mirëpo, për fat të keq, sot pasuria helmohet në këto forma dhe të ngjashme me këto. Nëse myslimani nuk tregohet i ditur, vigjilent, i përpiktë dhe i kujdesshëm, nuk mund ta ruajë pasurinë e tij nga e keqja e këtyre helmeve.

**- Çfarë kujdesi, vigjilence dhe përpikërie mund të këshillohet?**

- Për këtë, është e domosdoshme që jetës sonë tregtare t'i

70. shih. Ebu Daud, Akdije, 4, hd. nr. 3580.



japim formë sipas kufijve të hallallit dhe haramit, jo sipas logjikës abuzive dhe egoiste të kapitalizmit. Po ashtu, ne duhet ta ruajmë veten edhe prej tregtisë së prirë drejt ekonomisë së shpërdorimit, sepse rritja e shpërdorimit, e komoditetit dhe luksit (të tepruar), e çon shoqërinë drejt shkatërrimit. Në këtë aspekt, edhe kartat e kredit që shtojnë shpenzimet, janë kurthe financiare dhe mjete shfrytëzuese. Nevojat nuk mund të jenë arsyetime për këtë, sepse rregullat Islame në rast nevoje janë të qarta: “Kardh-i Hasen/Borxh i mirë për hir të Allahut”. Ky lloj borxhi është një borxh i mirë që ndihmon të falimentuarit dhe u ofron atyre një recetë shpëtimi. Ndërsa kartat e kreditit janë borxhe që të zhysin edhe më tepër në borxh. Ky është një sistem prej të cilit nuk fiton ai që shpenzon, por vetëm ata që të shtyjnë të shpenzosh.

Kjo është një nxitje e tillë drejt shpenzimeve, sa edhe të varfrit i fusin me dëshirën e tyre në këtë kurth në mënyrë të pamëshirshme, vetëm e vetëm që dikush të përfitojë. Në sajë të reklamave joshëse, shumë njerëz të mjerë bëhen kurban të këtyre metodave jo legjitime (në Islam).

Për shembull, me një reklamë tepër tërheqëse, një vajze të varfër i thuhet: *“Ti do të jesh më e bukur me këto. Nëse bën kështu, do të jesh më tërheqëse dhe shoqëria do të pranojë më lehtë!”*. Kështu, në sajë të këtyre metodave joshëse, të cilat përsëriten në mënyrë të vazhdueshme, ata e përmbysin botën e saj. Si përfundim, kjo vajze e mjerë kaplohet prej dëshirës dhe lakmisë për një jetë që buxheti i saj nuk mund ta pranojë. Mirëpo, kur ajo nuk arrin ta plotësojë dëshirën e vet, lakmia i shtohet edhe më tepër dhe, në fund ajo shkatërrohet duke rënë në rrugë të këqija...

Nisur nga kjo, para së gjithash, në zemrat tona duhet të zërë vend si një thesar i madh *“mjaftueshmëria dhe pasuria e të*



*qenit i kënaqur*". Allahu i Madhëruar nuk na ka urdhëruar në asnjë vend, *"bëhuni sa më të pasur materialisht!"*. Por, Ai na ka urdhëruar, *"Fitoni prej hallallit, jetoni dhe dhuroni brenda kritereve të hallallit!.. Pra, mos i harroni nevojtarët!.."*.

Prandaj, ne duhet ta ndërtojmë jetën dhe tregtinë tonë brenda kornizës së hallallit.

**- Në këtë pikë, ka edhe njerëz që mund të gabojnë, edhe pse i zbatojnë urdhrat e Islamit.**

- Për fat të keq, në ditët tona, kapitalizmi e ka dëmtuar aq shumë botën tonë shpirtërore, sa edhe në bizneset Islame janë bërë të natyrshme disa punë që nuk përputhen me moralin dhe parimet Islame. Shumë njerëz që shkojnë në haxh dhe falin namaz, hedhin hapa të gabuar e të papranueshëm me mendimin se, *"duhet të fitojmë më shumë, që të bëjmë bamirësi më shumë!"*. Pra, aty përzihet hallalli me haramin. Për shembull, nga gabimet më të spikatura, janë reklamat që s'përputhen me moralin Islam dhe sekretaret që tërheqin klientë me mënyrat e tyre joshëse.

Për shkak se fitimi i kësaj bote qëndron para fitimit të botës tjetër, egoja përgatit arsyetime si, *"kështu e ka kjo punë!"*, duke mos u shqetësuar aspak për aspektin e ndaluar të kësaj çështjeje. Mirëpo për fat të keq, këto nuk janë fitime, por mina të falimentimit që do të plasën në botën tjetër.

Nga kjo pikëpamje, është e domosdoshme që çdo çështje në fushën e tregtisë të shqyrtohet në mënyrë të veçantë. Duhet bërë kujdes në çdo gjë, deri edhe tek personat që punojnë pranë nesh dhe, nuk duhet t'i shkelim parimet Islame për asnjë lloj arsyeje. Po ashtu, nuk duhet t'i bëjmë njerëzit të sillen në mënyrë të kundërt me natyrën e tyre të krijimit, duke punësuar gruan në një punë për burra dhe anasjelltas. Morali dhe rregullat Islame,



të cilat i përcaktojnë në mënyrën më të bukur kriteret në këtë çështje, duhet të jenë parimet e vetme për ne. Ne duhet të bëjmë kujdes ndaj jetës sonë fetare dhe të drejtës së robit nën dritën e paralajmërimeve hyjnore. Para se të ndërronte jetë, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

*“Kini kujdes namazin! Po ashtu kini frikë Allahun edhe për ata që janë nën urdhrat tuaja!..”* (Ebu Daud, Edeb, 123-124/5156; Ibn-i Maxhe, Uasaja, 1.)

Profeti ﷺ, i cili ka treguar një kujdes të jashtëzakonshëm ndaj të drejtave të të gjitha krijesave, edhe në momentin e vdekjes e ka mbajtur në rend të ditës hakun e robit dhe, megjithëse ishte i pafuqishëm, doli prej shtëpisë dhe shkoi në xhami ku iu drejtua sahabëve me këto fjalë:

*“O shokët mi! Nëse kam marrë padashje prej pasurisë së ndonjërit prej jush, ja ku është pasuria ime, le të vijë ta marrë!.. Nëse e kam goditur dikë në shpinë padrejtësisht, ja ku është shpina ime, të vijë të më godasë!..”* (shih. Ahmed, III, 400.)

Këto fjalë, që i mbytën në lot sahabët e nderuar, në të vërtetë, për ne janë fjalë shumë domethënëse që tregojnë rëndësinë e hakut të robit. Me anë të këtij hadithi fisnik, i Dërguari i Allahut ﷺ, i ka dhënë një shembull të gjallë ummetit të vet deri në ditën e kijametit. Tashmë, detyra jonë është ta peshojmë veten nën dritën e këtyre kriterëve, sepse padrejtësia ndaj robit, është një injorancë dhe dhunë që mbetet deri në kijamet dhe e shpie robin në humbje të përjetshme.

Sot, kapitalizmi nuk e njeh hakun e robit. I shtypuri shtypet edhe më tepër dhe çdo gjë shihet si e lejueshme. Ndërsa në Islam, janë haram edhe hapat që shkojnë drejt haramit.

Shkurtimisht, sot kemi nevojë për një kontroll të fort të ndërgjegjes. Një shkundje të fortë që do të na sjellë në vete!..



Sepse sot, paraja i vë vulën individit. Mirëpo, në fakt, individi duhet t'i vërë vulën parasë...

**- Si mund të arrihet kjo, ndërkohë që paraja është thelbi i kapitalizmit dhe gjithçka rrotullohet rreth saj?**

- Për të arritur këtë, nuk duhet të jemi robër të parasë, por mbizotërues të saj. E kjo, është e mundur vetëm duke iu bindur urdhrin të Gjykatësit të gjykatësve dhe duke qenë të kënaqur me atë që posedojmë, pa rënë në dembelizëm.

Hidhini një sy shoqërisë: Shumë prej tyre kanë arritur mundësi të mëdha në aspektin material, mirëpo ende nuk janë rehat. Madje, ka prej atyre që kalojnë në çmenduri. Në krahasim me të shkuarën, pasuria dhe standardi i jetesës është rritur mjaft. Mirëpo, bashkë me këtë janë shtuar edhe problemet psikologjike. Jeta familjare është hallakatur dhe divorcet janë shtuar. Fëmijët vuajnë shumë dhe për shkak të privimit nga ngrohtësia familjare, brezat e rinj e kërkojnë lumturinë në rrugë, duke mbetur në mëshirë të fatit. Pra, sistemi egoist kapitalist që nuk njeh haram dhe hallall, nuk arriti t'i sjellë paqen shoqërisë sonë.

Një nga mësuesit që na jepnin mësim në medrese, i ndjeri Nurettin Topçu, ndonjëherë na pyeste:

*“A ka qenë më i qetë dhe më i lumtur njeriu i djeshëm, apo njeriu i sotëm?”*

Më pas, na tregonte pikë për pikë se sa i lumtur dhe i qetë ka qenë njeriu i djeshëm dhe se sa i stresuar e i pamëshirshëm është njeriu i sotëm.

**- Pasuria duket si një sprovë shumë e vështirë!**

- Në bazë të kushteve, edhe pasuria, edhe varfëria janë sprova të vështira. Për nga aspekti i vështirësisë, asnjëra nuk ka qenë ndonjëherë më e lehtë se tjetra. Për rrjedhojë, duke u nisur nga



ato që kemi thënë më lartë, nuk duhet të dalim në përfundimin e gabuar se për të arritur paqen duhet të jesh i varfër. Domethënë, fakti që po flasim në lidhje me përgjegjësinë ndaj pasurisë dhe jetën nën dritën e kritereve hyjnore, nuk duhet të na çojë në mendimin e gabuar se “duhet preferuar varfëria”.

Duhet ditur se Islami nuk ia ndalon kurrë njeriut të jetë i pasur. Përkundrazi, në Kuranin Fisnik, urdhri, **“jepni, shpenzoni!”** përmendet në më shumë se dyqind vende, gjë e cila nënkupton se njerëzit duhet të jenë të pasur që të mund të shpenzojnë në rrugë të Allahut. Mirëpo, çështja për të cilën bëhet fjalë, është ruajtja nga sforcimi i kufijve të caktimit të Zotit dhe mos konsiderimi si legjitime i çdolloj mënyre për tu pasuruar. Pra, të fitosh prej hallallit brenda kritereve të caktuara nga Allahu i Madhëruar dhe të arrish virtytin e dhurimit në rrugë të Tij.

Ashtu si në të shkuarën, edhe sot ka nevojë për njerëz me pasuri hallall, të mëshirshëm dhe bujarë, të cilët do të jenë ndihmë dhe strehim për të varfrit dhe të vetmuarit.

Çështja është të mos e vrasësh paqen shpirtërore për hir të mirëqenies materiale... Të mos e shkatërrosh qetësinë e zemrës që del në pah brenda bukurive të Islamit... Të arrish të bëhesh një shpirt altruist... Të mos harrosh se pasuria e vërtetë dhe e pafundme është në jetën shpirtërore...

**- A mund të përmendet si shembull në këtë çështje dijetari i madh Islam, Ebu Hanife, i cili në të njëjtën kohë merrej edhe me tregti?**

- Sigurisht. Ebu Hanife është një prej figurave me të vërtetë shembullore, si në dije, ashtu edhe në vepra të mira. Sidomos morali i tij në jetën e tregtisë dhe sjelljet e tij të shembullore, janë të mbushura me veçori legjendare të personalitetit të tij Islam. Mund të themi se, në shoqërinë tonë ku janë dobësuar ndjenjat



vëllazërore, kanë humbur paqja dhe qetësia sociale dhe është shtuar urrejtja e armiqësia, ka nevojë për një fushatë serioze të moralit tregtar si shembulli i Ebu Hanifes. Një prej shembujve të shumtë, është edhe ky:


Ebu Hanife, ishte një njeri i pasur që i siguronte të ardhurat nga tregtia. Mirëpo, për shkak se merrej edhe me dituri, çështjet e tij tregtare i menaxhonte me anë të një përfaqësuesi. Ndërsa vet kontrollonte nëse tregtia e tij ishte brenda kuadrit të hallallit apo jo. Në këtë çështje, ai ishte aq i kujdesshëm, saqë njëherë, kur e dërgoi ortakun e tij Hafs ibn Abdurrahmanin të shiste stof, i tha:

*“O Hafs! Ky mall ka këto e këto cene. Prandaj shpjegojua këto klientëve dhe shite kaq më lirë!”*

Hafsi veproi siç i tha Ebu Hanifja dhe e shiti mallin me atë çmim. Mirëpo, ai kishte harruar t’ua shpjegonte klientëve cenet e mallit që shiti. Kur Ebu Hanifja e mësoi këtë, e pyeti Hafs ibn Abdurrahmanin:

*“A i njuh klientët që blenë mallin?”*

Kur Hafsi i tha se nuk i njuh, nga frika se mos fitimet e tij hallall përlyheshin (me haram), Ebu Hanifja e ndau si sadaka të gjithë fitimin që kishte marrë prej mallit që u shit. Ja pra, pikërisht për shkak të kësaj devotshmërie, tregtia e tij materiale dhe shpirtërore u begatua edhe më tepër.

Për të kuptuar nëse dikush ka zemër të pastër, është i sinqertë dhe në rrugë të drejtë, më tepër se adhurimet që bëjnë, ne duhet të shohim se me çfarë niveli dhe gjendje shpirtërore i kryen ato adhurime. Pra, në mënyrë të veçantë duhen parë sjelljet e tij, nëse janë apo jo në përputhje me moralin Islam dhe a e fiton jetën në rrugë hallall. Nisur nga kjo, kur Omeri , dëgjoji dikë që lavdëronte dikë tjetër, ai e pyeti në lidhje me këto tre gjëra:



“A ke qenë fqinj i tij, a ke udhëtuar me të dhe a ke bërë tregti më të?”

Kur personi tha se nuk kishte bërë asnjë prej tyre, Omeri رضي الله عنه, tha:

“Atëherë mos e laudëroni, sepse ju nuk e njihni atë siç duhet!”

Për këtë arsye edhe Sufjan-i Theuri -Allahu e mëshiroftë- ka thënë:

“Devotshmëria e një njeriu, është aq sa e ka hallall edhe bukën!”

Njëherë i thanë:

“I nderuar! A mund të na tregoni diçka për vlerën e faljes së namazit në saf të parë?” Mirëpo, edhe këtu Sufjan-i Theuri tërhoqi vëmendjen tek kafshata hallall dhe tha:

“O vëlla! Ti shiko se ku e fiton bukën! Nëse fitimet i ke hallall, fale namazin në cilin saf të duash, sepse kjo nuk është ndonjë problem për ty.”

Babai im i ndjerë Musa Efendi, rëndësinë dhe begatinë e fitimit hallall në tregti dhe të mos përzjerjes së tij me haram, e shpjegonte me këtë ndodhi:

“Kishim një komshi i cili në fillim ishte jomysliman, por më vonë pranoi Islamit. Një ditë, kur e pyeta se si ishte udhëzuar, ai më tha:

«U bëra mysliman në sajë të moralit të bukur tregtar të Molla Rebi-ut, të cilin e kisha fqinj të arës në Axhibadem. Molla Rebiu ishte një person që e siguronte jetesën duke shitur qumësht. Një mbrëmje erdhi tek ne dhe na tha:

“Urdhëroni, ky qumështi është juaji!”





Unë u habita:

*“Si ka mundësi? Unë nuk kam kërkuar qumësht nga ju!”*

Ai njeri i ndjeshëm dhe i mirësjellshëm më tha:

*“Unë vura re se njëra nga bagëtitë e mia kishte hyrë në kopshtin tuaj dhe po kulloste pa dijeninë time. Prandaj ky qumësht është juaji! Por jo vetëm kaq. Unë do të vazhdoj t’jua sjell qumështin e bagëtisë gjersa bari që ka ngrënë te ju t’i dalë plotësisht jashtë trupit!..”*

Unë ia prita:

*“Ç’është ajo fjalë komshi? E çfarë hëngri? Bar! I qoftë hallall!..”*

Por, Molla Rebiu s’u bind! Ai nguli këmbë në të vetën dhe tha:

*“Jo, jo, gjë që s’bëhet! Qumështi i saj është haku juaj!..”*  
Dhe vazhdoi të na sjellë qumësht derisa kafshës i mbaroi cikli i tretjes së ushqimit.

Ja pra, sjellja e atij njeriu të bekuar më preku jashtë mase. Si rezultat, kjo m’i largoi perdet e padijes dhe indiferencës mbi sytë e mi dhe brenda meje lindi dielli i udhëzimit!

Thashë me vete:

*“Feja e një njeriu me një moral kaq të lartë, pa dyshim që është një fe e lartë! Nuk mund të dyshohet mbi vërtetësinë e një feje që edukon njerëz të tillë kaq delikatë, të drejtë, të përkryer e të pastër!”*

Më pas shqiptova Dëshminë Islame dhe u bëra mysliman!»”

**- Këto duken si sjellje të paarritshme në një dynja që sillet rrotull rreth parasë. Mirëpo ka edhe shumë shembuj të bukur dhe realë. Si përfundim dëshirojmë një përgjigje nga shkëlqesia juaj, se “çfarë duhet të bëhet?”.**



- Këto tregime të mbushura me urtësi, vënë në pah në mënyrë shumë të qartë faktin se sa të përpiktë dhe të kujdesshëm duhet të tregohemi në çështjen e fitimit hallall. Kjo, sepse fitimi hallall është një prej parimeve themelore të devotshmërisë. Lidhur me këtë, në një hadith fisnik thuhet:

*“Tregtari fjaldrejtë, i ndershëm dhe i besueshëm, (në ahiret) do të jetë bashkë me profetët, besnikët dhe dëshmorët.”*

(Tirmidhi, Buju, 4.)

Një tregtar me zemër të ndjeshme që fiton cilësinë e të qenit bashkë me profetët, besnikët dhe dëshmorët, bëhet shkak i paqes dhe begatisë përreth vetes dhe do të gëzojë lumturinë e të dyja botëve. Mirëpo, ata që bien pre e lakmisë ndaj pasurisë së kësaj bote, edhe nëse në këtë botë duken sikur po jetojnë në luks, ata nuk do ta shpëtojnë dot veten nga mjerimi dhe varfëria në botën e përjetshme.

Profeti ﷺ, nuk i quan pjesëtarë të bashkësisë së vet ata që lakmojnë dhe mashtrojnë në tregti. Lidhur me këtë, në një hadith thuhet:

Një ditë, i Dërguari i Allahut ﷺ, shkoi tek një shitës në pazar. Kur zhyti dorën në thesin e grurit, ndjeu se ai ishte i lagur. Prandaj ai e pyeti shitësin:

*“Ç’është kjo?”*

*“E ka lagur shiu, o i Dërguar i Allahut!”* -tha shitësi.

Më pas, Profeti ﷺ, tha:

*“A nuk kishe mundësi ta vendosje sipër pjesën e lagur të grurit që ta shihnin njerëzit? Mashtruesit nuk janë prej meje...”* (Muslim, Iman, 164.)

Njëherë tjetër, i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:



*“Çdo popull ka fitnen e vet. Fitnja e popullit tim është malli/pasuria.”* (Ahmed ibn Hanbel, IV, 160.)

Po ashtu, Profeti ﷺ, ka thënë:

*“Do të vijë një kohë e tillë kur njeriu nuk do të shqetësohet se si e fiton pasurinë, me hallall apo me haram.”* (Buhari, Buju, 7, 23.)

*“Për ju kam frikë se pas meje do t’ju hapen mirësitë dhe stolitë e kësaj bote, e ju do t’ia jepni zemrën atyre!”* (Buhari, Zekat, 47, Xhihad, 37; Muslim, Zekat, 121-123.)

Njëherë, i Dërguari i Allahut ﷺ, duke iu drejtuar sahabëve tha:

*“...Betohem në Allahun se, unë nuk kam frikë nga varfëria për ju. Unë kam frikë se bota do t’ju shtrohet para, ashtu siç u është shtruar atyre përpara jush, e ju do të garoni ashtu siç garuan ata për këtë botë dhe, bota do t’ju shkatërrojë ashtu siç i ka shkatërruar ata.”* (Buhari, Rikak, 7, Xhizje, 1; Muslim, Zuhd, 6.)

Ky hadith fisnik, përmbledh plotësisht të gjitha çështjet e kohës sonë. Shkurtimisht, në ditët tona, problemet për të cilat bëhet fjalë në hadithet fisnike, janë shfaqur së tepërmi dhe, edhe nëse zemrat përpiqen të braktisin haramet, ato nuk i lëshojnë zemrat. Për rrjedhojë, të tregosh kujdes ndaj hallallit në një kohë të tillë, është një nga çështjet më të rëndësishme dhe adhurimet më të mëdha.

Sot, myslimani duhet ta ruaj veten nga çdo e keqe e kapitalizmit. Ai duhet të ruhet nga kthimi i parasë në një lakmi dhe ambicie dhe, në çfarëdo situatë të jetë, ai duhet të zotërojë cilësitë si, frika ndaj Allahut, kërkimi i kënaqësisë së Tij, mëshirë ndaj shoqërisë, moralin Islam, respektin ndaj të drejtave të njeriut, mos shkeljen e kufijve të haramit dhe hallallit me asnjë lloj preteksti



dhe shumë cilësi të tjera që duhet të gjenden tek një besimtar i sinqertë...

Në kushtet e ditëve tona, është e domosdoshme të kujtojmë se, dhembshuria ndaj të dobëtëve, të varfërve, të vetmuarve dhe atyre që jetojnë në vuajtje, duhet të jetë ndjesi e zemrës së çdo njeriu të ndërgjegjshëm dhe të mëshirshëm.

Mirëpo, mjeranët e vërtetë për të cilët duhet ndërjer dhembshuri, janë ndërgjegjet e zullumqarëve, shpirtrat e atyre që jetojnë në luks, ndërkohë që janë robër të egos dhe zemrat e pista të të pasurve që grabisin në këtë sistem kapitalist, i cili është një regjim abuziv. Këta mjeranë të vërtetë, kanë më tepër nevojë për mëshirë. Kjo dhembshuri e mëshirë, bëhet në emër të shpëtimit të tyre nga gjendja e keqe ku kanë rënë dhe të udhëzimit në rrugën e drejtë. i Dërguari i Allahut ﷺ, ka thënë:

*“O Allah! Strehohem tek Ti nga dituria padobi, nga zemra që s’rrëqethet, nga egoja e pangopur dhe nga lutja që s’pranohet!”* (Muslim, Dhikr, 73.)

*“Nxitoni në punë të mira pa ardhur varfëria, e cila të bën të harrosh dhe pasuria që të harbon!..”* (shih. Tirmidhi, zuhd, 3/2306.)

Siç shprehet edhe në hadithin e fundi, varfëria që të bën të harrosh dhe pasuria që të harbon janë konsideruar të barabarta.

**Allahu i madhëruar na e bëftë të gjithëve të mundur të jetojmë mes mirësive hyjnore dhe të ruhemi prej çdolloj harami dhe të dyshimte!**

**Amin!..**



# PËRMBAJTJA

PARATHËNIE.....	5
NJË MËSHIRË E TILLË.....	11
Dashuria e zjarrtë e Profetit për umetin e Tij.....	13
Modestia e të Dërguarit të Allahut ﷺ.....	16
Bujaria e të Dërguarit të Allahut ﷺ.....	16
PARIMET E MORALIT TË LARTË - 1.....	27
PARIMET E MORALIT TË LARTË - 2.....	43
PARIMET E MORALIT TË LARTË - 3.....	55
DASHURIA NDAJ EHLI BEJTIT.....	73
Dashuria dhe Miqësia.....	73
Ehli Bejti.....	74
Selmani është prej nesh.....	76
Edukimi i Ehli Bejtit.....	79
EBU BEKRI ﷺ.....	87
Hulefa-i Rashidin.....	88
Ebu Bekri ﷺ.....	89
Ebu Bekri është prej meje dhe unë jam prej tij.....	90
Miku më i ngushtë i fshehtësive profetike.....	91
Një kala e palëkundshme besimi.....	94
Modestia.....	95



Model në maturi dhe pjekuri.....	96
Fjalë të urta nga Ebu Bekri ﷺ.....	97
<b>OMERI</b> ﷺ.....	105
Thjeshtësia.....	107
Dashuria e Tij ndaj të Dërguarit të Allahut ﷺ.....	109
Omeru'l Faruk ﷺ.....	110
Puna është pasqyra e njeriut... ..	111
Një jetë e lartësuar me Kuran.....	113
Fjalë të urta nga Omeri ﷺ.....	114
<b>OSMANI</b> ﷺ.....	123
Zotëruesi i dy dritave.....	123
Simboli i njeriut të turpshëm.....	124
Aty ku nuk pranohet i Dërguari i Allahut, nuk vij as unë!.....	127
Dielli i bujarisë.....	128
I dashuruar pas Kuranit.....	131
Zuhdi dhe Modestia .....	132
Dëshmori i pafajshëm .....	133
Fjalë të urta nga Osmani ﷺ.....	134
<b>ALIU</b> ﷺ.....	139
Mbreti i Bujarisë.....	140
Luani triumfues i Allahut .....	144
Prej Qabes në Mesxhidin e Kufes... ..	146
Disa fjalë të urta nga Aliu.....	149
<b>SHOQËRIA DHE UDHËHEQËSIT</b> .....	157
<b>E DREJTA DHE DREJTËSIA - 1</b> .....	173
Virtyti i faljes në drejtësi... ..	176
Drejtësia fitohet me meritë!.....	180



E DREJTA DHE DREJTËSIA -2-	189
E kundërta e drejtësisë, është padrejtësia...	190
Shembulli më i bukur në drejtësi	192
Edhe vajza ime Fatimja qoftë...	193
Mbajtja dhe ngritja e së drejtës	195
Mashtrimi i drejtësisë: Një pjesë prej Xhehenemit	196
Drejtësi ndërmjet fëmijëve	197
Përhapja e drejtësisë me përpikëri	198
Qëndrimi përballë dhunës dhe padrejtësisë	202
PËRGJEGJËSIA	207
Mos e hidhni veten në rrezik!..	215
Mos i beso punës tënde!..	218
VETËDIJA NDAJ AMANETIT	223
MEDITIMI	235
Meditimi trupor dhe shpirtëror	235
Zhvillimi shpirtëror	236
Meditimi i të Dërguarit të Allahut ﷺ	239
Thellësia e meditim të një sahabiu të verbër	241
Leximi me meditim i jetës dhe gjithësisë	242
Tasavufi: Mënyra për t'u thelluar me urtësi	244
Meditimi i vdekjes	244
VEZULLIME URTËSIE	
NGA ATMOSFERA SHPIRTËRORE E RUMIUT	249
Edukata në durim dhe tolerancë	253
Kërkoni shkaqe për t'u afruar tek Allahu!	255
Pastrimi i egos	257
Lakmia: Kanceri i zemrës	259
Dhurimi: Shërimi i zemrës dhe lumturia e të dyja botëve	261



<b>RAMAZANI I BEKUAR</b>	
<b>EDUKIMI I NJË JETE SHPIRTËRORE.....</b>	<b>265</b>
Kurani dhe Ramazani.....	266
Mundësia e Ramazanit në dhuntinë e jetës.....	268
Kapu pas agjërimit.....	269
Sinqeriteti dhe devotshmëria.....	273
Nata e Kadrit.....	276
Bajrami.....	277
<b>SHPËRDORIMI NË BESIM DHE IBADET.....</b>	<b>283</b>
b. Shpërdorimi në ibadet.....	288
<b>SHPËRDORIMI I KOHËS.....</b>	<b>297</b>
<b>SHPËRDORIMI NË DITURI.....</b>	<b>311</b>
<b>SHPËRDORIMI NË VLERAT MORALE.....</b>	<b>325</b>
<b>SHPËRDORIMI NË MEDITIM.....</b>	<b>341</b>
<b>SHPËRDORIMI NË SIGURIMIN E JETESËS DHE DHURIM.....</b>	<b>359</b>
<b>SHPËRDORIMI NË SHËNDETDHE USHQIME.....</b>	<b>373</b>
<b>NJË REPORTAZH NË LIDHJE ME ÇËSHTJET DELIKATE TË MYSLIMANIT NË FUSHËN E PUNËS.....</b>	<b>389</b>
<b>“KUFIJTË E HALLALLIT DHE HARAMIT NUK DUHET TË SHKELEN ME ASNJË PRETEKST”.....</b>	<b>389</b>

